

TITULLI I DISERTACIONIT

**HARMONIZIMI I SHPREHIVE BAZË JETËSORE QË OFRON
SHKOLLA PËR FËMIJËT E KOMUNITETIT ROM, ME NEVOJAT E
TYRE - SFIDË E SISTEMIT ARSIMOR SHQIPTAR**

DHURATA TURKU

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Shkenca Sociale
me profil Psikologji-Pedagogji, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Edmond DRAGOTI

Numri i fjalëve: 59.984

Tiranë, dhjetor 2016

DEKLARATË E AUTORËSISË

Me përgjegjësinë time të plotë deklaroj se ky punim është shkruar prej meje dhe nuk është paraqitur asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim. Punimi nuk përmban materiale të shkruara nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe referuara.

ABSTRAKT

Studimi “Harmonizimi i shprehive bazë jetësore që ofron shkolla për fëmijët e komunitetit rom, me nevojat e tyre - sfidë e sistemit arsimor shqiptar”, vë theksin në rëndësinë e arsimimit cilësor të fëmijëve romë. Deri tani problemi i arsimimit të romëve është fokusuar tek mosbraktisja e shkollës apo mësimi i shkrimit dhe këndimit. Mosbraktisja e shkollës, apopjesëmarrja sa më e lartë në shkollë, nuk është gjithmonë garanci për nxënës të suksesshëm. Kujdes i veçantë duhet t’i kushtohet edukimit cilësor të fëmijëve në shkollat tona dhe zhvillimit të tyre të përgjithshëm. Për këtë arsye reformat në edukim dhe politikat e edukimit duhet të drejtohen drejt këtij vizioni. Ky studim ka si qëllim eksplorimin e situatës reale arsimore të fëmijëve të komunitetit rom, për të evidentuar se çfarë u ofron atyre shkolla shqiptare dhe a synon ajo drejt edukimit gjithpërfshirës, gjithmonë në funksion të formimit të individit, nevojave, normave dhe vlerave të tij, cilësive të personalitetit dhe mbi të gjitha të aftësimit të tij, me shprehi praktike themelore bazë, për një jetë dinjitoze në shoqëri. Studimi synon të identifikojë sfidat dhe vështirësitë, që hasin fëmijët e komunitetit rom gjatë procesit mësimor në komunitetin shkollor. Në fokus të tij janë qëndrimet dhe opinionet e prindërve, mësuesve, nxënësve romë, lidhur me procesin e integritetit dhe gjithpërfshirjes në shkollë. Panorama është plotësuar edhe me mendimet e përfaqësuesve të institucioneve, për zbatimin e strategjive dhe politikave në dobi të integritetit të komunitetit rom në shoqëri. Për arsimimin sa më cilësor të fëmijëve romë, studimi e sheh zgjidhjen në rolin e politikave arsimore dhe sociale të ndjekura në vendin tonë dhe sidomos shkollës së harmonizimit të tyre. Përgjatë studimit parashtrohen arsyet se përse është i domosdoshëm ky harmonizim dhe cilat janë anët e forta dhe të dobëta të tij. Metoda e përzgjedhur për të mbledhur të dhënat është metoda cilësore. Të dhënat primare të studimit u mblodhën nga intervista gjysëm të strukturuar. Nisur nga përfundimet të cilat ofrojnë një

panoramë të detajuar të vështirësive dhe pengesave që hasin fëmijët romë, për edukim cilësor në përshtatje me dëshirat dhe nevojat që ata kanë, janë dhënë dhe rekomandimet përkatëse.

Fjalë kyçe: komunitet rom, shprehi jetësore, arsimim gjithëpërfshirës, dëshira, kapacitete, nevoja, integrim, politika arsimore, politika sociale, harmonizim

ABSTRACT

The study "Harmonization of basic life skills that school offers for Roma children with their needs, challenge the Albanian education system", emphasizes the importance of quality education of Roma children. Up to now the problem of Roma education has been focused on not dropping out of school or the teaching of literacy. But staying in school or a higher participation in it is not always a guarantee for successful students. Special attention should be paid to quality education of children in our schools and their overall development. Today it is very important that education is understood in its entirety. Therefore reforms in education and education policies should be directed towards this vision and Roma education should not be excluded from it. From this perspective, this study aims at exploring the real situation of the education of Roma children, to identify what Albanian schools offer them and if it is aiming toward inclusive education, including the formation of the individual, needs, norms and its values, personality qualities and above all his training with basic practical skills, for a dignified life in society. Education should be a function of needs, desires and capacities of the individual, in our case the Roma. Roma desires, needs and capabilities, which until now have been seen as three elements never intertwined with one another. Interventions to harmonize them have been fragmented and separated, which is evidenced in the lack of basic life skills that characterizes this community. The study aims to identify the challenges and difficulties Roma children face in the educational process in the school community. Its focus is on the attitudes and opinions of parents, teachers and Roma community regarding the process of integration and inclusion in school. This is also supplemented with opinions of representatives of institutions for the implementation of strategies and policies in favor of integration of Roma in society. For more qualitative education of Roma children, the study finds the solution in the role of education and social policy pursued in our country and especially the degree of harmonization. This report set out the reasons why such harmonization is necessary and what are their strengths and weaknesses. The selected method to collect data is qualitative method. The primary data was collected from semi-structured interviewees. Given the conclusions which provide a detailed overview of the difficulties and obstacles faced by Roma children to access quality education in accordance with their wishes and needs, recommendations to overcome these difficulties have been presented.

Key words: Roma minority, inclusive education, wishes, capacity, needs, integration, education policies, social policies, harmonization.

MIRËNJOHJE

Ky studim u bë i mundur me ndihmën e shumë personave, të cilëve dëshiroj t'u shpreh mirënjohjen. Si fillim falënderoj udhëheqësin shkencor të këtij punimi Prof. Dr. Edmond Dragotin, i cili me mbështetjen e tij, më inkurajoi dhe ndihmoi ta realizoj me sukses këtë kërkim. U jam mirënjohëse gjithashtu edhe të gjithë mësuesve, drejtorëve të shkollave, prindërve dhe nxënësve romë të shkollave 9-vjeçare të të Elbasanit, Korçës, Fierit dhe Beratit, si dhe specialistëve të institucioneve të ndryshme, të cilët u treguan të disponueshëm duke mos e kursyer përvojën, opinionet dhe rekomandimet e tyre lidhur me fushën e kërkimit.

LISTA E SHKURTIMEVE

SHQK - Shkolla Qendër Komunitare

KMD - Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

OJF - Organizatë jofitimprurëse

OKB - Organizata e Kombeve të Bashkuara

UNICEF - Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë

ZHNJ - Zhvillimi Njerëzor.

DAR - Drejtori Arsimore Rajonale

DPR - Dekada e Përfshirjes së Romëve

PNUD - Programi për zhvillim i Kombeve të Bashkuara

UNESCO - Organizata për Edukim, Shkencë dhe Kulturë e Kombeve të Bashkuara

PSHRSH - Prekshmeria shoqërore e romëve në Shqipëri”(2006)

SAPU - Sistemi arsimor parauniversitar

MASH - Ministria e Arsimit dhe Shkencës

MSA - Marrëveshja e Stabilizim Asociimit

KKAPSH - Korniza kurikulare e arsimit parauniversitar të Shqipërisë

KiE - Këshilli i Europës

IPA - Instrumente të ndihmës financiare para aderimit

PËRKUFIZIMI I TERMAVE

Diskriminim: Zhverësim i një grupi të huaj, në veçanti i një minoriteti shoqëror, brenda një shoqërie të ngritur mbi parimet e barazisë, ndalimit të dallimeve racore, fetare dhe politike. (<http://diskriminimi.org/default#!singlearticle-view/20151205-001>, parë më 07.03.2016)

Edukim gjithpërfshirës: Gjithpërfshirja është ngushtësisht e lidhur me konceptin e qytetarisë dhe synon t'u japë fund dallimeve në akses dhe status mes qytetarëve dhe përcaktimeve të qytetarëve në “të dorës së parë dhe të dytë” dhe në “të aftë e të paaftë”. Gjithpërfshirja është proces, dinamikë, lëvizje, përpjekje, bashkëpunim, sfidë, provë, integrim, pranim, barazi, e drejtë, përgjegjësi, mundësi, nevojë, ndryshueshmëri, gjallëri, risi, shumëllojshmëri, ndërhyrje, akses, ndërthurje, rëndësi, aftësi, fokus, ndikim, kulturë, qytetari, ëndërr, mësimdhënie, nxënie, deinstitutionalizim, liri, identitet, pavarësi, përfshirje...Gjithpërfshirja bazohet në parimet e edukimit pa paragjykime e përjashtime sociale. E vetmja gjë që ajo përjashton, janë paragjykimet. Shkencërisht ato njihen nga psikologjia sociale si forma regressive e mekanizma mbrojtëse, që plotësojnë apo zëvendësojnë mosnjohjen e paditurinë me mite e koncepte të gabuara, që nuk reflektojnë të vërtetën, faktet e studimet shkencore. (Kulla et al, 2014, 20, vv)

Shprehi sociale: nevoja për të ndërvepruar me të tjerët dhe përballimi i situatave të reja në mënyrë efektive.

Shkathtësi ose shprehi jetësore: Termi shprehi jetësore i referohet një grupi të madh shkathtësish(shprehish) psiko-sociale, qëllimi i të cilave është të kontribuojnë për zhvillimin personal, emocional dhe social të fëmijëve, si dhe të sigurojnë mirëqenie fizike, mendore dhe sociale për ta. (Petroska V, 2009, fq. 7).

Edukim – në përgjithësi fjala edukim nënkupton një formë të të mësuarit sipas të cilës njohuritë, aftësitë dhe zakonet e një grupi njerëzish transferohen nga një gjeneratë në tjetrën përmes të mësuarit, trajnimit ose kërkimit. Edukimi më shpesh ndodh nën udhëheqjen e të tjerëve, por mund të jetë edhe autodidaktik. Çdo eksperiencë që ka një efekt formues në mënyrën se si një individ mendon, ndien ose vepron, mund të konsiderohet edukative. Edukimi zakonisht ndahet

me faza të tilla, si: parashkollor, shkolla fillore, shkolla 9-vjeçare, shkolla e mesme, shkolla e lartë. Kjo ndarje është aktualisht pjesë e sistemit arsimor në vendin tonë.

Shkollë: Sipas ligjit të azhornuar Nr.7952, date 21.6.1995, “Për sistemin arsimor parauniversitar”, Neni 17,18, ndryshuar me ligjin Nr.8387, 1998 me shkollë kuptohet sistemi arsimor publik në Republikën e Shqipërisë, që përbëhet nga rrjeti i institucioneve arsimore, që realizojnë tërësinë e planeve dhe programeve mësimore në nivele të ndryshme shkollore e parashkollore. Kërkesat e programeve për institucionet shkollore dhe parashkollore përcaktohen nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës. Ndërsa ligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji projektstrategjia e arsimit parauniversitar për vitet 2013-2020, si dhe dokumente të tjerë, mbështesin një qasje të re, që është koncepti i shkollës qendër komunitare. Qasja e shkollës qendër komunitare është një dimension i rëndësishëm i reformimit të arsimit dhe përmirësimit të cilësisë së tij. Ajo krijon mundësinë e vlerësimit të punës së shkollës në lidhje me bashkëpunimin shkollë-familje-komunitet dhe mbi këtë bazë, hartimin e strategjive që mbështesin ngritjen e një modeli të shkollës komunitare, përmes bashkëpunimit me të gjithë aktorët. SHQK synon zhvillimin cilësor të shkollës dhe aftësimin e fëmijëve dhe të rinjve si qytetarë të gatshëm dhe të aftë për të kontribuar në komunitetet e tyre. SHQK konsiderohen ato institucione arsimore, të cilat i shërbejnë jo vetëm komunitetit shkollor (nxënës dhe mësues) por janë të hapura dhe në shërbim të të gjithë anëtarëve të komunitetit. SHQK janë institucione të cilat ngrenë dhe zhvillojnë punën e tyre bazuar në nevojat e nxënësve, të familjeve dhe komunitetit.(Markja, A et al, 2014, fq 6-7, vv)

Komunitet rom: Në përgjithësi me fjalën komunitet kuptojmë ndërthurjen e tre elementeve kryesorë: a) vendin ose territorin gjeografik; b) rrjetet shoqërore ose institucionet që ndërveprojnë rregullisht me banorët; c) ndërveprimin shoqëror për probleme me interes të përbashkët. Koncepti komunitet në nevojë është rrjedhojë e ndërthurjes së disa karakteristikave të disa nëngrupeve ose kategorive të veçanta të komunitetit të përjashtuara nga ana shoqërore. Faktorët nxitës të përjashtimit shoqëror lidhen me institucionet, proceset, normat dhe qëndrimet e shoqërisë duke ndikuar mbi një sërë problemesh të ndërlikuara dhe të përcaktuara nga shkaqe strukturore. Komuniteti në nevojë është i ekspozuar ndaj formave të ndryshme të mohimit, të abuzimit ose të shkeljes së të drejtave të tij, gjë që shkakton gjendje të rëndë social-ekonomike të

banorëve të tij, nivel të ulët arsimor, përjashtim shoqëror dhe diskriminim. Një komunitet i tillë është edhe komuniteti rom. (Terre des homes, 2012, fq 11, vv)

Arsim bazë: Arsimi bazë i detyruar synon të zhvillojë aftësitë intelektuale, krijuese, praktike dhe fizike të nxënësve, të zhvillojë personalitetin e tyre dhe t'i pajisë ata me elementët themelore të kulturës së përgjithshme dhe edukatës qytetare. (<http://www.arsimi.gov.al/al/arsimi/shkolla>, parë më 15.03.2015)

Politika sociale: Politikat sociale mbulojnë të gjitha dispozitat dhe masat, që synojnë të parandalojnë, të mënjanojnë ose të lehtësojnë situatat e varfërisë dhe problemet sociale, në nivel individual ose kolektiv, ose që kërkojnë të favorizojnë mirëqënien e grupeve më të brishta të shoqërisë. Në kuptimin e ngushtë, politikat sociale përcaktojnë masat, që shërbejnë drejtpërdrejt në luftën kundër varfërisë ose parandalimit të saj, në rradhë të parë sigurimet shoqërore dhe ndihma shoqërore, si dhe pagesa të tjera në varësi të burimeve të mundëshme. Në kuptimin e gjërë, fusha të tjera përfshihen gjithashtu në politikën sociale, të tilla si politika e tregut të punës dhe e punësimit, politika e arsimimit, e shëndetit, e strehimit, ose edhe e politika fiskale. (<http://shtetiweb.org/politikat-sociale-2>, parë më 21.03.2015)

E drejta për arsim: E drejta për arsim është një e drejtë kushtetuese. Në vendin tonë shteti ofron falas arsimin e detyruar duke krijuar lehtësi për këtë shërbim, në të gjithë vendin.

Dekada e Përfshirjes së Romëve 2010 – 2015,(2011) - është një dokument i Qeverisë Shqiptare i cili synon integrimin e minoritetit Rom në Shqipëri, në jetën social-ekonomike të vendit si dhe një shprehje e vullnetit të Qeverisë, në adresimin e nevojave komplekse të këtij minoriteti.

LISTA E TABELAVE:

Tabela 1- Lista e shprehive apo shkathtësive jetësore më të rëndësishme

Tabela 2 - Intervista gjysmë të strukturuar zhvilluar me aktorë të ndryshëm.

Tabela 3 -Fokus grupe organizuar me prindër romë

Tabela 4 -Të dhëna për moshën, arsimimin, profesionin, fëmijët të prindërve romë (nëna + baballarë)

Tabela 5 - Fokus grup organizuar me përfaqësues të OJF dhe përfaqësues të komunitetit rom në këshillat bashkiakë

Tabela 6 - Fokus grup organizuar me studentë romë

Tabela 7 - Anët e forta dhe anët e dobëta të harmonizimit të politikave arsimore dhe sociale në Shqipëri

TABELA E PËRMBAJTJES

KAPITULLI I. HYRJE	16
1.1 Konteksti i studimit	16
1.2 Qëllimi dhe objektivat e studimit	20
1.3 Përcaktimi operacional i variablave të studimit	21
1.4 Shtrimi i problemit	22
1.5 Rëndësia e studimit	24
1.6 Struktura e studimit	26
1.7 Epërsitë dhe kufizimet e studimit	28
KAPITULLI II. ASPEKTI TEORIK	29
2.1 Kontribute teorike mbi nevojat e njeriut	29
<i>Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit</i>	31
2.2 Kontribute teorike mbi romët në sistemin e edukimit	31
<i>Teoria etnocentrike (asimilim për të pasur sukses)</i>	33
<i>Teoria relativiste: (Veçimi nga shkollat për të ruajtur kulturën)</i>	34
<i>Teoritë defiqitare</i>	37
<i>Teoria e zhvillimit pozitiv të të rinjëve</i>	38
2.3 Shprehitë jetësore bazë të njeriut	39
<i>Raporti shprehi- nevoja</i>	40
2.4 Situata dhe nevojat e komunitetit Rom në Europë	45
<i>Politikat arsimore të Këshillit të Europës në lidhje me arsimin e romëve</i>	46
2.5 Situata dhe nevojat e komunitetit Rom në Shqipëri	53
2.6 Arsimimi i komunitetit rom në Shqipëri	54
2.7 Politikat arsimore në Shqipëri	55
<i>Arsimi Gjithpërfshirës</i>	57
<i>Politikat arsimore për komunitetin Rom në Shqipëri</i>	59

<i>Korniza kurikulare e arsimit parauniversitar</i> _____	63
2.8 Politikat sociale në Shqipëri _____	64
2.9 Diversiteti i romëve dhe karakteristikat e organizimit të jetesës faktorë ndikues të rëndësishëm në nivelin e arsimit të tyre _____	68
<i>Organizimi i familjes</i> _____	69
<i>Martësat e hershme</i> _____	72
2.10 Komentë dhe çështje kritike _____	75
2.11 Roli i institucioneve qendrore dhe lokale _____	75
KAPITULLI. III METODOLOGJIA _____	78
3.1 Qëllimi dhe objektivat e studimit _____	78
3.2 Përpunimi i qëllimit në kuadër operator _____	79
3.3 Kohëzgjatja dhe fazat e studimit _____	81
3.4 Metoda kërkimore e përdorur _____	82
3.5 Instrumentet e përdorur _____	84
3.6 Popullata e studimit _____	88
3.7 Kampionimi i studimit _____	91
3.8 Kriteret e përzgjedhjes së të intervistuarve _____	92
3.9 Të dhëna rreth numrit të intervistave dhe pjesëmarrësve në to _____	94
3.10 Mbledhja e të dhënave _____	98
3.11 Analiza e të dhënave _____	101
3.12 Vështirësitë e fazës së intervistimit _____	106
3.13 Aspekti etik i studimit _____	107
KAPITULLI IV. REZULTATET E STUDIMIT _____	108

4.1 Kuadri ligjor shqiptar për arsimimin e pakicave etnike, aspekti teknik dhe përfshirja në të e direktivave të BE dhe parimeve të Konventës antidiskriminim	108
4.2 Pengesat kulturore institucionale dhe infrastrukturore që vështirësojnë arsimimin sipas nevojave të fëmijëve romë	115
4.3 Nevojat e fëmijëve romë për shërbime arsimore	118
4.4 Roli dhe rëndësia e polititikave arsimore dhe sociale në ndihmë të arsimimit të fëmijëve të komunitetit rom	125
KAPITULLI V DISKUTIMI I REZULTATEVE	135
5.1 Objektivi 1: Analizë e kuadrit ligjor shqiptar për arsimimin e pakicave etnike në vendin tone	135
5.2 Objektivi 2: Evidentimi i pengesave kulturore institucionale dhe infrastrukturore që vështirësojnë arsimimin sipas nevojave dhe kapaciteteve të fëmijëve romë	137
5.3 Objektivi 3: Evidentimi i nevojave të fëmijëve të komunitetit Rom për shërbime arsimore	139
5.4 Objektivi 4: Roli dhe rëndësia e polititikave arsimore dhe sociale, në ndihmë të arsimimit bazë cilësor të fëmijëve të komunitetit rom	142
5.5 Objektivi 5: Si paraqitet harmonizimi i polititikave arsimore dhe sociale në Shqipëri	146
KAPITULLI VI PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME	148
BIBLIOGRAFIA	162
SHTOJCA	168

Harmonizimi i shprehive bazë jetësore që ofron shkolla për fëmijët e komunitetit rom, me nevojat e tyre - sfidë e sistemit arsimor shqiptar

KAPITULLI I: HYRJE

1.1 Konteksti i studimit

Gjatë gjithë etapave të historisë së tyre, dokumentet që Romët kanë lënë pas, si për mirë apo për keq, të vërteta apo jo, janë shkruar nga të tjerët. Informacioni që ne kemi për ta është bazuar në kujtime, gjë që e bën atë të njohur, por jo të sigurtë. Në librin e tij “Romët në Evropë”, Liégeois (2007), ka argumentuar se historia e Romëve është më shumë e përbërë nga rrugët nga kanë udhëtuar sesa nga gjurmët e lëna pas

Nga kjo lind edhe kuptimi i vërtetë i kulturës së tyre, i shprehur në lidhje sociale, përdorimin e gjuhës, muzikë, kërcim dhe stil jetese. Për shkak se kultura rome është e ndryshueshme në raport me rrethanat, romët nuk kanë vende arkeologjike, qytete të lashta apo monumente. Si ofrues të shërbimeve tek popullsitë rrethuese ata nuk kanë lënë të dhëna mbi historinë e tyre. Vështirë se gjen ndonjë vepër që të bënte të mundur gjurmimin e historisë së tyre; as nuk kanë prodhuar arkivat e tyre të shkuara, duke qenë njerëz me kulturë gojore. (Liégeois 2007 fq.100)

Po sipas Liégeois (2007), grupet e para të Romëve zbuluan Evropën në shtrirjen nga perëndimi kryesisht në shekullin e 14-të dhe 15-të. ... Ata e kanë origjinën nga lindja dhe shkenca gjuhësore jo më herët se shekulli i 18-të, zbuloi se gjuha e tyre ishte indiane, me shumë mundësi nga veri-perëndimi i kontinentit dhe e ka origjinën nga dialekte të folura gjërësisht me afërsi me sanskrishten. India ka qenë fillimi për migracionin e tyre midis shekullit të 9-të dhe 14-të. (fq.20). Fillesat e përpjekjeve për emancipimin e romëve vihen re kryesisht në fillim të shekullit të 20-të. Sipas Projektit të Këshillit të Europës, për Edukimin e Fëmijëve Romë në Evropë, (Romët/Histori, n.d) Lëvizja Romani [1971], shkaktoi një ndryshim rrënjësor në sjelljen e shoqërive rome:

Për një kohë të gjatë, fati i romëve ishte përcaktuar si “jashtë”, nga popullsitë shumicë. Modelet e tyre të sjelljes përgjatë shekujve korrespondojnë me të ashtuquajturën “shoqëri dalëse”. Në fillim të viteve ’70 një elitë e vogël rome ishte formuar në Evropën Lindore dhe Perendimore, e cila për herë të parë ngriti zërin për çështjet rome në publik dhe tregoi kundërshtim ndaj statusit të parashkruar social dhe ekonomik të romëve. (fq. 3)

Romët shfaqen në një dokument zyrtar të Organizatës së Kombeve të bashkuara për herë të parë në vitin 1977. Sipas këtij dokumenti (E/CN4/Sub2/399, 31.08.1977), Nën-Komisioni për

Parandalimin e Diskriminimit dhe Mbrojtjen e Minoriteteve i ka rekomanduar Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe Këshillit Ekonomik Social (ECOSOC), që vendet në territorin e të cilëve banojnë romë [individë pa kombësi], duhet t'i sigurojnë atyre, nëse nuk e kanë bërë ende, të gjitha të drejtat që gëzon pjesa tjetër e popullatës (fq. 47). Në mars të vitit 1979, ECOSOC ndërmori një hap mjaft të rëndësishëm në OKB kur njohu Unionin Ndërkombëtar të Romëve si OJQ, e cila përfaqësonte Romët. Ky Komision luajti një rol të rëndësishëm informativ dhe ndërgjegjësuës në OSBE. Sipas Sandro Costarelli, *Children of Minorities: GYpsiens, Innocenti, Insights*, UNICEF, International Children Development Center, Firence 1993, fq. 152. Në gusht 1991, Nën-Komisioni për Parandalimin e Diskriminimit dhe Mbrojtjen e Minoriteteve, duke rikujtuar Rezolutën e tij të vitit 1977, tërhoqi vëmendjen ndaj faktit se ekzistonin pengesa të ndryshme për zbatimin e plotë të saj nga persona që i përkasin komunitetit rom, të drejtave të tyre civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore, dhe se pengesa të tilla përbënin diskriminim drejtuar specifikisht kundrejt atij komuniteti, duke e bërë atë veçanërisht vulnerabël (Sesioni 33, 23 gusht 1991 /21 Mbrojtja e Minoriteteve) Ai theksoi edhe se manifestimet e paragjyqimeve, diskriminimit, mungesës së tolerancës dhe ksenofobisë prekin komunitetin rom dhe rekomandoi një projekt-rezolutë për t'u adoptuar nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut (Sesioni 33t, 23 gusht 1991/21, Mbrojtja e Minoriteteve) Në vijim, duke qenë se ishte hera e parë që një organ i OKB-së në këtë nivel adreson situatën e romëve drejtuar Komisionit për të Drejtat e Njeriut, pas diskutimeve dhe një votimi, gjatë Sesionit të tij më 4 mars 1992, miratoi Rezolutën 1992/65 "Mbi Mbrojtjen e Romëve" (Resolution 1992/65, "Protection of Roma (gypsies)", 4 mars 1992). Duke rikujtuar Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, Komisioni konsideroi se "Organizata e Kombeve të Bashkuara nuk mund të mbetet indiferente ndaj fatit të minoriteteve. Në mars 1993, OKB klasifikoi OJQ-të rome në kategorinë e dytë, gjë që ndikoi në rritjen e peshës së kontributeve të tyre. Mjaft raporte speciale të Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe Nën-Komisionin kanë nxjerrë në pah problemet me të cilat përballeshin romët në shtete të ndryshme. Këto probleme janë trajtuar nga organet e specializuara të OKB, si Zyra Ndërkombëtare e Punës (ILO), interesi i së cilës për çështjet e romëve ka ardhur gjithnjë e në rritje, Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racial (CERD) si dhe Grupi i Punës për të Drejtat e Personave që u përkasin minoriteteve kombëtare apo etnike, fetare dhe gjuhësore. Sot romët konsiderohen si minoritet gjuhësor dhe gëzojnë të drejta të barabarta me qytetarët e vendeve ku ata jetojnë. Kjo shihet edhe në ligjet themelore të këtyre vendeve përfshi këtu edhe

vendin tonë. Bërxolli (2003) ka shkruar se në Shqipëri në popullsisinë e pakicave kombëtare përfshihen ajo greke, maqedonase, si dhe ajo malazeze. Këto grupe cilësohen si pakica kombëtare. Ndërsa grupe të tjera etnike si arumunët, romët etj, të cilët kanë humbur lidhjet me vendin e tyre të prejardhjes, cilësohen si grupe kulturore apo gjuhësore. Këto grupe si rregull janë asimiluar me shumicën e popullsisë vendase dhe pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike gëzojnë administrativisht nënshtetësinë shqiptare. (fq.98). Crowe dhe Koltsi (1991), kanë vënë në dukje se disa familje rome, sipas burimeve kroate, duhet të kenë ardhur në Ballkan rreth shek XIV(fq.124). Ata janë vendosur në territorin shqiptar rreth shek. XV (Koinova, 2000, fq. 96). Duke iu referuar ERRC, 1997 ”gjatë periudhës së perandorisë osmane, romët dhe një pjesë e egjiptianëve, ashtu si dhe shumica e popullsisë shqiptare, u konvertuan për arsye ekonomike ose me forcë në fenë islame. Romët dhe egjiptianët në Ballkanin Perëndimor, ndonëse trajtoheshin si një popullatë “e dorës së dytë”, bashkëjetuan në paqe me grupet e tjera etnike dhe mund t’i kalonin lirisht kufijtë. Shpallja e pavarësisë së Shqipërisë në vitin 1912 u shoqërua me një trajtim relativisht më të mirë të romëve dhe egjiptianëve” (fq.56). Megjithëse sipas Koinova, (2000) hendeku social midis tyre dhe popullsisë në shumicë vazhdoi të ekzistonte (fq.135). “Gjatë Luftës së Dytë Botërore, thuajse gjysmë milioni romë nga vende të ndryshme të Europës u ekzekutuan ose u vranë në kampet naziste të përqendrimit” (Ringold, Orenstein dhe Wilkens 2003). Sipas Gëdeshi dhe Miluka (2012):

“në Shqipëri, trajtimi i tyre ishte më i mirë se sa në vendet fqinje, ku përveç internimit në kampet naziste, romëve iu duhej të përballeshin edhe me spastrim etnik... Gjatë periudhës socialiste (1945-1990), romët dhe egjiptianët përjetuan përmirësime të dukshme në strehim, arsim, përkujdesje shëndetësore dhe shërbime sociale. Ashtu si shqiptarët, ata gëzonin punësimin e plotë, ndonëse një pjesë e tyre punonin si punëtorë të pakualifikuar. Në fshatra, romët punonin në bujqësi dhe blegtori, kurse nëpër qytete punonin në ndërtim, në shërbimet publike dhe artizanat. Gjatë periudhës së tranzicionit pasocialist, romët si pasojë e kolapsit dhe mbylljes së ndërmarrjeve shtetërore, karakterit të njëanshëm profesional të tyre, arsimimit të ulët dhe diskriminimit, kaluan nga një begati relative në një varfëri të skajshme. Ata janë aktualisht grupet më të varfra dhe më të marginalizuara etnike në Shqipëri”. (fq. 16-17).

Po sipas Gëdeshi dhe Milukës (2012) niveli i varfërisë së romëve është më i lartë se ai i shqiptarëve dhe kjo gjendje po përkeqësohet edhe më tej, ndonëse popullata rome ka qenë historikisht më e varfra në Shqipëri. Rënia e standardit të tyre të jetesës gjatë tranzicionit pas socialist, ishte shumë më e shpejtë se sa disa grupe të tjera të popullsisë. Kjo gjë ka krijuar një rreth vicioz, që riprodhon analfabetizëm dhe nivel të ulët arsimor, duke thelluar edhe më shumë

margjinalizimin e tyre në shoqëri. Nga ana tjetër, tranzicioni passocialist, demokracia dhe ekonomia e tregut krijoi mundësi të reja për romët, për t'u organizuar dhe shprehur identitetin, si dhe për të mbrojtur interesat e tyre. Duke filluar që nga viti 1991, janë krijuar një numër OJQ-sh rome, si Amaro Dives, Amaro Drom, Rromani Baxt, Alb Rrom, Shoqata e Romëve për Integrim, Rromani Kham, Gratë Rome, Romët e Veriut, Roma Active Albania etj. Disa romë janë zgjedhur edhe si anëtarë këshillash të njësive vendore (Elbasan, Korçë, Delvinë, etj). Pavarësisht se marrin pjesë në parti të ndryshme politike, romëve u mungon përfaqësimi i drejtpërdrejtë dhe nuk kanë përfaqësues në administratën publike, që të mbrojnë interesat dhe nevojat e tyre. (19, vv). Në veri të vendit romët njihen me emrin *gabelë*, në jug dhe në Shqipërinë e mesme njihen me emrin *arixhinj*, ndërsa në juglindje njihen me emrin *kurbatë*. Duke iu referuar Dekadës së përfshirjes së romëve 2005-2015 (2011), për numrin e popullsisë Rome në Shqipëri nuk ka statistika të plota dhe të sakta; gjithsesi, sipas përfaqësuesve të organizatave Rome në Shqipëri dhe studimeve të bëra nga institucione të pavarura, shifrat variojnë nga 90 deri 120 mijë:

Shumica e minoritetit Rom jeton në zonat urbane dhe në rrethinat e qyteteve. Vlerësimet e ditëve të sotme tregojnë se ritmi i rritjes së popullsisë rome është 3% dhe është më i lartë se ritmi i rritjes së popullsisë shqiptare. Krahësuar me shumë vende të tjera të Evropës Lindore dhe Qëndrore, përqindja e popullsisë rome në krahasim me totalin e popullsisë shqiptare është relativisht më e vogël. Shqipëria historikisht është përmendur për bashkëjetesën në harmoni dhe paqe midis komuniteteve kombëtare dhe minoriteteve. Çdo minoritet ka demonstruar origjinalitetin e tij duke kontribuar në këtë bashkëjetesë. Për më tepër, është respektuar origjinaliteti dhe identiteti i çdo komuniteti dhe janë krijuar kushte për të ruajtur të veçantën e çdo minoriteti përgjatë brezave. Anëtarësimi i Shqipërisë në Organizatat Ndërkombëtare si OSBE, Këshilli i Evropës etj, firmosja e pothuajse të gjitha konventave të të drejtave njerëzore, i dha trajtimin të minoriteteve, një dimension të ri në Shqipëri pas viteve '90. (fq. 6).

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë vë në dukje garantimin e barazisë për të gjithë para ligjit, [neni 18 i saj] dhe ndalon diskriminimin për shkak të gjinisë, racës, fesë, përkatësisë etnike, gjuhës, bindjeve fetare, politike, filozofike apo lidhjes prindërore. Për më tepër, Kushtetuta lejon zbatimin e diskriminimit pozitiv në marrjen e masave specifike të favorshme për dhënien e mundësive të veçanta apo mbrojtjes për ata individë apo kategori të veçantë kur ekziston një justifikim i arsyeshëm dhe objektiv. E gjithë kjo me qëllimin final të sigurimit të mbrojtjes së barabartë nga ligji për të gjithë (paragrafi 1, 3).

1.2 Qëllimi, hipotezat dhe objektivat e studimit

Studimi merr përsipër të evidentojë mënyrën se si perceptohen synimet kryesore edukative të shkollës shqiptare, në raport me nevojat dhe aftësitë e fëmijëve të komunitetit rom. Të kuptuarit se për çfarë ata kanë nevojë, do të sillte aktualizimin e potencialeve e tyre, të cilat do të bënin që këta fëmijë të kontribonin pozitivisht në zhvillimin e vetes, familjes, komunitetit apo shoqërisë në të cilën jetojnë. Parë në këtë këndvështrim punimi ka si qëllim: eksplorimin në terma cilësorë të situatës arsimore të fëmijëve të komunitetit rom, për të evidentuar se çfarë u ofron atyre shkolla dhe a synon ajo drejt edukimit gjithpërfshirës, gjithmonë në funksion të formimit të individit, nevojave, normave dhe vlerave të tij, cilësive të personalitetit dhe mbi të gjitha të aftësisë së tij, me shprehje praktike themelore bazë, për një jetë dinjitoze në shoqëri.

Në funksion të qëllimit të studimit janë përcaktuar hipotezat, objektivat dhe pyetjet kërkimore:

Hipotezat:

1. Shkolla shqiptare nuk arrin plotësisht synimin arsimim për të gjithë, i cili i jep mundësinë çdo nxënësi të përparojë në varësi të aftësive që disponon.
2. Shkolla nuk merr parasysh nevojat, kapacitetet dhe aftësitë e fëmijëve të komunitetit rom.
3. Në vendin tonë nuk mund të flitet deri tani për harmonizim të mirëfilltë të politikave sociale me politikat arsimore.

Objektivat e studimit

- Analizë e kuadrit ligjor, shqiptar për arsimimin e pakicave etnike, në rastin tonë të komunitetit rom, në vendin tonë.
- Evidentimi i pengesave kulturore, institucionale dhe infrastrukturore që vështirësojnë arsimimin sipas nevojave të fëmijëve romë.
- Analiza e situatës arsimore e fëmijëve të komunitetit rom dhe evidentimi i nevojave të tyre për shërbime arsimore.
- Evidentimi i rolit dhe rëndësisë së politikave arsimore dhe sociale, në ndihmë të arsimimit të fëmijëve të komunitetit rom.
- Analizë e politikave arsimore dhe sociale dhe shkallës së harmonizimit të tyre, në dobi të arsimimit bazë cilësor të fëmijëve të komunitetit rom.

Pyetjet kërkimore:

- A është i plotë kuadri ligjor shqiptar për arsimimin e pakicave etnike në aspektin teknik dhe a përfshihen në të direktivat e BE dhe parimet e Konventës antidiskriminim?
- Cilat janë pengesat kulturore institucionale dhe infrastrukturore që pengojnë arsimimin sipas nevojave të fëmijëve romë?
- Cilat janë nevojat e fëmijëve romë për shërbime arsimore?
- Cili është roli dhe rëndësia e politikave arsimore dhe sociale në ndihmë të arsimimit të fëmijëve të komunitetit rom?
- A ka harmonizim midis politikave arsimore dhe sociale në Shqipëri?

1.3Përcaktimi operacional i variablave të studimit

Pas shqyrtimit të literaturës dhe teorive më kryesore ku mbështetet ky studim, u bë i mundur edhe operacionalizimi i variablave të studimit.

Si variabla të varur në këtë studim janë konsideruar:

1. Numri i fëmijëve romë, që nuk e ndjekin shkollën apo e kanë braktisur atë
2. Numri i fëmijëve romë që vazhdojnë shkollën
3. Niveli i të nxënësve të fëmijëve romë

Operacionalizimi rreth pengesave apo vështirësive, që pengojnë fëmijët e komunitetit minoritetin rom për të pasur një arsim cilësor në përshtatje me nevojat dhe aftësitë e tyre është zbërthyer në këto variabla të pavarur:

Varfëria, e cila matet me anë të disa nën-variablave: dimensionit të vështirësisë, kushte të vështira jetese, papunësi, mungesë aftësish, kequshqyerje, emigracioni dhe migracioni.

Niveli i ulët arsimor, i cili matet me anë të disa nën-variablave, mungesë të dhënash standarte në lidhje me arsimimin e komunitetit rom, mungesë objektivash të qarta në lidhje me arsimimin, mungesë monitorimi i nivelit të të nxënësve.

Diskriminimi i cili matet me anë të disa nën-variablave: diskriminimi në shkolla dhe kopshte, kushtet e këqia të shkollave periferike, arsimim jo cilësor, forma të ndryshme racizmi.

Kultura dhe tradita rome, e cila matet me anë të disa nën-variablave: gjuha rome, kultura rome mungesa e njohurive në gjuhën shqipe.

Familja rome e cila matet me anë të disa nën-variablave: prindër analfabetë, punësimi i fëmijëve romë, mungesë modelesh suksesi, mungesë njohurish për rëndësinë e arsimit.

Politikat në ndihmë të arsimimit të fëmijëve romë, që maten me anë të nën-variablit: njohuritë rreth politikave arsimore dhe sociale dhe hapave konkretë që janë ndërmarrë për harmonizimin e tyre.

1.4 Shtrimi i problemit

Sipas Progamit të Zhvillimit të PNUD “Romët në rrezik” të ardhurat mesatare për frymë për komunitetin rom janë afërsisht 3.3 herë më të ulëta se të popullsisë jo-rome, dhe pothuaj 80% e komunitetit rom jeton poshtë këtij kufiri varfërie. Tëardhurat mujore të 51% të romëve nuk i kalojnë 50 €, ndërsa gjysma e popullsisë jo-rome fiton të ardhura që i kalon 150 € në muaj. Si rezultat i shkallës së lartë të analfabetizmit (48% e romëve e krahasuar me 3% të jo-romëve), një niveli jashtëzakonisht të ulët arsimor dhe kualifikimi, si dhe diskriminimit, romët kanë një numër më të lartë papunësie dhe papunësie afatgjatë krahasuar me popullsinë jo-rome.(fq 9 vv). Përsa i përket arsimimit të romëve, ata historikisht kanë qenë karakterizuar nga një nivel mjaft i ulët shkollimi. Nëse do t’i referoheshim përsëri Gëdeshit dhe Milukës (2012):

“në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, në Shqipëri, romët, karakterizoheshin nga një nivel shumë i lartë analfabetizmi. Tradita nomade dhe mënyra e tyre e veçantë e jetesës, varfëria dhe diskriminimi ishin disa nga faktorët që e shpjegonin këtë situatë. Niveli arsimor i romëve u përmirësua dukshëm gjatë periudhës socialiste, si pasojë e politikave arsimore dhe masave që u morën për t’i integruar ata në shoqëri. vendosja e romëve në vendbanime të qëndrueshme gjatë viteve ‘60, punësimi i plotë dhe i garantuar, strehimi dhe përmirësimi i standardeve të jetesës u pasqyruan edhe në rritjen e nivelit arsimor të tyre. Gjatë tranzicionit passocialist, niveli arsimor i romëve u përkeqësua. Papunësia e lartë dhe varfëria, diskriminimi dhe përjashtimi shoqëror, u pasqyruan në uljen e nivelit të tyre arsimor.Ndërkaq, një krahasim i nivelit arsimor të romëve me popullsinë mazhoritare tregon se ende midistyre është shumë i madh.” (fq.52)

Në mungesë të arsimit, popullsia romë e ka të vështirë të integrohet në tregun e punës dhe aftësia e saj, në krahasim me popullsinë mazhoritare, do të vijë duke u ulur. Kryesisht gjatë dekadës së fundit arsimimit të fëmijëve romë i është kushtuar një rëndësi e konsiderueshme, pasi arsimimi shihet si një nga faktorët bazë apo si ndikues mjaft i fuqishëm në integrimin e individit në shoqëri. Kështu në vitin 2005 një studim i kryer nga Banka Botërore "Romët dhe egjiptianët në Shqipëri", i Hermine De Soto & al, jep një pasqyrë të arsimimit të romëve në dy sisteme, në atë komunist dhe pas tij. Studimi del në konkluzionin se romët kanë qenë më të arsimuar në periudhën e sistemit komunist. Në vitin 2006, PNUD kryen studimin "Prekshmeria shoqërore e romëve". Në këtë studim është bërë përpjekje për të shpjeguar shkaqet se pse situata arsimore e romëve është në nivele mjaft të ulta. Për këto dy studime që përmendëm ndoshta dhe të tjerë mund të themi se nuk janë studime ekskluzivisht për arsimimin e romëve, por ato trajtojnë edhe arsimimin e tyre. Në vitin 2007 studimi "Situata arsimore e fëmijëve romë financuar nga UNICEF dhe Save the Children i autorëve Adem Tamo dhe Theodhori Karaj, është një përpjekje për të bërë një përshkrim me natyrë sasiore dhe cilësore të situatës së arsimimit të fëmijëve romë në Shqipëri. Në vitin 2011 studimi "Hartësimi i shërbimeve kundrejt fëmijëve romë" i Ilir Gëdeshit dhe Elira Jorgonit, përshkruan gjendjen aktuale socio-ekonomike të komunitetit rom në Shqipëri dhe i kushton edhe një vëmendje të veçantë aksesit në arsim të këtij komuniteti. Studimi që po paraqesim vë gjithashtu theksin në rëndësinë e arsimimit të fëmijëve të komunitetit rom, por parë kjo nga një këndvështrim tjetër. Deri tani arsimimi i romëve është trajtuar kryesisht si mosbraktisje e shkollës apo mësim shkrimi e këndimi. Ky është vetëm sistemi formal i edukimit, i cili i jep përparësi përfitimit të dijeve duke lënë pas dore llojet e tjera të të mësuarit. Pjesëmarrja sa më e lartë në shkollë nuk është garanci për nxënës të suksesshëm. Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet edukimit cilësor për fëmijët në shkollat tona, si dhe zhvillimit të tyre të përgjithshëm. Sot është shumë e rëndësishme që edukimi të kuptohet në tërësinë e tij. Për këtë arsye reformat në edukim dhe politikat e edukimit duhet të drejtohen drejt këtij vizioni. Arsimimi i romëve nuk duhet të jetë vetëm mosbraktisje. Ka romë që e kanë ndjekur të gjithë ciklin 9-vjeçar të shkollimit dhe prapë nuk dinë të shkruajnë apo lexojnë si duhet, sikurse ka të tjerë që dinë shkrim e lexim, por që i mungojnë mundësitë, mekanizmat dhe strategjitë personale, që të familjarizohen me njohuritë e nevojshme për orientimin dhe zgjidhjen e problemeve të jetës së përditshme. Sipas raportit të UNESCO-s mbi edukimin për shekullin e 21, botuar nga komisioni gjerman i UNESCO-s, Neuwied; Krißtel; Berlin: Luchterhand (1997), koncepti i të mësuarit

përgjatë gjithë jetës bazohet në katër shtylla: të mësojmë si të përftojme dije, të mësojmë si të veprojmë, të mësojmë si të jetojmë së bashku, të mësojmë për jetën. Çdo person, qoftë fëmijë, adoleshent apo i rritur duhet të jetë në gjendje të përfitojë nga mundësitë e edukimit, që u përgjigjen nevojave të tij themelore të të mësuarit. Këto nevoja kanë të bëjnë si me teknikat e të mësuarit si p.sh. leximi dhe shkrimi, shprehitë me gojë, llogaritjet dhe zgjidhja e problemeve, ashtu edhe me përmbajtjet bazë të të mësuarit, si p.sh. dijet, aftësitë, vlerat, qëndrimet ndaj çështjeve të caktuara, të cilat u nevojiten njerëzve për të mbijetuar, për të shpalosur aftësitë e tyre, për të jetuar dhe punuar në dinjitet, për të marrë pjesë në mënyrë të plotë në zhvillimin e shoqërisë, për të përmirësuar cilësinë e jetës. (http://www.dadalos.org/politik_alb/bildung.htm, parë më 6 nëntor 2015)

Të mësosh për jetën do të thotë të shpalosësh më mirë personalitetin tënd, me një aftësi më të madhe gjykimi dhe me një ndjenjë më të madhe përgjegjësie. Për të arritur këtë, edukimi nuk duhet të lërë pasdore asnjë prej potencialeve ekzistuese brenda një individi si: aftësinë për të kujtuar, forcën e gjykimit, syrin për të bukurën, veprimtarinë manuale, aftësinë për të komunikuar etj. Arsimi duhet të jetë në funksion të nevojave, dëshirave dhe kapaciteteve të individit, në rastin tonë të fëmijëve romë. Komuniteti rom ka dëshira, nevoja dhe kapacitete, të cilat deri tani janë parë si tre gjëra të paharmonizuara. Ndërhyrjet për harmonizimin e tyre janë fragmentare, gjë që evidentohet tek mungesa e aftësive jetësore bazë që i karakterizon këto fëmijë. Studimi do të analizojë situatën arsimore të fëmijëve romë si dhe se çfarë i ofron sistemi ynë arsimor këtyre fëmijëve, thënë ndryshe sa e aftë është shkolla jonë për të bërë harmonizimin e shprehive bazë jetësore me nevojat reale që kanë fëmijët e komunitetit rom.

1.5 Rëndësia e studimit:

Ashtu siç është përmendur edhe më lart, ky studim ka si qëllim vlerësimin e situatës arsimore të fëmijëve të komunitetit rom, në këndvështrim cilësor dhe më konkretisht, në Elbasan, Fier, Korçë dhe Berat, për të evidentuar rolin që luan shkolla për:

1. Zhvillimin e shprehive bazë jetësore të këtyre fëmijëve (aftësitë për shkrim, lexim, aftësitë për zgjidhjen e problemeve, situatave, aftësitë komunikuese, njohuritë bazë për ushqimin, shëndetin, mënyrën e të sjellurit etj.)

2. Harmonizimin midis asaj që shkolla ofron dhe nevojave reale që ata kanë
3. Analizën e politikave arsimore dhe sociale në vendin tonë si dhe sa harmonizohen ato për t'i ardhur në ndihmë arsimimit cilësor të fëmijëve të komunitetit rom
4. Listimin e arsyeve se përse është i domosdoshëm harmonizimi i këtyre politikave dhe cilat janë anët e forta dhe të dobëta të këtij harmonizimi
5. Analizën e kuadrit ligjor shqiptarpër arsimimin e pakicave etnike

Në Republikën e Shqipërisë kushdo ka të drejtë për arsim dhe arsimi i detyrueshëm është caktuar me ligj si i tillë. Megjithatë në shumë raste arsimimi bazë shpesh herë nuk duket se ka fleksibilitet të lartë, që do të thotë se konceptimi dhe realizimi i mësimi nuk ndryshon në mënyrë thelbësore nga ajo çka ndodh tradicionalisht në klasat tona aktuale. Sipas raportit humultues “Arsimi bazik cilësor në funksion të zhvillimit njerëzor” (2006), në vitet 90-të themeluesi i raportit të zhvillimit njerëzor, Mahbub Ul Haq ka hedhur idenë se zhvillimi ekonomik i një vendi dhe mirëqenia e qytetarëve të tij, maten me këndin e indeksit të Zhvillimit Njerëzor i cili njerëzit, nevojat dhe dëshirat e tyre i vendos në qendër të tij. (fq.13). Si i tillë ky zhvillim nuk nënkupton dhe nxit gjithnjë ndryshime revolucionare, por ndryshime të qëndrueshme dhe të përhershme, të cilat sjellin mirëqenie ekonomike, drejtësi dhe barazi sociale, sundim të ligjit dhe barazi të plotë të qytetarëve para ligjit. Në ZhNj roli i arsimit është shumë i rëndësishëm dhe i pazëvendësueshëm. Hauard Gardner themelues i teorisë së inteligjencave të shumfishta, ka deklaruar se “qoftë kur jam duke udhëtuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ose duke vizituar Europën, Amerikën Latine apo Lindjen e Largët, kudo gjej një konsensus mahnitës, besimin se cilësia e sistemit arsimor të një kombi do të jetë një nga përcaktuesit më kryesorë gjatë shekullit të ardhshëm dhe më tej”. Ndërsa Jack Delors ka deklaruar se: “ nuk ka zhvillim të qëndrueshëm ekonomik afatgjatë, pa sistem të arsimit cilësor”. (Arsimi Bazik Cilësor në funksion të Zhvillimit Njerëzor, 2006, 6 vv). Sot gjithnjë e më shumë flitet për ndryshime në sistemin arsimor. Gjithpërfshirja në edukim është bërë tashmë një temë globale, duke kërkuar te çdo individ diçka vërtet të dobishme për shoqërinë dhe të jetuarit së bashku. Teoritë e inteligjencave të shumëfishta na çojnë pikërisht në integrimin e individit në shoqëri me potencialin që ai mbart, që mund të jetë i ndryshëm, por edhe mjaft i vlefshëm për komunitetin lokal apo global ku ai bën pjesë. Edhe shkolla shqiptare duhet të jetë pjesë e këtyre ndryshimeve, duke pasur si objektiv themelor të sajin gjithpërfshirjen dhe integrimin e individit në shoqëri. Ky studim synon të njohë lexuesin pikërisht me ndryshimet, që kanë ndodhur gjatë dy dekadave të fundit në mënyrën se si

perceptohen synimet kryesore edukative, të shkollës sonë në raport me nevojat, që paraqesin fëmijët e komunitetit rom, pasi të kuptuarit se për çfarë ata kanë nevojë do të sillte aktualizimin e potencialeve e tyre, të cilat do të bënë që këta fëmijë të kontribonin pozitivisht në zhvillimin e vetes, familjes, komunitetit apo shoqërisë në të cilën jetojnë. Studimi synon të ofrojë një panoramë dhe një analizë të ecursisë së politikave arsimore dhe sociale në Shqipëri, pas viteve 90-të e deri më sot, mënyrës se si ata funksionojnë dhe se si harmonizohen me njëra-tjetrën, gjithmonë në dobi të arsimit sipas nevojave dhe aftësive të fëmijëve të komunitetit rom. Bazuar në gjetjet e studimit jemi përpjekur gjithashtu të arrijmë në disa përfundime të cilat shërbejnë si bazë jo vetëm për sugjerime lidhur me harmonizimin e politikave arsimore me ato sociale, por edhe për të evidentuar anët e forta dhe të dobëta të këtij harmonizimi në vendin tonë. Përpos kësaj studimi synon të analizojë edhe kuadrin ligjor shqiptar për arsimimin bazë të minoritetit rom në Shqipëri, analizë e cila do të ndihmojë në gjykimin mbi masat konkrete, që duhet të ndërmeren në terma praktikë për përmirësimin e situatës, si dhe gjenerimin e politikave mbështetëse për t'a bërë ligjin sa më shumë të njohur dhe zbatueshëm në shkallë vendi.

1.6 Struktura e studimit

Studimi ndjek strukturën e mëposhtme:

Kapitulli i parë, prezanton idetë kryesore të cilat përcaktojnë problemin, qëllimin dhe objektivat e studimit. Në të përfshihen gjithashtu dhe operacionalizimi i variablave dhe organizimi i punimit.

Kapitulli i dytë, shqyrton literaturën me qëllim ideimin sa më të detajuar të projektit kërkimor. Shqyrtimi i literaturës është përqëndruar në nevojat bazë të njeriut në përgjithësi, të komunitetit rom në veçanti e më pas të komunitetit rom në Shqipëri, në situatën arsimore të fëmijëve të këtij komuniteti, politikat arsimore dhe sociale që janë ndërmarrë në vite në dobi të tyre etj. Shqyrtimi i literaturës ka qenë një ndihmesë e madhe për të shqyrtuar kornizat teorike të studimeve të mëparshme, të cilat ofrojnë informacione të përditësuara në lidhje me temën e studimit. Në këtë kapitull pasqyrohen kontributet e autorëve të ndryshëm lidhur me frekuentimin, rezultatet e ulta dhe braktisjen e shkollës nga fëmijët romë në Shqipëri dhe në vendet e tjera të rajonit. Përpos

kësaj prezantohen edhe teori kryesore si dhe praktikat evropiane, të cilat janë përpjekur në vite të interpretojnë ose shpjegojnë “disfatën” e romëve në edukim.

Kapitulli i tretë, përshkruan metodologjinë e punimit. Fillimisht prezantohen qëllimi dhe objektivat e studimit. Fokusi më pas zhvendoset tek përshkrimi i kampionimit dhe metoda e përdorur për përzgjedhjen e tij, hapat dhe procedurat e mbledhjes së të dhënave, instrumentet e përdorur dhe qëndrueshmëria e brëndshme e tyre. Gjithashtu jepet informacion rreth besueshmërisë, vlefshmërisë dhe aspekteve etike të punimit, si dhe analizës së të dhënave dhe kufizimeve të studimit.

Kapitulli i katërt, analizon gjetjet e studimit. Këtu trajtohen dhe problematikat në zbatimin e hapave që qeveria shqiptare ka ndërmarrë për hartimin e politikave arsimore dhe sociale dhe harmonizimit të tyre, gjithmonë në dobi të arsimimit bazë cilësor të fëmijëve të komunitetit rom. Në këtë kapitull marrin përgjigje pyetjet kërkimore, nëpërmjet analizës së të dhënave dytësore (studime, artikuj, intervista etj), analizës së intervistave individuale dhe intervistës së fokus grupit, të realizuara me prindër e fëmijë romë, të ballafaquara me mendimet e përfaqësuesve të institucioneve shtetërore (edukatorë, mësues, drejtues shkollash, përfaqësues dhe drejtues të drejtorive arsimore rajonale, si dhe me përfaqësues të institucioneve qendrore) dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile, të angazhuar në këtë problematikë.

Kapitulli i pestë, fokusohet në analizën dhe diskutimin e rezultateve. Në këtë kapitull lexuesi njihet me diskutimet rreth çështjeve, që janë trajtuar përgjatë studimit.

Kapitulli i gjashtë, sjell një panoramë të gjërë të gjetjeve kryesore rreth problemeve reale, që pengojnë minoritetin rom në Shqipëri për të pasur edukimin bazik cilësor, në përputhje me nevojat reale që ai ka. Jepen gjithashtu përfundimet dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e politikave arsimore dhe sociale në Shqipëri, si dhe listohen arsyet se përse është i domosdoshëm harmonizimi i këtyre politikave dhe cilat janë anët e forta dhe të dobëta të këtij harmonizimi

Punimi mbyllet me listën e referencave dhe shtojcën.

1.7 Epërsitë dhe kufizimet e studimit

Studimi ofron një panoramë dhe një analizë të ecurisë së politikave arsimore dhe sociale në Shqipëri, pas viteve 90-të e deri më sot, mënyrës se si ata funksionojnë dhe se si harmonizohen me njëra-tjetrën, gjithmonë në dobi të arsimimit sipas nevojave dhe aftësive të fëmijëve të komunitetit rom, si dhe synon të analizojë edhe kuadrin ligjor shqiptar për arsimimin bazë të minoritetit rom në Shqipëri. Ky studim të jep mundësinë të analizosh edhe duke u mbështetur në literaturë, situatën reale sociale dhe arsimore, në të cilën ndodhen fëmijët e komunitetit rom në qarqet Elbasan, Fier, Berat dhe Korçë, gjithmonë duke evidentuar rëndësinë e bashkëpunimit ndër-institucional, në ndihmë të arsimimit bazë cilësor të këtyre fëmijëve. Në të gjithë literaturën e gjetur dhe të shfrytëzuar, u konstatuan këto kufizime:

- Mungesa e të dhënave statistikore të sakta lidhur me numurin e romëve, që jetojnë në Shqipëri, pasi regjistrimi i përgjithshëm i tyre, nuk është kryer asnjëherë.
- Mungesa e të dhënave të plota dhe të sakta për arsimimin e popullsisë rome dhe në veçanti për fëmijët e këtij komuniteti.
- Të dhëna fragmentare dhe shpeshherë kontradiktore, që vijnë nga burime të ndryshme administrative, sondazhe të ndryshme, të dhëna, që vijnë nga parashikimet e bazuara në vlerësimet e përafërta zyrtare apo të shoqatave joqeveritare rome, për popullsinë rome.

Të gjitha këto, përbënin një nga kufizimet jo pak të rëndësishëm të studimit, por duke qenë se ky studim do të jetë një kërkim cilësor, ai mbart në vetvete disa kufizime të tjera, nga ku mund të veçojmë:

- Numri i vogël i pjesëmarrësve në studim, në raport me komunitetin e gjerë, që ato përfaqësojnë. Një përfaqësim i tillë nuk lejon përgjithësimin e rezultateve për tërë popullatën, por vetëm për kampione të popullatës rome, që jeton në komunitete të mëdha.
- Njohuritë jo të plota rreth gjuhës shqipe të pjestarëve të komunitetit rom dhe diferencat kulturore, pasi ndikojnë në kualitetin e intervistave dhe nivelin e të kuptuarit të pyetjeve.
- Mungesa e interesit të prindërve romë për t'u përfshirë në studim, pasi u treguan mosbesues për kontributin që mund të ketë studimi, në arsimimin cilësor të fëmijëve të tyre

KAPITULLI II

ASPEKTI TEORIK

Ky kapitull synon të bëjë një shqyrtim të plotë të literaturës, duke u përpjekur të nxjerrë në pah teoritë kryesore në të cilat mbështetet studimi. Për këtë arsye kapitulli fillon me teorinë e nevojave të njeriut dhe parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, që nënvizon rëndësinë dhe domosdoshmërinë e të qenit i barabartë me të tjerët në shoqëri.

2.1 Kontribute teorike mbi nevojat e njeriut

Maslow, A.H. (1943) ka siguruar se njerëzit kanë pesë grupe qëllimesh ose nevojash. Ai i ka sistemuar ato në një hierarki të forcës së nevojës sipas një piramide, bazën e së cilës e përbëjnë **nevojat fiziologjike**, karakteristike për çdo krijesë të gjallë. Nevojat fiziologjike për njeriun zënë vendin e parë, pasi ata përcaktojnë mbijetesën e tij. Këtu përfshihet nevoja për të marrë frymë, për të ngrënë, për të fjetur etj. Nevojat më të larta, nuk do të shërbejnë si motivuese derisa të plotësohen nevojat më të ulta. Është e vërtetë që njeriu jeton vetëm me bukë, në rastin kur nuk ka bukë, por kur ka bukë mjaftueshëm, lindin nevoja më të larta, të cilat më shumë se sa uria psikologjike e thjeshtë, dominojnë organizmin njerëzor. Në vendin e dytë janë të vendosura nevojat **për sigurinë dhe stabilitetin**. Këtu përfshihet jo vetëm nevoja e njeriut për të mbrojtur jetën e tij dhe të të dashurve të tij, por edhe nevoja për të mos humbur punën, strehimin, pronën etj. Në vendin e tretë janë të vendosura **nevojat sociale**, të cilat lidhen me dëshirën e njeriut për të qenë pjesë e një grupi të caktuar, të ketë miq, të komunikojë me ta, të detë dhe t'a duan, pasi mjedisi shoqëror i mundëson individit largimin e vetmisë dhe i forcon ndjenjën e sigurisë. Në vendin e katërt janë të vendosura **nevojat për të qenë i vlerësuar apo i respektuar nga të tjerët**. Këto nevoja bëjnë njerëzit të jenë sa më kërkues ndaj aftësive të tyre profesionale, me qëllim sigurimin e një reputacioni më të mirë dhe një statusi më të lartë shoqëror, të cilët do të ndikojnë direkt në imazhin e tyre. Në vendin e pestë janë të vendosura - **nevojat shpirtërore**, ose nevojat për vetë-realizim, të cilat lidhen me dëshirat e njeriut për të shpalosur potencialin dhe talentin e tij. Këto dëshira i bëjnë njerëzit të jetë kreativë, të zhvillojnë aftësitë e tyre, të mbrojnë pikëpamjet e tyre, për të luftuar për drejtësi dhe pavarësi. (370, vv)

Çdo njeri ka nevojat dhe të drejtat e veta, të cilat nuk mund të fitohen nëse nuk ka barazi midis njerëzve. Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit na e shpjegon më së miri, rëndësinë dhe

domosdoshmërinë e të qenit i barabartë me të tjerët në shoqëri. Nëse nuk je apo nuk ndihesh i tillë natyrisht edhe e drejta për arsimim sikurse shumë të drejta të tjera do të jenë të cunuara.

Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit

Kushti i parë i drejtësisë është barazia. Kërkesa për barazi para ligjit është në kuptimin e saj më esencial një nga të drejtat më themelore e njeriut. Ajo zë vendin e parë në shumicën e kushtetutave të shkruara. Lufta për të drejtat e njeriut fillon me përpjekjet për t'i njohur të drejtat e tij themelore siç është e drejta e jetës. Ndërsa barazia është pika fillestare për të gjitha të drejtat dhe liritë e tjera të njeriut. Principi i barazisë dhe diskriminimit përbën bazën në operacionalizimin e të gjitha të drejtave të tjera njerëzore, si në dokumentet ndërkombëtare po ashtu edhe në legjislacionin kombëtar.

Termi “diskriminim”, përdoret për treguar trajtimin e padrejtë ose mohimin e të drejtave minimale individëve për shkak të racës, seksit, kombësisë, ose fesë”. (Doebbler , C (2007) fq. 103-106). Avokimi dhe legalizimi i principit dhe idesë për barazi ndërmjet njerëzve është produkt i Revolucionit Borgjez Francez. Sipas Smith, Rh (2010), aktet më të rëndësishme të deklaruara si Deklarata e Pavarësisë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (1776), Deklarata për të Drejtat e Njeriut dhe Qytetarit (1789), si dhe Deklarata për të Drejtat e Njeriut dhe Qytetarit (1793), kanë vënë standartet themelore të të drejtave të njeriut si dhe janë bërë udhërrëfyes të popujve dhe shtetevedhe kane zënë një vend të rëndësishëm në historinë e njerëzimit”. (231, vv)

Në librin e tij Ali Musliu ka argumentuar se:

“Komuniteti ndërkombëtar nga gjysma e dytë e shekullit të XX, po angazhohet gjithnjë e më shumë për të siguruar barazi ndërmjet njerëzve, pa marrë parasysh dallimet racore, kombëtare, fetare, gjuhësore etj. Këtë e dëshmon edhe një numër i konsiderueshëm i instrumenteve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut të ratifikuara nga shtetet anëtare të OKN-së, të cilat ndalojnë çdo lloj diskriminimi. Ky princip me formulime të ndryshme gjendet në Kartën e Kombeve të Bashkuara (1945), Deklaratën Universale mbi të Drejtat e Njeriut (1948), Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (1966), Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës(1989), Konventën Ndërkombëtare mbi Mrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve-Emigrantëve (1990, Konventën Europiane për të Drejtat dhe Liritë themelore të Njeriut (1951/53)”. (fq.3).

Termi diskriminim është shpjeguar edhe në nenin 1 të Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial, ku shpjegohet se diskriminim racor ka të bëjë në çdo dallim, përjashtim, kufizim ose dhënie të përparësive, që është e bazuar në racë, ngjyrë, prejardhje, origjinë kombëtare ose etnike, që ka për qëllim ose për rezultat të shkatërrojë ose të komprometojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në kushtet e barazisë, të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në fushat politike, ekonomike sociale dhe kulturore ose në çfarëdo fushe tjetër të jetës politike. Një raport i Brownlie, I. (2009) Basic Documents in International Law, Oxford University Press ka përshkruar se në ndalimin e diskriminimit një rol të rëndësishëm kanë dhënë organizatat e specializuara të OKB-së, të cilat kanë miratur rregulla të shumtë dhe precizë, me anë të të cilave ndalohet dhe gjykohet praktika e dallimeve ndërmjet njerëzve, jotoleranca, urrejtja dhe mohimi i lirisë dhe barazisë. Kështu vlen të përmendet Konventa Ndërkombëtare për të gjitha Format e Diskriminimit Racial (1965/69), Konventa për Diskriminimin në Fushën e Punësimit dhe Profesionit (1968), Konventa kundër Diskriminimit në Fushën e Arsimit etj. Ndërsa në kuadër të akteve rajonale Europiane vlen të përmendim edhe Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut sikurse e kanë sugjeruar edhe Harris, O'Boyle dhe Warbrick (2009), se neni 14 i kësaj Deklarate ndalon diskriminimin dhe i detyron shtetet të sigurojnë të drejtat dhe liritë e qytetarëve pa asnjë lloj diskriminimi bazuar në gjini, racë ngjyrë lëkure, përkatësi të ndonjë pakice kombëtare, pasuri etj". (fq. 577)

Moskonsiderimi politik dhe historik i minoritetit rom në vite, ka bërë që shumë studiues, politikëbërës etj të zhvillojnë një sërë teorish, me qëllim interpretimin dhe justifikimin e problemeve që karakterizojnë këtë minoritet në sferën e edukimit. Studimi ynë ka konsideruar disa prej tyre.

2.2 Kontribute teorike mbi romët në sistemin e edukimit

Në morinë e teorive që trajtojnë problemet e romëve në fushën e edukimit, kemi veçuar teoritë e mëposhtme, pasi në to gjejmë interpretime të ndryshme për mënyrën e edukimit të romëve, mënyrën se si funksionojnë sistemet e edukimit, nevojës për ndryshim etj. Teoritë e perzgjedhura janë:

- *Teoria etnocentrike (asimilim për të pasur sukses)*
- *Teoria relativiste: (Veçimi nga shkollat për të ruajtur kulturën)*
- *Teoritë defiqitare*
- *Teoria e zhvillimit pozitiv të të rinjëve*

Teoria etnocentrike (asimilim për të pasur sukses)

Sipas Claveri, Alonso, (2003).

një nga teoritë që shpjegon dhe justifikon problemet e romëve në edukim është ajo etnocentrike..... Kjo teori ka sjellë një seri pikpamjesh dhe supozimesh që përkufizojnë “të tjerët” dhe statusin e “tyre”.... Janë këto pikpamje dhe supozime të frymëzuara nga këto tradita të etnocentrizmit, që propagandojnë modelet e segregimit dhe përjashtimit në politikat, praktikat dhe kërkimet shkencore mbi edukimin në Evropë. (fq. 280-284).

Etnocentrizmi ka të bëjë me konceptin që racat e tjera janë inferiore kundrejt racës Europiane, dhe pozicioni i kulturës perëndimore është parë si modeli më i mirë që shoqëritë e tjera inferiore duhet ta përshtasin me qëllim përmirësimin e tyre... Mënyrat e ndryshme të ekzistencës dhe funksionimit konsiderohen të rrezikshme për unitetin dhe stabilitetin në botë. Parë në këtë këndvështrim, Flecha, R. (1999)ka deklaruar se romët, në mënyrë që të përmirësojnë nivelin e tyre të edukimit, duhet t’u përshtaten modeleve Evropiane Perëndimore, të lënë mënjanë kulturën dhe vlerat e tyre tradicionaledhe të bëhen pjesë e kulturës dominante. Në këtë kontekst treguesit e ulët të shkollimit të romëve, shihen si mungesë përshtatje me vlerat universale të të mësuarit. (fq.150-156).

Shpeshherë në politikat arsimore, që ndërmerren nga shtetet nuk konsiderohen ose eliminohen diferencat kulturore që minoriteti rom paraqet. Pikërisht mosmarrja parasysh e këtyre diferencave sjell probleme në edukimin e tyre. Claveria et Alonso (2003), kanë sjellë një shembull etnocentrizmi të theksuar nëpërmjet një drejtori shkolle në Dorset të Anglisë. Kur një grup familjesh romë u vendosën në Dorset, drejtori listoi gjithë vështirësitë që shkolla hasi me të sapoardhurit. Këto vështirësi kishin të bënin me probleme edukative dhe sociale që vetë fëmijët romë paraqesin, si p.sh nevoja për një bashkëpunim të ngushtë dhe ndërtimi i marrëdhënieve reale mes shkollës dhe prindërve romë, probleme të integritetit në komunitetin shkollor, nevoja

për të shmangur ndikimin sado minimal rreth mundësive arsimore dhe sociale tek fëmijët e fshatit, nevoja për të shmangur çdo lloj ftohjeje ndërmjet shkollës dhe prindërve të fshatit etj. Drejtori e indentifikoi këtë problem si të lidhur me kulturën e fëmijëve dhe jo me pamundësinë e shkollës, për t'u marrë me këtë diversitet nxënësish. Ai jo vetëm parashikoi problemin e fëmijëve romë në lidhje me integrimin, por parashikoi gjithashtu impaktin negativ që prezenca e fëmijëve romë mund të sillte tek fëmijët e fshatit, pasi procesi i të mësuarit për ta u perceptua nga drejtori si i kërcënuar nga të sapoardhurit. Ai shkoi dhe më tej dhe denoncoi mungesën e vëmendjes në lidhje me “impaktin që një grup vlerash të huaja kulturore mund të kenë tek fëmijët e shkollës”. Drejtori ishte më i preokupuar për procesin mësimor të fëmijëve të fshatit se sa për fëmijët romë. (289 vv).

Nëse kultura rome shihet si shkak i dështimit në edukim për fëmijët e komunitetit rom, por edhe për fëmijët e tjerë, që kanë kontakte me ta, është i nevojshëm dizenjimi i hapave për të eliminuar “rrënjët e problemit”. Fajësimi i kulturës së minoritetit, është pasojë e karakterit etnocentrik që shkollat maxhoritare përcaktojnë. Nga ky pozicion superior kulturor, karakteri etnocentrik i një shkolle është i padukshëm dhe i paprekshëm. Sipas tij sistemet shkollore janë tashmë janë të projektuara, dhe familjet duhet t'i pranojnë ato siç janë.

Teoria relativiste: (Veçimi nga shkollat për të ruajtur kulturën)

Perspektiva se varfëria e pakicave etnike rome dhe mangësitë e qasjeve në edukim janë vetëm manifestime të diferencave të tyre kulturore, u bë shtylla e reformave arsimore të shumë vendeve pas viteve 1990. Kjo perspektivë i çoi mjaft politikëbërës, teoricienë, drejtues mësues etj, në përfundimin se për të ruajtur kulturën duhet që minoritetet të mbahen larg arsimit mazhoritar. Duhet theksuar megjithatë se studiues të tjerë të fushës së edukimit kanë vërtetuar, se krijimi i ambjenteve të veçuara larg klasave normale, në të vërtetë ka thelluar segregimin dhe pabarizitë në sistemet arsimore. Relativizmi shihet si eliminimi i çdo modeli ose principi negativ. Sipas Feyerabend (1993), ekziston vetëm një princip i cili duhet mbrojtur me të gjitha mënyrat dhe në të gjitha fazat e zhvillimit human. Bëhet fjalë për parimin se “çdo gjë shkon”. Aplikimi i këtij parimi në studimin e kulturës, quhet relativizëm kulturor i cili nënkupton se: kulturat konsiderohen as superiore e as inferiore, vetëm të ndryshme. (fq. 19).

Duke i detyruar studentët, që janë më pak të favorizuar të pranojnë nënshtrimin e paracaktuar në emër të diferencave kulturore, në fakt, reformat arsimore relativiste përshtaten dhe nuk sfidojnë aspak pabarazitë që ekzistojnë në edukim. Nxënësit romë hasin pengesa të shumta në edukim si rrjedhojë e diferencave kulturore. Megjithatë pengesat kryesore që ata hasin, lidhen me varfërinë dhe kushtet e këqia të jetesës. Teoria relativiste, nënvizon faktin se respekti për të ndryshmen do të thotë pranimi dhe respektimi i varfërisë së një grupi si pasojë e faktorëve kulturorë, një efekt ky të cilin Agnes Kende e përshkruan si “etnikizimi i varfërisë”. Sipas Kende (2000), kur kushtet e jetesës konsiderohen si një tipar kulturor, antarët e atij grupi etnik, janë përgjegjës për varfërinë e tyre dhe shoqëria maxhoritare është e përjashtuar nga mundësia për të gjetur rrugët rreth eliminimit të këtij problemi dhe inpatit që ai ka në edukim. (fq. 187).

Teoritë e mësipërme (etnocentrike dhe relativiste kanë të përbashkët disa elementë kyç, që manifestohen në politikat, praktikat dhe gjetjet kërkimore të përfituara nga to, të cilat janë:

1. objektivizmi i komuniteteve rome
2. përfshirja e limituar e romëve në proceset kërkimore, duke vënë theksin mbi teoritë deficiente.

▪ ***Objektivizmi i komuniteteve rome***

Një nga principet bazë në kërkimin shkencor është objektiviteti. Objektiviteti gjithmonë dikton një ndarje të qartë mes studimit shkencor neutral dhe objektit të studimit. Subjektiviteti i kërkuesit, supozohet të jetë objektiv, pasi është i vetmi që ka rëndësi dhe kërkuesi merr përgjegjësi të plotë për interpretimin e çdo të dhëne. Të dyja teoritë si ajo etnocentrike dhe ajo relativiste, objektivizmin e subjektivitetit të studimit e shohin si pasojë e një superioriteti të padiskutueshëm të subjektivizmit të kërkuesit. Politikat e ndërmara dhe kërkimet edukuese, të cilat objektivizojnë komunitetet rome nuk janë fokusuar në rrënjët e marxhinalizimit të romëve me qëllim ofrimin e zgjidhjeve. Ato kanë trajtuar tiparet diverse rome, pa i ndihmuar ata të kapërcejnë përjashtimin social. Vetëm një pjesë fare e vogël e përpjekjeve kërkimore i janë fokusuar tek mënyrat se si të ulet varfëria relative dhe marxhinalizimi i tyre. Kërkimet kryesisht kanë qënë përshkrues dhe sipërfaqësor, duke u fokusuar në kulturën dhe traditat tona, ose karakteristikat biologjike të racës së bardhë. Edhe kur studimet, politikat, ose praktikat bazohen në teoritë gjithëpërfshirëse, të cilat janë zhvilluar dekadat e fundit dhe që njohin subjektivitetin e aktorëve socialë, shumica prej tyre janë përjashtuar nga mundësia për të interpretuar rezultatet.

Sipas Habermas (1981), kur kërkuesit nuk i kanë krahasuar interpretimet e tyre me ato të pjesëmarrësve në studim, është rrezikuar një analizë e shtrëmbëruar, e cila nuk merr në konsideratë hende kun metodologjik që egziston mes “interpretimit të realitetit” dhe “realitetit të interpretuar”. Kjo formë mbikëqyrjeje metodologjike i ka çuar shumë studiues, politikbërës dhe mësues të interpretojnë sjelljet kulturore vetëm duke u bazuar në kënvështrimet dhe paragjykimet që ata kanë.

▪ *Ekipe kërkimore jorome*

Objektivizmi i romëve lidhet me mungesën e kërkuesve romë rreth studimeve mbi kulturën e tyre. Dominimi i joromëve në studimet në fushën e edukimit si nga prespektiva etnocentrike dhe ajo relativiste, ka shtuar pengesat për pjesëmarrjen e romëve në hartimin e politikave edukuese dhe prespektivave të përshtatshme. Deri disa vite më parë të gjitha studimet rreth komuniteteve rome, ndërmerreshin në mënyrë ekskluzive nga ekipe kërkuese jorome, gjë që lidhet shumti me mungesën e qasjes në trajnimet e nevojshme, mungesën e kapitalit social si dhe burimeve për të kryer studime. Kompleksiteti i procesit dhe struktura e komunitetit shkencor, ka penguar dhe më tej pjesëmarrjen e romëve në studime dhe pozicione të tjera profesionale. Mjaft studiues kanë nënvizuar faktin se mungesa e ekspertëve romë ka penguar përfshirjen e tyre në procesin e politikëbërjes. Sipas Mac Laughlin (1999):

Debati rreth romëve si “të tjerët”, në Evropë sot ndodh jashtë komuniteteve dhe aktiviteteve rome. Debatuesit në përgjithësi kanë pak ose aspak inpakt në vetëdijen politike dhe përvojat reale të jetës së këtyre grupeve.... Ata thjesht lejojnë teoricienët socialë të përshtasin ekspriencat e “të tjerëve”, në mënyrë që të përmirësojnë debatin akademik dhe gjithashtu lejojnë teoricienët socialë të paktën të “shtiren ” duke shprehur shqetësime rreth të marxhinalizuarve në shoqërinë Europiane (fq. 57).

Dihet se vetëm pak romë kanë arritur majat më të larta të shkollimit, të cilat zakonisht kërkohen nga komunitet maxhoritare, por metodat alternative lejojnë përfshirjen e përfaqësuesve romë, në dizenjimin, mbledhjen dhe interpretimin e të dhënave, hapa këto, që mund të arrihen nëse studiuesit i konsiderojnë ato të rëndësishme për të siguruar vlefshmërinë. Dihet se përfshirja e tyre nuk do të garantojë çrrënjosjen totale të paragjykimeve rreth minoritetit rom, por do të jetë të paktën një përpjekje apo një hap pozitiv në inkurajimin e ekipeve kërkuese multikulturore.

Teoritë deficiente

Teoritë deficiente janë pretendime pseudo-shkencore që mbështesin mendime raciste, seksiste ose homofobike, për më tepër legjitimojnë diskriminimin dhe në përgjithësi i referohen grupeve të marxhinalizuara. Teoritë deficiente gjenden në sfond të programeve speciale edukuese të cilat targetojnë romët dhe emigrantët apo komunitete si këto, si probleme që duhen zgjidhur. Në thelb të tyre përpilohen korelacione ndërmjet nivelit të edukimit që një grup njerëzish përfaqëson, shkallës së motivimit që nxënësit kanë dhe kulturës së tyre; kështu, shkalla e lartë e analfabetizmit që komuniteti rom përfaqëson interpretohet si provë e mos interesimit të tyre në edukim. Influenca e trajtimit etnocentrik dhe relativist në teoritë deficiente është i qartë. Mos interesimi i familjeve romë për shkollat rrallë shpjegohet se vjen si rezultat i deficitit që sistemet e edukimit paraqesin, duke u parë si problem i tyre. Në këtë punim thuhet se shpjegimi i cili fajëson kulturën romë për mos interesimin e tyre rreth shkollimit është i zakonshëm mes mësuesve, politikbërësve dhe studiuesve. Sipas Kende (2000) teoritë deficiente rreth romëve gjenden në idetë dhe proceset e punës së ekspertëve edukues në Hungari të cilët shpjegojnë mosinteresimin e tyre si rezultat i “hendetit të shoqërisë”. (fq.188). Një tjetër studim rreth romëve në Spanjë, thekson se fëmijët rom shkojnë në shkollën fillore, edhe kur kanë ndjekur kopshtin, duke mbartur me vetë deficiente, të cilat përfaqësojnë një handicap. Iniesta (1981), shkruan se ky handicap zhvillohet më tej: 1. Përgjatë jetës së tyre pasi ata do ta kenë të pamundur të jenë normal 2. Ata do mbeten përgjithmonë të marxhinalizuar (fq. 179-180). Këto interpretime, shtrembërojnë arsyet e dështimit në shkollë që hasen në edukimin e romëve sot dhe që ndikojnë në vendimet e prindërve, të cilët, gjykohen në bazë të mënyrës se sa mirë ose keq ata adaptohen me kushtet që identifikohen si të vlefshme nga sistemi shkollor. Në përgjithësi teoritë deficiente mohojnë aftësinë që njerëzit kanë për të ndihmuar në përcaktimin dhe organizimin e një ambjenti shkollor sa më efektiv. Përsa i përket sistemeve Evropiane të edukimit në raport me minoritetin rom është se këto sisteme jo vetëm që nuk ndihmojnë për të ndryshuar statusin e marxhinalizuar të këtij minoriteti, por ato po kontribuojnë në stereotipe, paragjykime dhe përjashtim social të mëtejshëm. Kjo bën që diskriminimi ndaj romëve do të vazhdojë të ekzistojë dhe të zgjasë për një kohë të gjatë. Claveria et Alonso (2003) kanë vënë në dukje se, shkolla si njësi bazë e sistemit të edukimit është vendi ku së bashku me familjen formtohen qëndrimet, mësohet rreth kulturës dhe marrëdhënieve njerëzore në përgjithësi. Për aq kohë sa vetë shkolla

mëson fëmijët me qëndrime përjashtuese, kjo në vetvete e bën situatën akoma dhe më kritike (fq. 560-561). Ky sistem përjashtues edukimi ka rrënjë të thella në të kaluarën, ku shkollat Evropiane (sidomos në vendet ish-komuniste), kryesisht frekuentoheshin nga fëmijë që vinin nga shoqëri homogjene të cilët mësoheshin me principet homogjene të kulturës Evropiane. Sot është gjithnjë e më e vështirë të flasësh për mjedise homogjene. Si rrjedhojë dhe fëmijët që frekuentojnë këto shkolla janë heterogjenë kulturalisht, ndërkohë që sistemet e edukimit kanë mbetur të njëjta, duke nxjerrë në pah gjithnjë e më shumë tension dhe nevojë për ndryshim. Stafeve pedagogjike u mungojnë njohuritë dhe trajnimet speciale. E vetmja zgjedhje që grupet etnike kanë në këtë realitet është adaptimi me vlerat dhe normat e shoqërive maxhoritare evropiane në mënyrë që të jenë të suksesshëm në edukimin e tyre. Nëse nuk e arrijnë këtë, siç ndodh kryesisht me romët, ata do të kenë gjithmonë probleme me edukimin e tyre.

Teoria e zhvillimit pozitiv të të rinjëve

Në fillimet e viteve 90-të studiues të ndryshëm, profesionistë dhe politikbërës në SH.B.A, zhvillimin pozitiv të të rinjëve, filluan t'a bëjnë moto të punës së tyre. Ata kuptuan dhe evidentuan nevojën për të mbështetur të rinjtë që të mësojnë dhe zhvillohen përgjatë fushave të ndryshme, duke marrë parasysh mirëqenien konjitive, sociale, morale, qytetare, kulturore, fizike etj. Në literaturën bashkëkohore ekziston një koncept i ri për mënyrën se si perceptohet brezi i ri “ të rinjtë janë burime të cilat duhen zhvilluar” (Benson, 2003, fq.19-23). Kjo lloj paradigme konfirmon nevojën për t'i ndihmuar të gjithë të rinjtë, që të mund të zhvillojnë potencialin e tyre, përfshi këtu edhe ata me probleme, vulnerabël apo në rrezik, duke u fokusuar në pikat e forta të tyre. Kjo lloj perspektive pëpiqet t'i kthejë përgjigje këtyre pyetjeve:

Si mund të rriten të suksesshëm të rinjtë? Çfarë aftësish dhe shprehish duhet të kenë ato për të qenë të tillë? Natyrisht që për të qenë të suksesshëm, fëmijët [brezi i ri], duhet të fitojnë njohuri sociale dhe intelektuale, qëndrime dhe kompetenca që do t'i bëjnë [ata], qytetarë produktivë në të ardhmen” (Mc Donald et al, 2000, paragrafi1)

Hamilton et Pittman, K., (2004) kanë bërë përpjekje të shumta për të artikuluar konceptet dhe principet kryesore të zhvillimit pozitiv të brezit të ri. Më poshtë po paraqesim një sintezë të gjashtë principeve, për të cilat ka një konsensus të konsiderueshëm mes akademikëve dhe ekspertëve të fushës:

1. Të gjithë të rinjtë kanë një kapacitet të lindur për t'u rritur dhe zhvilluar pozitivisht.
2. Një trajektore positive e zhvillimit bëhet e mundur vetëm atëherë kur të rinjtë rrethohen nga marrëdhënie, kontekste dhe ekologji, të cilat ushqejnë dhe mbështesin zhvillimin e tyre.
3. Promovimi i zhvillimit pozitiv bëhet i mundur edhe më tepër, kur të rinjtë marrin pjesë aktive në marrëdhënie të shëndetshme, në kontekste dhe ekologji mbështetëse.
4. Të gjithë të rinjtë përfitojnë nga këto marrëdhënie, kontekste dhe ekologji. Mbështetja, fuqizimi, përfshirja janë asete zhvillimore për të gjithë të rinjtë, pavarësisht racës, etnisë, gjinisë apo të ardhurave familjare. Megjithatë strategjitë dhe metodat për të ndërtuar këto asete, variojnë në mënyrë të konsiderueshme në varësi të kontekstit social.
5. Komuniteti është një faktor tepër i rëndësishëm për zhvillimin pozitiv të të rinjve.
6. Të rinjtë janë aktorët kryesorë të zhvillimit të tyre si dhe janë burime mjaft domethënëse për të krijuar dhe ndërtuar marrëdhënie, kontekste, ekologji dhe komunitete, të cilat mundësojnë një zhvillim pozitiv të tyre(3 vv).

Mendimet dhe besimet e mësuesve mbi problemet e romëve në edukim, influencojnë në qëndrimet dhe sjelljet e tyre ndaj fëmijëve romë. Sipas mësuesve të dhënat statistikore rreth frekuentimit të ulët dhe shkallës së lartë të braktisjes, janë tregues, që shpjegojnë mosinteresimin e romëve në shkollë dhe performancën e tyre të ulët. Ata mendojnë se vetë fëmijët romë dhe familjet e tyre janë arsyeja kryesore për këtë situatë problematike. Në të vërtetë ashtu siç rezulton nga punimi, është sistemi dhe harmonizimi i cunguar i politikave arsimore me ato sociale burimi i problemit dhe përjashtimit të fëmijëve romë nga mundësia, të paktën për edukimin bazë cilësor në Shqipëri.

Në përgjithësi të gjithë nxënësit pavarësisht prejardhjes së tyre, kanë nevojë për arsimim cilësor, që do të thotë pajisja e individit me ato shprehje apo shkathtësi të cilat do t'a ndihmojnë të jetë i pjekur, aktiv dhe i përgjegjshëm në një shoqëri qytetare dhe multikulturore. Më poshtë jemi përpjekur të paraqesim një tablo të shprehive jetësore bazë të njeriut si dhe raportit shprehje-nevoja.

2.3 Shprehitë [shkathtësitë] jetësore bazë të njeriut

Kompetencat jetësore përfshijnë shprehitë personale që fëmijët dhe të rinjtë përdorin për t'u përballur me sfidat, zgjedhjet apo mundësitë e ndryshme. Ky koncept megjithëse i vështirë për t'u përkufizuar, i referohet “funksionimit të përshtatshëm”, ku individi mbështetet në burime personale dhe mjedisore, si psh të jesh i aftë të përdorësh njohuritë personale për një situatë sociale, të bësh ose jo një veprim të caktuar, të jesh i aftë të kërkossh ndihmë kur të nevojitet etj. Në vendin tonë, arsimi parauniversitar synon të krijojë kushte dhe mundësi, që nxënësi të ndërtojë dhe të zhvillojë njohuri, shprehi [shkathtësi], qëndrime dhe vlera, që kërkon shoqëria demokratike, siç janë zhvillimi i individit në mënyrë të pavarur e të gjithanshme, kontributi në ndërtimin e mirëqenies vetjake dhe të shoqërisë, si dhe përballja në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës. Të gjithë fëmijët, pavarësisht nga prejardhja dhe aftësitë, kanë nevojë për shkathtësi, që t'u mundësojnë shfrytëzimin e diturive të tyre, me qëllim praktikimin e formave të shëndosha të sjelljes dhe shmangien e atyre formave, që paraqesin kanosje ndaj shëndetit të tyre personal, emocional dhe social. Arsimimi për shprehi apo shkathtësi jetësore, nisët nga premisa themelore se përvetësimi i shkathtësive jetësore është e drejtë e çdo fëmijë. Ai duhet t'i përgjigjet nevojave të fëmijëve të secilës moshë.

Termi shkathtësi (shprehi) jetësore i referohet një grupi të madh shkathtësish apo shprehish psiko-sociale, qëllimi i të cilave është të kontribuojnë për zhvillimin personal, emocional dhe social të fëmijëve, si dhe të sigurojnë mirëqenie fizike, mendore dhe sociale për ta. (Petroska-Beshka et al., 2009, fq. 7)

Shprehitë apo shkathtësitë jetësore janë të shumta. Cilat shkathtësi jetësore do të theksohen dhe cilave do t'u kushtohet vëmendje më e madhe në shkollë, kjo varet kryesisht nga nevojat konkrete të vetë nxënësve.

Petroska-Beshka et al (2009), kanë vënë në dukje se është vështirë të bëhet një listë e të gjitha shkathtësive të mundshme jetësore, por zakonisht si më të rëndësishme mund të konsiderohen ato që janë dhënë në tabelën që vijon:

Tabela 1

Vetëdija për veten Vetëdija për vlerat personale (vetëbesimi, imazhi pozitiv për veten) Vetëdija për dobësitë personale (prishmëritë reale, imazhi real për veten) Vetëdija për të drejtat dhe përgjegjësitë Motivimi dhe kujdesi për vetveten	Empatia Kujdesi për të tjerët Toleranca ndaj dallimeve Respektimi i të tjerëve Të qenët i shoqërueshëm
Shkathtësitë komunikuese Komunikimi efektiv dhe adekuat verbal dhe joverbal Aftësia për t'u shprehur Dëgjimi aktiv Aftësia për bisedime	Shkathtësitë interpersonale Bashkëpunimi Përgatitja për punë në grup Formimi dhe ndërprerja e miqësive Njohja e kufijve të sjelljes adekuate interpersonale
Shkathtësitë e marrjes së vendimeve Marrja e vendimeve me vetëdije të plotë për faktorët që ndikojnë në mendimin dhe zgjedhjen Marrja e vendimeve që janë të bazuara në vlerësim të saktë të situatës Parashtrimi i qëllimeve reale Planifikimi i procedurave personale duke marrë parasysh pasojat e mundshme Marrja e përgjegjësisë personale Përgatitja për ndryshimin e vendimeve me qëllim përshtatjen ndaj situatave të reja	Shkathtësitë për zgjidhjen e problemeve Identifikimi i problemeve dhe shkaqeve të lindjes së tyre Vlerësimi i saktë i veprimeve, që mund të ndërmerren për zgjidhjen e problemeve Njohuritë se ku mund të kërkohet ndihmë për zgjidhjen e problemit. Përgatitja për kompromis Përgatitja për pjesëmarrje në zgjidhjen e problemeve në grup.
Të menduarit krijues Të menduarit pozitiv Mësimi aktiv (nevoja për të kërkuar njohuri të reja) Aftësia për ta shprehur vetveten Identifikimi i mundësive alternative Zbulimi i zgjidhjeve origjinale të problemeve	Të menduarit kritik Njohja e ndikimeve sociale dhe kulturore ndaj qëndrimeve, vlerave dhe sjelljes (përfshirë edhe presionin e moshatarëve dhe ndikimin e mediave) vetëdija për pabarazinë, padrejtësinë dhe paragjykimet Vetëdija për rolin e qytetarit të përgjegjshëm
Ballafaqimi me emocionet Njohja e emocioneve personale dhe e emocioneve të të tjerëve Ndërlidhja e emocioneve me përjetimet, të menduarit dhe sjelljen Ballafaqimi me frustracione, hidhërim, pikëllim, frikë dhe ankth Ballafaqimi me emocione të fuqishme të të tjerët	Ballafaqimi me stresin Ballafaqimi me situata në të cilat nuk mund të ndikohet zhvillimi i strategjive për t'u ballafaquar me humbjen, refuzimin dhe kritikën Ballafaqimi me përdorimin e substancave psikotropike Rezistenca ndaj trysnive Ballafaqimi me situata të stresit menaxhimi i kohës

(8 vv)

Raporti shprehi [shkathtësi] nevoja

Nxënësit në përgjithësi pavarësisht prejardhjes së tyre, kanë nevojë për ato shkathtësi që do t'i ndihmojnë ata të jenë të pjekur, aktivë dhe persona të përgjegjshëm në një shoqëri qytetare dhe

multikulturore. Ajo që e dallon arsimimin për shkathtësi jetësore nga qasjet e tjera të cilat orvaten të ndikojnë në sjelljen e fëmijëve, qëndron në faktin se arsimimi për shkathtësi jetësore është i orientuar drejt futjes së ndryshimeve të sjelljes përmes përvetësimit të diturive, qëndrimeve dhe shprehive të caktuara. Këto qëndrime dhe shprehje i ndihmojnë fëmijët të zgjedhin dhe praktikojnë sjellje të shëndosha, në vend të mësimit të thatë me shpjegimin se ç'do të thotë x sjellje në teori. Detyra themelore e arsimimit me fokus shprehitë jetësore është ta transformojë diturinë në sjellje, prandaj secili program për shkathtësi jetësore duhet të ofrojë raport të balancuar ndërmjet: (1) diturive dhe informacioneve; (2) qëndrimeve dhe vlerave dhe (3) shkathtësive. Arsimimi me fokus shprehitë jetësore bazohet në metodat pjesëmarrëse të mësimit dhe mësimdhënies, që i bën fëmijët pjesëmarrës aktivë në procesin e mësimit, në vend që t'i trajtojnë ata si pranues pasiv të informacioneve. Nëse do ti referoheshin programeve mësimore të arsimit parauniversitar për lëndë të ndryshme, qoftë programeve të shkencave sociale, atyre natyrore etj, do të konstatojmë se ato i përshkon një fill i përbashkët: Ato i shërbejnë zhvillimit të kompetencave, shprehive dhe synojnë të ndihmojnë nxënësin, të lidhë shkollimin e tij me jetën e përditshme. Shprehitë apo kompetencat sociale p.sh i gjejmë fare mirë të pasqyruara në tekstin "Program i Qytetarisë" (2014), për klasat 1 dhe 6 ku është nënvizuar rëndësia e krijimit të shprehive apo kompetencave sociale tek nxënësit. Sipas këtij programi qytetaria demokratike i shërben nxënësit për zhvillimin e kompetencave të qytetarisë, në mënyrë që ai të përballojë sfidat e jetës. Ajo bazohet në një metodë shumëpërmasore e cila përfshin:

Përmasën politike, pjesëmarrja në procesin e marrjes së vendimit dhe në ushtrimin e pushtetit politik.

Përmasën ligjore, vetëdija dhe ushtrimi i të drejtave dhe përgjegjësisë qytetare.

Përmasën kulturore, respekti për të gjithë njerëzit, vlerat themelore demokratike, për historinë dhe trashëgiminë e përbashkët dhe njëkohësisht të ndryshme, si dhe ndihma për vendosjen e marrëdhënieve ndërkulturore paqësore.

Përmasën shoqërore dhe ekonomike, veçanërisht në përpjekjet kundër varfërisë dhe përjashtimit social, përpjekjet për krijimin e formave të reja të punës dhe të zhvillimit të komuniteteve... Ekonomia të mund të ndihmojë krijimin e një shoqërie demokratike.

Përmasa evropiane, vetëdija për unitetin dhe diversitetin e kulturës evropiane dhe të mësuarit për të jetuar në një kontekst evropian.

Përmasën globale, njohja, pranimi dhe nxitja e ndërvlerësive dhe solidaritetit global. (5, vv)

Formimit të shprehive apo kompetencave jetësore të nxënësit i shërben edhe edukimi nëpërmjet mësimit të integruar, i cili sipas Zenelaj & Bajrami (2008), është një koncept i orientuar nga e ardhmja dhe mbështetet në idenë se mësimi duhet të përqendrohet në njohuritë, aftësitë, vlerat dhe qëndrimet, që u nevojiten nxënësve për t'u orientuar natyrshëm në një botë komplekse, të ndërvleruar dhe në ndryshim të shpejtë. Kështu në kurrikulën e re të biologjisë në mënyrë të përmblodhur janë trajtuar lidhjet dhe bashkëpunimi i biologjisë me lëndët e tjera si më poshtë:

Shkencat e natyrës:Bashkëveprimi i njohurive të këtyre lëndëve krijon për nxënësit kushtin paraprak për ndërtimin e një imazhi racional të botës dhe të bazuar në shkencat natyrore.

Shkencat shoqërore dhe humane: Në kuadër të projekteve të ndryshme, krijohet mundësia e një bashkëpunimi të mirë ndërmjet biologjisë dhe lëndëve shoqërore, veçanërisht në fushat e edukimit seksual, të të ushqyerit të shëndetshëm, edukimi për HIV/AIDS, parandalimin e drogës, duhanit, alkoolit, të edukimi mjedisor, etj.

Fusha e artit: Pasuria e magjishme e formave të natyrës është një burim i rëndësishëm për shpalosjen e fantazisë dhe të krijimit edhe në fushën e artit, duke dhënë kështu një ndihmesë me vlerë në formimin estetik të nxënësve përmes muzikës, pikturës, veprimtarive artistike etj. Në këtë mënyrë biologjia realizon formimin shkencor dhe zhvillimin e personalitetit të nxënësve si më poshtë: Rruga drejt fitimit të njohurive empirike Në mësimet e biologjisë nxënësit njihen me rrugën e përftimit empirik të njohurive dhe në bazë të rregullave të njohura mund të bëjnë parashikime. Procesi mësimor i orientuar drejt veprimit, kontribuon në përftimin e aftësive dhe qëndrimeve, të cilat janë të përbashkëta për të gjitha lëndët e shkencave natyrore. Nxënësit, në bazë të planifikimit dhe kryerjes së eksperimenteve, mësojnë të vëzhgojnë dhe të përshkruajnë qartë, të paraqesin dhe të interpretojnë saktë.

Aftësia për abstraksion dhe të menduarin logjik: Në orën e mësimit të biologjisë nxënësit merren gjithnjë e më shumë me çështje që përmbajnë kërkesa që kërkojnë zbatim, të cilat

kërkojnë si kusht paraprak të menduarit e përgjithshëm dhe logjik duke përdorur njohuritë bazë të këtyre shkencave. Për shembull, puna që bëhet me paraqitjen e niveleve të ndryshme të organizimit të së gjallës (organela, qeliza, inde, organe, organizma, popullime, bashkësi jete, sisteme ekologjike dhe biosfera) nxisin të menduarin abstrakt dhe krijojnë të menduarin logjik.

Aftësia e gjykimit: Mësimi i biologjisë transmeton njohuri orientuese, të cilat u mundësojnë nxënësve pjesëmarrjen në komunikim dhe në procese vendimmarrëse, të cilat u përkasin çështjeve biologjike, shëndetësore e mjedisore.

Në mënyrë të veçantë lënda e biologjisë është shumë e rëndësishme për **imazhin e njeriut**. Nxënësit njihen me bazat e organizimit të çdo qenieje; kjo çon në gatishmërinë për të pranuar veten dhe për të kontribuar në mënyrë aktive në ruajtjen e shëndetit personal, por edhe në respektin ndaj të tjerëve dhe të të gjitha qenieve të tjera të gjalla.(20 vv)

2.4 Situata dhe nevojat e komunitetit rom në Europë

Romët në Europë gjithmonë kanë pasur një qëndrim pro-aktiv ndaj tregtisë. Në shoqëritë ish komuniste shumë familje rome kanë treguar aftësitë e tyre në aktivitete të vogla tregtare. Në shumë vende të Europës, me ardhjen e zhvillimit ekonomik, romët u vendosën në periferitë e qyteteve në gjendje të vështirë sociale dhe ekonomike. Sipas Liegeois (2007) ndryshimet në ekonomi dhe rregullat e reja e kanë komplikuar tregtinë e vogël, nëpërmjet aplikimit të taksave, përpjekjeve për të zbatuar ligjet etj. Meqenëse nuk janë pjesë e organizatave të biznesit romët në Evropë, nuk mund të jenë pjesë e qarqeve politike si dhe nuk mund të gëzojnë mbrojtjen e unioneve tregtare. Çdo shtet ka rregulla fikse që kanë kufizuar prodhimin në vend dhe si rezultat shumë familje rome nuk mund të sigurojnë minimumin e mundshëm të jetesës, duke u bërë të varura nga ndihma sociale. Në Europën Perëndimore punësimi me rrogë të rregullt po bëhet gjithminë e më i shpeshtë, ndërsa në Europën Lindore, një numër i vogël romësh janë të punësuar në punë jo të rëndësishme dhe trajtohen si qytetarë të dorës së dytë, si në shoqëri edhe në punë. Pra punësimi nuk ka ndikuar në integrimin e këtyre grupeve. Në shumë vende pjesa dërmuese e romëve është e papunë dhe gjithnjë e më shumë po rritet varësia e tyre ndaj ndihmës sociale. (89, vv)

Po sipas Liegeois (2007) sot në shumë vende mijëra familje rome jetojnë në baraka veçuar nga komunitetet fqinje. Mungesa e hapësirës për të jetuar, i detyron të jetojnë në një dhomë, me

mungesë uji dhe ngrohjeje, mungesë mundësish punësimi, indiference sociale dhe politike etj. E gjithë kjo ka bërë që çështjet mbi kulturën, arsimin apo të ardhmen të jenë gati të pavlera, kur jeta ka degjeneruar në një luftë të përditshme për të mbijetuar. Kështu afërsisht 9 milionë romë në të gjithë Europën, gjysma janë të moshës shkollare, por jo të gjithë frekuentojnë shkollën. Një studim i kryer në dhjetë vende të BE-së më 1985 dhe dy të tjera më 1988, treguan se vetëm 30-40% e fëmijëve romë frekuentonin shkollën. Përqindja e fëmijëve që shkonin deri në shkollën 8-vjeçare ishte e vogël, nivelet e arritjeve të fëmijëve, sidomos në shkrimin e leximin e përditshëm ishin nën normë, duke marrë parasysh kohëzgjatjen e frekuentimit të shkollës, tregues ky se shkolla nuk po e kryente funksionin e saj në lidhje me aftësitë bazë” (163, vv).

Romët përbëjnë grupin minoritar më të madh në Europë. Disa shtete në Europë kanë filluar të zhvillojnë dhe realizojnë politika mbi arsimimin e romëve dhe shtegtarëve. Që nga 1960-ta deri më sot, asnjë qeveri europiane nuk mund të pretendojë për një rezultat plotësisht të suksesshëm në mbrojtjen e të drejtave të njeriut të këtij minoriteti. Këtë pikëpamje e gjejmë të pasqyruar në një raport gjithëpërfshirës mbi situatën e romëve dhe shtegtarëve në Europë siç është Raporti mbi të Drejtat e Romëve dhe të Komuniteteve Shtegtare në Europë (2012). Sipas këtij raporti:

“Disa mijëra romë anembanë Europës nuk janë pjesë e sistemit arsimor, nuk janë fare të shkolluar ose kanë lënë shkollën me një edukim shumë të ulët. Në disa vende, fakti që romët dhe shtegtarët nuk kanë dokumente identifikimi ka një impakt negativ në rregjistrimin në shkolla. Mungesa e transportit publik ose e fondeve për transport, ashtu si dhe ngacmimet raciste dhe mungesa e materialeve shkollare, përbëjnë pengesa shitesë në rrugëtimin e nxënësve romë që dëshirojnë të shkollohen. Fëmijët romë vuajnë gjithashtu mungesën e strukturave para-shkollare. Politika dhe praktika që i ndajnë fëmijët romë nga fëmijët e tjerë në sistemin arsimor janë hasur në disa shtete anëtarë të Këshillit të Europës. Mjediset edukuese të tyre janë shpesh të izoluar në rastet kur romët jetojnë në komunitete të ndara – qofshin ato grupime në lagje të varfëra ose në geto urbane..... Dhe në shkollat e zakonshme, nxënësit romë janë shpesh të veçuar nga shumica e klasës”s.(fq. 9)

Politikat arsimore të Këshillit të Europës në lidhje me arsimin e romëve

Politikat arsimore janë konsideruar si një element kyç i të gjitha politikave sociale. Këshilli i Europës është i përfshirë në mënyrë aktive në zhvillimin e politikave dhe praktikave të mira në lidhje me arsimimin e pakicave, duke vënë theksin në mundësitë e barabarta për akses në edukimin cilësor. Organet e Këshillit të Europës kanë qenë të parat që ngritën zërin për situatën e

komuniteteve Rome duke propozuar masa praktike për përnirësimin e tyre. “Qysh më 1969 Asambleja Parlamentare[e quajtur më parë Asambleja Këshillimore], ka tërhequr vëmëndjen për problemet e diskriminimit akomodimit, sigurimit të shkollimit konsultimit, sigurimeve shoqërore dhe përkujdesit shëndetsor që prek këto komunitete”(Liegeois, 2007, fq. 248). Puna në këtë drejtim ka vazhduar në vite nga Këshilli i Europës me forma të ndryshme si: projekte pilote dhe raste studimore, module trajnimi, diskutime dhe studime të thelluara etj. KiE gjithmonë i ka dhënë vendeve anëtare udhëzime drejtuese, për një politikë edukimi për fëmijët romë në vendet e BE-së, duke vendosur prioritetet mbi struktura, kurrikula, materiale pedagogjike, rekrutimin dhe trajnimin e mësuesve, informimin, kërkimin dhe vlerësimin, konsultimin dhe koordinimin. Duke ju referuar librit” Pakicat dhe mbrojtja e të drejtave të tyre në Shqipëri” (2003), [libër i realizuar me mbështetjen e këshillit të Europës], politikat që kanë si qëllim të trajtojnë problemet me të cilat përballen romët/ciganët në fushën e edukimit duhet të jenë të gjithanshme, nisur nga fakti se çështja e shkollimit për fëmijët romë është e lidhur me një gamë të gjerë faktorësh dhe kushtesh... si aspektet sociale dhe kulturore, diskriminimi etj. (fq. 117). Këshilli i Europës duke pasur parasysh:

1. Rekomandimet 563 të vitit 1969 dhe 1203 të vitit 1993 të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, ku përmendet nevoja për arsimimin e romëve në Europë.
- 2 Rezolutat 125 të vitit 1981, 16 të vitit 1995 dhe 249 të vitit 1993, Rekomandimin 11 të vitit 1995 të Kongresit të Autoriteteve Lokale dhe rajonale të Europës për situatën e romëve në Europë.
3. Rekomandimin No.3 të Politikës së Përgjithshme të Komisionit Europia kundër racizmit dhe intolerancës për “luftimin e racizmit dhe diskriminimt kundër romëve në Europë
4. Memorandumin e përgatitur nga grupi i specialistëve për romët me titull: “Dokumenti i Politikës së Edukimit të Fëmijëve Romë: Elemente Strategjike të Politikës së Edukimit të Fëmijëve Romë në Europë (MG-S-ROM (97)11), rekomandon se parimet drejtuese të një politike edukimi për fëmijët romë në Europë duhet të mbështeten në:

Struktura

1. Politikat e edukimit të fëmijëve romë duhet të shoqërohen nga burime të përshtatshme dhe struktura elastike.... për t'iu përshtatur diversitetit të popullsisë rome.
2. Duhet koordinuar më mirë nivelet ndërkombëtare, kombëtare, rajonale dhe locale me qëllim që të shmanget shpërndarja e përpjekjeve për të siguruar bashkëjetesën.
3. Për këtë qëllim shtetet anëtare duhet të sensibilizojnë Ministritë e Arsimit për çështjet e edukimit të fëmijëve romë
4. Duhet të zhvillohen projekte të edukimit me qëllim sigurimin e mundësisë së ndjekjes së shkollës nga fëmijët romë
5. Prindërve u duhet të jepet informacion dhe këshillim i veçantë mbi nevojën e edukimit
6. Duhet të ngrihen strukturat e duhura me qëllimin e mundësive të barabarta në shkollë.
7. Shtetet anëtare duhet të ofrojnë mjetet e nevojshme për të zbatuar politikat e sipërpërmendura me qëllim mbylljen e hendekut midis nxënësve romë dhe shumicës....

• *Programe dhe materiale të mësimdhënies*

1. Politikat e edukimit në favor të fëmijëve romë duhet të kryhen brenda kuadrit të një politike më të gjerë ndërkulturore, duke mbajtur parasysh tiparet karakteristike të kulturës rome si dhe pozitën e disfavorshme të shumë romëve.
2. Programet dhe materialet e mësimdhënies duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë, që të kenë parasysh identitetin kulturor të fëmijëve romë. Kultura dhe historia rome duhet të të përfshihet në materialet e mësimdhënies, me qëllim që të pasqyrohet identiteti kulturor i tyre. Duhet të inkurajohet pjesmarrja e përfaqësuesve të komunitetit rom në hartimin e materialeve të mësimdhënies për historinë, kulturën dhe gjuhën e tyre.
3. Shtetet anëtare duhet të kenë kujdes që kjo të mos çojë në vendosjen e programeve të shkëputura, të cilat mund të na çojnë në ngritjen e klasave të veçanta.

4. Shtetet anëtare duhet të inkurajojnë hartimin e materialit të mësimdhënies bazuar mbi praktika positive, me qëllim që të ndihmohen mësuesit në punën e tyre të përditshme me nxënësit romë.

5. Në vendet ku flitet gjuha rome duhet ofruar mundësia për të mësuar në shkollë në gjuhën amëtare për fëmijët romë

- ***Punësimi dhe përgatitja e mësueve***

1. Mësuesit e ardhshëm duhet të paisem me njohuri dhe përgatitje të veçantë në mënyrë që t'i kuptojnë më mirë fëmijët romë, edukimi i të cilëve duhet të jetë pjesë përbërëse e sistemit të përgjithshëm arsimor.

2. Komuniteti rom duhet të përfshihet direkt në hartimin e programeve dhe në përpilimin e informacionit të nevojshëm për mësuesit e ardhshëm.

3. Duhet mbështetur mundësia e përgatitjes dhe punësimit të mësuesve nga vetë komuniteti.

- ***Kërkimi i informacionit dhe vlerësimi***

1. Shtetet anëtare duhet të nxisin projekte veprimi për kërkime novatore në shkallë të vogël me qëllim gjetjen për nevojat lokale të zgjidhjes në nivel lokal. Rezultatet e projekteve të tilla duhet të propagandohen.

2. Rezultatet e politikave të edukimit për nxënësit romë duhet të vëzhgohen me kujdes. Të gjithë pjesëmarrësit e përfshirë në edukimin e fëmijëve romë (autoritetet e shkollave, mësuesit, prindërit, organizatat joqeveritare), duhet të ftohen të marrin pjesë në procesin e vëzhgimit.

3. Vlerësimi i rezultateve të politikave të edukimit ndaj fëmijëve romë duhet të marrë parasysh shumë kriterë, duke përfshirë zhvillimin personal dhe social dhe të mos kufizohet vetëm në vlerësimet për frekuentimin dhe përqindjen e braktisjes së shkollës.

4. Përfshirja e të gjithë palëve të interesuara (Ministria e Arsimit, autoritetet shkollore, familjet dhe organizatat e romëve), në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave të edukimit për romët duhet të përkrahët nga shteti.

5. Duhet të përdoren ndërmjetës nga vetë komuniteti Rom, në mënyrë të veçantë për të lehtësuar kontaktet midis romëve, shumicës së popullsisë dhe shkollës, në mënyrë që të shmangen konfliktet në shkollë.

6. Ministritë e arsimit, duhet të lehtësojnë koordinimin e përpjekjeve të palëve të ndryshme të përfshira dhe të lejojnë kanalizimin e informacionit midis niveleve të ndryshme të autoriteteve arsimore.

7. Shtetet anëtare duhet të nxisin dhe të përkrahin më tej shkëmbimin e eksperiencës dhe të praktikave pozitive. (Qendra Shqiptare për të Drejtat e Njeriut, 2003, fq. 116-120)

Politikat sociale të Këshillit të Europës në lidhje me romët

Këshilli i Europës duke pasur parasysh se të drejtat sociale janë pjesë përbërëse e të drejtave të njeriut, sikundër njihen edhe nga Karta Sociale e rishikuar, gjithmonë ka rekomanduar që zbatimi i politikave sociale të synojë përmirësimin e situatës ekonomike të romëve, duke u mbështetur në:

- ***Parime të përgjithshme:***

1. Komunitetet dhe organizatat e romëve duhet të marrin pjesë në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e programeve dhe politikave, që kanë si synim përmirësimin e situatës së tyre ekonomike dhe të punësimit.

2. Qeveritë duhet të përkrahin plotësisht forcimin dhe krijimin e kapaciteteve Brenda komuniteteve rome për të përmirësuar situatën e tyre ekonomike dhe të tregut të punës.

3. Qeveritë duhet të përkrahin, me një angazhim afatgjatë, politikat ekonomike dhe të punësimit të romëve.

4. Autoritetet qendrore, rajonale dhe lokale duhet të përpunojnë struktura dhe qëndrime fleksibël, përkrah strategjive të komunikimit, të përshtatura me situatat e ndryshme të komuniteteve rome.

5. Me qëllim që të përkrahet bashkëveprimi dhe partneriteti lokal, duhet vënë theksi mbi nevojën e forcimit të koordinimit midis autoriteteve kombëtare, rajonale dhe lokale dhe organizatave të romëve.

6. Strategjitë e bazuara në zhvillimin lokal duhet të përmbajnë objektiva të qarta për komunitetin rom.

7. Legjislacioni kundër diskriminimit duhet të bëhet më i efektshëm, duke pasur parasysh se romët ndeshen me diskriminim të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë. Prandaj duhen përkrahur organizatat jo qeveritare që u ofrojnë asistencë ligjore romëve.

8. Në luftën kundër diskriminimit, mund të ndërmerrren fushata për të rritur ndërgjegjësimin e atyre që kërkojnë punë, për të mundësi të barabarta në tregun e punës.

9. Efekshmëria e ligjeve kundër diskriminimit do të përmirësohet duke paraqitur provën e akuzës për personin ndaj të cilit pretendohet diskriminimi.

10. Grumbullimi i informacionit për tregun e punës, ku është e mundur ligjërisht dhe me pëlqimin e romëve, duhet të respektojë tërësisht dispozitat e Konventës Europiane për Mbrojtjen e Individëve ndaj Përpunimit Automatik të të Dhënave Personale (ETS No.108), për të shmangur përjashtimin dhe diskriminimin e mëtejshëm.

11. Autoritetet duhet të njohin dhe ligjitojnë veprimtaritë ekonomike të nisura nga romët si dhe kontributin e tyre ekonomik në përfitimin e të ardhurave.

- ***Politika të punësimit dhe mundësi për tregun e punës***

1. Qeveritë duhet të mbështesin mundësi të barabarta për romët përse i përket tregut të fuqisë punëtore, veçanërisht nëpërmjet politikave dhe qëndrimeve jo diskriminuese nga ana e shërbimeve kombëtare të punësimit.

2. Aty ku ekzistojnë plane veprimi në shkallë kombëtare për punësimin, i duhet kushtuar vëmendje e veçantë problemeve të tregut të punës për romët dhe të përfshihen masa specifike për të përmirësuar gjendjen e tyre.

3. Përbërja e qeverive qendrore, rajonale dhe lokale duhet të reflektojë strukturën e komunitetit, të cilit ato i shërbejnë, duke përfshirë edhe romët.

4. Punësimi i romëve në të gjitha nivelet e sektorit publik duhet përkrahur, duke u vendosur partneritete me romët me qëllim që t'u jepet mundësia e kualifikimit gjatë qenies në punë. Në

raste kur është e nevojshme, duhet të zhvillohen strategji për të përmirësuar mundësinë e punësimit të romëve përmes kualifikimit të aftësive të tyre.

5. Në kuadër të masave të politikës së punësimit, mund të aplikohet heqje takse për punëdhënësit e sektori privat, që i ofrojnë romëve përvojë pune dhe mundësi punësimi

6. Një rëndësi të veçantë duhet t'i kushtohet edhe ofrimit të mundësive grave romë, që të hyjnë në tregun e punës apo të kenë mundësi për të pasur veprimtari, që janë me interes për to, në të cilat mund të vetë punësohen apo të krijojnë të ardhura.

- ***Veprimtari që gjenerojnë të ardhura***

1. Qeveritë duhet t'i heqin barrierat për krijimin e biznesit të vogël, me qëllim që të bëjnë të mundur zhvillimin e ndërrmarjeve të vogla ose familjare të romëve.

2. Qeveritë duhet të ngrejë një kuadër ligjor për ndërrmarjet sociale, të cilat shpesh mund të jenë rruga për integrimin ekonomik dhe në tregun e punës, për grupet e lëna jashtë shoqërisë.

3. Veprimtaritë që prodhojnë të ardhura nga ana e romëve duhet të përkrahen me anë të këtyre parimeve: partneritet midis organizatave joqeveritare romë dhe jo romë, hartim i politikave dhe programeve nga poshtë- lart, pjesmarrje e të gjithë palëve të interesuara, mundësi të barabarta për burrat dhe gratë, përgjegjësi dhe transparencë.

4. Qeveritë, administrata qendrore dhe lokale duhet të jenë të ndërgjegjshme për mundësitë që kanë romët për të prodhuar të ardhura në fushat e shërbimit dhe prodhimit.

5. Qeveritë duhet të përkrahin ngrijtjen e strukturave ndërmjetëse për iniciativat në nivel lokal duke ofruar asistencë në kërkimin dhe vlerësimin e nevojave dhe burimeve locale.

6. Autoritetet duhet të ofrojnë motivime për të inkurajuar shërbimet publike, të nënshkruajnë kontrata me bizneset e romëve, që këta të fundit të ofrojnë shërbime.

7. Autoritetet lokale dhe qendrore duhet të përkrahin futjen dhe zhvillimin e sistemeve të shkëmbimeve dhe tregëtisë lokale, unioneve të kreditit dhe instrumenteve të tjera financiare alternative.

8. Autoritetet lokale dhe organizatat jo qeveritare duhet të inkurajohen për të përkrahur krijimin e rrjeteve të qëndrueshme midis projekteve të industrisë dhe të romëve, si në nivel rajonal ose kombëtar ashtu edhe në nivel evropian.

9. Duhet përkrahur mundësia e organizatave tregëtare romë për të hyrë në tregjet e huaja duke bashkëpunuar me organizatat e tregëtisë së lirë.

10. Qeveritë duhet t'u garantojnë romëve mundësi të ligjshme dhe të efektshme për të pasur tokë për veprimtari bujqësore duke ngritur truste të tokës për komunitetin.

- ***Mjete Financiare***

1. Qeveritë duhet të inkurajohen për të ofruar mbështetje buxhetore afatgjatë për programet e zhvillimit dhe prodhimit të të ardhurave nga romët.

2. Strategjitë finaciare duhet të përfshijnë përkrahjen e organizatave romë dhe pro-romë, që veprojnë në fushën e veprimtarive të punësimit dhe prodhimit të të ardhurave në nivele lokale, rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare.

3. Shtetet anëtare duhet të marrin pjesë në shkëmbimet dypalëshe dhe shumë palëshe si dhe në programet europiane dhe ndërkombëtare, që kanë si objektiv romët e vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore(dhe ku është e mundur të japin për ta edhe kontribute financiare).

4. Agjensive lokale dhe qendrore duhet t'u jepen mjetet e nevojshme ligjore dhe buxhetore për të përkrahur iniciativat e zhvillimit të komunitetit rom.

5. Kanalet ndërkombëtare të fondeve, si Bashkimi Evropian, Banka Botërore, Banka e Zhvillimit të Këshillit të Europës etjluajnë një rol të rëndësishëm në ofrimin e burimeve, duke përfshirë donacione dhe hua për politikatat dhe programet e reja. Projektet e fondeve duhet të nxisin pjesëmarrjen e romëve, bashkëpunimin midis qeverisë dhe shoqërisë civile, decentralizimin e sektorëve të administratës publike si dhe ofrimin e shërbimeve nga organizatat jo qeveritare. (Pakicat dhe mbrojtja e të drejtave të tyre në Shqipëri 2003, fq. 108-115)

Nga gjithë çka paraqitëm më lart mund të themi se politikatat sociale synojnë të trajtojnë problemet që ndeshin romët në fushën e punësimit dhe të veprimtarisë ekonomike. Ato kanë si

qëllim përmirësimit të situatës ekonomike të këtij komuniteti, e cila duhet të shihet lidhur me faktorë të tjerë siç janë edukimi, kualifikimi, strehimi, diskriminimi etj.

2.5 Situata dhe nevojat e komunitetit rom në Shqipëri

Shqipëria historikisht është përmendur për bashkëjetesën në harmoni dhe paqe midis komuniteteve kombëtare dhe minoriteteve. Çdo minoritet ka demonstruar origjinalitetin e tij duke kontribuar në këtë bashkëjetesë. Për më tepër, është respektuar origjinaliteti dhe identiteti i çdo komuniteti dhe janë krijuar kushte për të ruajtur të veçantën e çdo minoriteti përgjatë brezave. Një ndër këta komunitete është edhe komuniteti Rom. Në 2011, Dekada e Përfshirjes së Romëve, ka vënë në dukje se romët janë një nga minoritetet, që jetojnë në Shqipëri dhe që konsiderohen si minoritet gjuhësor. Sipas saj studimet linguistike kanë vërejtur ngjashmëri të konsiderueshme midis gjuhës Rome dhe disa prej dialekteve të gjuhës Indiane, të cilat (sipas studjuesve) dëshmojnë për origjinën Indiane të Romëve. Ata jetojnë në Shqipëri qysh prej 600 vjetësh dhe u vendosën këtu ashtu si edhe në vende të tjera të Evropës gjatë periudhës midis shekullit të XIII-të dhe XV –të. Po sipas (DPR, 2011):

“Për numrin e popullsisë Rome në Shqipëri nuk ka statistika të plota dhe të sakta; gjithsesi, sipas përfaqësuesve të organizatave Rome në Shqipëri dhe studimeve të bëra nga institucione të pavarura, shifrat variojnë nga 90 deri 120 mijë. Shumica e minoritetit Rom jeton në zonat urbane dhe në rrethinat e qyteteve. Vlerësimet e ditëve të sotme tregojnë se ritmi i rritjes së popullsisë Rome është 3% dhe është më i lartë se ritmi i rritjes së popullsisë shqiptare. Krahasuar me shumë vende të tjera të Evropës Lindore dhe Qëndrore, përqindja e popullsisë Rome në krahasim me totalin e popullsisë shqiptare është relativisht më e vogël”. (fq. 6)

Tashmë dihet nga të gjithë se Shqipëria është e anëtarësuar në Organizatat Ndërkombëtare si OSBE, Këshilli i Evropës etj, dhe ka miratuar ose firmosur pothuajse të gjitha konventat e të drejtave njerëzore. Kjo të bën të mendosh se trajtimi i minoriteteve, në Shqipëri pas viteve '90, ka marrë një dimension të ri. Kështu Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton barazinë e të gjithëve para ligjit me Nenin 18 të saj (paragrafi 1), si dhe ndalon diskriminimin për shkak të gjinisë, racës, fesë, përkatësisë etnike, gjuhës, bindjeve fetare, politike, filozofike apo lidhjes prindërore. Për më tepër, Kushtetuta lejon zbatimin e diskriminimit pozitiv, me Nenin 18 të saj (paragrafi 3), që nënkupton marrjen e masave specifike të favorshme, për dhënien e mundësive të veçanta apo mbrojtjes, për ata individë apo kategori për të cilët, ekziston një justifikim i arsyeshëm dhe objektiv. E gjithë kjo me qëllimin final të sigurimit të mbrojtjes dhe barazisë nga

ligji për të gjithë. Nëse do të shohim me kujdes studimet, dokumentet dhe raportet e publikuara për romët, siç është “Strategjia Kombëtare Shqiptare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës të Minoritetit Rom” (2003-2015) e miratuar në 2003 me vendim të Këshillit të Ministrave, “Studim për vlerësimin e nevojave të komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri”, (2012), realizuar me mbështetjen financiare të Programit: “Një OKB – Fuqizimi i Komuniteteve Lokale në Nevojë”, “Dekada e Përfshirjes së Romëve” Plani Kombëtar i Veprimit 2010-2015 etj, do të vëmë re se situata e komunitetit Rom në Shqipëri, e evidentuar nga studimet e përmendura më lart, si edhe të tjera të tjera është:

Nivel arsimor mjaft i ulët- nivel i ulët i rregjistrimit në shkolla, shtim i analfabetizmit.

Varfëri dhe papunësi- shumica e familjeve rome jetojnë nën nivelin e varfërisë dhe norma e papunësisë midis romëve është shumë më e lartë krahasuar me atë të pjesës tjetër të popullsisë.

Kushte të këqija jetese- shumë prej familjeve rome iu mungon strehimi i sigurtë, kushtet sanitare ose furnizimi me ujë të pijshëm etj

Shërbim shëndetësor i pamjaftueshëm- disa zona të banuara nga romët nuk kanë akses në institucionet e shërbimit shëndetësor dhe/ose popullsia nuk mund të paguajë për shërbimet shëndetësore apo ilaçet.

Një situatë e tillë ka bërë që niveli i varfërisë i familjeve rome të jetë i lartë dhe familjet e varfëra dhe shumë të varfëra rome të përballen me nivele të larta të përjashtimit social, sepse ato janë më pak të afta të përballojnë nevojat e jetës së përditshme dhe kanë më pak mundësi të marrin pjesë në proceset që ndikojnë në jetën e tyre, të tilla si punësimi dhe arsimi etj. Sipas Gëdeshit dhe Milukës (2012):

“në Shqipëri romët, ashtu si popullsia në shumicë, kanë një kuptim shumëdimensional për varfërinë. Ata e kuptojnë varfërinë në aspektin e pamundësinë për të plotësuar nevojat materiale, për të vazhduar traditat familjare, me ndjenjën e përjashtimit nga jeta sociale e ekonomike, me mungesën e shpresës dhe të sigurisë. Elementi më i rëndësishëm janë nevojat materiale (ushqim, veshje, strehim, etj). Rrjedhimisht, duke u bazuar në vetëvlerësimin e romëve..., në shkallën e plotësimit të nevojave për ushqim, veshje, strehim etj, familjet e tyre ndahen në katër grupe të ndryshme socio-ekonomike: shumë të varfër, të varfër, jo të varfër dhe relativisht në gjendje të mire”. (fq. 36)

2.6 Arsimimi i komunitetit rom në Shqipëri

Niveli i arsimimit, i shkrimit dhe këndimit i popullsisë Rome është shumë më i ultët sesa mesatarja në shkallë kombëtare. Nëse do t'i referoheshim një pyetsori të PNUD, pasqyruar në studimin "Prekshmeria shoqërore e romëve në Shqipëri"(2006):

"përqindja mesatare e shkrimit dhe këndimit tek Romët është vetëm 62%, ndërkohë që përqindja e shkrimit dhe këndimit tek popullsia jo-Rome rezulton 97%. Gratë Rome kanë mesatarisht nivel më të ulët arsimimi sesa burrat Rom. Vetëm 58% e grave Rome të anketuara rezultuan që dinin shkrim dhe këndim, krahasuar me 66% të burrave Romë, ndërkohë që ky nivel rezultoi 96% për gratë jo-Rome ,e krahasuar me 98% të burrave jo-Romë. Numri mesatar i viteve të shkollës së Romëve është 3.4 (3.8 për burrat dhe 3.1 për gratë), ndërsa për popullsinë jo-Rome ky tregues është 9.8%". (fq. 22-24)

Numri i nxënësve romë në të gjitha nivelet e sistemit arsimor është dukshëm më i ulët sesa numri i nxënësve nga të gjithë komunitetet e tjera. Ka tregues të dukshëm që tregojnë se një numër i madh fëmijësh romë nuk e frekuentojnë shkollën fare ose e braktisin atë në klasën e tretë apo të katërt, madje edhe e braktisin qysh në muajt e parë të klasës së parë në shkollën fillore. Shkaqet e nivelit të ulët të arsimimit në komunitetin rom janë të shumta, por më i rëndësishmi është varfëria ekstreme. Të ardhurat mujore për frymë midis Romëve janë 3.3 herë më të ulëta se ato të popullsisë jo-rome dhe shumë familje rome jetojnë në vështirësi(De Soto et al 2005, fq.55). Për shkak të varfërisë ekstreme, mjaft familje të këtij komuniteti, nuk mund të përballojnë blerjen e teksteve dhe materialeve të tjera shkollore, apo të ushqejnë fëmijët e tyre në mënyrën e duhur, ose t'iu blejnë atyre veshje për të shkuar në shkollë. Shumë shpesh fëmijët romë hyjnë në tregun e punës në një moshë shumë të hershme, në mënyrë që të kontribuojnë për mbijetesën e familjeve të tyre. Janë mjaft faktorë të tjerë, që ndikojnë qoftë në përqindjen e regjistrimit, qoftë në braktisjen e shkollës nga ana e fëmijëve romë, si psh:

Migrimi dhe emigrimi: mjaft fëmijë romë nuk rregjistrohen në shkollë ose e braktisin atë, pasi familjet e tyre migrojnë gjatë vitit akademik apo vendosin të shkojnë diku jashtë. Në raste të tilla është e vështirë, që pasi ata të kthehen, t'i rikthehen arsimimit dhe të përfundojnë klasën në fund të vitit shkollor. (DPR, 2011, fq.11)

Mungesa e dokumenteve të identifikimit: një pengesë e madhe për regjistrimin e fëmijëve romë në shkollë, ka qenë gjithashtu fakti se romët përballen me vështirësi në pajisjen me dokumente identifikimi.

Niveli i ulët arsimor i prindërve Romë. Pritshmëritë e ulta të prindërve, janë një prej arsyeve, që i pengojnë fëmijët të shkojnë në shkollë, apo t'a braktisin atë përfundimisht pasi rregjistrohen. Rreth 13% e fëmijëve romë të intervistuar pohojnë se nuk kanë marrë shkollim sepse ata “ishin ndaluar prej prindërve të tyre”. (PSHRSH, 2006, fq.25).

Paaftësia për të folur shqip. Paaftësia për të folur shqip përbën një vështirësi reale, e cila varet nga mungesa e klasave parashkollore të mësimi të gjuhës shqipe për këta fëmijë dhe mungesa e mësuesve romë. Vështirësitë gjuhësore sjellin vështirësi në shkollë dhe për pasojë kemi braktisje të madhe të shkollës. (PSHRSH, 2006, fq.26).

Po sipas De Soto et al 2005, rezulton që 53% e Romëve mbi 6 vjeç nuk e kanë mbaruar klasën e parë dhe 62% e Romëve midis 7 dhe 20 vjeç nuk kanë frekuentuar asnjëherë shkollën.(fq.56)

Duke parë këtë situatë Shteti Shqiptar ka bërë përpjekje për reforma në sistemin arsimor, të cilat janë përqendruar në hartimin e një kornize të plotë ligjore, për të garantuar të drejtën për arsimim personave, që i përkasin minoriteteve etnike, si dhe zhvillimin e programeve të reja shkollore, në mënyrë që të sigurohet arsimimi i duhur, i cili duhet të jetë në përputhje me standartet moderne Evropiane. Sistemi arsimor kombëtar ka si qëllim të tijin të shërbejë si sektor shërbimi, i cili synon paisjen e qytetarëve të ardhshëm shqiptarë, me njohuritë e nevojshme, me aftësitë e shkathtësitë e mjaftueshme, të edukuar dhe të përkushtuar për të realizuar planin kombëtar ekonomik e zhvillimor të vendit. Në shërbim të këtij qëllimi duhet të jenë edhe politikat arsimore të ndërmarra në vite.

2.7 Politikat arsimore në Shqipëri

Gjatë dy dekadave të fundit, sistemi arsimor parauniversitar (SAPU) ka kryer një cikël ndryshimesh reformuese, në nivel sistemi dhe në praktikën mësimore, duke kaluar nëpër 3 faza kryesore. Sipas raportit paraprak “Reforma e sistemit arsimor”, (2014), këto tri faza janë:

1. Faza e korrektimit të brendisë së arsimit (deri në vitin 1995).
2. Faza e përgatitjeve për ndryshim, bazuar në ligjin nr. 7952, datë 21.06.1995, "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar (1995-2010).
3. Faza e reformimit të mëtejshëm të SAPU, bazuar në ligjin 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në R. Sh” (2012 e në vijim).

Në fazën e parë, u synua “pastrimi” nga “trashëgimia” dhe ndikimet e ideologjisë komuniste. Si arritje kryesore mund të vlerësohen çlirimi i kurrikulës nga manipulimet politike dhe deformimet ideologjike, zvogëlimi relativ i ngarkesës mësimore, baraspeshimi më i mirë i dijeve, shkathtësive dhe qëndrimeve, rishqyrtimi i objektivave dhe përmbajtjeve të lëndëve shoqërore, si dhe futja e disa lëndëve të reja (informatika, edukimi qytetar) etj.

Në fazën e dytë, u synua përgatitja e bazës ligjore që ligjëroi nevojën për ndryshimin e përgjithshëm. U analizua cilësia e kurrikulës dhe u njohën më mirë përvojat dhe zhvillimet bashkëkohore. U thellua bashkëpunimi me organizata të huaja dhe me Bankën Botërore, me ndihmën dhe ekspertizën e së cilës u hartuan dy strategji kombëtare të arsimit dhe u zbatuan dy projekte madhore për rritjen e cilësisë (2000-2005; 2006-2010). Ndryshimet prekën strukturën e sistemit arsimor, kurrikulën dhe sistemet e menaxhimit. Por, pavarësisht përpjekjeve dhe investimeve, vlerësimet e agjencive kombëtare dhe ndërkombëtare treguan se cilësia e arritjeve të nxënësve është e dobët, sikundër janë të tilla efienca dhe efektiviteti i sistemit.

Në fazën e tretë, po bëhen përpjekje që SAPU-ja të ofrojë arsim demokratik, duke marrë parasysh kërkesat e parimeve themelore të barazisë së mundësive për arsim cilësor dhe të respektimit të dallimeve individuale (5. vv). Po sipas këtij raporti:

Vizioni arsimor në Shqipëri shpalos një sistem arsimor, që ka në qendër nxënësin me nevojat dhe interesat e tij, i ndryshëm rrënjësisht nga sistemi tradicional që e detyronte nxënësin t'i përshtatej atij mekanikisht. Sistemi i sotëm është një sistem arsimor ku nxënësit dhe mësuesit duhet të punojnë së bashku, një sistem ku dijet e fushave të nxënies dhe kompetencat e ndërtuara nga subjektet, duhet të prodhojnë zgjidhje për problemet e ndërlikuara jetësore për individin dhe shoqërinë, një sistem që vlerëson forcën e larmisë kulturore, gjuhësore dhe të teknologjive bashkëkohore të informimit dhe të komunikimit, për t'i përgatitur nxënësit të përballen me vetëbesim me sfidat e mjedisit global, një sistem ku të gjithë aktorët dhe përfituesit të aftësohen për të nxënë gjatë gjithë jetës. (fq. 9-10).

Thënë ndryshe sistemi ynë arsimor kombëtar shërben si sektor shërbimi, që ka si qëllim paisjen e qytetarëve të ardhshëm shqiptarë me njohuritë e nevojshme, me aftësitë e shkathtësitë e mjaftueshme, të edukuar dhe të përkushtuar për të realizuar planin kombëtar ekonomik e zhvillimor të vendit. Ky sistem, duke synuar plotësimin e nevojave kombëtare të tregut të punës dhe aspiratat social-kulturore të popullit, paraqitet si kushtëzues për rritjen ekonomike dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Një nga kushtet bazë për të arritur të gjitha këto është edhe përpjekja për të vënë në jetë parimin e arsimit gjithëpërfshirës.

Arsimi Gjithpërfshirës

Arsimi gjithëpërfshirës është një temë shumë e studiuar e cila përfshin një tërësi sfidashme të cilat ballafaqohen proceset e zhvillimit të politikave dhe të zbatimit të tyre. Konceptimi i arsimit gjithëpërfshirës...varion nga këndvështrimet më të ngushta, të tilla si: arsimigjithëpërfshirës, konsiderohet si “përpjekje për të arsimuar njerëz me paaftësi intelektuale duke i integruar ata sa më pranë strukturave përkatëse të sistemit të arsimit”, deri në ato më të gjerat, të tilla si: arsimi gjithëpërfshirës konsiderohet “një parim udhëheqës për të mbështetur Arsimin për të Gjithë” (Michailakis & Reich, 2009, fq.25). Pikërisht këto sisteme arsimimi, që përfitojnë nga diversiteti, synojnë ngritjen e një shoqërie thjesht më shumë demokratike (Acedo, 2008, fq. 5). Sikurse shprehen Sebba & Sachdev, (1997), arsimi gjithëpërfshirës në një këndvështrim më të gjerë, kuptohet si një proces përmes të cilit shkollat përpiqen t’i përgjigjen të gjithë nxënësve, si individë mëvete...Përmes këtij procesi, shkollat ndërtojnë kapacitetet e tyre, për të pranuar të gjithënxënësit nga komuniteti lokal, të cilët dëshirojnë të ndjekin arsimin, dhe në këtë mënyrë reduktojnë të gjitha format e përjashtimit dhe të poshtërimit të nxënësve, që kanë të bëjnë me paaftësinë e tyre, etnicitetin, apo çdo gjë tjetër që bëhet shkak për t’ia bërë jetën shkollare tej mase të vështirë këtyre fëmijëve”. (78, vv).

Në një kuptim më të gjerë, gjithëpërfshirja është një proces i rritjes së pjesëmarrjes dhe uljes së përjashtimit, përmes të cilit pjesëmarrja nënkupton njohje pranimit dhe respekt, si dhe përfshirje në procesin e të nxënësve dhe në veprimtaritë sociale, në mënyrë të tillë, që i siguron individit zhvillimin e ndjesisë që është pjesë e kësaj shoqërie.

Politikat arsimore për komunitetin rom në Shqipëri

Ndryshimet e paraqitura më lart në sistemin arsimor parauniversitar janë ndryshime në nivelin e sistemi dhe në praktikën mësimore, që prekin arsimimin e fëmijëve dhe minoriteteve në përgjithësi. Përsa i përket minoritetit rom në veçanti, mund të themi se deri në vitin 2003, në Shqipëri, nuk ka pasur politika më vete për arsimimin e tij. **Në vitin 2003** u miratua nga qeveria shqiptare “Strategjia kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom” që përfshin periudhën 2003-2015. Në këtë dokument krahas aspekteve të tjera sociale, kulturore dhe ekonomike, janë shprehur në një seksion të veçantë edhe politikat për arsimimin e minoritetit rom. Kjo strategji shoqërohet edhe nga Plani i Veprimit, i cili përcakton specifikisht aktivitetet,

autoritetet përkatëse dhe buxhetin e parashikuar. Të gjitha shërbimet e ofruara ndaj romëve bazohen në të drejtat e njeriut, sipas së cilave institucionet publike, kanë për detyrë të ofrojnë shërbime për anëtarët e komunitetit rom, të cilët kanë të drejtën të kërkojnë përfitimin e këtyre shërbimeve dhe respektimin e drejtave të tyre. **Në vitin 2007** u hartua “Strategjia për përfshirjen sociale”, që përfshin periudhën 2007-2013. Tamo dhe Karaj (2007), kanë vënë në dukje se edhe në këtë dokument, i jepet rëndësi edhe arsimimit të fëmijëve romë, me objektiva të njëjta me “Strategjinë kombëtare, për përmirësimin e kushteve të jetesës së minoritetit rom” të vitit 2003. Këto objektiva synojnë **edukimin e fëmijëve në moshën parashkollore** nëpërmjet:

- Evidentimit të numrit të fëmijëve që duhet të frekuentojnë kopshtet
- Evidentimit të frekuentimit të kopshteve nga fëmijët romë
- Evidentimit të kapaciteteve thithëse të objekteve parashkollore në zonat ku banon minoriteti rom dhe sugjerime për të ardhmen
- Rikonstruksionit të kopshteve që janë në gjëndje jo të mirë në zonat ku banon komuniteti rom
- Ngritjen e objekteve të reja në zonat ku aktualisht nuk ka kopshte për fëmijë sipas nevojave që lidhen me numrin e fëmijëve
- Domosdoshmërisë së mësimi të gjuhës shqipe për grupin e tretë të arsimit parashkollor për t’i përgatitur fëmijët për klasën e parë; si dhe
- Emërimin e edukatoreve me përvojë duke marrë më parë mendimin e minoritetit, si dhe **arsimimin e fëmijëve romë** që duhet të realizohet nëpërmjet:
- Evidentimit të numrit të nxënësve që duhet të frekuentojnë shkollën.
- Evidentimit të gjendjes së frekuentimit të shkollës.
- Sensibilizimit të opinionit rom për regjistrimin e nxënësve në shkolla e cila do të bëhet vazhdimisht.
- Marrjes së masave ndëshkimore ndaj familjeve që nuk çojnë fëmijët në shkolla.
- Evidentimit të kapaciteteve thithëse të objekteve shkollore në zonat ku banojnë romët dhe sugjerimeve për të ardhmen për shkollat, që kanë nevojë për rikonstrukcione ose ngritjen e shkollave të reja në funksion të kërkesave të numrit të nxënësve, duke caktuar në këto shkolla mësues me përvojë duke i kualifikuar dhe stimuluar ata por në të njëjtën kohë.

- Stimulimit të nxënësve nëpërmjet dhënies falas të teksteve shkollore për ciklin e ulët dhe 9-vjeçar
- Organizimit të aktiviteteve brënda dhe jashtë shkollës.
- Intensifikimit të punës me prindërit romë për ndërgjegjësimin e tyre për një qëndrim dhe vlerësim sa më pozitiv ndaj shkollës
- Paisjes së shkollave me bazë materiale didaktike të nevojshme për ta bërë sa më tërheqës mësimin, me laboratorë të gjuhëve të huaja dhe të informatikës si dhe hapjes në shkollat e mesme profesionale, ku numri i nxënësve romë është i konsiderueshem i kurseve për gjuhën romë si dhe i kurseve të trajnimit sipas natyrës së shkollës, traditës dhe prirjeve të këtyre nxënësve
- Organizimit për nxënësit që kanë vështirësi për të folur gjuhën shqipe në klasën e parë i kurseve për mësimin e gjuhës shqipe
- Organizimit të punës së diferencuar në shkollë për evidentimin e talenteve me qëllim që t'u krijojnë mundësinë nxënësve romë për të konkuruar në shkollat artistike dhe profesionale.
- Eliminimit të analfabetizmit nëpërmjet kurseve për të rriturit që kanë braktisur shkollat.” (40, vv)

Në vitin 2008 Shqipëria u bë vend anëtar në Dekadën e Përfshirjes së Romëve **2005-2015**, një angazhim politik i vendeve evropiane, për përmirësimin e situatës socio-ekonomike të komunitetit rom si dhe për të rritur përfshirjen sociale të këtij komuniteti. Kjo nismë është një iniciativë e cila përfshin shumë qeveri, organizata të rëndësishme ndërkombëtare dhe në veçanti përfaqësuesit e shoqërisë civile romë. Qëllimi është që të përshpejtojë procesin e përparimit dhe përmirësimit të gjendjes së komunitetit rom dhe në veçanti të vlerësojë dhe analizojë këtë proces në mënyrë transparente dhe të matshme. Dekada është inisiativa më e plotë për përmirësimin e jetesës së romëve në Shqipëri. Ajo vë theks të veçantë në arsimimin e fëmijëve romë, duke e konsideruar këtë të fundit si një nga rrugët kryesore të integritit të tyre në shoqëri. Dekada fokusohet në disa fusha prioritare të tilla si arsimi, kultura, punësimi, shëndetësia dhe strehimi. (Instituti për ndryshim dhe Lidërship në Shqipëri; Çështje të arsimimit të fëmijëve të komunitetit rom, fq.16)

Dekada e përfshirjes së romëve (2011), nënvizon se: qëllimi strategjik përse i përket fushës së arsimit është përmirësimi i situatës arsimore të minoritetit rom me këto objektiva:

1.Sigurimi i të drejtës së fëmijëve dhe të rinjve të minoritetit rom për akses të barabartë në të gjitha nivelet e sistemit arsimor

- Krijimi dhe/ose përmirësimi i të dhënave statistikore në fushën e arsimit që të mundësojnë analizat e vazhdueshme rreth gjendjes arsimore të fëmijëve romë.
- Ofrimi i këshillimit prindëror në shkolla dhe kopshte për prindërit romë, rreth të drejtave dhe detyrimeve për zhvillimin arsimor të fëmijëve.
- Hartimi dhe zbatimi i programeve parapërgatitore për të eliminuar vështirësitë në komunikim në gjuhën shqipe të fëmijëve romë dhe për të ndihmuar integrimin e tyre në sistemin e detyruar arsimor.
- Zbatimi sistematik, i mirëfinancuar dhe i shtrirë gjerësisht i programeve të llojit «Shansi i Dytë» për fëmijët që kanë braktisur shkollën me synim integrimin e tyre në sistemin e rregullt arsimor.
- Sigurimi nga autoritetet lokale i shërbimit të transportit shkollor për nxënësit rom që e kanë shkollën larg qendrës së banimit.
- Sigurimi i teksteve dhe mjeteve shkollore falas për fëmijët rom që ndjekin arsimin e detyruar dhe që vijnë nga familje të varfëra.
- Ofrimi i mësimdhënies në lëndë të ndryshme jashtë procesit mësimor, në përputhje me nevojat e fëmijëve Romë për të siguruar ecurinë e tyre normale.
- Dhënia e bursave për studentët Rom të shkollave të larta, në veçanti studentëve të profilit arsimor dhe social, përmes krijimit të Fondit Rom, nga fondi i përgjithshëm i bursave.
- Rezervimi i të drejtës së studimit, në universitetet publike, për studentët Rom.

2.Eliminimi i qëndrimeve përjashtuese dhe inferiore ndaj Romëve në komunitetin shkollor dhe transformimi i diversitetit kulturor në një burim njohurish dhe atmosfere të respektit reciprok, tolerancës dhe mirëkuptimit

- Përfshirja në rregulloret e institucioneve parashkollore, parauniversitare dhe universitare si dhe në përshkrimet e punës së personelit arsimor të kërkesave që sigurojnë respekt dhe

qëndrime jo-inferiore ndaj fëmijëve dhe të rinjve Rom duke krijuar kështu një ambjent përfshirës ndaj Romëve.

- Eliminimi nga kurrikula shkollore në të gjitha nivelet e gjuhës që ngjall distancë dhe inferioritet ndaj minoritetit Rom dhe përfshirja në kurrikula e historisë dhe kulturës Rome.
- Sesione trajnimi rreth mësimdhënies në një ambjent ndër-kulturor si dhe kualifikimi periodik i mësuesëve në sesionet përkatëse.
- Organizimi i aktiviteteve sociale ndërkulturore nga shkollat me prindër dhe nxënës romë dhe jo romë, me qëllim rritjen e njohurive dhe mirëkuptimit midis fëmijëve romë dhe atyre jo romë.
- Sigurimi i pjesëmarrjes së prindërve romë në bordet e prindërve apo trupat e tjerë qeverisës në shkolla.
- Dhënia përparësi e regjistrimit të fëmijëve rom në institucionet e arsimit parashkollor.
- Krijimi i mundësive që studentët e mësuesisë në universitetet publike të realizojnë një pjesë të praktikës mësimore pranë organizatave romë që ofrojnë shërbime në fushën e arsimit.

3. Ruajtja dhe zhvillimi i identitetit kulturor të nxënësve dhe studentëve të minoritetit rom

- Zhvillimi i një kurrikule për mësimin e gjuhës dhe kulturës romë në nivelet parauniversitare dhe universitare.
- Krijimi i kursit të gjuhës dhe kulturës romë në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Tiranës.
- Dhënia e bursave për studentët romë dhe jo romë që studiojnë gjuhën dhe kulturën romë për të rritur numrin e mësuesve të gjuhës kësaj gjuhe.
- Përgatitja e programeve të kualifikimit dhe trajnimit sistematik (fillestar dhe në vazhdimësi) të mësuesve të gjuhës Rome.
- Futja në kurrikulat e fakulteteve/degëve të mësuesisë e programit të gjuhës romë si lëndë me zgjedhje.
- Ofrimi i orëve të mësimin të gjuhës romë në arsimin parauniversitar edhe për nxënësit jo romë (Dekada e përfshirjes së romëve, 2010-2015, 13-17 vv)

Përpos gjithë sa thamë më lart, gjatë periudhës 2004-2008, Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka lançuar iniciativa ligjore dhe programe speciale për të minimizuar disa nga vështirësitë në fushën e arsimit dhe për përmirësimin e aksesit të fëmijëve romë në të gjitha nivelet e arsimit të detyrueshëm. Këtu mund të përmendim udhëzimin e MASH, që lejonte rregjistrimin e fëmijëve romë në shkollë edhe nëse ata nuk kishin një certifikatë të vlefshme. Kjo masë ka çuar në eliminimin e barrierës me të cilën përballen fëmijët romë, që nuk janë të regjistruar në gjendjen civile. Projekti i “Shansit të dytë” u lançua për të ndihmuar fëmijët të cilët kanë braktisur shkollën, [bazuar në udhëzimin përkatës Nr. 34, datë 08.12.2004, “Për zbatimin e projektit “Shansi i dytë”] dhe kishte si qëllim mbështetjen e edukimit dhe integritit të fëmijëve të shtresave të marginalizuara (romë, egjiptianë, me aftësi të kufizuara dhe fëmijëve të ngujuar) dhe trajnimit të mësuesve që punojnë me nxënësit e këtyre shtresave. Në kuadër të këtij projekti u krijuan 61 klasa me një numër total nxënësish prej 469, ku mbi 50 përqind e nxënësve janë romë. (UNICEF, 2012, fq 5).

Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar

Paradigma e re kurrikulare nuk ka parashikuar zëvendësimin e kurrikulës ekzistuese me një kurrikul të re, por ridimensionimin, modifikimin dhe rimodelimin e saj. E rëndësishme ka qenë që ky ridimensionim të përputhet me vizionin arsimor që nuk ka qenë një përcaktim rastësor, por i bazuar në vizionin e zhvillimit të vendit. Qëllimi i paradigmes së re është të ndikojë që të gjithë nxënësit të funksionojnë në mënyrë optimale në shoqërinë e së tashmes dhe të së ardhmes. Ajo mban parasysh dinamikën e realitetit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe të njerëzve në veprim. Zhvillimi dhe ndërmarrja e politikave dhe strategjive arsimore në vendin tonë pasqyrohet edhe në kurikul. Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar, priret drejt ndryshimeve kurrikulare, të cilat ndër të tjera synojnë: “Zhvillimin e interesave të larmishme të nxënësve... edukimin ndërkulturore për komunikim dhe bashkëjetesë paqësore dhe të suksesshme në shoqëri..., zhvillimin e aftësive dhe shprehive bazë, që lehtësojnë përshtatjen e të rinjve me kërkesat në ndryshim të profesioneve, fushave, veprimtarisë shoqërore etj.” (Korniza kurrikulare e arsimit parauniversitar të Shqipërisë, 2014. (fq. 4). Po kështu (KKAPSh, 2014), konsideron si pikë të rëndësishme referimi, për sistemin parauniversitar edhe kompetencat themelore europiane ku, ndër të tjera mund të përmendim: kompetencën ndërpersonale, ndërkulturore, shoqërore dhe qytetare si dhe kompetencën e shfaqjes së identitetit kulturor, mirëkuptimin e larmisë së

kulturave, krijimin dhe paraqitjen e ideve, përvojave dhe emocioneve në forma të larmishme si dhe rezultatet e pritshme për nxënësin sipas cikleve të studimit. Kështu në përfundim të **arsimit parashkollor**, nxënësi ndër të tjera duhet të kuptojë dhe pranojë ndrysheshmërinë e jetës të përdorë gjuhën shqipe për të shprehur ndjenjat dhe mendimet e tij, të përdorë njohuri të thjeshta në jetën e përditshme etj. Në përfundim të **arsimit fillor** nxënësi ndër të tjera duhet të përdorë drejt në jetën e përditshme gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur, të respektojë veçoritë kulturore të individëve, grupeve dhe kombeve të tjera, të kërkojë të drejtat e tij dhe të respektojë të drejtat e të tjerëve, të komunikojë në mënyra të ndryshme ndjenjat idetë dhe përvojat vetjake, të përdorë konceptet fillestare të kohës dhe hapësirës për t'u orientuar në mjedis etj... Në përfundim të **arsimit të mesëm të ulët** nxënësi duhet të kuptojë dhe komunikojë në gjuhën amëtare, të zotërojë dhe përdorë metoda e shprehje të përshtatshme për të jetuar, për të nxënë dhe për të punuar në shkollë, familje dhe komunitet, të zotërojë njohuritë bazë të shkencave të natyrës e të shoqërisë dhe rëndësinë e vlerave të tyre praktike, të kuptojë veten si pjesë e grupit dhe e shoqërisë, të zbatojë njohuritë dhe aftësitë e fituara në mënyrë krijuese e rrethana të ndryshme etj.(8 vv)

Ajo që bie në sy në kornizën kurrikulare të Republikës së Shqipërisë është rëndësia që ajo i jep njohjes së të drejtave të njeriut e në veçanti të drejtave të fëmijëve, edukimit për komunikim, aftësive bazë për jetën, etj. Paradigma e re kurrikulare bazohet në disa koncepte bazë nga të cilat mund të përmendim konceptin e përmbajtjes së arsimit shkollor, i cili duhet të konceptohet si një model i integruar kulturor dhe pedagogjik, i skicuar në përputhje me potencialin real të nxënësve, moshën, sistemin e vlerave. Përmbajtja arsimore duhet të mbështesë nxënësit në strukturimin e njohurive të tyre për natyrën, njerëzit, shoqërinë, të nxisë marrëdhëniet midis tyre, kuptimin e vetes dhe të botës. Përmbajtja arsimore duhet të zgjidhet në përputhje me kontekstin kombëtar dhe ndërkombëtar të zhvillimit të shoqërisë. Shkolla si një tjetër koncept i rëndësishëm, vlerësohet si faktor kyç në ndryshimin e shoqërisë, roli i së duhet të rivlerësohet. Shkolla si një institucion social duhet të plotësojë funksionet e saj tradicionale në përputhje me kuptimin e ri për arsimin shkollor. Është e ditur se cilësia e shkollës vlerësohet sipas arritjeve të nxënësve dhe sipas arritjeve konkrete të shkollës si institucion. Në këto kushte, rezultatet e arsimit duhet të jenë konsistente me nevojat e nxënësve dhe nevojat e mjedisit të tyre. Në këtë kuptim shkolla duhet t'u japë nxënësve mundësinë të fitojnë jo vetëm njohuri, aftësi dhe zotësi për lëndë të veçanta, por edhe aftësinë për t'i përdorur ato për zhvillimin personal. Nxënësit duhet të bëhen

zotë të procesit të tyre të të nxënësve. Këtij qëllimi i shërben edhe futja e lëndëve të mirëfillta të njohjes dhe të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, të aftësive për jetën etj.

Filozofia kurrikulare synon të ndërtojë një tërësi komponentësh rreth nevojave të nxënësve dhe rrugëve më të përshtatshme për t'i realizuar këto nevoja në mënyrë sistematike dhe produktive. Një "filozofi kurrikulare" nuk duhet të perceptohet si një dogmë e ngurtë; për më tepër ajo është si një arkitekturë e hapur e perspektivave arsimore që janë provuar nëpërmjet praktikës dhe që janë fleksibël në kohë të ndryshme ndaj rregullimeve dhe përmirësimeve me një art dinamik të projektit kurrikular. "Filozofia kurrikulare" përfshin dialogun social profesional dhe politik.

2.8 Politikat sociale në Shqipëri

Politikat sociale mbulojnë të gjitha dispozitat dhe masat, që synojnë të parandalojnë, të mënjanojnë ose të lehtësojnë situatat e varfërisë dhe problemet sociale, në nivel individual apo kolektiv, ose kërkojnë të favorizojnë mirëqenien e grupeve më të brishta të shoqërisë. Politikat sociale të një vendi kanë ndikim të drejtpërdrejtë përveç të tjerash edhe në të drejtat e njeriut siç janë të drejtat ekonomike dhe sociale. Në Shqipëri ka diferenca të mëdha ndërmjet banorëve që jetojnë në zonat urbane me ata në zonat rurale, ndërmjet atyre që jetojnë në veri dhe atyre, që jetojnë në zonat e tjera të vendit dhe veçanërisht ndërmjet romëve/egjiptianëve dhe pjesës tjetër të popullsisë. Përfshirja sociale në Shqipëri vjen si rezultat i varfërisë, decentralizimit të ngadaltë, politikave sociale të papërshtatshme, trajtimit të pamjaftueshëm të familjeve të varfra, zbatimit të dobët të ligjeve etj. Sipas studimeve dhe dokumentave të ndryshme politike, grupet më të prekura në Shqipëri janë fëmijët në nevojë, gratë e shfrytëzuara, personat me aftësi të kufizuara (mendore/ose fizike), të papunët; pensionistët dhe të moshuarit, si dhe romët dhe egjiptianët. Bazuar në udhëzimet e BE-së, qeveria shqiptare është përpjekur të integrojë politikat sociale në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI). Strategjia e Përfshirjes Sociale është një përbërës integral i SKZHI-së dhe fokusohet në varfërinë dhe rreziqet e përjashtimit social në Shqipëri. Sipas Social Inclusion and Social Protection in Albania (2008), kjo është një strategji ndërsektoriale e cila është plotësisht konsistente me strategjitë sektoriale kryesore. Strategjia e mbrojtjes sociale, si pjesë e strategjisë ndërsektoriale të përfshirjes sociale, parashikon objektiva konkrete për uljen e varfërisë dhe ofrimin e shërbimeve për grupet në nevojë. Ajo bazohet në përparësitë e programit qeveritar mbi politikat sociale siç janë reduktimi i varfërisë, përmirësimi i cilësisë së jetesës për grupet në nevojë dhe mbështetja për përfshirjen e tyre në zhvillimin e

komunitetit. Ka dy kategori kryesore ndihme sociale në pagesa (kesh) që shpërndahen nga sektorët e asistencës sociale nëpër bashki. Ndihma ekonomike synon në parim të garantojë minimumin e standardeve të jetesës. Përveç kësaj, ekziston edhe një skemë subvencioni që rimbursen pjesërisht faturat e energjisë elektrike për të varfrit dhe familje të tjera në nevojë, dhe një sistem të shërbimeve sociale në qendra rezidenciale dhe ditore që ofrojnë mbështetje për këto kategori. Kontributet sociale janë burimi kryesor financiar për skemat e mbrojtjes sociale si sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe përfitimet e sigurimit për papunësinë. Shteti luan rolin e kontribuesit për grupe të veçanta, së bashku me popullsinë ekonomikisht aktive. (6, vv). Pillay dhe Duraj (2007), kanë vënë në dukje se:

“Në Shqipëri nuk ka ndonjë përfitim specifik për familjet ose ndonjë program mbështetjeje/asistence për fëmijët. Ka disa kompensime suplementare për shumën e pensioneve dhe të përkrahjes sociale për fëmijët/anëtarët e familjeve që varen nga përfituesi, si dhe kompensime të lidhura me rritjen e çmimit të bukës dhe energjisë elektrike, të gjitha të financuara nga buxheti i shtetit. Strategjia e Qeverisë nuk ka ndonjë program të veçantë mbi mbrojtjen e fëmijëve”. (fq. 3).

Përsa i përket politikave sociale për fëmijët, botimi “Politikat e përfshirjes sociale për fëmijët dhe financimi i tyre në Shqipëri”, nënvizon faktin se “politikat kryesore të përfshirjes sociale, nën këndvështrimin e të drejtave të fëmijëve, konsistojnë në të drejtën për mbijetesë dhe zhvillim, të drejtën për mbrojtje, të drejtën për mosdiskriminim, si edhe të drejtën për shërbime sociale themelore”. (fq.7). Po i njëjti botim bën këtë ndarje të politikave:

Në politikat që garantojnë të drejtën e mbijetesës dhe zhvillimit përfshihen:

1. E drejta për arsimim
2. Mbijetesë dhe akses në shërbimet shëndetësore

Në politikat që garantojnë të **drejtën për mbrojtje** përfshihen:

1. E drejta e mbrojtjes së fëmijëve jashtë kujdesit prindëror
2. E drejta e mbrojtjes nga dhuna (në familje apo komunitet)
3. E drejta e mbrojtjes ndaj punësimit të fëmijëve
4. E drejta e mbrojtjes së fëmijëve në konflikt me ligjin apo në gjakmarrje

Në politikat që garantojnë të **drejtën për mosdiskriminim** përfshihen:

1. E drejta e komunitetit rom për t’u mbrojtur nga diskriminimi

2. E drejta e fëmijëve me aftësi të kufizuar për t'u mbrojtur nga diskriminimi

Në politikat që garantojnë të drejtën për shërbime themelore përfshihen:

1. Vlerësim i mundësive për shërbime bazë të fëmijëve, familjeve dhe komuniteteve.

2. Identifikimin e problemeve që lidhen me aksesin ndaj këtyre problemeve.

Politikat sociale për komunitetin rom në Shqipëri

Gjatë viteve të sistemit të kaluar, shteti zbatonte politika të trajtimit të barabartë duke integruar njëloj të gjitha pakicat etnike. Pas viteve 90, me ndryshimin e sistemit dhe ushtrimin e lirë të së drejtës së fjalës dhe organizimit, të gjitha pakicat u organizuan për të mbrojtur interesat dhe të drejtat e tyre në shoqëri. Një rol të rëndësishëm për njohjen, zbulimin dhe zbutjen e problemeve sociale luajnë organizatat joqeveritare vendase dhe të huaja që indirekt janë ofrues të fuqishëm shërbimesh. Veprimtaria e organizatave të shoqërisë civile është e shumëllojshme, por shpesh herë ka qënë e pakoordinuar dhe jo e organizuar për të përdorur burimet e komunitetit në funksion të zhvillimit dhe përmirësimit të jetës së vetë komunitetit. Shteti shqiptar nga ana e tij në vite është përpjekur të hartojë politika dhe praktika për të siguruar mbrojtjen sociale të shtresave në nevojë, ku padyshim bën pjesë edhe komuniteti rom. Mbrojtja sociale gjithmonë ka konsistuar dhe konsiston në:

1. Integrimin e fëmijëve romë të rrugës në jetën normale
2. Asistencën për aplikimin e ndihmës ekonomike për familjet e varfëra
3. Stimulimin dhe mbështetjen e shoqatave romë si përfaqësues të aspekteve të ndryshme të jetës së tyre

Këtij qëllimi i kanë shërbyer Kushtetuta e 2008-tës, që garanton *barazinëpara ligjit* sikurse dhe *mbrojtje të barabartë nga ligji*, ligji i miratuar në 2010-tën kundër diskriminimit, që paraqet përveç të tjerave mundësi për mbrojtje të barabartë si ndaj akteve shtetërore ashtu dhe akteve të individëve privatë, në fushën e punësimit, edukimit dhe shërbimeve, Strategjia Kombëtare për Romët (2003), Plani i Veprimit për Dekadën e Përfshirjen së Romëve (2009), si dhe një sërë projektesh të UNDP-së, nga ku mund të përmendim:

Projektin “Ndërtimi i Kapaciteteve për të Drejtat e Minoriteteve dhe Advokasi” (2006-2007), cili përgatiti Manualin e Trainimit për të Drejtat e Minoriteteve dhe Ndër-Kulturalizmin, ofroi

trainim për nëpunësit civilë, mediat, përfaqësues të komunitetit rom dhe OJF-ve, si dhe përgatiti studimin kombëtar për vulnerabilitetin social të romëve në Shqipëri dhe raportin e parë të progresit për strategjinë kombëtare të romëve.

Në 2008-2010 një tjetër projekt i titulluar “Fuqizimi i Komuniteteve Vulnerabël”, ofroi mbështetje për regjistrimin civil, trainime profesionale dhe lehtësim të procesit të punësimit, ndërmjetësim komunitar për mbrojtjen e shëndetit të fëmijëve dhe edukimin, përgatitjen e planit të veprimit për Dekadën e Romëve si dhe lobim për përfshirjen sociale të minoriteteve.

Më 2010-2013, Projekti “Fuqizimi i komuniteteve lokale vulnerabël, ofroi mbështetje për pjesëmarrjen e komunitetit në vendimmarrjen lokale, rritjen e mundësive të komunitetit për të pasur akses mbi të drejtat dhe shërbimet sociale; ndërtimin e kapaciteteve për institucionalizimin e përfshirjes sociale.

Shteti Shqiptar është munduar gjithashtu të ndërtojë kapacitet e duhura për zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë për romët. Këtu mund të përmendim:

1. Trajnimin e punonjësve në ministritë e linjës për planifikimin strategjik dhe operacional, për të drejtat e komuniteteve vulnerabël si dhe promovimin e ndërkulturalizmit.
2. Planin Kombëtar të Veprimit për Dekadën e Përfshirjen së Romëve, hartuar dhe miratuar nga Këshilli i Ministrave.
3. Krijimin e 3 Komitete Koordinuese Rajonale për Romët në Fier, Elbasan dhe Tiranë.

Një rëndësi të konsiderueshme ka marrë edhe lobimi për përfshirjen sociale të komunitetit rom, nga institucionet shtetërore nëpërmjet aktiviteteve apo organizimeve të ndryshme siç janë: 8 Prilli, Dita Ndërkombëtare e Romëve, e cila është bërë ngjarje e përvitshme e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe festohet përmes organizimit të javës kulturore të romëve; krijimit në gjithë vendin të rrjetit të “Artizanëve Romë”, të cilët marrin pjesë në panairin vjetor të artizanëve romë, përgatitjen dhe paraqitjen në faqen e websit-tit 3 të dokumentarëve mbi punësimin e romëve, prodhimit dhe shpërndarjes së bulentineve informative 4 mujore, posterave etj për njohjen e komunitetit me kulturën rome.

2.9 Diversiteti i romëve dhe karakteristikat e organizimit të jetesës faktorë ndikues mjaft të rëndësishëm në nivelin e arsimimit të tyre

Romët kanë ardhur në Shqipëri para pushtimit otoman. Në kohën e pushtimit otoman për arsye sigurie ata kanë ndryshuar besimin e tyre fetar duke e konvertuar në besim mysliman. Gjatë Luftës së Dytë Botërore romët nuk u persekutuan në kampet e vdekjes siç ndodhi në shumë vende të Europës Lindore. Sipas raportit studimor “ Mbi situatën e romëve që jetojnë e punojnë në vendshkarkimin e mbeturinave në ata nuk u Gjatë Luftës së Dytë Botërore, romët e Shqipërisë nuk u persekutuan në kampet e vdekjes siç ndodhi në shumë vende të Europës Lindore. Sipas raportit studimor “Mbi situatën e romëve që jetojnë e punojnë në vendshkarkimin e mbeturinave në Sharrë”:

“Për herë të parë romët u regjistruan në Shqipëri gjatë viteve 1522-23 dhe u vlerësuan rreth 1,270 vetë. Emri i romëve përmendet në tekstet e vjetra shqiptare më 1635. Në vitin 1930, sipas vlerësimeve popullore kishte 20,000 romë në të gjithë vendin. Në 1980 kishte 62,000 romë, të vlerësuar sipas dokumentave franceze”. (fq.7)

Pas çlirimit të vendit, shteti ynë, ndoqi politikën e asimilimit dhe të homogjenizimit të kombit shqiptar, duke e konsideruar këtë komunitet si pjesë e popullsisë shqiptare. Romët janë të organizuar në grupe ose fise, që dallohen nga njëri-tjetri nga koha dhe rruga e ardhjes së tyre në Shqipëri, nga profesionet, nga mënyra e jetesës, zakonet, nga dialektet gjuhësorë, etj. Në artikullin e tij “Marrëdhëniet dhe integrimi i romëve në jetën shqiptare”, Leci (2001), ka shkruar se në Shqipëri jetojnë kryesisht katër fise romësh: fisi i madh **Meçkarë**, të cilët dallohen nga të tjerët pasi janë bujq të mirë... Shtrirja e tyre është në rrethet e Myzeqesë, të Fierit, Lushnjes por edhe në Berat e Vlorë. Ky fis qëndron më lart si nga niveli ekonomik, ashtu dhe nga ai i arsimit. Ata kanë jetesë të stabilizuar dhe mes tyre gjejmë mjaft intelektualë... Fisi tjetër është ai i **Kaburxinjëve**, që jeton kryesisht në Devoll, Bilisht, Korçë, Pogradec, Elbasan, Tiranë dhe një pjesë e vogël në Fushë-Krujë. Janë tipa ekspresivë, shpesh herë edhe shpërthyes. Profesionet e tyre tradicionale kanë qenë shitblerja e kuajve, punimet e artizanatit dhe kryesisht punimet e thuprës. Një fis tjetër janë **Çergarët**, të cilët ndeshen kryesisht në zonat e Veriut si Shkodër, Milot por edhe në Durrës e Tiranë. Ata janë mjeshtër të astrologjisë primitive, merren me fall dhe magji. Ndërsa fisi i **Kurtofëve** është më i pashkolluari dhe më problematiku. Pjestarët e këtij fisi shpeshherë nuk kanë një vendqëndrim dhe bëjnë një jetë kolektive”. (37, vv)

Gjuha përbën një element të rëndësishëm karakteristik të një bashkësie etnike, dhe ky fakt është i vlefshëm edhe në rastin e romëve. Romët të shpërndarë në të gjithë botën në të vërtetë bashkohen vetëm nga origjina e njëjtë, ku gjuha është një dëshmi përcaktuese. Gjuha rome ndahet në dialekte aq të shumtë në numër sa janë edhe familjet rome të shpërndarë në pesë kontinentet. Çdo grup rom mund të dallohet nga dialekti që përdor (p.sh. meçkarët, kaburxhijtë dhe çergarët kanë secili dialektin e tyre). Romët mund ta shfrytëzojnë gjuhën e tyre edhe si mjet për vetëizolim gjatë kontakteve me bashkësinë rrethuese, kur nuk duan të jenë të kuptueshëm.

Situata e romëve gjatë periudhës socialiste dhe gjatë tranzicionit pas socialist nuk është e njëjtë. Gjatë periudhës socialiste (1945-1990), romët përjetuan përmirësime të dukshme në strehim, arsim, përkujdesje shëndetësore dhe shërbime sociale. Studimi për vlerësimin e nevojave të komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri, (2012) ka vënë në dukje se:

“Romët ashtu si shqiptarët, gëzonin punësimin e plotë, ndonëse një pjesë e tyre punonin si punëtorë të pakualifikuar. Në fshatra, ata punonin në bujqësi dhe blegtori, kurse nëpër qytete punonin në ndërtim, në shërbime publike dhe artizanat. Përveç kësaj, shumë romë e vazhduan tregtinë e tyre të vogël edhe pasi veprimtaritë ekonomike private u bënë të dënueshme me ligj, sidomos pas Kushtetutës së vitit 1976. Ndër këto veprimtari ishin blerja dhe shitja e kuajve, prodhimet e artizanatit dhe prodhime të tjera, që bliheshin në qytete dhe shiteshin në fshatra ose anasjelltas. Pjesëmarrja në këto veprimtari informale u jepte atyre të ardhura shtesë dhe, në njëfarë mënyre, i privilegjonte ata në krahasim me grupet e tjera”. (fq. 17)

Gjatë periudhës së tranzicionit pas socialist, romët si pasojë e kolapsit dhe mbylljes së ndërmarrjeve shtetërore, karakterit të njëanshëm profesional të tyre, arsimimit të ulët dhe diskriminimit, kaluan nga një begati relative në një varfëri të skajshme. Ata janë aktualisht grupet më të varfra dhe më të marginalizuara etnike në Shqipëri. Po sipas “Studimit për vlerësimin e nevojave të komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri”, (2012), niveli i varfërisë së romëve është më i lartë se ai i shqiptarëve dhe kjo gjendje po përkeqësohet. Ndonëse popullata rome ka qenë historikisht më e varfra në Shqipëri, rënia e standardit të saj të jetesës gjatë tranzicionit pas socialist ishte shumë më e shpejtë se për disa grupe të tjera të popullsisë. Kjo ka krijuar një rreth vicioz, që riprodhon analfabetizmin dhe nivelin e ulët arsimor midis romëve, çka e thellon edhe më shumë marginalizimin e tyre në shoqëri. Nga ana tjetër, tranzicioni pas socialist drejt ekonomisë së tregut dhe demokracisë krijoi mundësi të reja për romët, që të organizohen për të shprehur identitetin dhe për të mbrojtur interesat e tyre. Duke

filluar që nga viti 1991, janë krijuar një numër OJQ-sh rome dhe egjiptiane, si Amaro Dives, Amaro Drom, Rromani Baxt, Alb Rrom, Shoqata e Romëve për Integrim, Rromani Kham, Gratë Rome, Romët e Veriut, Roma Active Albania etj. Disa romë janë zgjedhur edhe si anëtarë këshillash të njësive vendore (CRS, 2007). Pavarësisht se marrin pjesë në parti të ndryshme politike, romëve u mungon përfaqësimi i drejtpërdrejtë dhe nuk kanë përfaqësues në administratën publike që të mbrojnë interesat dhe nevojat e tyre.”. (17, vv)

Sot në Shqipëri komuniteti rom përgjithësisht diskriminohet në tregun e punës, ka shanse më të vogla punësimi dhe paga më të ulëta për shkak të arsimimit. Në përgjithësi kultura rome shihet si indiferente ndaj arsimit dhe përfitimeve që do mund të kishin fëmijët e këtij komuniteti prej tij. Në zakonisht marrim vendime për arsimimin tonë duke ditur vlerën që ka dhe të mirat që ai do të sjellë në të ardhmen. Për romët nuk është e njëjta gjë. Braktisja e shkollës është një vendim që merret nga prindërit romë, i rrënjosur në besimin e tyre se “shkolla nuk është e ardhmja”.

Braktisja e shkollës në komunitetin është raportuar për të dy gjinitë në vitet e fundit të arsimit të detyrueshëm, për arsye të ndryshme. Djemtë priren të lënë shkollën në mënyrë që të hyjnë në tregun e punës, ndërsa vajzat e braktisin në mënyrë që të përgatiten për martesë. (Observatori për të Drejtat e Fëmijëve, 2015. fq. 25)

Organizimi i familjes

Liegeois (2007) ka vënë në dukje se në jetën e romëve/ciganëve, gjithçka sillet rrotull familjes. Ajo është njësia bazë e strukturës sociale ... si dhe është njësia edukative që siguron faktin që shoqëria riprodhon veten dhe jep siguri e mbrojtje për individin. (fq.77).

Familja nuk është thjesht mbledhja e individëve brenda saj, është një e tërë, me të drejtat e veta, një organ i përbërë nga pjesëtarët e saj. Konflikti përjetohet së bashku dhe marrëdhëniet sipas individëve janë marrëdhëniet midis grupeve të tyre të familjeve. Individët veprojnë në konceptin e tyre si pjesëtarë të familjes, një veprim që vlerësohet dhe përforcon prestigjin e familjes. Një fëmijë i rritur nderon familjen dhe kur martohet. Nëse hyn në një grup të ri familjar, do të vazhdojë brenda atij grupi të përfaqësojë familjen e tij të lindjes. Nëse të dy grupet do të hyjnë në konflikt me njëri-tjetrin, atij mund t'i duhet të kthehet tek njerëzit e tij. Qëndrimi i tij në të gjitha rrethanat përcaktohet nga familja e tij e origjinës, me të cilën mbetet pjesë e pandarë.

Sipas Liegeois (2007) solidariteti shoqëror i mban të gjithë pjesëtarët e familjes të bashkuar. Ata pak të rritur që nuk martohen, mbeten tek prindërit e tyre. Jetimët mbahen nga të afërmit ose të moshuarit, për të cilët kujdesen dhe i respektojnë, duke mos i lënë kurrë vetëm. Dërgimi i një të moshuari në azil është më i paperceptueshëm se sa dërgimi i një fëmije në shkollë me konvikt. Të sëmurët nuk braktisen, as të vdekurin nuk e lënë asnjëherë vetëm. Derisa të bëhet funerali, ai ruhet gjatë gjithë natës nga të afërmit. Kjo na bën të kuptojmë shkallën e rëndësisë për personin. Solidariteti shoqëror është gjithashtu një formë e sigurisë shoqërore e psikologjike. Në përgjithësi, njësia e familjes është familja e zgjeruar që përbëhet nga disa çifte dhe fëmijët e tyre, si dhe disa breza. Brenda familjes, rolet e burrave dhe të grave janë dukshëm të ndryshëm dhe komplementarë... Burrat mbrojnë dhe mbartin prestigjin e familjes përballë botës së jashtme. Brenda familjes ata kanë përgjegjësinë, autoritetin dhe kompetencën e vendimmarrje. Familja fillon të ekzistojë me lindjen e fëmijës së pare. Kjo ndiqet nga lindje të tjera, shpesh shumë të tjera. Rritja e një fëmije është veprimtari që përfshin të gjithë familjen. Zakonisht nuk ka kontradita midis brezash. Ata formojnë një grup dhe nuk ka ndarje midis brezave të fëmijëve apo brezave të të rriturve. Fëmijët respektojnë dhe respektohen nga të rriturit. Sjellja e fëmijëve kanalizohet drejt zhvillimit të autonomisë së tyre. Familja në të cilën rriten, është e një rëndësie primare dhe merr përparësi në aleancat të mëvonshme, që lidhen, martesat etj". (78, vv).

Martestat e hershme

Karakteristikë tjetër e familjeve romë është edhe martesa e hershme e fëmijëve të tyre, kryesisht e vajzave. Origjina e martesave të fëmijëve është multidimensionale dhe me rrënjë të thella. Historikisht, martesat e hershme janë përdorur si një mekanizëm për të rritur pjellorinë në kontekstin e normave të vdekshmërisë së lartë. Martesa e fëmijëve është përdorur në marrëdhëniet e mëtejshme ekonomike, politike apo sociale. Sot, kjo traditë motivohet nga varfëria, marginalizimi social, normat kulturore dhe përjetësohet nga pabarazia gjinore dhe statusi i ulët i vajzave dhe grave. Janë një sërë faktorët që kontribuojnë në martesat e hershme të vajzave romë. Sipas De Soto et al (2005):

"Martesa e hershme dhe sjellja e fëmijëve në përgjithësi pasqyrojnë traditatën romëve në lidhje me martesën dhe rolin gjinor. Ata presin që femrat të jenë bashkëshorte dhe nëna. Përveç kësaj, vajzat dhe djemtë janë shumë pak të informuar në lidhje me planifikimin familjar. Si rezultat, përdorimi i metodave kontraceptive është i ulët, dhe normat e abortit të larta. Efektet kryesore të martesave të hershme dhe lindjet e fëmijëve në moshë

të re, sjellin nivel të ulët të arsimimit dhe me norma të larta të divorcit. Për Romët, normat e divorcit janë më të larta në krahasim me pjesën maxhoritare të vendit. Për gratë, divorci çon në rritjen e varfërisë dhe përjashtimit social për ato vetë, familjet dhe fëmijët e tyre. Ato shpeshherë e shohin prostitucionin si një strategji për të mbijetuar dhe përballuar varfërinë”. (fq.28)

Nëse do ta përmbledhim çka shkruam më lart do të thonim, se martesat në moshë të hershme vijnë nga normat kulturore, rolet gjinore tradicionale, varfëria, frika e prindërve për rrëmbim dhe prostitucionin, si dhe pak njohuri për planifikimin familjar. Ndikimi i këtyre normave dhe vlerave është veçanërisht i fortë për grate e vajzat e komunitetit rom. Gratë rome pritet që të martohen herët dhe të kenë fëmijë. Prindërit mendojnë se “e drejta” mbi vajzat e tyre për t’i lidhur në martesë bie me moshën. Ata besojnë se kur vajza është 18-19 vjeç dhe e pa martuar, diçka nuk shkon me këtë vajzë. Një arsye tjetër e martesës së hershme, është shenjtëria e virgjërisë femërore, e cila në kulturën rome është përkthyer si besnikëri e vajzës ndaj burrit të saj. Martesa e fëmijëve nuk është një ngjarje e izoluar. Ajo është e lidhur me probleme të tjera sociale me të cilat përballen familjet rome, të tilla si vështirësi ekonomike, mungesa e strehimit të përshtatshëm, mungesa e qasjes në shërbimet arsimore dhe shëndetësore, mungesa e informacionit rreth planifikimit familjar etj. Bitu dhe Morteau (2010), kanë bërë një listim të normave kulturore të romëve dhe faktorëve, që ndikojnë në ruajtjen e tyre. Ata kanë vërejtur se faktorët e përgjithshëm ndikues në ruajtjen e këtyre normave janë:

- *Presioni i kulturës patriarkale;*
- *Rëndësia e ruajtjes së nderit të vajzës dhe virgjërisë;*
- *Vendi i burrit në familje dhe roli që luan vjehrra;*
- *Sigurimi i një imazhi para grupit / komunitetit;*
- *Dëshira e prindërve për t’u siguruar se të rinjtë nuk do të humbasin vlerat e tyre kulturore dhe tradicionale duke u bërë shumë “modernë”;*
- *Ndikimi i racizmit ndaj këtij komuniteti, i cili çon në krijimin e komuniteteve kompakte, pa socializim të përzier;*
- *Shqetësimi në lidhje me “përzierjen” e martesave; etj”. (fq.29)*

Martesat e hershme bëjnë që vajzat dhe gratë t’a lënë shkollën shumë herët, që të kujdesen për burrat, familjen dhe fëmijët e tyre. Ato gjithmonë janë të lidhura fort me braktisjen e shkollës, që sjell për rrjedhojë nivel të ulët të arsimor. Mjaft vajza dhe gra rome nuk shkojnë në shkollë, por edhe ato që e vazhdojnë shkollën e braktisin atë herët për të kryer detyrat e familjes. Si pasojë e kësaj zgjedhjeje vijnë me rradhë shkalla e lartë e analfabetizmit, kualifikimet e ulëta, fare pak (nëse ka) aftësi të dobishme profesionale dhe mungesë e aftësive bazë për jetën. Përgjithësisht

martestat e hershme në komunitetin Rom kanë bërë që kultura e këtij komuniteti të gjykohej nga ky fenomen dhe traditat e veçanta të dallohen dhe identifikohen si karakteristikat më të këqija të këtij komuniteti. Efektet e këtyre martesave përbëjnë një kërcënim serioz për të drejtat e njeriut dhe mirëqenien e fëmijëve. Ato i mohojnë të rinjve mundësinë për t'u rritur dhe fuqizuar veten duke sfiduar të drejtat themelore për arsimim, mbrojtje dhe zhvillim. Sipas Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve (2015), disa nga efektet që martesat e hershme sjellin janë:

- Niveli i ulët arsimor
- Kujdesi i pakët për fëmijët [shumë nëna të reja janë ende fëmijë vetë dhe nuk kanë asnjë ide të kërkesave dhe kujdesit ndaj fëmijëve].
- Rritja e përqindjes së divorceve
- Arsimi dhe ekonomia: duke qenë se vajzat e reja martohen herët, shumë pak i mësohet edukimit të tyre. Si pasojë brezat e ardhshëm lihen pa shkollimin e duhur, cikli i varfërisë vazhdon dhe në këtë mënyrë, gjë që ndikon edhe në rritjen e përgjithshme ekonomike të kombit.
- Rreziku i shëndetit, pasi vajzat e martuara në moshë të vogël, bien pre e lindjeve të shpeshta të fëmijëve, shtatzënive të pa planifikuara, sëmundjeve seksualisht të transmetueshme, abordeve etj. (41 vv)

Po sipas Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve (2015), i cili i referohet Hartës së Romëve të vitit 2011 martesat e fëmijëve romë fillojnë që nga moshë 13 vjeç:

“Përqindja e fëmijëve beqarë në moshën nga 13-18 vjeç në komunitetin Rom është 76% ose 1488 fëmijë dhe është shumë e ulët krahasuar me martesat e hershme në pjesën më të madhe të Shqipërisë e cila është 96.9%. Përqindja e kategorive të tjera (të martuar, të divorcuar dhe ata që bashkëtojnë) është më e lartë në numër për këtë komunitet. Përqindja e martesave të hershme në komunitetin Rom është 9% ose 180 fëmijë dhe është më e lartë se pjesa më e madhe e popullsisë që është 2.9%. Përqindjen më të madhe në komunitetin Rom e zënë fëmijët që bashkëtojnë të cilët zënë 14% ose 275 fëmijë”. (fq. 50).

Nga sa shkruam më lart mund të themi se jo vetëm varfëria ekstreme, interesimi shumë i pakët i prindërve romë, kryesisht për shkak të gjendjes ekonomike të familjeve të tyre, migrimi, trajtimi diskriminues etj, por edhe traditat kulturore romë përbëjnë pengesa potenciale për arsimimin e tyre.

2.10 Komente dhe çështje kritike

Integrimi i romëve dhe mbrojtja e tyre ka marrë një vëmendje të veçantë, në kuadër të procesit të pranimit të vendeve të Evropës Juglindore në BE. Mbrojtja e minoriteteve konsiderohet si një ndër kriteret më kryesore, që duhet të plotësojnë vendet potencialisht kandidatë për t'u bërë pjesë e BE. Shqipëria ashtu si dhe vendet e tjera të rajonit ka adaptuar disa programe për romët, me qëllim plotësimin e këtij kriteri.

Dekada e Romëve (2005-2015), është një iniciativë e qeverive të Evropës Qendrore dhe Juglindore me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës së këtij minoriteti në rajon. Prioritetet kryesore të Dekadës së Romëve përfshijnë; arsimimin, punësimin, kujdesin shëndetësor, strehimin, zbutjen e formave të ndryshme të diskriminimit, pabarazisë gjinore dhe varfërisë. Kjo iniciativë dikton pjesëmarrjen e romëve në politikën, që duhen ndërmarrë me qëllim eliminimin e përjashtimit social dhe varfërisë. Shumë organizata ndërkombëtare, agjenci rajonale dhe donatorë të ndryshëm si Këshilli Evropës, BE, Open Society Institute, OSCE, Banka Botërore dhe UNDP i janë bashkëngjitur kësaj iniciative. Me përjashtim të Fondit për Edukim, i cili tashmë është funksional, Dekada e Romëve nuk ka një financim të sajën. Kjo përbën edhe një ndër pikat më të dobëta të kësaj iniciative. Sipas Abdikeeva (2005):

“Vendet pjesëmarrëse si pasojë e kësaj iniciative kanë adaptuar tashmë plane kombëtare veprimi për sektorët prioritarë. Megjithatë, nuk është e qartë sesi zbatimi i këtyre planeve do të financohet. Çdo qeveri pjesëmarrëse në këtë iniciativë pritet që të ofrojë nga buxhetet respektive fondet e nevojshme për zbatimin e këtyre plan veprimeve. Kryesisht për vendet më të varfra të rajonit, pjesë e të cilave është dhe Shqipëria, kjo pritshmëri është jo realiste. Në këtë kuadër financimi i këtyre planeve si nga qeveritë pjesëmarrëse dhe nga donatorët është i paqartë”. (fq.2)

Qeveria Shqiptare ka hartuar qysh në 2003-shin dokumentin strategjik: “Strategjia Kombëtare për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom”. Afati i pritshëm i zbatimit të kësaj strategjie ishte deri në fund të vitit 2015. Politikën dhe programet e saj, synojnë zbutjen e varfërisë, ruajtjen dhe zhvillimin e identitetit rom, përfshirjen e këtij minoriteti në jetën publike, trajtimin e problemeve të strehimit, punësimit, arsimit dhe kujdesit shëndetësor. Për realizimin e tyre strategjia përcakton aktorët kryesorë përgjegjës, që do të zbatojnë dhe monitorojnë ecurinë apo vazhdimësinë. Këto programe dhe politika janë të organizuara sipas objektivave specifike, fushave të veprimit, kohës së realizimit dhe kostove përkatëse. Në tekstin e strategjisë nënvizohet fakti, se Qeveria Shqiptare e konsideron minoritetin rom dhe përfaqësuesit e tij si

partnerë në hartimin dhe zbatimin e saj. Sipas OJF-ve rome, ato kanë qenë pjesë e hartimit të strategjisë dhe rekomandimet e tyre janë pasqyruar në variantin përfundimtar të saj.

Në kuadrin e kordinimit të strukturave Institucionale në zbatimin e Strategjisë së Romëve një vend kryesor zë krijimi i Sektorit të Monitorimit pranë Shërbimit Social Shtetëror në Ministrinë e Punës, Mirqënies Sociale dhe Rinisë. Aktiviteti i këtij sektori është fokusuar në këto drejtime:

1. Mbajtjen e kontakteve me ministritë e linjës dhe institucionet përgjegjëse të përfshira në zbatimin e strategjisë, me synimin embledhjes së informacioneve mbi progresin e objektivave sektorial në fushën e arsimit, të shëndetësisë, punësimit, strehimit, sigurisë etj.
2. Nxitjen dhe ndërgjegjsimi i institucioneve, strukturave rajonale dhe pushtetit vendor për t'u përfshirë në zbatimin e strategjisë së komunitetit rom.
3. Bashkëpunimit dhe koordinimit me përfaqësues të komunitetit rom, shoqatave përfaqësuese, dhe NGO-ve për të kontribuar në procesin e zbatimit dhe monitorimit të strategjisë së romëve.
4. Bashkëpunimi me donatorët dhe NGO-të, për fuqizimin e kapaciteteve të sektorit dhe institucioneve në nivel qendror, rajonal dhe lokal për zbatimin e strategjisë.

2.11 Roli i institucioneve qendrore dhe lokale

Për zbatimin e strategjisë në nivel qendror janë përgjegjëse dhjetë ministri. Secila prej tyre ka një sërë objektivash konkrete që tregojnë domosdoshmërinë e pjesëmarrjes së strukturave rajonale dhe lokale në realizimin e tyre.

Autoritetet lokale: në nivel vendor është krijuar një Komitet Koordinues për Programimin, Vlerësimin dhe Koordinimin e Mbrojtjes Sociale në çdo Këshill Qarku. Përveç kësaj, është krijuar një Grup Teknik për çështjet rome, i përbërë nga përfaqësues të të gjitha njësive administrative që kanë banorë romë, përfaqësues të Departamenteve Rajonale në varësi të Qeverisë Qendrore, përfaqësues të OJQ-ve rome dhe OJQ-ve të tjera përkatëse lokale. Në përgjithësi, të gjitha strukturat e mësipërme institucionale në nivel vendor janë më të përfshira në koordinimin e masave për zgjidhjen rast pas rasti të problemeve rome sesa në formulimin, vlerësimin dhe monitorimin e politikave. Në fakt, hartimi i politikave është një funksion ekskluziv i Ministrive dhe institucionet rajonale dhe institucionet e qeverisë vendore janë ngarkuar vetëm për të zbatuar politikat dhe strategjitë e miratuara nga qeveria qendrore. Si rezultat, zëri i tyre nuk dëgjohej në nivel politikash, me përjashtim të rasteve kur ftohen në seminarët e organizuara nga Ministritë për shkëmbimin e opinioneve mbi strategjitë e hartuara.

Po t'i referohemi raportit "Monitorimi nga shoqëria civile i zbatimit të strategjisë Kombëtare dhe i planit të veprimit të Dekadës Rome në Shqipëri", do të vërejmë se ai nënvizon faktin se nuk ka politika vendore ose plane vendore veprimi në lidhje me komunitetin rom. Ajo që vihet re është se mungojnë të dhëna statistikore lokale mbi komunitetin rom. Një numër i madh agjencishndërkombëtare donatore po bëhen gjithnjë e më të interesuara për mbështetjen e çështjeve rome në Shqipëri, nëpërmjet projekteve të zbatuara nga ata vetë ose nëpërmjet OJQ-ve ndërkombëtare dhe ose lokale. Sekretariati Teknik, i cili është krijuar pranë Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale qysh në vitin 2004, ka bërë disa përpjekje koordinuese nëpërmjet organizimit të takimeve vjetore informative të këtyre donatorëve/organizatave. Megjithatë ekziston një nevojë për institucionalizimin e këtij koordinimi, me qëllim shmangien e mbivendosjeve dhe rritjen e efikasitetit të financimit. Ajo çka mund të themi është se ekzistojnë mjaft dokumente strategjike dhe Plane Veprimi të lidhura specifikisht me komunitetin rom, të cilat janë ndryshuar kohët e fundit ose janë zëvendësuar pjesërisht nga dokumente të tjera të sugjeruara. Sipas raportit "Monitorimi nga shoqëria civile i zbatimit të strategjisë Kombëtare dhe i planit të veprimit të Dekadës Rome në Shqipëri, numri i madh i strukturave të ngjashme institucionale është "pasqyrim" i kësaj shumëllojshmërie dokumentesh strategjike. Shumë shpesh këto nisma ndikohen nga kriteret e harmonizimit të MSA-së. Në këtë kontekst ekziston një nevojë për një qasje të njësuar para së gjithash brenda institucioneve përkatëse të BE-së, të përshtatura më së miri me "madhësinë", kontekstin dhe mundësitë shqiptare dhe më pas për një vendimmarrje më të vemendëshme ndaj efektivitetit dhe efikasitetit të vendimeve të tyre në lidhje me dokumentet strategjike dhe strukturat e ngjashme institucionale. Kjo lidhet, për shembull, me një numër shumë të madh dokumentesh strategjike dhe planesh veprimi të miratuara nga Ministri të ndryshme për sektorë të ndryshëm që lidhen me çështjen rome, shpesh "të imponuara" nga institucione të BE-së ose nga mbështetja me asistencë teknike e BE-së në kuadrin e procesit të stabilizim asocimit. Ka nevojë për qasje sinergjike në lidhje me masat prioritare dhe mbështetjen financiare. Shqipëria është inkurajuar nga Bashkimi Europian për të përdorur optimalisht instrumentet financiare, si për shembull instrumentet për para-aderimin, në përpjekjet për të arritur përfshirjen sociale të grupeve në nevojë. Në përgjithësi përfaqësuesit e komunitetit rom nuk ftohen për të marrë pjesë në mënyrë aktive në programimin e këtyre burimeve financiare. Opinioni i përgjithshëm i romëve është se pjesa më e madhe e këtij

financimi adreson mbështetjen institucionale dhe jo nevojat e tyre reale në lidhje me zbutjen e varfërisë dhe përmirësimin e kushteve të jetesës”.(fq.3)

Nga pikëpamja institucionale, numri i madh i institucioneve, strukturave dhe pikave të kontaktit në lidhje me çështjet rreth nuk ka rezultuar as efektiv, as eficient. Për shembull, është shumë i diskutueshëm efektiviteti i krijimit të dy institucioneve të veçanta si Avokati i Popullit dhe Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) me objekt të ngjashëm pune. Të gjitha këto të bëjnë të mendosh se progresi nuk duhet të matet vetëm me numrin e dokumenteve strategjike të përgatitur nga institucionet shetërore, me nivelin e harmonizimit të disa Ligjeve specifike me standardet përkatëse të BE-së, përmirësimin e kuadrit rregullator përkatës, promovimin e hapjes së qendrave kulturore dhe ngritjen e disa institucioneve të anti-diskriminimit etj.

KAPITULLI III.

METODOLOGJIA

Ky kapitull parashton mënyrën e realizimit të studimit, etapat e ecurisë së tij, si dhe prezanton instrumentet e përdorura për grumbullimin e informacionit të nevojshëm. Kapitulli nënvizon gjithashtu edhe problematikat që kanë dalë gjatë studimit, procedurat e ndjekura për të siguruar besueshmërinë dhe vlefshmërinë e rezultateve, kufizimet dhe vështirësitë e hasura për realizimin e tij, si dhe kriteret e përzgjedhjes së pjesëmarrësve.

3.1 Qëllimi, hipotezat dhe objektivat e studimit

Ky studim vë theksin në rëndësinë e arsimimit të fëmijëve të komunitetit rom, i cili nuk duhet të funksionojë si sistem formal i edukimit, që i jep përparësi përfitimit të dijeve, duke lënë pas dore llojet e tjera të të mësuarit. Shpeshherë pjesëmarrja sistematike në shkollë nuk është garanci për nxënës të suksesshëm. Ka romë që e kanë ndjekur të paktën gjithë ciklin 9-vjeçar të shkollimit dhe prapë nuk dinë të shkruajnë apo lexojnë si duhet, sikurse ka të tjerë që dinë shkrim e lexim, por që i mungojnë mundësitë dhe mekanizmat, që të familjarizohen me njohuritë e duhura, për orientimin dhe zgjidhjen e problemeve të jetës së përditshme. Arsimi ynë duhet të synojë drejt gjithëpërfshirjes, e cila i jep mundësinë çdo nxënësi të përparojë sipas ritmit specifik që e karakterizon, në varësi nga aftësia që disponon. Studimi synon të analizojë situatën arsimore të fëmijëve romë si dhe se çfarë i ofron atyre sistemi ynë arsimor, për të parë se sa e aftë është shkolla shqiptare, për të bërë harmonizimin e shprehive bazë jetësore me nevojat reale, që kanë fëmijët e komunitetit rom. Në përputhje me qëllimin e studimit janë ngritur edhe hipotezat dhe objektivat e mëposhtëm:

Hipotezat:

1. Shkolla shqiptare nuk arrin plotësisht synimin arsimim për të gjithë, i cili i jep mundësinë çdo nxënësi të përparojë në varësi të aftësive që disponon.
2. Shkolla jonë nuk merr parasysh nevojat, kapacitetet dhe aftësitë e fëmijëve të komunitetit rom.
3. Në vendin tonë nuk mund të flitet deri tani për harmonizimin të mirëfilltë të politikave sociale me politikat arsimore.

Objektivat e studimit

1. Analizë e kuadrit ligjor, shqiptar për arsimimin e pakicave etnike, në rastin tonë të komunitetit rom, në vendin tonë.
2. Evidentimi i pengesave kulturore, institucionale dhe infrastrukturore që vështirësojnë arsimimin sipas nevojave të fëmijëve romë.
3. Analiza e situatës arsimore e fëmijëve të komunitetit Rom dhe evidentimi i nevojave të tyre për shërbime arsimore.
4. Evidentimi i rolit dhe rëndësisë së politikave arsimore dhe sociale, në ndihmë të arsimimit të fëmijëve të komunitetit rom.
5. Analizë e politikave arsimore dhe sociale dhe shkallës së harmonizimit të tyre, në dobi të arsimimit bazë cilësor të fëmijëve të komunitetit rom.

Pyetjet kërkimore:

- A është i plotë kuadri ligjor shqiptar për arsimimin e pakicave etnike në aspektin teknik dhe a përfshihen në të direktivat e BE dhe parimet e Konventës Antidiskriminim?
- Cilat janë pengesat kulturore institucionale dhe infrastrukturore që pengojnë arsimimin sipas nevojave të fëmijëve romë?
- Cilat janë nevojat e fëmijëve romë për shërbime arsimore?
- Cili është roli dhe rëndësia e politikave arsimore dhe sociale në ndihmë të arsimimit të fëmijëve të komunitetit rom?
- A ka harmonizim midis politikave arsimore dhe sociale në Shqipëri?

3.2 Përpunimi i qëllimit në kuadër operator

Gjithë punimi dhe pyetjet kërkimore të evidentuara e të shtjelluara qysh në kapitullin e parë orientohen e burojnë nga qëllimi kryesor i studimit. Ai konsiston tek teza jonë se:

Shkolla shqiptare duhet të synojë drejt një edukimi gjithpërfshirës, i cili duhet të jetë në funksion të formimit të individit, normave dhe vlerave të tij, cilësive të personalitetit në mjedisin social e emocional, të karakterit dhe mbi të gjitha të aftësisë së tij me shprehi praktike themelore për jetën.

Ky qëllim ndërlidh një sërëkonceptesh kyç të studimit si: edukimi gjithpërfshirës (A), i cili duhet të synojë: Formimin e nxënësve me shprehje jetësore bazë sipas nevojave që ka gjithësecili prej tyre (B). Ndërmjet këtyre koncepteve mund të derivojnë edhe mjaft variabla të rëndësishëm e me peshë në studim.

Në të njëjtën kohë ky qëllim formulon edhe lidhjen midis këtyre koncepteve, që në thelb është një lidhje modaliteti, që shpreh domosdoshmërinë e çështjes së zhvillimit të aftësive bazë për jetën, si një nga synimet kryesore edukative, që duhet të ketë shkolla shqiptare sot, në raport me nevojat, që paraqesin fëmijët e komunitetit rom. Përdorimi i variablave për të përshkruar një sërë faktorësh ndikues tek studimi i çështjes së “aftësive bazë për jetën”, ishte i nevojshëm si nivel i parë i operacionalizimit, por jo i mjaftueshëm. Çështjet e kërimit janë përpunuar edhe në një nivel të dytë duke përdorur edhe një numër indikatorësh, si referentë empirikë, të cilët janë shprehur me anën e masave apo të shprehur në përqindje. Kryerja e përpunimit të koncepteve në dy nivele operacionalizimi; në variabla dhe indikatorë, ka ndihmuar mjaft analizën dhe argumentimin në punim. Për të ilustruar këtë aktivitet, gjatë të cilit u përpunua punimi në planin operativ po rendisim disa prej tyre. Për të operacionalizuar në nivelin e parë konceptet e qëllimit, me synim paraqitjen e tyre nëpërmjet variablave u përdorën këto përcaktime: “arsim gjithpërfshirës”, “aftësi motivuese”, “aftësi menaxhuese”, “shmangie e pasigurisë”, “harmonizim politikash”, “orientim drejt arritjes”, “mënyra të zhvillimit të aftësive për jetën”, “efikasiteti i ligjit”, etj. Për të operacionalizuar në një nivel të dytë, konceptet tashmë variabla, u përdorën indikatorë përkatës të cilët i përfaqësonin variablat përmes një karakteristike të matur, të nxjerrë nga kuadri i referencës ose të shprehur në përqindje tek të dhënat statistikore, të mbledhura nëpërmjet pyetësorëve. Kështu u përdorën mjaft indikatorë si “% e rezultateve të ulëta në mësim”, “% e gjendjes së rënduar social-ekonomike”, “% e shkallës së diskriminimit”, “% e njohjes së nevojave nxënësve”, “% e krijimit të klimës mbështetëse”, “% e të qenit ndihmues në kapërcimin e problemit”, “% e nevojës për trajnim”, “% e njohjes së vlerës së shkollimit”, etj. Gjatë përdorimit të variablave dhe indikatorëve në të dy nivelet e operacionalizimit u verifikua edhe konsistenca e relacionit të qëllimit, ky relacion duhej të mbetej i njëjtë sa herë që ai shkruhej qoftë me anën e variablave qoftë me anën e indikatorëve.

3.3 Kohëzgjatja dhe fazat e studimit

Ky studim ka nisur në vitin 2013 dhe ka përfunduar në 2016 dhe ka ndjekur fazat e mëposhtme;

Faza e parë ka të bëjë me rishikimin e literaturës, për t'u njohur me nevojat bazë të njeriut në përgjithësi, të komunitetit rom në veçanti e më pas të komunitetit rom në Shqipëri, me situatën arsimore të fëmijëve të këtij komuniteti, politikat arsimore dhe sociale që janë ndërmarrë në vite në dobi të romëve etj. Rishikimi i literaturës ka qenë gjithashtu edhe një ndihmesë e madhe për të shqyrtuar kornizat teorike të studimeve të mëparshme, të cilat ofrojnë informacione të përditësuara në lidhje me temën e studimit.

Faza e dytë ka konsistuar në përgatitjen e pyetjeve kërkimore, të cilat nxjerrin në pah problematikën mbi fenomenin e studiuar. Gjatë kësaj faze, është hartuar një platformë pune në lidhje me studimin në vazhdim. Mbledhja dhe klasifikimi i materialit informues mbi problematikën ka ndihmuar më pas përzgjedhjen e pyetjeve kyçe, të domosdoshme për analizën cilësore të rezultateve.

Faza e tretë ka përcaktuar metodat dhe instrumentet e kërkimit. Këto të fundit kanë ndihmuar në mbledhjen e informacionit të nevojshëm për arritjen e qëllimit. Hartimi i pyetjeve për fokus grupet si dhe intervistat me personat kyç ka pasuar punën pas një konsultimi me specialistë të fushës së kërkimit cilësor. Në këtë fazë janë përcaktuar gjithashtu popullata dhe kategoritë e tjera që do të ishin në fokus të këtij studimi, pa lënë pas dore dhe zonën e studimit. Fokus grupet u zhvilluan me prindër të komunitetit rom në qytetet: Korçë ku ky komunitet përbën sipas Censurit të vitit 2011, 1.005 ose 0.46%, të totalit të popullsisë rome në vend; Fier (1.640 ose 0.53 %); Berat (202 ose 0.14%) dhe Elbasan (1064 ose 0.36%), qytete ku dhe popullsia e komunitetit rom rezulton mjaft e lartë. Pjesëmarrës të fokus grupeve në këto zona ishin prindër të fëmijëve romë, që janë regjistruar në shkollë, dhe e vazhdojnë atë, prindër të fëmijëve që e kanë braktisur shkollën, si dhe prindër të fëmijëve, që nuk e ndjekin shkollën. Pjesëmarrës të tjerë ishin dhe persona apo aktorë institucionalë kyç si: përfaqësues të Ministrisë së Arsimit, Ministrisë së Punës e Çështjeve Sociale, përfaqësues të DAR-ve në rrethe, përfaqësues të sektorit të shërbimeve sociale pranë bashkive, mësues e drejtues shkollash.

Faza e katërt ka vazhduar me organizimin e fokus grupeve dhe intervistimin e subjekteve. Zhvillimi i fokus grupeve dhe intervistat u regjistruan në rastet kur ishte siguruar më parë leja

nga pjesëmarrësit. Pjesëmarrësit që ishin dakort me regjistrimin u njohën me këtë proces paraprakisht. Procesi i regjistrimit u pasua më tej me procesin e transkriptimit të intervistave. U zbardhën gjithashtu, intervistat e dhëna nga personat që ishin në fokus të studimit, por që nuk pranuan të intervistohen me regjistrim. U mbledhën dhe u analizuan edhe të dhënat e marra në mënyrë elektronike nga përfaqësuesit DAR-ve, sepse vetë të intervistuarit kishin mangësi informacioni në momentin e kryerjes së intervistës.

Faza e pestë ka të bëjë me diskutimin e rezultateve sipas objektivave të përcaktuar

Faza e gjashtë ka të bëjë me konkluzionet dhe rekomandimet të përgjithshme, që u nxorrën pas diskutimit të gjetjeve. Kryesisht janë nxjerrë konkluzione për institucionet, të cilat merren në mënyrë të drejtëpërdrejtë me këto çështje, si dhe janë dhënë rekomandime specifike për të gjithë aktorët, përfshirë këtu institucionet qendrore dhe lokale, politikëbërëse e zbatuese, si dhe janë dhënë orientime e rekomandime për prindërit, mësuesit e të gjithë punonjësit e sistemit arsimor të përfshirë në këtë problem.

3.4 Metoda kërkimore e përdorur

Metodat e kërkimit janë një tërësi procedurash logjike dhe operative, të cilat lejojnë të kryhet në praktikë mbledhja dhe interpretimi i të dhënave, në mënyrë që të çojnë më tej, verifikimin e hipotezave të vendosura në planin kërkimor. Për këtë studim vendosëm të përdorim metodën cilësore, pasi në përgjithësi metodat cilësore prodhojnë të dhëna mbi dukuritë e përshkruara, që lidhen me grupe të kufizuara apo me individë të veçantë. Matja e këtyre dukurive nuk mund të jetë e kufizuar nga numrat. Metoda cilësore bazohet mbi një qëndrim njerëzor cilësor, për aq kohë sa trajtohen tema delikate, të cilat prekin sferën personale të sjelljeve dhe u japin përparësi aspekteve të ndërveprimeve të krijuara midis kërkuesit dhe objektit të kërkimit. Meqenëse mbizotëron prirja e përdorimit të asaj metode që nxjerr në dritë aspektet e ndryshme të problemit dhe duke pasur parasysh qëllimin e këtij studimi, i cili lidhet me një grup të caktuar shoqëror, siç është komuniteti rom, është zgjedhur metoda cilësore. Kjo metodë është zgjedhur enkas, pasi ka të bëjë edhe me të kuptuarit e "përvojave të brendshme të subjekteve", "format e bashkëveprimit social" midis tyre dhe shoqërisë, të para përmes syve të pjesëmarrësve përfaqësues, dhe të bazuara në "kuptimin kulturor", që ata i japin këtyre përvojave, për të kuptuar në thellësi realitetet personale të pjesëmarrësve në studim, nga perspektiva e tyre gjinore, aspektet e

përvojave të tyre jetësore etj. Më konkretisht mund të themi se metoda cilësore u përdor në këtë studim pasi studimi pati si qëllim:

- Kërkimin në thellësi. Në rastin tonë u bënë përpjekje për të kuptuar se cilat janë pengesat kulturore, institucionale dhe infrastrukturore, që pengojnë arsimimin sipas nevojave të fëmijëve romë
- Njohjen e përjetimeve personale, subjektive rreth një fenomeni. Në rastin tonë të kuptojmë se ç'ndodh me përjetimet personale të fëmijëve dhe prindërve, në lidhje me problematikat e shkollimit të fëmijëve të tyre.
- Ndhimën për të studiuar një çështje delikate, siç është çështja e arsimimit të fëmijëve të komunitetit rom, që shpeshherë konsiderohet si problem i mprehtë dhe delikat, jo vetëm për institucionet që prodhojnë politika arsimore por edhe për ato që prodhojnë politika sociale, pasi harmonizimi i këtyre politikave, do të ishte mbështetje e fuqishme, në dobi të arsimimit bazë cilësor të këtyre fëmijëve.
- Konsiderimin e kontekstit natyror të një çështjeje si mjaft të rëndësishëm. Në rastin tonë, e drejta për arsimim është e drejtë për këdo, pa dallime gjinie, race, feje apo etnie.
- Kuptimin e fenomeneve komplekse që janë të vështira ose të pamundura të kapen në mënyrë sasiore.

Metoda cilësore e mbledhjes së të dhënave në këtë studim ka ndihmuar në shpjegimin e arsyes se pse fëmijët romë janë më pak të arsimuar se pjesa tjetër e fëmijëve, duke e përshkruar situatën aktuale në mënyrë të natyrshme. Përdorimi i kësaj metode studimi, ka lehtësuar procesin e të kuptuarit të realitetit, në të cilin jetojnë fëmijët romë dhe ka adresuar përgjigjet e pyetjeve lidhur me arsimimin e tyre, sipas nevojave që ata kanë. Analiza cilësore e të dhënave ka bërë të mundur sigurimin e një informacioni të pasur dhe mjaft të gjerë rreth problematikës që shfaqet në familjet romë, vlerave dhe kulturës së tyre, sfidave me të cilat ato përballen, rolit të institucioneve, bashkëpunimit ndërinstitutional, anëve të forta dhe të dobëta të këtij bashkëpunimi etj.

Ndërsa analiza e të dhënave dytësore, ka konsistuar në rishikimin dhe shqyrtimin e literaturës ekzistuese botërore, në kontekstin teorik dhe praktik të saj, duke përfshirë në shqyrtim studime, raporte, vlerësime etj. Faza e studimit të literaturës ka synuar të identifikojë literaturën përkatëse, për t'u njohur me nevojat bazë të njeriut në përgjithësi, të komunitetit rom në veçanti e më pas të komunitetit rom në Shqipëri, me situatën arsimore të fëmijëve të këtij komuniteti, politikat

arsimore dhe sociale që janë ndërmarrë në vite në dobi tyre, ecurinë dhe ndryshimet që kanë pësuar këto politika, kuadrin ligjor shqiptar për arsimimin e pakicave etnike etj. E gjitha kjo ka ndihmuar në krijimin e një perspektive teorike, e cila ka drejtuar pyetjet kërkimore të studimit, duke marrë në konsideratë faktin se ka pak ose aspak kërkime për arsimimin bazë cilësor të fëmijëve romë.

3.5 Instrumentet e përdorur

- *Intervistat gjysëm të strukturuar*

Instrumenti më i përdorur për të mbledhur të dhëna në kërkimet cilësore është intervista e cila nuk është gjë tjetër, veçse një proces pyetje – përgjigje i realizuar përballë me personin në intervistim. Intervistat janë mjete fleksibile për mbledhjen e të dhënave, që përdoren për të portretizuar ngjarje të caktuara në lidhje me një temë, duke e paraqitur realitetin, sipas perceptimeve dhe qëndrimeve të pjesëmarrësve. Kjo lloj interviste përdoret kur studiuesi ka informacion rreth fenomeneve apo dukurive për të cilat do të marrë të dhëna, në rastin konkret të studimit. Pikërisht kjo intervistë është përdorur si instrument kërkimi, për mbledhjen e të dhënave në këtë studim, pasi intervista gjysmë e strukturuar i adreson pyetjet duke respektuar probleme të caktuara, të cilat i shtron më hapur se intervistat e tjera. Këto intervista, gjithashtu përdoren kur duhet të merret informacion për shumë njerëz dhe kur duhet të mësojmë rreth përvojave të tyre, si dhe inkurajon të intervistuarin të shprehë mendimet, të sjellë ndër mend kujtimet e tij, të zbulojë emocione etj. Parë në këtë kontekst u konsiderua si instrumenti më i përshtatshëm, që përmbush qëllimin e këtij studimi. Përmbajtja dhe procedura e intervistës kanë qenë të organizuara paraprakisht, para se të mblidheshin të dhënat, gjithashtu ndërtimi i intervistave është orientuar nga intervista të studimeve të tjera, me fokus arsimimin e fëmijëve të komunitetit rom. Për të adresuar në mënyrë të përshtatshme pyetjet kërkimore të studimit, si dhe për të mësuar më shumë mbi përvojat e prindërve të fëmijëve romë, për të kuptuar më mirë kontekstin brenda të cilit këto përvoja zhvillohen, janë realizuar intervista gjysmë të strukturuar me nëna dhe baballarë të këtyre fëmijëve. Gjithashtu, nëpërmjet intervistave edhe me persona kyç, është marrë më shumë informacion, për llojet dhe natyrën e shërbimeve që ofrohen për familjet në vështirësi ekonomike të këtij komuniteti si dhe janë prezantuar një numër arsyes dhe faktorësh të jashtëm, që ndikojnë drejtpërdrejtë në mungesën e shkollimit cilësor. Intervistat

gjysëm të strukturuar u përdorën edhe me lider informale romë dhe mësues të ciklit të ulët të arsimit të detyruar, të cilët punojnë edhe me fëmijët romë në shkollat 9-vjeçare, me vendodhje pranë komuniteteve romë të përzgjedhura në studim. Përzgjedhja e subjekteve të cilët u intervistuan me anë të intervistave gjysëm të strukturuar u bë në mënyrë të qëllimshme. Mendimet dhe opinionet konkrete të liderve informale, mësueseve, specialistëve në bashki, drejtori arsimor etj, ofruan një opinion më të thelluar dhe asnjans në lidhje me problemet e fëmijëve romë në edukim, zbatimin e politikave arsimore dhe sociale nga ana e institucioneve shtetërore, harmonizimin e tyre, format e diskriminimit në institucionet edukuese etj. Procesi i intervistimit u krye në ambiente të përshtatshme pranë shkollave 9-vjeçare (për këtë arsye iu kërkua paraprakisht leje drejtorive të shkollave). Siç shkruam edhe më lart intervista na jep mundësinë të fokusohemi në një numër të limituar subjektesh. Përsa i përket intervistimit të nxënësve romë, para nesh u paraqitën dy mundësi, ajo e intervistimit të nxënësve në fokus grupe dhe ajo e intervistimit të tyre individualisht. Problemi kryesor në intervistimin e fokus grupeve, mund të jetë hezitimi i individëve për të mos ndarë në grup përvojat e tyre personale, pasi ato mund të ndjehen në vështirësi për t'i deklaruar ato haptazi, mes shokëve të tyre të klasës. Nisur nga kjo menduam që me nxënësit të përdorim formatin e intervistave individuale. Për më tepër është mjaft e rëndësishme, mbajtja e shënimeve me saktësi për secilin nxënë. Lehtësia në mbajtjen e shënimeve apo edhe në regjistrimin e intervistave në intervistat individuale, është një element më favorizues përkundrejt fokus grupeve. Për të marrë përgjigje rreth çështjeve të caktura, mund të ishin përdorur edhe pyetsorë, por interesi ynë ishte marrja e informacioneve të mëtejshme më të detajuara, gjë që pyetsorët nuk e mundësojnë dot. Intervistat u kryen në periudhën prill-maj 2016 dhe zgjatën nga 40-50 minuta. Pjesëmarrësit në studim, që të gjithë u siguruan për ruajtjen e konfidencialitetit dhe anonimatit.

Intervistat gjysëm të strukturuar sollën këto avantazhe për studimin:

Së pari, përdorimi i tyre na mundësoi mbledhjen e një informacioni të detajuar rreth mendimeve dhe piknamjeve të njerëzve të ndryshëm, rreth çështjeve specifike pasi kjo lloj interviste ofroi fleksibilitetin përgjatë procesit të kryerjes së saj.

Së dyti, i dha mundësinë të intervistuarve të shpreheshin lirisht, rreth çështjeve që ishin sensitive dhe të lidhura drejtpërdrejt me objektivat kërkimore.

Intervista gjysëm e strukturuar pati gjithashtu dhe disavantazhe ku më kryesori ishte koha relativisht e gjatë për përgatitjen, zhvillimin e procesit intervistues dhe interpretimin e të dhënave.

- ***Intervistat e fokus grupeve***

Përsa i përket intervistave të fokus grupeve mund të themi se ato stimulojnë më shumë “hapjen” e të intervistuarëve, duke bërë që informacioni të jetë më i lirë dhe kompleks. Nëpërmjet këtyre intervistave të intervistuarit stimulojnë njëri-tjetrin me ide dhe mendime, nisur nga përdorimi i fleksibilitetit në mënyrën se si ata pyeten. Elementet më të rëndësishëm të intervistës së fokus grupit janë stimulimi dhe inkurajimi, që mundësojnë zhvillimin e diskutimeve rreth jetës personale, familjare si dhe problematikave të prindërve të fëmijëve romë, në raport me edukimin e fëmijëve të tyre. Kjo është një formë relativisht e shpejtë dhe e përshtatshme për të mbledhur të dhëna nga disa individë njëkohësisht. Në këtë studim për realizimin e fokus grupeve u mbajtën parasysh:

- madhësia e grupit
- mënyra e akomodimit të pjesëmarrësve
- stili dhe personaliteti i lehtësuesit të takimit

Një rol të rëndësishëm në suksesin e fokus grupit e luan edhe moderatori, kështu që iu kushtua shumë rëndësi kësaj pjese. Gjithashtu u bënë përpjekje edhe për të ruajtur ekuilibrat në fokus grup. Krahas avantazheve që përmendëm edhe intervistat e fokus grupeve patën disa dizavantazhe:

- Ngurimi i ndonjë pjesëmarrësi për të marrë pjesë ose për të komunikuar në mënyrën e duhur me të tjerët.
- Influenca e heshtjes së ndonjë pjesëmarrësi tek të tjerët mund të shkaktojë pakënaqësi, duke marrë parasysh dhe kompleksitetin e çështjes.
- Vetë prania e të tjerëve mund t'i pengojë disa individë të shprehen lirshëm dhe të tregojnë arsytet e vërteta, që pengojnë fëmijët e tyre në frekuentimin e shkollës.
- Mosdakortësia për të regjistruar bisedat pasi një pjesë e pjesëmarrësve nuk ndjeheshin “komodë”, kur regjistroheshin me diktofon.

Hartimi i intervistave gjysmë të strukturuar dhe fokus grupeve

Ashtu siç e kemi përmendur edhe më lart në këtë studim instrumentët e kërkimit janë intervista gjysmë e strukturuar dhe intervista e fokus grupit. Intervistat gjysmë të strukturuar si elementë të mbledhjes së informacionit i adresojnë pyetjet në përputhje me probleme të caktuara dhe i shtrojnë ato në mënyrë më të hapur se intervistat e tjera. Këto intervista përdoren kur na duhet të merrim informacion për shumë njerëz dhe duhet të mësojmë rreth përvojave të tyre. Përmbajtja dhe procedura e intervistave u organizuan paraprakisht, para mbledhjes së të dhënave. Ato u hartuan të orientuara nga intervista në studime të tjera, rreth problemeve që hasin romët në arsimimin e tyre, duke u bazuar në orientimet e Planit Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë 2016-2020”. Në studimin tonë intervistat gjysmë të strukturuar përbëhen nga 4 grupe pyetjesh:

1. grupi i parë i pyetjeve fokusohet në informacionin që lidhet me hapat dhe politikat konkrete, që janë ndërmarrë për komunitetin rom dhe rolin e shkollës dhe institucioneve të tjera vendore, për zbutjen e pengesave që fëmijët romë hasin në edukim.

2. grupet e tjera të pyetjeve (tre), orientohen drejt marrjes së informacionit të thelluar rreth problemeve si varfëria rome, kultura rome, diskriminimi, marrëdhëniet prind-fëmijë, nxënës-mësues etj.

Fokus grupet janë organizuar kryesisht me prindër romë, të cilët kanë fëmijë në moshë shkollore dhe një fokus grup është zhvilluar me studentë romë. Këto të fundit shprehën opinionet e tyre rreth arsimit në përgjithësi, cilësisë së tij, suportit që institucione të ndryshme arsimore por jo vetëm i kanë dhënë ose jo atyre etj. Pyetjet për intervistat e fokus grupeve janë hartuar në mënyrë të tillë, që synojnë mbledhjen e informacionit të ndarë në tre grupe:

1) arsimi i detyruar 9-vjeçar, interesi, perceptimi, pritshmëritë dhe përgjegjësitë e shkollës, pushtetit vendor si dhe të prindërve romë në lidhje me arsimimin e fëmijëve të tyre.

2) programet e ndihmës ekonomike, mbështetjes shkollore dhe psikosociale si pjesë përbërëse e politikave të mbrojtës sociale, ndikimi i tyre në shkollimin e fëmijëve të shtresave të marginalizuara, pritshmëritë e prindërve romë për to, menaxhimi dhe shpërndarja e ndihmës ekonomike nga pushteti lokal.

3) politikat që ndjekin institucione të ndryshme vendore, që janë përfaqësuese dhe zbatuese të politikave sociale dhe arsimore, në lidhje me arsimimin e fëmijëve romë.

Ndarja e pyetjeve sipas këtyre grupimeve ka shërbyer për të qartësuar panoramën e vështirësive, që hasin prindërit romë për arsimimin e fëmijëve të tyre, si dhe përpjekjeve familjare dhe institucionale të bëra në këtë drejtim. Marrja e informacioneve sipas këtyre grupimeve ka shërbyer gjithashtu për të nxjerrë në pah të një sërë faktorësh të pandeshur më parë në studime të tjera, të cilët janë konsideruar në studim si pengesa serioze për arsimimin cilësor të fëmijëve të komunitetit rom.

Çdo fokus grup kishte deri në tetë persona pjesëmarrës. Pjesëmarrësit në fokus grupe ishin nëna dhe baballarë të fëmijëve romë. Përzgjedhja e tyre u realizua në bashkëpunim me shoqatat rome e organizatat e tjera, që operonin në zonat e marra në studim. Kriteret bazë të përzgjedhjes janë vendosur nisur nga numri i fëmijëve që pjesëmarrësit kishin dhe nga shkalla e aftësive komunikuese që posedonin.

3.6 Popullata e studimit

Popullatën teorike të studimit e përbëjnë familjet rome, fëmijët e të cilëve vazhdojnë ose kanë braktisur arsimin në katër qytete të katër qarqeve, ku përqëndrimi i komuniteteve rome është mjaft i konsiderueshëm. Qarqet epërzgjedhura janë: Fieri, Elbasani, Korça dhe Berati. Qindra familje rome në qytetet kryesore të vendit jetojnë në komunitete të cilat prezantojnë problematika të njëjta. Ato jetojnë kryesisht në zona periferike, të izoluara gjeografikisht me akses të limituar përsa i përket kushteve të jetesës, ujit të pijshëm, kanalizimeve të ujrave të zeza, shëndetit etj. Tamo dhe Karaj në raportin “Situata arsimore e romëve në Shqipëri”, 2007 na kanë dhënë një tablo të numrit të fëmijëve romë në Shqipëri. Për këtë, ata i janë referuar shifrave të “Monitoring Education for Roma- A statistical Baseline for Central, Eastern and South Europe” 2006, që ka bërë një vlerësim të përafërt të numrit të fëmijëve romë, pasi sipas përfaqësuesve të minoritetit rom, numri i fëmijëve të moshës shkollore të këtij komuniteti nuk është i saktë, pasi familjet rome emigrojnë drejt vendeve fqinje por edhe brenda vendit. Kështu për të gjitha familjet rome që ndodhen aktualisht në Shqipëri, numri i përgjithshëm i fëmijëve romë për grupmoshën 3-16 vjeç është 4654. Nga këta 2414 (52%) janë meshkuj dhe 2240 (48%) janë femra. (Tamo, Karaj, 2007, fq. 10)

Ndërsa përse i përket statusit arsimor të këtyre fëmijëve, po të njëjtët autorë kanë shkruar se:

“vetëm 13% e fëmijëve të grupmoshës 3-5 vjeç ndjekin arsimin parashkollor. E shprehur ndryshe kjo do të thotë se vetëm 148 nga 1099 fëmijë të grupmoshës 3-5 vjeç ndjekin arsimin parashkollor. Ndërkohë vetëm 45.6% e grupmoshës 6-16 vjeç ndjek shkollën. ...Siç shihet niveli i braktisjes së shkollës është shumë i lartë. Gati 1 në 2 fëmijë romë në moshë shkollore e kanë braktisur atë”. (fq.12)

Siç e kemi përmendur edhe më lart, arsyeja e përzgjedhjes së qarqeve të mësipërme në këtë studim është se komuniteti rom, është i shtrirë në një masë shumë të gjërë në këto qarqe. Kështu sipas “Raportit studimor “Situata e fëmijëve romë” për vitin 2012 për Qarkun Fier”, 15% e këtij komuniteti në rang kombëtar është i përqëndruar në qarkun e Fierit, i cili në 2012- tën numëron një popullsi prej 489,457 banorë, nga të cilët rrethi Fier ka edhe numrin më të lartë të banorëve. (fq. 5).

Ndërsa nëse i referohemi qarkut Berat edhe këtu numri i familjeve rome është i lartë. Sipas “Planit ndërvendor për zhvillimin e komuniteteve rome dhe egjiptiane” 2014-2020, të Bashkisë Berat, në këtë bashki jetojnë rreth 670 familje rome dhe egjiptiane. Komuniteti rom përbëhet nga 120 familje me një popullsi prej më tepër se 600 banorë. (fq.29). Përpos kësaj, po sipas këtij Plani Ndërvendor “Qendra Administrative Otllak është një nga qendrat me një përqendrim të lartë të komunitetit rom. Në të janë të vendosura rreth 197 familje rome. Popullsia rome e kësaj komune llogaritet rreth 931 banorë të vendosur kryesisht në fshatin Moravë. (fq. 63).

Po të njëjtën gjë mund të themi edhe për bashkitë e Korçës dhe të Elbasanit. Sipas planit ndërvendor të bashkisë Korçë, në këtë bashki numurohen rreth 800 familje rome dhe egjiptiane (fq. 29), ndërsa Bashkia Elbasan sipas “Panoramës sociale për Qarkun e Elbasanit”, numuron rreth 3112 banorë të komunitetit rom ose 496 familje vetëm në qytet. (Lika, 2008, fq. 96). Siç e kemi përmendur edhe më lart popullata e studimit janë familjet rome, fëmijët e të cilëve vazhdojnë ose kanë braktisur arsimin. Duke qenë se familjet rome në qytetet kryesore të vendit jetojnë kryesisht në zona periferike, të izoluara gjeografikisht, në katër qarqet e përmendura u përcaktuan komunitetet rome, për çdo qytet sipas kësaj përzgjedhje:

Në Fier u përzgjedh komuniteti rom i cili jeton në zonën: “Fshati Rom”. Sipas studimit krahasues “Çështje të arsimimit të fëmijëve të komunitetit rom”, 2013: “Fshati Rom ndodhet në kufi me qytetin e Fierit praktikisht në vazhdim të atij territori, që konsiderohet zonë e qytetit (në kufi të vijës së verdhë) dhe e ka marrë këtë emër në fund të viteve ’80, sepse përbëhet prej një

popullate pothuaj 100 % rome (rreth 900 banorë dhe 194 familje).(Studim krahasues, 2013, fq. 22)

Në Berat u përzgjedh Rajoni Administrativ 2, pasi familjet rome janë të përqendruara në këtë Rajonin Administrativ...Në bazë të të dhënave të Bashkisë Berat, këto familje të ardhurat i sigurojnë kryesisht përmes tregtimit të rrobave të përdorura, migrimit, mbledhjes dhe riciklimit të mbetjeve metalike, ndihmës ekonomike shtetërore dhe pensioneve të paaftësisë. (Bashkia Berat 2014-2020, fq. 30)

Në Korçë u përzgjidhën rajonet 2 dhe 3, pasi romët janë përqëndruar veçanërisht në këto rajone.Burimi kryesor i të ardhurave të kësaj popullsie bazohet në tregëtinë e rrobave të përdorura, punëve sezonale, mbledhjen e mbetjeve të hekurit, pensionet dhe ndihmën ekonomike. (Bashkia Korçë, 2014-2020 fq. 29)

Në Elbasan u përzgjedhën lagjet “5 Maj”, “Emin Matraxhiu”, lagje që në popull njihen edhe si zona e Rrapishtës. Edhe këtu burimi kryesor i të ardhurave të kësaj popullsie bazohet në tregëtinë e rrobave të përdorura, punëve sezonale, ndihmën ekonomike etj.

Këto zona u bënë pjesë e popullatës së arritshme nga e cila u përzgjedh edhe kampioni.

Për të krijuar një panoramë të qartë e të plotë për sa i përket situatës së arsimimit dhe shkallës së arsimimit të fëmijëve romë, si dhe për t’u njohur me perceptimin e institucioneve në lidhje me situatën në fjalë, u realizuan edhe fokus grupe. U realizuan gjithashtu edhe intervista me lider informalë romë dhe mësues të ciklit të ulët të arsimit të detyruar, të cilët punojnë edhe me fëmijët romë në shkollat 9-vjeçare, me vendodhje pranë komuniteteve rome të përzgjedhura në studim. Përzgjedhja e subjekteve të cilët u intervistuan me anë të intervistave gjysëm të strukturuar u bë në mënyrë të qëllimshme. Në total u kryen 55 intervista. Një ndihmesë të madhe për njohjen e mënyrës se si i perceptojnë institucionet e ndryshme qendrore dhe vendore politikat arsimore dhe sociale dhe si i zbatojnë ato në ndihmë të arsimimit të fëmijëve romë, dhanë edhe intervistat me personat kyç.Persona kyç konsiderohen ato individë që përfaqësojnë institucione të ndryshme politikëbërëse, arsimore, edukative etj. Informacionet me të intervistuarit kyç janë pjesë e intervistave cilësore të personave, të cilët dinë se çfarë ndodh në këtë komunitet. Qëllimi i intervistimit të tyre është mbledhja e një informacioni më të gjërë pasi personat kyç janë hartues e zbatues të politikave e strategjive në komunitet.

3.7 Kampionimi i studimit

Kampionimi në këtë studim është konsideruar si mjaft i rëndësishëm, pasi është ai që i jep përgjigje pyetjeve kërkimore të ngritura. Duke iu referuar Cohen et al (2007), “Kampioni është një nëngrup i popullatës së studiuar, që do t’ japë përgjigje pyetjeve kërkimore. Kampioni në kërkimet cilësore është zakonisht më i vogël se ai në kërkimet sasimore. (fq.143). Në kërkimet cilësore, që bazohen kryesisht tek intervistat, zakonisht studiuesit propozojnë kampionimin e qëllimshëm apo kampionimin pa probabilitet. Po sipas Cohen et al (2007), “Në këtë lloj kampionimi presupozohet se kampioni i përzgjedhur nuk përfaqëson plotësisht popullatën e gjerë, ai thjesht përfaqëson vetveten” (fq. 57). Nisur nga pyetjet kërkimore të ngritura në këtë studim, i cili kërkon një larmi informacioni është parë si i përshtatshëm pikërisht ky lloj kampioni, i cili prezanton karakteristikat e kërkuara, prandaj dhe është një kampionim i qëllimshëm. Metoda e të zgjedhurit të kampionit i jep mundësinë studiuesit të zgjedhë me dëshirë individët, të cilët do të marrin pjesë në studim dhe ata që mendohet se mund t’u përgjigjen pyetjeve kërkimore. Kampionimi pa probabilitet synon të marrë informacion të pasur nga pjesëmarrësit. Ky studim ka për qëllim të eksplorojë situatën arsimore të këtij komuniteti, duke u fokusuar tek ato elementë, të cilët krijojnë një pasqyrë më të qartë të ndërthurjes së problemit me faktorët ekonomikë, socialë, kulturorë por edhe institucionale. Këtij qëllimi i shërbyen edhe intervistat e fokus grupeve. Intervista e fokus grupit si një instrument, që përdoret në kërkimet cilësore i jep mundësinë kërkuesit që të pyesë pjesëmarrësit për perceptimet, mendimet, besimet dhe qëndrimet e tyre për një shërbim, për një temë, për situata të caktuara etj. Në rastin tonë ajo u hartua duke pasur parasysh qëllimin e studimit. Këto intervista kanë një shkallë të lartë vlefshmërie pasi rezultatet janë të besueshme dhe kanë kosto të ulët. Rezultatet e fokus grupeve mund të përflohen më shpejt dhe madhësia e kampionit mund të rritet, pasi intervistohen disa individë njëherazi (Catherine , M et al, 1999, fq. 39).

Një ndihmesë të madhe në përzgjedhjen e pjesëmarrësve në këtë studim dhanë edhe liderët informalë romë. Nevoja për të aktivizuar liderët informalë romë lindi për disa arsye:

- Një numër jo i vogël i pjesëtarëve të komuniteteve romë në secilin nga qytetet e përzgjedhura në studim, nuk është regjistruar në ndonjë institucion lokal.

- Në komunitetet rome, homogjeniteti i lartë (pasi jetojnë të veçuar nga komunitetet maxhoritare), është tipar dallues dhe liderët romë ndihmuan në identifikimin e vendodhjeve në praktikë të komuniteteve.
- Nevoja për asistencë për të kontaktuar subjektet e kampionit, apo për të informuar familjet rome pjesëmarrëse rreth studimit në fjalë, rreth pjesmarrjes vullnetare në studim dhe ruajtjes së konfidencialitetit nga ana e kërkuesit.

3.8 Kriteret e përzgjedhjes së të intervistuarve

Informuesit kyç

Siç e kemi përmendur edhe më lart informues kyç konsiderohen ato persona, që përfaqësojnë institucione të ndryshme politikëbërëse, edukative, arsimore etj. Informacionet e marra prej tyre janë pjesë e intervistave cilësore të personave, të cilët dinë se çfarë ndodh në këtë komunitet. Intervistimi i tyre ka si qëllim mbledhjen e një informacioni më të gjërë pasi ata janë hartues e zbatues të politikave dhe strategjive në komunitet.

Gjatë fazës fillestare të studimit përfshirja e informuesve kyç na ndihmoi në marrjen e informacionit në lidhje me politikat arsimore dhe sociale, që ndiqen në dobi të arsimimit të fëmijëve romë dhe punën e bërë për harmonizimin e tyre . Informuesit kyç, si përfaqësues të institucioneve që merren në mënyrë të drejtpërdrejtë me politikat dhe strategjitë që janë hartuar e zbatohen në lidhje me përmirësimin e situatës së komunitetit rom, na njohën dhe me gjendjen dhe punën e bërë gjatë tre viteve të fundit, duke na ofruar dhe statistika në lidhje me fenomenin në studim. Kështu mund të themi se studimit tonë i është bashkëngjitur që në fazën fillestare edhe informacioni i marrë nga përfaqësuesit e katër drejtorive arsimore në rrethet Elbasan, Korçë, Berat dhe Fier. Pjesë e intervistimeve kyçe ishin edhe specialistë të drejtorive të kujdesit social në bashki, misioni i të cilave ndër të tjera është edhe:

- Identifikimi i familjeve më të varfëra në territor dhe planifikimi i dhënies së ndihmës ekonomike, sipas kriterëve ligjore
- Identifikimi i nevojave të grupeve sociale në rrezik si fëmijët, të rinjtë, gratë, personat me aftësi të kufizuar, të moshuarit si dhe etnitë për shërbime sociale, duke monitoruar dhe ndjekur problematikat sociale të tyre, në përputhje me strategjitë dhe planet kombëtare apo rajonale të veprimit etj

Gjithashtu u intervistuan edhe mësues të ciklit fillor dhe atij 9–vjeçar në zonat e studimit. Pjesë e informuesve kyç ishin edhe përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare në këto rrethe të cilët ishin përfshirë në ndihmë të komunitetit rom me projekte të ndryshme. Këtu mund të përmendim përfaqësuesit e fondacioneve të ndryshme si: përfaqësuesi i fondacionit “Romani Baxt” në Fier, përfaqësuesi i fondacionit “Terres des Hommes, Elbasan, përfaqësuesi i fondacionit “Romët e bashkuar” Berat, si dhe përfaqësuesi i fondacionit “Romët për Integrim”, Korçë.

Informacioni i marrë nga të intervistuarit na njohu me sfidat me të cilat përballen institucionet në lidhje me zbatimin e politikave arsimore dhe sociale si dhe me fakte e statistika të braktisjes të shkollës nga ana e fëmijëve romë. Ky informacion na njohu gjithashtu edhe me përpjekjet e bëra për të ndërgjegjësuar këtë komunitet për rëndësinë e edukimit të fëmijëve të tyre. Intervistat me personat kyç na ndihmuan që në filim për të krijuar një ide më të qartë rreth situatës së romëve në shkolla dhe kopshte dhe rreth nismave të ndërmerra nga drejtoritë arsimore apo drejtoritë e kujdesit social në bashki në lidhje me sigurimin e arsimimit bazë cilësor të këtij komuniteti. Të dhënat e marra në drejtoritë arsimore, krijuan një tablo më të qartë rreth asaj që do të ndiqej në vijim të studimit. Nga përfaqësuesit e drejtorive të kujdesit social që bashkëpunojnë me OJF- të e ndryshme që kishin kontakte të vazhdueshme me komunitetin rom, u pa se çfarë ishte arritur të realizohej në dobi të frekuentuentimit të shkollës nga fëmijët romë, cilat ishin mbështetjet e ofruara prej tyre etj. Intervistat me përfaqësues të shoqatave romë në komunitetet në studim, na njohën me punën e tyre në mbrojtje të të drejtave të këtij komuniteti, veçanërisht të drejtën për arsim apo shkollim të fëmijëve romë, por edhe të përpjekjeve të tyre lobuese për të drejtat e përfshirjes dhe integritit të tyre, në jetën e gjerë sociale. Me anë të të dhënave të grumbulluara gjatë intervistave të kryera me mësuesit e fëmijëve romë, por edhe me nxënës romë u krijua një tablo rreth nivelit apo shkallës së interesimit të prindërve për shkollën, marrëdhënies që fëmijët kishin krijuar me këtë të fundit, aftësive të veçanta që këto fëmijë shfaqnin në fusha të ndryshme si dhe arritjet dhe vështirësitë e tyre në shkollë. Në analizën e intervistave, u vërejtën një sërë problematikash sociale, me të cilat ndesheshin fëmijët romë dhe familjarët e tyre në frekuentimin e shkollës, arsyet e braktisjes së saj apo arsyet e një arsimimi i cili nuk i përgjigjet nevojave dhe dëshirave të këtyre fëmijëve.

3.9 Të dhëna rreth numrit të intervistave dhe pjesëmarrësve në to

Ashtu siç e kemi përmendur edhe më lart ky studim mbështetet kryesisht në intervistat gjysëm të strukturuar dhe intervistat e fokus grupeve. Në total u kryen 55 intervista. Intervistat gjysëm të strukturuar u zhvilluan kryesisht me informues kyç (specialistë në ministri, drejtori arsimore, bashki), lider informalë romë, drejtorë shkollash, mësues dhe nxënës kryesisht romë. Numri i pjesëmarrësve në intervistat gjysëm të strukturuar ishte 50, të ndarë përkatësisht sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela 2

- **Intervista gjysëm të stukturuar zhvilluar me:**

Rrethi	Specialistë në ministri	Specialistë në bashki	Specialistë në D.A	Lider informalë	Drejtorë shkollash	Mësues	Nxënës
1.Elbasan		1	1	1	2	6	6
2.Berat		1	1	1	1	2	4
3.Fier		1	1	1	1	3	3
4.Korçë		1	1	1	1	3	3
Totali	1	5	5	4	5	14	16

Fokus grupet u organizuan me prindër romë (nëna dhe baballarë), që kishin fëmijët në moshë shkolllore. Një fokus grup u zhvillua me studentë romë. Numri i fokus grupeve është gjashtë. Për çdo qytet u organizua nga një fokus grup me nëna dhe baballarë, ndërsa një fokus grup u organizua me përfaqësues të shoqatave të ndyshme që merren me çështjet rome, si dhe me përfaqësues të komunitetit rom në këshillat bashkiakë. Një fokus grup tjetër u zhvillua me studentë romë, të cilët mund të shërbejnë fare mirë si modele suksesi në komunitetet e tyre. Numri i pjesëmarrësve të fokus grupeve me prindër ishte 35 nga ku 15 ishin femra. Moshë e tyre varionte për nënat rome 18-45 vjeç, ndërsa për baballarët nga 21-55 vjeç. Numri i pjesëmarrësve të fokus grupit me përfaqësues të shoqatave të ndyshme si dhe përfaqësues të komunitetit rom në

këshillat bashkiakë ishte shtatë. Numri i pjesëmarrësve të fokus grupit me studentë romë ishte nëntë. Këto të dhëna janë pasqyruar në tabelat e mëposhtme:

Tabela 3

- Fokus grupe organizuar me prindër romë

Rrethi	Nr.i F.G.	Nr i nënave	Nr i baballarëve	Nr në total
1. Elbasan	1	6	5	10
2. Berat	1	3	4	7
3. Fier	1	2	7	9
4. Korçë	1	4	4	8
Totali	4 F.G	15 nëna	20 baballarë	35 gjithsej

Tabela 4

- Të dhëna për moshën, arsimimin, profesionin, fëmijët e prindërve romë (nëna + baballarë)

Nëna	Mosha	Arsimimi	Profesioni	Nr dhe arsimimi i fëmijëve
1	B.K, 24 vjeç	asnjë klasë	pa punë	1(një), në klasë të tretë
2	L.I, 33 vjeç	asnjë klasë	pa punë	3(tre),asnjë klasë
3	M.A, 54 vjeç	arsimi 8-vjeçar	pa punë	3(tre),6,4,3 klasë
4	A.A, 72 vjeç	3 klasë	shet rroba të përdorura	1(një), 5 klasë
5	Z.M, 42 vjeç	asnjë klasë	pa punë	3(tre),asnjë klasë
6	Sh.D, 53 vjeç	2 klasë	pa punë	6(gjashtë),3-6 klasë
7	A.N. 22 vjeç	asnjë klasë	shet rroba të	1(një), në klasë të parë

			përdorura	
8	V.N, 29 vjeç	4 klasë		3(tre), vazhdojnë filloren
9	A.C, 38 vjeç	asnjë klasë	pa punë	4(katër),vetëm 2 vazhdojnë filloren
10	I.L, 48 vjeç	5 klasë	pa punë	3(tre),asnjë klasë
11	M.M, 31 vjeç	3 klasë	pa punë	2(dy), vazhdojnë filloren
12	E. M, 36 vjeç	asnjë klasë	pa punë	3(tre),asnjë klasë
13	Z. J, 51 vjeç	4 klasë	shet rroba të përdorura	5(pesë),asnjë klasë
14	L.Z, 54 vjeç	4 klasë	shet rroba të përdorura	3(tre), vetëm i pari 2 klasë
15	A. M, 25 vjeç	asnjë klasë	pa punë	2(dy) vazhdojnë filloren
Baballarë	D.K, 26 vjeç	asnjë klasë	pa punë	2(dy) në klasën e dytë
1	L.Z, 34 vjeç	asnjë klasë	pa punë	3(tre),asnjë klasë
2	D.A, 58 vjeç	asnjë klasë	shet rroba të përdorura	pa punë
3	A.A, 59 vjeç	3 klasë	punëtor ndërtimi	6(gjashtë),2-3 klasë
4	I.N, 44 vjeç	8 klasë	Punëtor(lavazh)	2(dy) 5 klasë
5	I.I, 41 vjeç	6 klasë	pa punë	3(tre), 5-6 klasë
6	N.I, 36 vjeç	asnjë klasë	pa punë	3(tre), klasë 3-të, klasë 5-të
7	N.M, 29 vjeç	asnjë klasë	pa punë	2(dy), vazhdojnë filloren
8	E.F, 32 vjeç	8 klasë	roje	3(tre), vazhdojnë filloren
9	Z.E, 45 vjeç	5 klasë	pa punë	3(tre), 4 klasë
10	E. M, 41 vjeç	asnjë klasë	pa punë	5(pesë),asnjë klasë
11	B.B, 52 vjeç	arsim i mesëm	biznes privat	2(dy), 12 klasë
12	M. Z,47 vjeç	8 klasë	biznes privat	3(tre), arsim 8-vjeçar, i mesëm, i lartë
13	Sh.D, 50 vjeç	3 klasë	pa punë	6(gjashtë),2-6 klasë
14	B.D, 34 vjeç	asnjë klasë	pa punë	2(dy),asnjë klasë

15	L.I, 25 vjeç	asnjë klasë	pa punë	1(një),në klasën e parë
16	Z. M, 33 vjeç	5 klasë	shet rroba të përdorura	2(dy),asnjë klasë
17	D.Ç, 38 vjeç	asnjë klasë	shet rroba të përdorura	4(katër), vetëm 2vazhdojnë filloren
18	Z.B, 49 vjeç	2 klasë	shet rroba të përdorura	2(dy), 2 dhe 4 klasë
19	S. L 41 vjeç	asnjë klasë	pa punë	3(tre),asnjë klasë
20	XH.V 26 vjeç	3 klasë	Pa punë	2(dy), në klasën e parë dhe të dytë

Fokus grupi organizuar me përfaqësues të OJF-ve të ndryshme, dhe përfaqësues të komuniteteve romë në këshillat bashkiakë kishte tetë pjesmarrës, nga ku gjashtë ishin përfaqësues të OJF-ve dhe vetëm dy ishin anëtarë të këshillave bashkiakë. Të dyja anëtarët e këshillave bashkiakë përkatësisht në Berat dhe Elbasan ishin të vetmet përfaqësuese të komunitetit rom në të gjithë Shqipërinë.

Tabela 5

- Fokus grup organizuar me përfaqësues të OJF-ve dhe përfaqësues të komunitetit rom në këshillat bashkiakë

Rrethet	Nr i pjesmarrësve	Përfaqësues të OJF	Anëtarë të k.bashkiakë
1.Elbasan	3	2	1
2.Berat	2	1	1
3. Fier	1	1	-
4. Korçë	2	2	-
Totali	8 gjithsej	6 pjesmarrës	2 pjesmarrës

Tabela 6

- Fokus grup organizuar me studentë romë

Nr	Rrethi	Nr total	Mashkull	Femër	Dega
1	Elbasan	4	1	2	gj.shqipe,gj frënge,juridik, cikli i ulët
2	Fier	2	1	1	juridik, cikli i ulët
3	Berat	1	1	-	anglisht
4	Korçë	2	1	2	gjuhë shqipe, cikli i ulët
Totali		9 studentë	4 djem	5 vajza	

3.10 Mbledhja e të dhënave

Në këtë studim analiza cilësore u përdor kryesisht për të përftuar informacion nga individë të ndryshëm, që kanë eksperiencë pune me fëmijët romë. Informacioni i përftuar nga instrumentat cilësorë u organizua në tematika dhe më pas u kryen konceptualizimet autentike, për të formuar një panoramë sa më të plotë rreth dëshirave, nevojave dhe kapaciteteve që kanë fëmijët e komunitetit rom dhe se sa i përgjigjet shkolla, janë këtyre nevojave apo dëshirave. Ndjekja dhe eksplorimi sistematik dhe i kujdesshëm i informacionit që shpesh shoqërohej edhe me shembuj konkretë, vëmendja ndaj hollësive apo detajeve dhënë nga të intervistuarit kontribuan në përftimin e një informacioni të përgjithshëm konkret rreth komponentëve përbërës për çdo vështirësi, që nxënësit e komunitetit rom hasin në edukim. Procesi i ndërtimit të tematikave përgjatë analizës cilësore u konsiderua si shumë i rëndësishëm. Ai u përftua si rrjedhojë e modelit specifik të përsëritur dhe solli reduktimin e pjesës dërrmuese të informacionit të përftuar. Identifikimi i tematikave të ngritura u krye duhe u bazuar në metodën e interpretimit direkt dhe grumbullimit kategorik. Bazuar në këtë metodë të dhënat fillimisht shqyrtohen veç e

veç, për të vazhduar më tej me grumbullimin e tyre, me qëllim përftimin e një informacioni sa më kuptimplotë. Kështu fillimisht intervistat u shqyrtuan në mënyrë specifike njëra pas tjetrës dhe në vazhdim u krye krahasimi i tyre me anë të kryqëzimit. Më pas u procedua me kodimin aksial i cili ofroi formimin e marrëdhënieve ndërmjet kodeve. Modelet e përfituara u analizuan me vëmendje dhe u pa përputhshmëria midis dy ose më shumë modeleve të kategorive. Në vazhdim kategoritë u formësuan sipas grupimeve të kodeve, hap i cili solli identifikimin e tematikave. Përgjatë fazave të analizimit së të dhënave cilësore tematikat e krijuara u përpunuan në mënyrë të vazhdueshme deri sa u ndërtuan kategoritë ose komponentët. Pjesë tepër e rëndësishme ishte gjithashtu krahasimi i tematikave me informacionet kryesore të ofruara nga literature, rreth vështirësive dhe mundësive që kanë fëmijët romë për një edukim cilësor, në përputhje me nevojat dhe kapacitetet që ata kanë. Mbledhja e të dhënave si proces mjaft i rëndësishëm i studimit, pati si udhërrëfyes dy elementë kryesorë:

1. Përpikmëria dhe besueshmëria në prezantimin e të dhënave. Përpikmëria lidhet drejtpërsëdrejti me korrektësinë apo pastërtinë e ruajtjes së të dhënave, të cilat u transkriptuan në mënyrë të përpiktë, duke pasqyruar edhe diskutime të fokus grupeve, që në momente të caktuara devijonin nga pyetjet. Kjo u bë me qëllimin e vetëm për të qenë sa më korrektë dhe të saktë, pasi edhe në këto diskutime dolën në pah problematika që ishin me interes për studimin, gjë që nxori në pah edhe prezencën e elementit rastësor në studim.

2. Strukturimi në mbledhjen e të dhënave. Strukturimi ka të bëjë me shkallën e fleksibilitetit të përshtatjes së metodave të përdorura, gjatë mbledhjes së të dhënave. Baza e të dhënave cilësore, që janë mbledhur gjatë këtij studimi janë fjalët të cilat përshkruajnë drejtpërdrejtë situata por kanë edhe nëntekset e tyre. Parë në këtë këndvështrim mund të themi se fjalët janë “më të pasura” se numrat dhe duke qenë se kanë kuptime shumëfishe, e kanë bërë analizën e të dhënave një sfidë të vërtetë.

Burimi kryesor i të dhënave siç e kemi përmendur edhe më lart kanë qenë intervistat gjysmë të strukturuar, intervistat e fokus grupeve, elementët rastësorë, por edhe vëzhgimet e kujdesshme që i kemi bërë qoftë mbledhjeve të mësuesve në shkollë, qoftë dokumenteve të ndryshme zyrtarë (statistika kalueshmërie, tekste shkollore etj.), qoftë dokumenteve të ndryshme marrë në drejtoritë arsimore apo drejtoritë e shërbimeve sociale në bashki (statistika të frekuentimit apo braktisjes së shkollës, statistika të ndihmës sociale etj.). Fokus grupet me nënat dhe baballarët,

por edhe intervistat me persona kyç, janë zhvilluar në mjedise të përshtatshme, që siguronin qetësinë dhe lirshmërinë në bisedim, për të mbledhur një informacion sa më të gjërë. Kohëzgjatja e intervistave ishte 30-50 minuta, ndërsa për fokus grupet 90-100 minuta në varësi të numrit të pjesëmarrësve, por dhe të aktivizimit të tyre. Tema me fokus arsimimin e fëmijëve romë në bazë të shprehive dhe nevojave që ata kanë, bëri që herëpashere të jenë prezent debate dhe diversitete mendimesh midis të pranishmëve, të cilët nuk binin dakord me njëri-tjetrin dhe ndërhynin herë pas here, çka e bënte të vështirë deshifrimin e mendimeve të gjithsecilit. Natyra dhe temperamentit i prindërve romë shfaqej në momente të caktuara të diskutimeve sidomos kur bëhej fjalë për kushtet e vështira të jetesës së tyre. Diskutimet shpeshherë dilnin jashtë fokusit të studimit si pasojë e mosnjohjes së politikave shtetërore nga ana e prindërve, të cilët e lidhnin diskutimin me përjetime që nganjëherë e kundërshtonin njëra-tjetrën. Si rrjedhojë na është dashur që herë pas here të ndalojmë për të sqaruar edhe njëherë rëndësinë e marrjes së informacioneve të qarta, të cilat dalin nga përvojat individuale të çdo të pranishmi. Diskutimet shumë herë janë shoqëruar me shpërthime emocionale nga ana e prindërve, të cilët mendonin se ishin lënë në harresë nga shteti për gjëra që ata i konsideronin të rëndësishme, përfshirë edhe arsyet e mosarsimimit të fëmijëve të tyre. Gjatë gjithë procesit të mbledhjes së të dhënave, janë analizuar në një bllok shënimesh të veçantë reagimet e pjesëmarrësve, përshtypjet e tyre rreth çështjeve të ndryshme etj. Moderatorit dhe mbajtësi i shënimeve (kanë qenë persona të ndryshëm) kanë rishikuar shënimet pas çdo interviste e fokus grupi të zhvilluar. Rishikimi i ka lejuar ato, apo u ka dhënë mundësinë të shprehin perceptimet, çështjet që ato kanëurvejuar, si dhe të mbajnë shënim rreth observimeve (komunikimin joverbal e gjuhën e trupit), të cilat i japin kuptim fjalëve. Pavarësisht se pyetjet e para të intervistës kanë qenë të fokusuara në marrjen e informacioneve rreth frekuentimit të arsimit bazë nga ana e fëmijëve romë, intervistat zakonisht kanë filluar me një bisedë të përgjithshme për përbërjen familjare, numrin e fëmijëve dhe perceptimit rreth shkollës nga prindërit romë. Kjo ka ndikuar në mosndjekjen në mënyrë rigoroze të radhës së pyetjeve gjatë intervistës, duke nxitur të pranishmit të flasin rreth përvojave të tyre, duke rrëfyer përjetimet e tyre ku natyrshëm i jepeshin përgjigje pyetjeve të intervistës në faza të ndryshme të saj. Pavarësisht kësaj është ndjekur e gjithë dinamika e procesit të intervistimit duke bërë që çdo pyetje të marrë përgjigje nga të intervistuarit. Zhvillimi i intervistave është ndërprerë kur është parë “ngopja” e informacioneve që kanë qenë në fokus të studimit dhe marrja e të dhënave të nevojshme. Bashkëbisedimi i natyrshëm rreth problematikave që hasin prindërit në

jetën e përditshme, ka vazhduar më pas. Ndonëse kjo situatë nuk ka qenë në qendër të intervistimit ajo ka qenë një ndihmesë e madhe për të kuptuar jo vetëm botëkuptimin e prindërve romë, mënyrën e organizimit të jetesës së tyre, vëshirësitë që hasin në integrimin e tyre në jetën sociale, po edhe për të njohur më nga afër zakonet, kulturën, traditën apo mënyrën e jetesës së këtij komuniteti.

3.11 Analiza e të dhënave

Analiza e të dhënave në kërkimet sasimore gjithmonë kryhet pas mbledhjes së tyre. Kërkimet cilësore ndryshe nga ato sasoret, analizën e të dhënave e fillojnë pasi të dhënat e para janë mbledhur, pasi analiza fillestare duhet të përcaktojë fokusin dhe strategjitë e përdorura në mbledhjen vijuese të të dhënave, duke e bërë kështu këtë proces të vijojë në mënyrë ciklike. Duke vepruar në këtë mënyrë mund të identifikohen dhe ndiqen gabime në mbledhjen e të dhënave qysh në zanafillën e procesit të kërkimit. Kjo mënyrë bën që të ketë vend për përshtatje apo ndryshime gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave të instrumenteve, pyetjeve e deri diku edhe metodave të përdorura. Në këtë mënyrë janë rezultatet ato që përcaktojnë metodën që do të përdoret. Ndryshe nga analiza sasimore në analizën e të dhënave cilësore, nuk ka rregulla dhe procedura të pranueshme botërisht. Gjithmonë ka përjasje të ndryshme për analizën e të dhënave cilësore, të cilat ndryshojnë bazuar në hipotezat apo natyrën e kërkimit cilësor, statusin e vlerësimeve të kërkuesit, fokusin apo qëllimet e procesit analitik. Në rastin tonë qëllimi kryesor i analizës së të dhënave ishte shqyrtimi dhe organizimi i sasisë së informacionit të marrë nga realizimi i intervistave, me qëllim që temat dhe interpretimet, të cilat do të dilnin nga ky proces të kishin lidhje llogjike me objektivat apo pyetjet kërkimore të ngritura në fillim të studimit. Mbledhja e materialeve u pasua nga transkriptimi i të dhënave, duke i shndërruar në material të shkruar. Problemet apo konceptet kyçe që dolën nga intervistat u mbajtën shënim. Analiza dhe transkriptimi i intervistave ka filluar pas përfundimit të tyre, por pati edhe disa raste të veçanta ku ato u koduan dhe u analizuan që gjatë kohës së mbledhjes. Në formatimin e transkripteve u patën parasysh dy gjëra:

- leximi me lehtësi
- hapësira e mjaftueshme për të shkruar komente.

Gjithashtu u përpilua një listë me terma dhe koncepte të koduara. Kjo u arrit duke bërë identifikimet e lidhjeve ndërmjet kategorive, grupimit të tyre sipas temave dhe klasifikimit sipas niveleve të përgjithësimit, në mënyrë që kodimi të respektojë një hierarki qoftë të çështjeve kryesore, qoftë të nënçështjeve. Për të shmangur përsëritjen e mundshme të klasifikimit të çështjeve, çdo çështje u shkruajt në etiketë dhe u ngjit në tekst. Pasi u qartësuan të gjitha të dhënat e mbledhura, u bë klasifikimi i tyre në njësi me kuptim. Procedurë e njëjtë është ndjekur edhe me identifikimin pjesëve të informacionit, që të mund të përshtateshin me njëra me tjetrën nga ana kuptimore, për të vazhduar me pas me kodimin e tyre. Transkriptimi i të gjitha të dhënave të nevojshme dhe përmbledhja e tyre në mënyrë paraprake, ka bërë të mundur kodimin e nivelit të parë. Kodim i nivelit të parë do të thotë kombinim i njësive, të cilat janë identifikuar si njësi kuptimi, duke i përshtatur ato në kategori për të vazhduar më tej me kodimin e çdo kategorie. Identifikimi i njësive të kuptimit u mundësua pikërisht nga kodimi i nivelit të parë. Kategorive të grupeve të njësive me kuptim të njëjtë u janë vënë emra dhe kode për secilën prej tyre. Në këtë mënyrë janë klasifikuar dhe mbledhur të dhënat në njësi me kuptim. Menaxhimi i të dhënave është bërë manualisht. Pas mbledhjes së informacioneve të nevojshme nga të gjitha intervistat, është bërë identifikimi i njësive të kuptimit duke koduar dhe interpretuar të dhënat në mënyrë të vazhdueshme. Kodimi i nivelit të parë ka kaluar në disa nënfaza:

- identifikimi i njësive të kuptimit
- emërtimi i kategorive dhe grupeve të njësive me të njetin kuptim
- kodimi i kategorive
- riorganizimi dhe përpunimi i kodimeve

Fazë e parë e kodimit është ndjekur me kodimin e nivelit të dytë, i cili ka të bëjë me interpretimin e asaj çfarë thonë kategoritë e nivelit të parë. Gjatë këtij procesi janë vendosur bashkë ose janë korrigjuar njësitë e kuptimit që përshtaten brenda çdo kategorie. Në këtë mënyrë, fokusi i analizës përqëndrohet apo kalon nga konteksti i të intervistuarit tek konteksti i kategorisë, duke bërë të mundur identifikimin e dallimeve dhe ngjashmërive ndërmjet kategorive. Njësitë e kuptimit në kategori janë sistemuar dhe janë krahasuar kategoritë në mënyrë, në mënyrë që të zbulohen marrëdhëniet midis tyre. Kategoritë, bazuar në përmbajtjen e tyre, janë integruar në çështje dhe nënçështje. Çdo çështje e identifikuar është koduar në të njëjtën mënyrë sikurse u koduan dhe kategoritë.

Intervistat gjysmë të strukturuar u koduan sipas këtyre çështjeve kryesore:

➤ *Vështirësitë për arsimim cilësor të fëmijëve romë:*

Nivel i ulët arsimor i prindërve, vetëbesim i ulët për veten dhe aftësitë që kanë, mungesë sensibilizimi për rëndësinë e arsimit, mungesë e modeleve të suksesit, mungesë e mjediseve miqësore në shkolla (diskriminim), vështirësi në përdorimin e gjuhës shqipe, mungesë interesi nga prindërit për mbarëvajtjen e arsimimit të fëmijëve të tyre, vështirësi në zbatimin e ligjit për arsimin parauniversitar, mosharmonizim i politikave arsimore dhe sociale, kushte të vështira social-ekonomike, mungesë e programeve argëtuese dhe tërheqëse për fëmijët romë në shkolla, mungesë e elementëve të historisë dhe kulturës rome në tekste shkollore, mungesë e arsimimit sipas aftësive dhe nevojave, përfshirja në punë në moshë të vogël, vështirësitë në përshtatje të fëmijëve romë të kthyer nga emigrimi, diferencë e madhe midis moshës dhe nivelit shkollor (13-14 vjeç i pashkolluar ose në klasë të parë, dytë, tretë etj), mungesë dokumentacioni si çertifikatë lindjeje, dëftesë, ndonjëherë nuk figurojnë fare as në zyrat e gjendjes civile, martesë kryesisht e vajzave në moshë të hershme.

➤ *Situata social –ekonomike e familjeve rome*

Varfëri ekstreme e familjeve rome, mungesë informacioni dhe interesi për mikrokredi me qëllim gjenerim të ardhurash nga bashkitë apo fondacione të ndryshme (pagesa për qera banesash, ndihma ushqimore etj), përfshirja në problemet familjare e fëmijëve që në moshë të vogël, mungesë informacioni nga ana e prindërve për rrjedhojë edhe e fëmijëve romë për dobitë e shkollimit, mosregjistrimi në gjendjet civile i fëmijëve që lindin dhe i fëmijëve familjet e të cilëve janë kthyer nga emigrimi, braktisja e fëmijëve nga prindërit dhe kujdesi i të afërmeve për to, mungesë mbështetjeje psikologjike, mungesë ndihme mjeksore dhe medikamentesh falas, mbështetje me materiale pedagogjike (libra shkollore) bërë sensibilizimin e duhur, duke mos nënvizuar faktin se çdo fëmijë jashtë sistemit shkollor të detyrueshëm është fëmijë i rrezikuar, mungesë politikash ndërgjegjësuere për shkollim e fëmijëve të këtij komuniteti, mungesë kontributesh nga bashkitë për formimin profesional të prindërve romë.

➤ **Këndvështrimet e specialistëve, drejtuesve të shkollave dhe mësuesve për arsimimin e fëmijëve romë:**

Gjendje e rënduar social ekonomike e familjeve rome, mosndërgjegjësimi i prindërve për mundësitë e arsimimit të fëmijëve, prindër analfabetë, rezultatet e ulëta në mësim, ndikimi i karakteristikave të roleve gjinore në rolet prindërore, mungesë pritshmëri, mungesë besimi nga ana e prindërve për ecurinë në shkollë të fëmijëve të tyre, mungesë konsideratash për politikën arsimore dhe sociale, mungesë sensibilizimi për rëndësinë e arsimit, konflikti normative familje-shkollë, mungesa e punonjësit social në shkollë, roli i cunguar i psikologut shkollor, mësuesit zakonisht janë në rolin e psikologut dhe punonjësit social.

➤ **Këndvështrimet e nxënësve romë për shkollën, aktivitetet shkollore dhe jashtëshkollore etj**

Mungesë aktiviteteve jashtëshkollore gjatë vitit, mungesë e teksteve shkollore ku të jenë të pasqyruara kultura dhe traditat rome, mësimet nuk i zgjojnë interesa, mungesë e shkollave verore, mungesë e të ardhurave ekonomike të mjaftueshme për pjesëmarrje në aktivitete, punësim sezonal i fëmijëve romë.

Intervistat e fokus grupeve u koduan sipas këtyre çështjeve kryesore:

➤ ***Rëndësia e arsimit bazë cilësor, në përputhje me aftësitë dhe nevojat e gjithsecilit:***

Rëndësia dhe domosdoshmëria e arsimimit bazë në jetën e fëmijëve romë, probleme ekonomike për mosfrekuentimin e tij, informacion i munguar ose fragmentar nga ana e prindërve për dobitë e arsimit, vështirësi institucionale, sensibilizimi fare i pamjaftueshëm nga ana e institucioneve përkatëse në lidhje me arsimimin bazë cilësor, vështirësi në regjistrimin e fëmijëve romë të kthyer nga emigrimi, lëvizja në mënyrë të pakontrolluar e familjeve rome, mungesa e përdorimit të gjuhës rome në sistemin parashkollor, fëmijë romë që nuk dinë shqip, mungesë shprehish dhe aftësish të domosdoshme për integrim, vetëvlerësim i ulët për aftësitë e tyre, modele suksesi inegzistente.

➤ ***Këndvështrimet e prindërve për rolin e shkollës në jetën e fëmijëve të tyre:***

Fokusimi tek punët artizanale apo tregëtia, diskriminimi në shkollë, dallime gjinore në arsimimin brenda familjes rome, vetëvlerësim i ulët për veten, familje që lëvizin shpesh, situatë e rënduar

ekonomike, angazhimi në punë që në moshë të hershme e fëmijëve, politika jofavorizuese për arsimimin e fëmijëve të tyre, pasojat negative të pasuara nga prindërit të fëmijët, mungesë e modeleve të suksesit, mungesë e mjedisit miqësor në shkolla, diskriminim social brenda dhe jashtë shkolle, papunësi e lartë brenda komunitetit dhe brenda familjes, mungesë stabiliteti, mungesë pritshmërisht nga shkolla.

➤ ***Marrëdhëniet e prindërve romë me institucionet arsimore***

Marrëdhënia mësues-nxënës rom, marrëdhënia mësues-prind rom, nisma apo fushata sensibilizuese me prindërit romë në lidhje me nevojën e arsimimit të fëmijëve të tyre, mungesë informacioni në lidhje me ligjin për arsimimin e pakicave, mungesë informacioni për politikën arsimore dhe sociale në dobi të arsimimit të fëmijëve romë, diskriminimi i fëmijëve romë në institucionet shkollore, mosnjohja e pranisë dhe rolit të psikologut shkollos nga prindërit.

➤ ***Politika e programe mbështetëse në ndihmë të arsimimit të fëmijëve romë:***

Shkalla e frekuentimit të arsimit të detyruar 9-vjeçar, politika shtetërore lidhur me këtë fenomen, ndihma konkrete të ofruara nga shteti, informacioni shumë të pakët, në lidhje me mundësitë për përfitime apo shërbime të ndryshme, probleme gjinore, martesë të hershme kryesisht e vajzave por edhe e djemve, vështirësi të mëdha financiare në familje.

Analiza e intervistave individuale dhe të fokus grupit mundësoi identifikimin e kategorive të mëposhtme:

Qëndrime

Modele të gjithëpërfshirjes

Perceptime për arsimin gjithëpërfshirës

Në vazhdim të analizës këto kategori u ndanë në disa nënkategori në përputhje me qëllimin e studimit. Kategoritë e mësipërme u zbërthyen në disa nënkategori që zbulojnë më mirë eksperiencat e mësuesve dhe prindërve të fëmijëve romë, si dhe perceptimet e tyre për përmirësimin e këtij procesi. Kategoritë u ndanë në disa nënkategori :

A. Reagime të ndryshme

➤ mungesë besimi

- nevoja të ndryshme
- indiferencë
- pasiguri
- zemërim

B. Nevoja të ndryshme

- mbështetje nga komuniteti shkollor
- mbështetje nga familja
- vështirësi ekonomike
- gjithëpërfshirje
- shërbime sociale të pamjaftueshme

C.Problematika në fazën post miratim të ligjit për arsimimin e pakicave etnike, e cila lidhet me politikat ekzekutive të shtetit, që duhet të përfshijnë gjithë institucionet përgjegjëse.

- mbështetje financiare për arsimimin bazë të fëmijëve
- sensibilizim dhe ndërgjegjësim i komunitetit
- mungesë besimi ndaj institucioneve të ndryshme
- mungesë harmonizimi të politikave sociale me politikat arsimore
- mësues të pakualifikuar
- aftësim me shprehi jetësore bazë
- mungesë e modeleve të suksesit

3.12 Vështirësitë e fazës së intervistimit

Gjatë fazës së intervistimit u vërejtën këto vështirësi:

Mosdakortësi në shumicën e rasteve për regjistrimin e intervistave.

Indiferencë apo mungesë gatishmërie për t'u intervistuar nga specialistë të ndryshëm në bashki, në drejtori arsimore etj

Pengesa burokratike pasi intervistuesit kyç, specialistët e përmendur më lart nguronin në dhënien e intervistve pa lejen nga titullarët e tyre.

Neglizhencë, mungesë besimi dhe mirëkuptimi nga ana e kryetarëve të shoqatave, pasi e konsideronin informacionin që do të jepnin si një punë rutinë të bërë edhe më parë.

Informacion statistikor kontradiktor rreth të dhënave për frekuentimin e shkollës nga fëmijët romë.

3.13 Aspekti etik i studimit

Për të ruajtur aspektin etik të studimit u patën parasysh:

Përpjekjet për eliminimin sa më shumë të rezultateve të pavërteta. Pothuajse i gjithë procesi është kryer nën supervizion.

Shpërndarja paraprake e lejes informuese rreth studimit dhe të drejtat e tij për të gjithë subjektet.

Njoftimet specifike rreth qëllimit të studimit, metodologjisë së përdorur dhe fazave të tij.

Informimi i pjesëmarrësve për të drejtën e tyre për të qenë pjesë ose jo në studim, duke i bërë gjithashtu të qartë faktin se mund të hiqnin dorë në çdo kohë prej tij, nëse e ndienin të nevojshme.

Garantimi i subjekteve për konfidencialitetin dhe anonimat, i cili është ruajtur sipas të gjitha rregullave bazë të etikës në kërkimin shkencor.

Garantimi dhe ruajtja e të dhënave në mënyrë anonime.

Garantimi se të dhënat do të përdoren vetëm për këtë studim

KAPITULLI IV

REZULTATET E STUDIMIT

Rezultatet e mëposhtëme diktojnë edhe gjetjet kryesore të studimit, sipas objektivave të parashtruara qysh në fillim të tij. Këto gjetje i japin përgjigje pyetjeve kërkimore të studimit.

4.1 Kuadri ligjor shqiptar për arsimimin e pakicave etnike, aspekti teknik dhe përfshirja në të e direktivave të BE dhe parimeve të Konventës Antidiskriminim

Qëllimi i kësaj pyetje kërkimore ka të bëjë me shqyrtimin dhe analizën e kuadrit ligjor shqiptar për arsimimin e pakicave etnike, me synim gjykimin mbi masat konkrete që duhet të ndërmerren në praktikë, për të sensibilizuar dhe për të tërhequr vëmendjen e të gjithë aktorëve dhe specialistëve të arsimit dhe jo vetëm. Është shumë e rëndësishme që të gjithë ta njohin dhe ta kuptojnë si duhet rëndësinë e ligjit për arsimin parauniversitar të minoriteteve, siç është e rëndësishme të nënvizohet domosdoshmëria e gjenerimit të politikave mbështetëse dhe marrjes së masave konkrete, për ta bërë ligjin sa më shumë të njohur dhe zbatueshëm në shkallë vendi. Çështjet që vlejnë të analizohen këtu janë:

- E drejta për t'u arsimuar, si një e drejtë kushtetuese, duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e barazisë (çdokush ka të drejtën për arsimim).
- Ligji “Për arsimin parauniversitar” është një ligj gjithëpërfshirës, ku sanksionohet në mënyrë taksative e drejta për arsimim e pakicave etnike.
- Në kuadër të zhvillimit në terma praktikë të parimit të barazisë në fushën e arsimit për pakicat etnike duhet një trajtim i diferencuar

Duke qenë përballë një situate të tillë le të shohim dhe analizojmë situatën ligjore të vendit tonë në lidhje me arsimimin e komunitetit rom. Shteti ynë aspirojnë të përmbushë të gjithë kushtet legale dhe faktike të shtetit të së drejtës. Strategjitë që ngrihen, aktet ligjore që hartohen dhe hyjnë në fuqi, duhet që patjetër të përfshijnë parimet bazike ndërkombëtare në hierarkinë e normave të së drejtës, të sanksionuara në kushtetutë. Konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare rradhitën të dytat. Duke iu referuar instrumentave ndërkombëtarë antidiskriminim, d.m.th. konventave ndërkombëtare, marrëveshjeve ndërkombëtare për

antidiskriminim, etj vihet re se ata theksojnë rëndësinë soico-juridike të së drejtës për arsimim, si një ndër të drejtat bazike të çdo individi, i kujtudo përkatësie race, etnike, kulturore, moshore dhe gjinore.

Fryma e instrumenteve ndërkombëtare vë theksin në disa elemente thelbësorë që janë:

1) E drejta e personave që u takojnë pakicave kombëtare për të mbajtur identitetin e tyre, mund të realizohet plotësisht në qoftë se u mundësohet arsimi në gjuhën amtare. Në të njëjtën kohë personat, që u takojnë pakicave kombëtare duhet të integrohen në shoqëri duke mësuar gjuhën e shtetit. E drejta për arsimim për këtë target-grup është më komplekse, pasi përfshin gjuhën dhe kulturën amtare dhe gjuhën dhe kulturën e shtetit ku jetojnë.

2) Gjatë zbatimit të instrumenteve ndërkombëtare nga të cilat përfitojnë personat që u takojnë pakicave kombëtare, shtetet duhet në mënyrë të vazhdueshme dhe të qëndrueshme t'u përmbahen parimeve qenësore për barazi dhe jodiskriminim.

3) Nuk duhet harruar se burimet ndërkombëtare paraqesin minimumin e standardeve për t'u aplikuar. Parashikimet minimale ndërkombëtare janë të detyrueshme për t'u respektuar, thënë ndryshe detyrimet minimale që aktet ndërkombëtare sanksionojnë. Shteteve u lihet hapësirë e lirë veprimi për detajimin e parashikimeve minimale dhe për tejkalimin e tyre

Masat dhe burimet

Shtetet duhet të ndërmarin masa konkrete për zbutjen dhe minimizimin e diskriminimit. Këto masa duhet të jenë në përshtatje me rekomandimet e ndërkombëtarëve. Shteti ynë, si një shtet me praktikë demokratike të re, duhet patjetër t'u referohet akteve ndërkombëtare, për zbutjen e diskriminimit dhe përfshirjen massive të pakicave në arsimin parauniversitar. Aktet ndërkombëtare, në hierarkinë e burimeve të së drejtës renditen të dytat, gjë që dëshmon rëndësinë e tyre. Kushtetuta e Shqipërisë rendit burimet e së drejtës dhe aktet ndërkombëtare menjëherë pas saj. Në aktet ndërkombëtare përfshihen marrëveshje, konventa etj.

4) Shtetet duhet t'u qasen të drejtave arsimore të pakicave në mënyrë proaktive. Aty ku duhet mund të ndërmerren masa të veçanta nga shtetet, që në mënyrë aktive t'i zbatojnë të drejtat e arsimit në gjuhë të pakicës duke përdorur të gjitha mundësitë egzistuese individualisht dhe

nëpërmjet ndihmës dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, sidomos në fushën ekonomike dhe teknike.

5) Shtetet duhet t'u mundësojnë institucioneve që përfaqësojnë pakicat kombëtare, që në mënyrë gjithpërfshirëse të marrin pjesë në zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe programeve të lidhura me arsimin e pakicave

6) Sipas Rekomandimeve të Hagës (Konventa Antidiskriminim), shtetet duhet t'u japin autoriteteve lokale dhe qendrore kompetencat e nevojshme për arsimin e pakicave duke lehtësuar kështu pjesëmarrjen e pakicave në procesin e formulimit të politikës në nivel qendror ose lokal.

7) Shtetet duhet të marrin masa për inkurajimin e inkuadrimit të prindërve në zgjidhjen e sistemit arsimor në nivel lokal, duke e përfshirë arsimimin në gjuhën e pakicës. (OSCE High Commissioner on National Minorities, fq. 26)

Parimet e mësipërme sanksionohen tek raporti i Komisionerit për Mbrojtjen e Minoriteteve, si një organ specifikisht i profilizuar për minoritetet.

Pse sanksionohet për pakicat kombëtare, specifikisht e drejta për t'u arsimuar?

E drejta për arsim hyn në kategorinë e të drejtave kushtetuese. (Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, 2012 neni 6, pika 5, fq. 4404)

Ajo trajtohet si një ndër të drejtat bazike dhe si e tillë nuk mjafton vetëm të përmendet taksativisht.

Kjo e drejtë shihet e lidhur ngushtë me parimin kushtetues të barazisë, sipas të cilit në kushte të barabarta të gjithë duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë.

Pse për pakicat kombëtare ka një trajtesë më specifike?

Rëndësia e një trajtimi të diferencuar për pakicat etnike duhet të shihet e lidhur ngushtë me argumentet e mëposhtme të cilat janë:

1) Është detyrë e shtetit të gjejë e aplikojë mekanizma, të përshtatur dhe proporcionalë për realizmin në terma praktikë të parimit të barazisë.

2) Backgroundi socio-kulturor, i kësaj kategorie dëshmon nevojën e gjallë për një trajtesë me specifike.

E drejta për arsimim duhet të prekë çdo kategori, por kushtet socio-kulturore e treguesit konkrete diktojnë në absolut nevojën e ngritjes dhe aplikimit të mekanizmave specifike për kategori specifike. Në kuadër të parimit të barazisë, i lidhur ngushtë me çështjen e së drejtës për arsimim do të shihet edhe parimi i proporcionalitetit, ky i fundit një parimkushtetues. E thënë ndryshe pakicat kombëtare hyjnë në kategorinë e grupeve sensitive osevunerabël, e si të tilla duhet të trajtohen në mënyrë të diferencuar për të arritur barazinë me kategoritë e tjera. Hapat e trajtimit të diferencuar duhet që patjetër të jenë proporcionale me situatën që i dikton. Thelbi i parimit të barazisë është: trajtim i barabartë në kushte të barabarta. Pikërisht arritja e kushteve të barabarta për pakicat kombëtare, në raport me pjesën tjetër të popullsisë, kërkon mekanizma sui generis (të një lloji të veçantë). Kushtet e barabarta janë element kyç që paraprin trajtimin e barabartë.

Mekanizmat që duhet të vënë në lëvizje shtetet

Mekanizmat kyç e fillestare janë ato ligjore. Shteti ynë, si shtet i së drejtës sanksionon të drejtën për arsim që në Kushtetutë, për të vazhduar me pas me ligjet konkrete. Pas viteve '90, siç dihet, shumë vende europiane të dala nga regjimet totalitare u përfshinë në reforma të gjëra edukative për të rindërtuar dhe rikompozuar sistemet edukative të rënuara nga sistemi me qëllim që t'i përgjigjeshin erës europiane dhe zhvillimeve botërore globale në arsim. Shqipëria, si një ndër këto vende, u përfshi në valën e këtyre ndryshimeve të cilat sigurisht morën kahjen e reformave progresive në edukim dhe u orientuan drejt prirjeve të kohës, të tilla si: depolitizimi i sistemit arsimor, modernizimi i sistemit, globalizimi, decentralizimi, arsimi për të gjithë, të mësuarit për gjatë gjithë jetës, të nxënies në shoqërinë e dijes, respektimi i të drejtave humane, barazi dhe cilësi në arsim, gjithëpërfshirja, diskriminimi etj. Ligji për arsimin parauniversitar nr 69/2012 sipas Fletore Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, nenit 10, në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 e kushtetutës, thotë shprehimisht:

“1. Personave, që u përkasin pakicave kombëtare, u krijohen mundësi të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën amtare, të mësojnë historinë dhe kulturën e tyre, sipas planeve dhe programeve mësimore. (fq. 4405)

2. Për të mundësuar pjesëmarrje aktive dhe të barabartë në jetën ekonomike, shoqërore, politike e kulturore të Republikës së Shqipërisë, nxënësve të pakicave kombëtare u krijohen kushte për mësimin e gjuhës shqipe dhe njohjen e historisë e të kulturës shqiptare.

3. Planet e programet mësimore, si dhe raportet e përdorimit të gjuhës amtare dhe asaj zyrtare në procesin mësimor përcaktohen me akte të veçanta të ministrit.”

Duket qartazi në këtë nen, sanksionimi i parimit të barazisë, sikundër është një trajtim disi më specifik për këtë target grup. Ky trajtim i diferencuar vjen si nevojë për mësimin e të dy gjuhëve. Në mënyrë të koncentruar në ligj pasqyrohen qartazi jo vetëm parimet kushtetuese, por edhe ato ndërkombëtarisht të pranura. Duke u nisur nga problemet e mëdha që paraqesin pakicat etnike, kryesisht rome dhe egjiptiane në Shqipëri në lidhje me arsimimin bazë të tyre, mund të themi se problemi nuk qëndron tek kuadri ligjor shqiptar. Kuadri ligjor në Shqipëri, për arsimimin e pakicave etnike, në aspektin teknik është i plotë dhe inkorporon direktivat e BE dhe parime të Konventës antidiskriminim. Shqipëria si shtet i së drejtës sanksionon të drejtën për arsim që në Kushtetutë, për të vazhduar me pas me ligjet konkrete. Atëherë ku qëndron problematika? Problematika qëndron tek faza post miratim e ligjit. Kjo fazë lidhet me politikat ekzekutive të shtetit që duhet të përfshijnë të gjithë institucionet përgjegjëse.

Njohuritë e mësuesve, specialistëve të arsimit, prindërve romë etj, lidhur me kuadrin ligjor shqiptar të arsimit të pakicave kombëtare.

Nga përpunimi i të dhënave rezulton se një pjesë e konsiderueshme e prindërve romë, nuk janë informuar mbi kuadrin ligjor të arsimit bazë të detyrueshëm apo të arsimit gjithëpërfshirës. Ata duken indiferentë ndaj ligjit dhe nuk e kanë shkuar ndër mend ta lexojnë apo të informohen për të.

“Jo, jo nuk di gjë fare për ligj unë, nuk kam kohë për këto gjëra, ohu ne jemi të gjithë pa punë pa zanat”. (Baba, Fier)

“Nuk di unë gjë as për ligjin e ri e as të vjetër. Na thanë se po t’i regjistronim tek “ Shansi i dytë”, do të jepnin roba për të shitur e ashtu bëmë, ku di unë” (Nënë, Elbasan)

“ Jo nuk di gjë për ligjin. Mirë është që edhe fëmijët tanë të shkollohen sit ë tjerët, po nga ana tjetër për çfarë i duhet kur në klasë të dytë fëmija nuk di as të shkruajë as të lexojë” (Nënë Berat)

Burimi kryesor i informimit për prindërit romë është media dhe institucionet arsimore. Marrëdhëniet deficiente të romëve me institucionet i bënë ato indiferentë dhe mosbesues ndaj ligjit dhe zbatimit të tij.

“Unë e di që nuk zbatohet ligji, prandaj...” (Baba, Berat)

“Jo nuk na ka thënë njeri gjë, po dihet se ligji nuk zbatohet”. (Baba, Elbasan)

“Po kam dëgjuar në televizor për këtë ligj, po puna është se kalamajtë në klasë të parë nuk dinë të flasin mirë shqip, nuk e kuptojnë flasin vetëm gjuhën tonë”. (Baba, Fier)

“E kam dëgjuar, në një emision për romët me thënë të drejtën, se kështu nuk kam takuar njeri e nuk kam pyetur njeri e nuk di kë të pyes...” (Baba, Korçë)

Një pjesë e mirë e prindërve romë nuk e njohin as ligjin e arsimit bazë dhe as pasojat e moszbatimit të tij. Kjo vjen edhe nga mungesa e punës sensibilizuese nga ana e institucioneve shkollore me nxënësit dhe prindërit e këtij komuniteti. Përsa i përket mësuesve, ato janë më të ndërgjegjësuar për çështjet që lidhen me arsimin gjithëpërfshirës por niveli i informacionit që ato kanë është i përgjithshëm dhe jo i plotë. Mësuesit nuk janë interesuar për të pasur nxënës romë në klasën e tyre, pasi mendojnë se janë të pazotë dhe problematike. Kjo tregon se kualifikimi i tyre ka pasur mangësi që në kurrikulën universitare si dhe me trajnime në punë përgjatë viteve. Mungesa e trajnimeve mbi trajtimet dhe metodat praktike të punës fëmijët e komunitetit rom duhet të përbëjë shqetësim për mësuesit, në lidhje me punën konkrete që duhet të bëjnë me këta fëmijë.

“ Në fakt unë kam marrë informacion nga interneti se kam pesë nxënës romë në klasën që kam kujdestari. Ndonjë seminar trajnues nga DAR, nuk na kanë bërë” Mësuese, Berat

“ Kam kontaktuar me një shoqatë romë dhe kam mësuar se çfarë interesash kanë romët. Trajnime? Jo, unë jam mësuese e re, deri më tani s’kemi bërë ndonjë trajnim as nga DAR, as nga dikush tjetër”. Mësuese, Fier

“ Me thënë të drejtën nuk kemi ndonjë problem me romët. Braktisja është minimizuar ndjeshëm, kështu që nuk e kemi parë të udhës të organizojmë ndonjë seminar trajnues” Specialiste, DAR, Korçë

Ligji shqiptar për arsimimin e pakicave, parashikon edhe mësimin e gjuhës rome përkrah gjuhës shqipe. Përveç qendrave publike për fëmijët dhe të rinjtë romë ose qendrave komunitare rome, ku ofrohen edhe kurse mësimi të gjuhës rome, mësimin e gjuhës rome, si gjuhë e dytë, nuk e shohim pothuajse fare në shkollat publike. Megjithatë diçka po fillon të lëvizë në këtë drejtim. Mund të përmendim këtu si rast i parë në Shqipëri, futjen e mësimit të gjuhës rome në shkollën 9-vjeçare “ Hamit Mullisi”, për vitin shkollor 20016-2017, në Elbasan:

“ Sivjet me këmbënguljen tonë, bëmë të mundur futjen e mësimit të gjuhës rome, në një nga shkollat, ku fëmijët e komunitetit rom janë më të shumtë në numër në raport me shkollat e tjera të qytetit, në shkollën “Hamit Mullisi”. Mësimi jepet nga një studente rome, e cila mori përsipër të japë mësim vullnetarisht. Në momentin kur ajo do të mbarojë studimet dhe do të pajiset me licensë, atëherë do ta punësojmë menjëherë. Kështu ne bëhemi shembulli i parë dhe i vetëm në Shqipëri, që bëmë të mundur futjen mësimit të gjuhës rome në një shkollë publike” Specialiste, DAR, Elbasan

Drejtorët e shkollave si dhe mësuesit në mjaft raste nuk i deklarojnë shkëputjet e konsiderueshme kohore si dhe braktisjen e shkollës nga ana e fëmijëve romë. Një pjesë e prindërve nuk e di që mosparaqitja e fëmijës në shkollë, sipas ligjit ka pasoja ndëshkimore, pjesa tjetër është e kënaqur me këtë qëndrim.

“Djali im është në të dytën. Nuk di as shkrim as lexim. Po mësuesja bëri diçka të mirë. E kaloj në të tretën pavarësisht se vjet nuk vajti fare në shkollë”. Baba, Berat

“Djalin unë e marr me vete te tregu se shes rroba. Mësuesja ama nuk ia heq emrin nga klasa. Unë e mbaj që të mësojë mbas meje”. Nënë, Elbasan

Problemi mjaft i madh i romëve është mungesa e modeleve pozitive apo modeleve të suksesit, gjë që bën që familjet apo prindërit romë të vlerësojnë përfitimin imediat, apo mbështetjen materiale në vend të interesit më të mirë për fëmijët e tyre. Kjo sjell indiferencë dhe mosbesim jo vetëm ndaj shkollës si institucion por edhe ndaj kuadrit ligjor shqiptar për arsimimin e pakicave etnike, në Shqipëri.

4.2 Pengesat kulturore institucionale dhe infrastrukturore që vështirësojnë arsimimin sipas nevojave të fëmijëve romë

Arsimimi i fëmijëve romë është një nga sfidat kryesore për të ndryshuar situatën në të cilën ndodhet ky komunitet. Braktisjet shkollore, por sidomos mosarritjet shkollore tek fëmijët romë mbeten problemet më esenciale të këtyre fëmijëve. Në qytetin e Elbasanit ashtu si dhe në qytetet e tjera që kemi marrë në analizë, fëmijët romë përbëjnë pjesën më të madhe të fëmijëve në nevojë. Pas viteve '90 sistemi arsimor pësoi një tkurrje dhe u vunë re fenomene të braktisjes së shkollës në shifra shumë të larta. Situata e vështirë e minoritetit rom është e një natyrë të përbërë. Vështirësitë apo pengesat që ndikojnë në arsimimin cilësor të romëve mund t'i ndajmë në dy grupime: pengesa ekonomike dhe pengesa sociale. Situata jo e favorshme ekonomike natyrisht që sjell edhe një situatë arsimore jo të mirë. Nga intervistat që kemi zhvilluar me prindër romë, mund të themi se ata shprehin interes për arsimimin e fëmijëve të tyre. Gjatë intervistave prindërit flasin qartë për nevojat dhe dëshirat e fëmijëve të tyre. Edhe pse prindërit romë janë të interesuar që fëmijët e tyre të vazhdojnë shkollën, vështirësitë ekonomike janë shumë të mëdha dhe sipas tyre janë pengesa kryesore në arsimim. Kjo situatë është pothuajse në të gjitha zonat ku është shtrirë studimi ynë. Në të gjitha zonat e studimit, prindërit shprehen se i çojnë fëmijët në shkollë, por vështirësitë që pengojnë procesin e arsimimit janë të mëdha dhe të natyrave të ndryshme. Një nga pengesat më të mëdha sipas tyre është gjendja shumë e vështirë ekonomike në të cilën ato ndodhen:

“Fëmijët në shkolla duan lekë mos kujto ti. Puna nuk është se ne i çojmë në shkollë, po na kërkojnë lekë. Pesë mijë lekë thonë për rrogën e rojës, 30 mijë lekë për uniformën etj. Ne nuk kemi t'i paguajmë. Unë jam pa punë, burri pa punë, na kan heq edhe ndihmën që patëm. Nuk po na del as për bukë, jo për të paguar dhe lekë në shkollë”: Nënë, Berat

“Me thënë të drejtën ne mezi e shtyjmë muajin me bukë. Na jepnin përkrahje sociale po na e hoqën nuk e di. Vetë jam pa punë me burrë të sëmurë. Tani do shkoj t'i marr ilaçet. Nuk kam, nuk me del për bukë kështuqë as që e mendoj shkollën për fëmijët. Mirë do ishte po s'i kam mundësitë.” Nënë, Elbasan.

“ Në periudhat kur vijnë në shkollë, se zakonisht bëjnë shumë mungesa, pjesës dërrmuese e tyre u mungojnë mjetet shkollore, u mungon higjena dhe vishen shumë keq” Mësuese, Rrapishtë, Elbasan.

Situata e vështirë ekonomike e familjeve romë, ka bërë që të lindin fenomene të tilla si: emigrimi, migrimi dhe punësimi i fëmijëve romë, të cilat konsiderohen si pengesa mjaft serioze për arsimimin e këtyre të fundit. Këtë fakt e pohojnë jo vetëm mësues por edhe lider informalë romë:

*“ Kemi nxënës që i kanë prindërit në emigrim. Përparimi i tyre është mjaft i dobët, pasi ata zakonisht rrinë me gjyshërit, të cilët nuk interesohen fare për shkollën e tyre”*Mësuese, Berat

*“ Mjaft prindër kanë emigruar në Greqi. Kur i marrin fëmijët me vete, ata nuk bëhen më për shkollë”*Lider informal, Korçë

“Ka kalamaj që nuk shkojnë në shkollë sepse nuk kanë hesap, kështuqë largohen për të punuar dhe për të siguruar bukën, edhe në qytete të tjera. Prandaj edhe largohet fëmija nga shkolla. Shkojnë sa andej këndej për të siguruar një punë.” Baba, Korçë

Është pikërisht papunësia në nivelë shumë të larta për pothuajse të gjithë komunitetin rom, e cila i detyron prindërit romë të heqin fëmijët e tyre nga shkolla dhe t'i përdorin si krah pune për të ndihmuar familjen.

Një baba në Elbasan, i cili ka një djalë dhe një vajzë shprehet për djalën e tij:

“Djali im ka bërë vetëm tri klasë shkollë, po të kisha ekonominë nuk kisha pse ta largoja fëmijën nga shkolla se e kishte dhe me qejf, ecte mirë me mësimë” Baba, Elbasan.

Pothuajse të gjithë prindërit me të cilët u kontaktua, nënvizuan situatën e vështirë socialekonomike të familjeve dhe fëmijëve të tyre. Për prindërit romë, vështirësitë e ekonomike ishin pengesa kryesore, që i detyron fëmijët e tyre të mos frekuentojnë shkollën. Sipas prindërve romë fëmijët e tyre kanë nevojë të ushqehen mirë, pasi nuk e përballojnë dot orën e mësimi. Ato nuk ia plotësojnë dot këtë nevojë. Gjithashtu ato kanë nevojë edhe të vishen mirë. Mungesa e robave të përshtatshme sipas stinëve, përbën një tjetër vështirësi për fëmijët romë dhe detyron prindërit e tyre të mos i lejojnë të shkojnë në shkollë.

“Ne kemi këtu afër dy shkolla: “Hamit Mullisi dhe “Qemal Haxhihasani”. Te të dyja shkojnë më shumë fëmijët tanë. Me thënë të drejtën shkojnë më hope në shkollë. Kur është kohë e mirë shkojnë. Kushtet nuk janë edhe aq të mira. Në klasa nuk ka ngrohje. Në ditët me shi fëmijët lagen dhe ftohen, pastaj shumica e familjeve nuk kanë mundësi t’u japin me vete për të ngrënë dhe nuk kanë t’i veshin në mënyrë të përshtatshme, si të tjerët. Prandaj i mbajmë në shtëpi apo i marrim me vete te tregu, pasi i sajojmë si mundemi qoftë për të ngrënë, qoftë për të veshur” Nënë, Elbasan

Krahas problemeve që përmendëm më sipër si varfëria, papunësia, punësimi i fëmijëve, martesat në moshë të hershme etj edhe regjistrimi i fëmijëve romë të kthyer nga emigrimi, të cilët nuk figurojnë në regjistrat e gjendjeve civile, përbën një tjetër problem jo të vogël. Kur prindërit romë kthehen nga emigrimi përballen me një kosto të pajisjes me dokumente që për ta është mjaft e konsiderueshme. Këto dokumente janë mjaft të nevojshëm për të regjistruar fëmijët në shkollë. Mospajisja me to i detyron një pjesë të prindërve romë që të mos e bëjnë asnjëherë regjistrimin e fëmijëve të tyre në shkolla, gjë që sjell mohimin e mundësisë për të frekuentuar shkollën. Kështu një baba në Korçë shprehet:

“ Kunati im ishte refugjat në Greqi. U kthye se nuk i eci. Ku filloi shkolla në shtator donte edhe ai t’i çonte fëmijët në shkollë. Po i thanë se po mos t’i regjistronte nuk ia pranonin. Që të bënte regjistrimin donte lekë goxha, se ka tre fëmijë. Kështu e la fare atë muhabet se nuk kishte para. Nuk e di po i ngelën fëmijët pa shkollë të shkretit”.

Përpos këtyre vështirësive që përmendëm, komuniteti rom ka edhe vështirësi apo pengesa sociale, të cilat shpesh herë janë rrjedhojë e mentalitetit që ata kanë, i cili i dallon dukshëm nga pjesa tjetër e popullsisë. Kështu martesat e hershme pjesë e mentalitetit të komunitetit rom, përbëjnë një tjetër faktor të braktisjes së shkollës në moshë të vogël. Vajzat e komunitetit rom e braktisin shkollën edhe më herët se djemtë, pasi ato martohen nga familjet e tyre në moshë mjaft të re. Në një pjesë të konsiderueshme të rasteve vajzat rome që në moshën 11-12 vjeç nuk lejohen nga familjet e tyre të shkojnë në shkollë, pasi ata preferojnë martesën në vend të shkollës. Këtë fenomen e ndjejnë kryesisht nënat rome, të cilat kanë akumulimet e veta ndaj këtyre martesave. Shumica e tyre nuk duan që vajzat e tyre të kenë të njejtin fat. Kështu një nënë në Berat, e cila ka dy vajza në moshë të re: njëra e martuar me vetëm dy klasë shkollë, ndërsa tjetra në klasë të VI thotë:

“Vajzën e madhe e martova kurse te dytën e kam fejuar. Sa të mbarojë ky vit nuk do ta çoj më në shkollë. Të ishtë për mua, unë nuk doja që vajza ta linte shkollën, as vajza nuk donte se i pëlqente shumë mësuesja e muzikës, se kështu këndon shumë bukur, që e vogël ka kënduar. Po çfarë t’i bësh burrit! Neve nuk na pyesin burrat fare. Nënë, Berat.

“Mjaft nxënës romë që braktisin shkollën vijnë nga familje me prindër të divorcuar. Meqenëse martohen shumë të vegjël, çiftet rome kanë mjaft probleme dhe divorce. Fëmijët natyrisht që vuajnë pasojat”. Mësuese, Fier.

Ndërsa nëse do t’i referoheshim lidhjeve që prindërit romë mbajnë me fëmijët apo mësuesit e tyre, mund të themi se ato lënë shumë për të dëshiruar. Prindërit romë nuk e shohin këtë kontakt si diçka të nevojshme. Ata nuk arrijnë të kuptojnë se fëmijët kanë nevojë edhe për ndihmën e tyre. Për shumicën dërrmuese të këtyre prindërve rezultatet në mësimet e fëmijëve të tyre nuk janë të rëndësishme.

“Kam shkuar ndonjëherë në shkollë se kam dy djem e kam frikë mos zihen me shokët prandaj. Po deri tani nuk më kanë thënë gjë për ndonjë gabim” Baba, Fier

“Na thirrën një herë për takim dhe shkova. Kishin mbledhje me prindër. Nuk e di unë nuk kam kohë të merrem me fëmijët, po m’u lutën dhe shkova. Ata kanë shumë vështirësi po dhe mësuesja i vë gjithmonë në bankat e fundit”. Nënë, Elbasan

“ Mirë është që të shkollohen fëmijët nuk them gjë, po për çfarë i duhet kur në klasë të tretë nuk dinë të shkruajnë dhe me zor të madh lexojnë. Më mirë të rrinë mbas meje sesa të shkojë në shkollë”. Nënë, Korçë

Një tjetër problem, pjesë përbërëse e rëndësishme problemeve sociale, që vazhdon akoma të jetë i prekshëm është edhe diskriminimi. Ndonëse me tone më të zbutura ky problem vazhdon të jetë akoma prezent.

“ Këtu në Rrapishtë, meqenëse ka shumë nxënës romë, nuk ka edhe aq shumë diskriminim. Mësueset edhe shajnë nganjëherë, por po të ankoresh drejtoresha të jep gjithmonë të drejtë”
Lider informal rom, Rrapishtë, Elbasan.

“Këtu tek ne në Korçë fëmijët romë shihen si inferiorë. Shkolla 9-vjeçare “Naim Frashëri”psh, është katandisur vetëm me nxënës romë. Maxhoranca nuk i sjell fëmijët këtu pasi i sheh fëmijët tanë me një sy tjetër. Kështuqë ato rrinë vetëm me njëri-tjetrin dhe shkolla është etiketuar si “shkolla e romëve”. Lider iformal rom, Korçë

4.3 Nevojat e fëmijëve romë për shërbime arsimore

Komuniteti rom vazhdon të përfaqësojë pjesën më të varfër të popullsisë shqiptare dhe minoritetin më të brishtë në vend. Nevojat prioritare të romëve nuk janë të lidhura vetëm me disa çështje të përgjithshme të të drejtave të njeriut apo me disa çështje të të drejtave të minoriteteve. Perceptimi i përgjithshëm është se deri tani vëmendja e të gjithë institucioneve lokale, qendrore dhe ndërkombëtare është fokusuar më shumë tek antidiskriminimi sesa nevojat reale të këtij komuniteti. Arsimimi i fëmijëve romë sipas nevojave që ata kanë, vazhdon të mbetet një nga sfidat më të mëdha të sistemit tonë arsimor. Gjithmonë flitet për mungesë të aksesit të arsim të komunitetit rom, për nivel shumë të ulët arsimimi dhe kualifikimi profesional të këtij komuniteti, për nivele të ulëta të regjistrimeve në shkollë, nivele të larta të braktisjes së shkollës etj. Të gjitha këto çështje janë prezente në shumë raporte studimore, punime shkencore të autorëve të ndryshëm etj etj, ku ato janë trajtuar gjërë e gjatë. Ajo që bie në sy nga gjithë ç’ka thamë, është fakti se në asnjë vend nuk shkruhet apo nuk trajtohet niveli i të nxënësve të fëmijëve të komunitetit rom, sikurse nuk flitet për objektiva të qarta për sa i përket arsimimit të tyre. Arsimimi i romëve është trajtuar kryesisht si mosbraktisje e shkollës apo mësim shkrimi e këndimi. Kështu e mendojnë jo vetëm prindërit romë por edhe mësues, nxënës e më gjerë. Vlen të nënvizohet se qoftë mosbraktisja, qoftë mësimi i shkrimit apo leximit kanë të bëjnë vetëm me sistemin formal të edukimit. Ky sistem i jep përparësi përfitimit të dijeve duke lënë pas dore llojet e tjera të të mësuarit. Pjesëmarrja në nivele sa më të kënaqshme në shkollë nuk është gjithmonë garanci për nxënës të suksesshëm. Shkollat tona duhet të fokusohen tek edukimi cilësor i fëmijëve si dhe tek zhvillimi i tyre i përgjithshëm. Edukimi duhet të kuptohet në tërë tërësinë e tij. Arsimi duhet të jetë në funksion të nevojave, dëshirave dhe kapaciteteve të individit, në rastin tonë të fëmijëve romë. Fëmijët e këtij komuniteti ashtu si të gjithë fëmijët e tjerë kanë dëshira, nevoja dhe kapacitete. Deri tani që të trija janë parë si tre gjëra të paharmonizuara. Ndërhyrjet për harmonizimin e tyre janë fragmentare, gjë që evidentohet tek mungesa e aftësive jetësore bazë që i karakterizon këto fëmijë. Teoritë e inteligjencave të shmëfishta na çojnë pikërisht në integrimin

e individit në shoqëri me potencialin që ai mbart, që mund të jetë i ndryshëm por edhe mjaft i vlefshëm për komunitetin lokal apo global ku ai bën pjesë. Shkolla është institucioni kryesor mbi të cilën bie kjo detyrë e vështirë. Fëmijët përballen qysh në moshën 3-vjeçare me kopshtin e më pas me shkollën, e cila së bashku me familjen konsiderohen si dy vendet më të rëndësishme të jetës së përditëshme të fëmijës. Në secilën prej tyre zhvillohen norma e vlera dhe fëmija influencohet nga këto elemente. Nocionet e se mirës e të keqes i ofrohen fëmijës njëkohesisht nga të dy hapësirat. Nganjëherë ndodh që ndryshimi midis normave të secilës hapësire të jetë aq i madh sa që krijohet një konflikt i vërtetë. P.sh. për shkak të traditës së mosshkollimit, shkolla mund të ngarkohet me nota shumë negative në gjirin e familjes. Në raste kur prinderit nuk kanë shkuar kurrë në shkollë ose dhe kur kanë shkuar ruajnë një kujtim shumë të keq (diskriminimin, rezultate të dobëta, etj). Pra, derisa shkolla nuk ka qenë e dobishme për ta, atëherë përse duhet të jetë e dobishme për fëmijët e tyre. Në këto raste fëmija gjenden gjithmonë në një pozicion delikat e të sikletshëm. Duke pasur prindër me kualifikim të ulët shumicën e rasteve analfabetë shkollës i bie një barrë jashtëzakonisht e madhe në rritjen e motivimit të fëmijëve romë por edhe të prindërve të tyre për ndjekjen e arsimit të paktën të arsimit të detyruar. Mësuesit kryesisht duhet të mbështesin dhe të inkurajojnë fëmijët romë jo vetëm në frekuentimin e shkollës por kryesisht në të nxënësit sipas nevojave dhe dëshirave që ata kanë. Në intervistat e zhvilluara me mësues dhe prindër romë ata midis të tjerave nënvizojnë si shqetësim kryesor mungesën e kushteve dhe mjeteve shkollore. Ndërsa liderët informalë romë nënvizojnë edhe një shqetësim tjetër. Sipas tyre ka mjaft mësues që nuk kanë përgatitjen apo kualifikimin e duhur.

“Nëqoftëse do të kishim mjetet e nevojshme mësimore apo laboratorët e duhur mësimi do të konkretizohej dhe do të bëhej më tërheqës edhe për nxënësit romë, pasi kam vënë re se nuk janë të vëmendshëm, teoria i mërzi shumë shpejt dhe nuk të ndjekin pothuajse fare kur shpjegon ”
Mësuese, Berat

“ Ne kemi marrë falas vetëm librat, po sa gjëra të tjera duhen. Duhen për të shkruar stilolapsa, duhen fletore për detyrat. Ja djali i vogël më kërkoi vizore. Do lekë çdo gjë, po s’e kemi mundësinë për të gjitha ” Nënë, Elbasan

“ Kalamajtë i morën falas një pjesë të librave, nuk e di unë po goca më tha që nuk ia dhanë të gjitha. Kushedi ia shpërnadnjë më vonë, se librat janë shtrejtë nuk ia kemi vaktin fare, se kemi pesëqind halle ” Nënë Elbasan

“Po t’i shikoni klasat nga kjo anë janë shumë të ftohta në dimër dhe fëmijët romë, ngaqë nuk vishen mirë, nuk përqëndrohen fare madje as nuk vijnë gjatë dimrit” Mësuese, Fier

“Për sa i përket mësuesve, mendoj se nuk përkushtohen sa duhet sidomos me fëmijët tanë. Fëmijët tanë qëndrojnë zakonisht në bankat e fundit dhe mësuesi nuk merret fare me to, ato nga ana e tyre kanë shumë vështirësi. Ne kemi edhe raste kur fëmijët e kanë braktisur shkollën, vetëm nga sjellja e ashpër e mësueses” Lider informal, Fier

“Do të tregoj diçka nga jeta ime. Kur kam qenë i vogël mbeta jetim dhe më rritën gjyshërit, por mësuesja më ka dhënë shumë ngrohtësi. Ajo ka qenë shkaku kryesor që unë arrita të mbaroj 8-vjeçaren. Sot nuk ka më kështu mësuesish” Lider informal, Korçë

“Mësuesja më thotë sa herë që shkoj në shkollë se djali s’ia thotë fare për mësim. E vetmja gjë që di të bëjë është se këndon bukur. Para ca kohësh e kishte nxjerrë nga klasa se nuk kishte libër dhe se shkonte i papërgatitur në shkollë. Ai është mërziur shumë, jo vetëm që vazhdon të ketë probleme në mësim, po nuk do fare të shkojë në shkollë”. Lider informal Elbasan

Mësuesit e intervistuar nga ana tjetër, akuzojnë vazhdimisht fëmijët romë për rezultate të dobëta dhe i etiketojnë shpesh herë si të pazotë, duke bërë përgjegjës kryesorë për këtë prindërit e tyre, të cilët nga ana tjetër i etiketojnë si neglizhentë. Mësuesit shkojnë edhe më tej. Në disa raste ato shprehen edhe pro ndëshkimeve qoftë fizike apo verbale, për të cilat besojnë që janë të nevojshme, për të edukuar fëmijët dhe për mbarëvajtjen e klasës. Në përgjithësi mësuesit nuk arrijnë të vlerësojnë interesa apo dëshira të ndryshme, që mund të shfaqin nxënësit romë gjatë mësim, pasi edhe të këndosh bukur, të kërcesh bukur etj nuk janë gjëra që duhet të anashkalohen, të mosvlerësohen, madje madje të merren si shembuj jo pozitivë për të tjerët. Mësuesit e intervistuar në përgjithësi edhe në biseda të lira që zhvilluam me to, vlerësonin maksimalisht nxënësit që ishin shumë mirë në lëndët matematikë dhe gjuhë dhe nuk i konsideronin pothuajse fare, nxënësit e tjerë që mund të shkëlqenin në lëndë si edukimi muzikor, edukimi fizik apo edukimi figurativ, lëndë për të cilat nxënësit romë shfaqin mjaft interes.

“I dhashë si detyrë klase të përshkruajnë ditën e parë të shkollës. Jo vetëm që nuk e bëri, por gjithë orës vizatoi pa pushim. Vizaton bukur në fakt, po ç’më duhet mua, kur nuk zbaton atë që i them unë. E kritikova para klasës e bëra për një lek. Nuk iu bë vonë fare. Le të bëjë ç’të dojë për vete e ka, unë për vetë nuk merrem më me të” Mësuese, Elbasan

“Familja ime nuk është marrë fare me mua, as prindërit asnjëri. Mësuesen e fillores nuk do ta harroj. Ajo e para e ka kuptuar pikën time të dobët. Më thoshte sa herë që di t’i ndërtosh fjalitë shumë bukur dhe shkrimin e ke shumë të bukur. Falë saj jam këtu sot”. Student, Universiteti i Elbasanit, dega gjuhë- letërsi

Një tjetër pengesë që hasin fëmijët romë gjatë shkollimit të tyre është mungesa e teksteve shkollore, ku ilustruhet historia dhe kultura rome. Nga vëzhgimet që i kemi bërë teksteve shkollore të ciklit fillor, nga klasa e parë deri në të pestë, si dhe teksteve të ciklit 9-vjeçar nga klasa e gashtë në të nëntë, kemi vërejtur se në asnjë tekst nuk trajtohet historia dhe kultura e kësaj pakice kombëtare qoftë edhe përciptazi. Nga ana tjetër kemi vëzhguar edhe planet vjetore të shkollave, kemi zhvilluar edhe biseda të lira me drejtorë dhe nëndrejtorë shkollash kryesisht të ciklit fillor, për të parë nëse kanë diçka të planifikuar në dobi të njohjes së traditës dhe kulturës rome. Për pakicat kombëtare, shkollat, në planet e tyre vjetore mbështeten në qëllimet strategjike, të pasqyruara në Planin Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve (2016-2020), ku në rubrikën: *Arsimimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor*, nëobjektivin e katërt përcaktohet shprehimisht:

“Promovimi i njohjes së identitetit Rom dhe atij Egjiptian si pjesë përbërëse e trashëgimisë kulturore të Shqipërisë”. (fq. 25)

Përveç Strategjisë, si pikëmbështetje për shkollat për planet e tyre vjetore shërben edhe Plani i Veprimit, 2016 i datës 03.08.2016, udhëzimi numër 16, sipas të cilit:

“Drejtorja e Arsimit Parauniversitar në MAS, DAR...etj, duhet të hartojnë plane pune vjetore me detyra konkretepër zhvillimin e një komuniteti shkollor, që promovon dialogun ndërkulturor dhe mirëkuptimin e përbashkët..... vlerësimin dhe promovimin e njohjes së identitetit rom dhe atij egjiptian, si pjesë përbërëse e trashëgimisë kulturore të Shqipërisë”. (fq. 17.

Ndërkaq nga intervistat me mësues apo nëndrejtorë të ciklit fillor mësuam se i vetmi aktivitet që organizohet për romët nga shkolla ishte më 8 prill ditën e festës së këtij komuniteti.

“Çdo 8 prill organizojmë një koncert të vogël, ku përpiqemi të bëjmë protagonistë nxënësit romë, të cilët kërcejnë dhe këndojnë” Nëndrejtoreshë e ciklit fillor, Elbasan.

“Asgjë nga historia, kultura apo traditat rome nuk ka të pasqyruar në librat apo tekstet shkollore. Flitet diçka për rracat në përgjithësi dhe barazinë midis njerëzve, po ndonjë gjë specifike për këtë komunitet nuk ka të pasqyruar në asnjë tekst”. Mësuese, Elbasan

“ Për nxënësit romë nuk ka ndonjë gjë veçse një ditë në vit në 8 Prill ata kanë festën e tyre dhe na kanë udhëzuar, që t'i kushtojmë 20 minuta të një ore mësimi këtij komuniteti. Natyrisht që nuk është fare e mjaftueshme” Mësuese, Berat

Në fakt unë vetë gjuhën rome po edhe historinë rome e kam mësuar në komunitet, nga të vjetrit. Unë kam tetë klasë shkollë se më parë na çonin në shkollë me detyrim, po në shkollë nuk mësova fare nga këto gjëra. Këto unë i kam mësuar në grup. Edhe fëmijët e mi nuk mësojnë fare nga këto gjëra në shkollë”. Prind, Korçë

Në përgjithësi prindërit romë, kryesisht nënat rome, nuk përpiqen t'u mësojnë fëmijëve të tyre disa aftësi bazë, mjaft të domosdoshme për jetën e tyre të përditshme, si p.sh si të vishen, si të ushqehen, si të mbajnë higjienën vetjake, si të komunikojnë me të tjerët etj. Nënat rome por edhe baballarët duke qenë vetë të pashkolluar nuk janë në gjendje t'u mësojnë apo t'u ofrojnë modele fëmijëve të tyre.

“ Vjet u sëmura në shkollë më dhimbte shumë koka dhe më merreshin mentë. Mësuesja më tha që kur të shkoj në shtëpi të masja temperaturën. I thashë mamit por nuk m'a mati se nuk dinte”. Nxënës, klasa 2-të cikli fillor

“Unë nuk di të gatuaj se ne e blemë ushqimin. Edhe kur morëm ndihma se na dhanë miell e oriz i shitëm se nuk dinim se ç'të bënim me to. Ne zakonisht blemë qofte tek një dyqan, që nuk është shumë larg nesh”. Nxënëse rome, klasa 5-të cikli fillor

Në mjaft studime nënat e arsimuara konsiderohen si matës i përafërt(proxy), për statusin ekonomik social të familjes. Sipas Glasgow L.K., Dornbusch,S.M., Troyer, L., Sreinberg, L.,& Ritter P.L. (1997) “ Parenting Styles”, adolescents'attributions and educational outcomes in nine heterogeneous high schools” *Child development*, 68, 508-528. pasi fëmijët me nëna të pashkolluara kanë më tepër tendencë të jenë të varfër.

Pikërisht kjo mungesë njohurish dhe shprehish nuk kuptohet si duhet nga pjesa më e madhe e mësuesve, të cilët duhet të përpiqen maksimalisht, që mësimdhënien t'a përshtasin me nevojat

reale dhe dëshirat, që paraqisin nxënësit në përgjithësi dhe nxënësit e komunitetit rom në veçanti. Ky është një nga shkaqet themelore i një mospërputhje të madhe midis nevojës për arsimim apo edukim i fëmijëve të komunitetit rom dhe sistemit të edukimit zyrtar të shkollave tona. Ajo ç'ka mund të themi është se ka diferenca të mëdha ndërmjet mënyrave të rritjes të fëmijëve të maxhorancës dhe atyre romë. Vetë mësuesit e intervistuar, por edhe psikologët shkollorë e kanë konfirmuar këtë gjë.

“ Pjesa më e madhe e fëmijëve romë janë shumë asocialë dhe rrinë të veçuar nga të tjerët, nuk i pëlqen farë të përfshihen në grup ” Mësuese, Korçë

Po ajo që ra në sy gjatë intervistave është fakti se mësuesit vetëm konstatonin pa u thelluar në analiza apo pa e konsideruar veten si pjesë shumë e rëndësishme në edukimin e fëmijëve romë. Ata mendonin se shkak kryesor i vështirësive të shumta që fëmijët romë hasin në shkollë, janë pikërisht kultura dhe traditat e këtij komuniteti.

“Prindërit romë janë shumë neglizhentë. Ato i lënë të lirë fëmijët e tyre dhe nuk u mësojnë shumë gjëra të rëndësishme për jetën. Kjo bën që këta fëmijë të jenë shumë difiçitarë në marrëdhëniet me nxënësit e tjerë në klasë, por edhe në marrëdhëniet me ne mësuesit ”. Mësues, Elbasan

Mësuesit zakonisht gjenden të papërgatitur përballë fëmijëve të këtij komuniteti, duke mos gjetur shpeshherë rrugën e duhur të trajtimit të tyre apo mënyrën e duhur të komunikimit me to.

“Me thënë të drejtën është mjaft e vështirë që t'i bësh këto fëmijë të ecin në mësim. Nuk di si të komunikosh me to. Prindërit po as që duan t'ia dinë. Ç'të bësh, ata sikur nuk kanë interes për asgjë ” Mësuese, Korçë

Gjatë intervistave u vu re se disa përgjegjësi ligjore përkundrejt fëmijëve romë, shkolla nuk i konsideron si nevojë të domosdoshme për ta. Kështu marrëdhëniet që fëmijët romë krijojnë me punonjësit socialë apo psikologët në shkolla, janë pothuajse inegzistente. Kjo gjë u vu re pothuajse në të gjitha zonat që morëm në studim. Në Berat, Fier, Elbasan dhe Korçë prindërit e intervistuar nuk kishin dijeni për punojnësin social dhe detyrat e tij.

“ Nuk di se çfarë është punojnësi social ”. Nënë, Elbasan

“ Jo nuk ka punonjës social. Janë anëtarët e shoqatës “Romët e Bashkuar”, që janë marrë me problemet e fëmijëve në shkollë. Ata shkojnë dhe takojnë mësuesit, prindërit dhe përpiqen të zgjidhin konfliktet mes mësuesve dhe nxënësve apo prindërve romë” Lider informal, Berat

“Në disa raste konfliktesh të mësuesve me fëmijët romë ne i jemi adresuar “Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve” në Bashki, e cila ka bërë takimet me personat e duhur për mbarëvajtjen e këtyre fëmijëve në shkollë” Anëtar, Shoqata “Romët për Integrim”, Korçë

Një tjetër nevojë mjaft e rëndësishme për fëmijët e komunitetit rom është edhe organizimi i aktiviteteve të ndryshme nga institucionet shkollore.

“ Organizohen nganjëherë eskursione. Fëmijët duan të marrin pjesë se kanë shumë qejf, por jo gjithmonë kemi mundësi”. Nënë, Fier

“ Në shkollë bënë njëherë një koncert për festën që e kemi në prill, po gjë tjetër jo. Këtu te lagjia jonë organizohet kampi veror, po jo nga shkolla. Atë e organizon një shoqatë. Atje shkojnë fëmijët tanë se u japin për të ngrënë, bëjnë lojëra dhe eskursione. Kështu duan fëmijët të lozin se në shkollë nuk kanë qejf të shkojnë. Kur shkojnë djali për herë të parë në eskursion erdhi i çuditur, se kishte parë detin nga afër për herë të parë. Këto kampet verore janë të mira se dalin fëmijët. Ne s’kemi mundësi t’i nxjerrim. Nënë, Elbasan.

4.4 Roli dhe rëndësia e polititikave arsimore dhe sociale në ndihmë të arsimimit të fëmijëve të komunitetit rom

Politikat arsimore

Arsimi si një mjet themelor për zhvillimin ekonomik dhe social të një vendi po kalon një sfidë të vështirë. Ndjekja e të gjitha niveleve arsimore nga parashkollori deri tek shkollat e larta, pas një rënie të viteve të para, ka kohë që ka filluar ringritjen. Megjithatë janë theksuar shumë diferencat në ndjekjen e shkollës. Këto diferenca janë ndërmjet zonave fshatare dhe qytetare, ndërmjet zonave rreth qyteteve dhe atyre më të thella etj. Por ajo që është më e evidente janë diferencat për shkaqe ekonomike, sociale e kulturore. Fëmijët që përbëjnë grupimin më të privuar nga pikëpamja arsimore, janë fëmijët e komunitetit rom. Shkollimi i pakët i të cilëve përbën një nga burimet më themelore të varfërisë, burim i cili është kthyer në një rreth vicioz të mbyllur për to, ku varfëria prodhon padituri dhe padituria prodhon varfëri. Disnivelet e thelluar ekonomike dhe

sociale pasqyrohen në probleme të mprehta të barazisë së shanseve. Braktisësit e arsimit të detyruar, fëmijët që nuk hyjnë fare në shkollë por edhe ata që shkojnë në shkollë por me shumë vështirësi shkruajnë dhe lexojnë, ka gjasa të ngelin analfabetë. Shtimi i ndjekësve të arsimit është kusht i nevojshëm për thyerjen e ciklit të varfërisë dhe rritjen e produktivitetit, aq më tepër sot që politikat arsimore diktohen nga një vizion krejt i ndryshëm nga ai tradicional, i cili e detyronte nxënësin t'i përshtatej atij mekanikisht. Vizioni arsimor në Shqipëri sot, ka në qendër nxënësin me nevojat dhe interesat e tij. Thënë ndryshe sistemi ynë arsimor kombëtar shërben si sektor shërbimi, që ka si qëllim paisjen e qytetarëve të ardhshëm me njohuritë e nevojshme, me aftësitë e shkathtësitë e mjaftueshme, të edukuar dhe të përkushtuar për të realizuar planin kombëtar ekonomik e zhvillimor të vendit. Ky sistem, duke synuar plotësimin e nevojave kombëtare të tregut të punës dhe aspiratat social-kulturore të popullit, paraqitet si kushtëzues për rritjen ekonomike dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Një nga kushtet bazë për të arritur të gjitha këto është edhe përpjekja për të vënë në jetë parimin e arsimit gjithëpërfshirës. Arsimi gjithëpërfshirës në kuptim të gjërë, nënkupton procesin e rritjes së pjesëmarrjes dhe uljes së përjashtimit, kupjesëmarrja nënkupton njohje pranim, respekt dhe përfshirje në procesin e të nxënies dhe në veprimtaritë sociale, në mënyrë të tillë që t'i sigurojë individit zhvillimin e ndjesisë që është pjesë e kësaj shoqërie. Megjithatë varfëria vazhdon të mbetet faktor negativ për ndjekjen e shkollës së detyruar. Nëse do t'i referoheshim realitetit, do të vërejm se probleme të ndryshme emergjente, mund t'i bëjnë autoritetet lokale përgjegjëse të pavëmendshme ndaj arsimimit sidos të grupeve vulnerabël. Për këto arsye, objektivat e arsimit të detyruar do të mund të bëhen të arritshëm vetëm në saj të harmonizimit të politikave sociale të programeve specifike arsimore dhe forcimit të ligjit.

Politikat sociale

Politikat sociale mbulojnë të gjitha dispozitat dhe masat, që synojnë të parandalojnë, të mënjanojnë ose të lehtësojnë situatat e varfërisë dhe problemet sociale, në nivel individual ose kolektiv, ose që kërkojnë të favorizojnë mirëqënien e grupeve më të brishta të shoqërisë. Në kuptimin e ngushtë, politikat sociale përcaktojnë masat, që shërbejnë drejtpërdrejt në luftën kundër varfërisë ose parandalimit të saj, në rradhë të parë sigurimet shoqërore dhe ndihma shoqërore, si dhe pagesa të tjera në varësi të burimeve të mundëshme. Në Shqipëri rrjeti i asistencës sociale përbëhet nga 2 programe:

1.Ndihmë në para

2. Programe shërbimesh dhe përkujdesjesh sociale për grupet vulnerabël (fëmijët, të moshuarit, gratë dhe vajzat në nevojë, etnitë).

Programet e asistencës sociale janë:

- Ndihmë në para, e cila njihet si ndihmë ekonomike, që i jepet familjeve më të varfra
- Pagë që lëvrohet çdo muaj për të paafët dhe kompesim çmimi për pensionistët.

Programi i ndihmës ekonomike si pjesë përbërëse e politikave të mbrojtës sociale, në thelb përfaqëson një program ekonomik në formën e transferatve në kesh. Ky program financohet plotësisht nga buxheti i shtetit, ndërsa menaxhimi dhe shpërndarja e ndihmës ekonomike të çdo familje bëhet nga bashkitë. Programi në fjalë bazohet në testimin e mjeteve të jetesës.

Çështjet që vlejnë të diskutohen janë:

1. A bazohet programi i asistencës në testimin real të mjeteve të jetesës?
2. A realizohet në mënyrën e duhur menaxhimi dhe shpërndarja e ndihmës ekonomike nga pushteti lokal?

Në përzgjedhjen e familjeve aplikuese dhe përcaktimin e moshës së ndihmës ekonomike për çdo familje, njësitë e pushtetit vendor aplikojnë kritere të përcaktuara, që kanë të bëjnë me kushtet dhe strukturen e familjeve, por në disa raste, njësitë vendore aplikojnë edhe kritere specifike, të cilat lidhen me:

- Situatën sociale të familjes dhe probleme të shëndetit
- Familje që kanë kryefamiljare gra
- Familje me persona me nevoja të veçanta

Çështja tjetër që shtrohet është:

Përse nuk trajtohen familjet që nuk e përballojnë dot arsimin e detyrueshëm të fëmijëve të tyre me ndihmë ekonomike?

Çështjet e shtruara më lart në formë pyetjesh do të ritrajtojm në rubrikat në vazhdim në një këndvështrim më të ngushtë, të cilin do ta fokusojme tek kushtet specifike të zonave të marra në studim.

Roli i pushtetit vendor në ndihmë të politikave arsimore dhe sociale

Pranë bashkive funksionojnë drejtoritë e shërbimeve dhe programeve sociale, që përbëhen nga dy sektorë:

1. Sektori i ndihmës ekonomike dhe i kompesimit së aftësisë së kufizuar
2. Sektori i shërbimeve sociale

Sektori i ndihmës ekonomike duke u nisur nga të dhënat e njësive administrative për familjet në nevojë, realizon suportin ekonomik të këtyre familjeve. Ky suport për hir të së vërtetës lë shumë për të dëshiruar, pasi nuk përmbush nevojat elementare të jetesës, kështu që nuk mendohet të flitet për të përmbushur kërkesat e fëmijëve të këtyre familjeve për t'u arsimuar. Fëmijët e familjeve të varfra përfitojnë nga fondi, i cili alokohet për ndihmën ekonomike në mënyrë indirekte, ose përmes ndihmës që i jepet familjes në tërësi ose përmes skemës së personave me aftësi të kufizuar. Në këtë prizëm çështjet që ngrihen janë:

- A është i mjaftueshëm suporti për këto familje?
- A jemi në gjendje të japim një shifër totale se sa shpenzojmë për fëmijët në mënyrë direkte apo indirekte?

Sektori i shërbimeve sociale funksionon në bazë të një ndarjeje të grupeve vulnerabel, që janë:

- 1) fëmijët
- 2) etnitë
- 3) të moshuarit
- 4) aftësia e kufizuar

Për secilin ngakëto target – grupe, ka persona përgjegjës puna e të cilëve bazohet në koordinimin mes institucioneve përkatese shtetërore dhe ojf-ve, që veprojnë në qytete të ndryshme, për t'u ardhur në ndihmë këtyre target grupeve sipas nevojave.

Në qytetet e trajtuara në studimin tonë janë Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve, të cilat konsiderohen si pjesë të sektorit të shërbimeve sociale. Këto njësi bashkëpunojnë dhe koordinojnë me shumë aktorë të tjerë lokalë, duke filluar nga zyrat e ndihmës ekonomike, DAR-të (drejtoritë arsimore rajonale), shkollat (personat e kontaktit, psikologët), njësitë bashkiake (kryetarët e njësive bashkiake, administratorët socialë), poliklinikat e lagjeve, gjykatat, policinë etj, për identifikimin e fëmijëve vulnerabël. Këto zyra duke pasur në fokus fëmijët dhe duke bashkëpunuar me tërë këto institucione, sidomos me drejtoritë arsimore, shkollat, personat e kontaktit në shkolla, mësuesit, prindërit, nxënësit etj, kanë evidentuar një sërë problematikash që ndikojnë në vijueshmërinë e fëmijëve në shkollë. Në të katër zonat e marra në studim është fakt (në bazë të të dhënave të marra pranë drejtorive arsimore rajonale), braktisja e shkollave si në zonat rurale apo në ato periferike, ku ka më shumë akumulime të komunitetit rom. Braktisja por edhe lëvizja masive demografike e familjeve, bënë që shumë fëmijë të fillojnë të enden rrugëve apo të bëjnë punë ilegale duke u bërë viktima të rekrutimit. Në raste të tjera, sidomos në komunitete dhe në familje të marginalizuara, jo të ndërgjegjesuara për punën e fëmijëve dhe pasojat e saj, nxitet dërgimi i fëmijëve jashtë shtetit me besimin, se atje do të krijojnë një të ardhme më të mirë, duke bërë marrëveshje me të ashtuquajturit “mbrojtës” të tyre. Ky fenomen vihet re sidomos tek komuniteti rom, i cili përballlet me një situatë të vështirë ekonomike e sociale, që siç e kemi përmendur edhe herë të tjera, karakterizohet nga një jetesë nën normalen, strehim jo të përshtatshëm dhe mjedis jo të përshtatshëm për mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve. Karakteristikat e jetesës së këtyre familjeve kanë ndikim të konsiderueshëm tek fëmijët të cilët duke mos marrë arsimin e duhur, nuk mund të integrohen në shoqëri duke sjellë si rezultat qarkullimin e varfërisë dhe të problemeve sociale në një cikël të mbyllur që trashëgohet ndër breza. Mungesa e informacionit rreth planifikimit familjar, bën që këto familje të jenë të zgjeruara dhe me shumë fëmijë dhe të vuajnë nga probleme të mprehta sociale si dhuna, mosrespektimi i të drejtave të fëmijëve, divorcet, abuzimi me alkoolin, shtatzanitë në moshë shumë të re. Shumica e fëmijëve të familjeve të marginalizuara për vetë nivelin e ulët arsimor, ekonomik dhe kulturor që kanë bien pre e trafikeve të ndryshme (duhet pasur parasysh faktin që një pjesë e mirë e fëmijëve romë jetojnë me një prind apo me gjyshërit). Nga ana tjetër komuniteti rom ka një jetë jo stabël. Ndryshimi i ambientit ku jetojnë, lëvizja nga një shkollë tek tjetra vështirësitë për t’u integruar ka pasojat e veta. Si rrjedhojë shumë familje nuk përfitojnë ndihmën ekonomike për arsye se lëvizja e tyre nuk është regjistruar në zyrën e gjendjes civile.

Parë në këtë këndvështrim situata social-ekonomike e familjeve rome, reflektohet në një spektër të gjërë problematikash tek fëmijët romë: fëmijë të paregjistruar, fëmijë që braktisin shkollën, fëmijë që shfrytëzohen për qëllime përfitimi etj. Për përmirësimin e situatës arsimore të fëmijëve romë vazhdimisht janë marrë masa si nga Ministria e arsimit dhe Sporteve ashtu edhe nga pushteti lokal.

“Në periudhën 2003-2007 Ministria e Arsimit dhe Shkencës (sot Ministria e Arsimit dhe Sporteve), shpërndau falas në masën 100% librat e arsimit të detyruar për fëmijët prindërit e të cilëve ishin të papunë dhe 85% për nxënësit romë. Për vitin shkollor 2007-2008, të gjithë fëmijët e familjeve të varfëra përfshi këtu edhe fëmijët romë i përfituan librat vetëm duke paguar 10% të vlerës së tyre. Për vitin shkollor 2011-2012 e në vazhdim në kuadër të Dekadës rome, janë shpërndarë libra shkollorë falas vetëm për fëmijët e komunitetit Rom” Përgjegjëse sektori, Njësia për Mrojtjen e Fëmijëve, Bashkia Elbasan

“Në janar 2015, në qytetin tonë u ngrit Qendra Komunitare Rome e cila nën kujdesin e baskkisë Korçë, është përpjekur të ofrojë për të rinjtë romë kurse mësimi për gjuhët rome dhe shqipe, aktivitete të ndryshme kulturore artistike etj” Punonjëse Qendra Komunitare Rome, Korçë

Megjithë masat e marra nga bashkitë prapë arsimimi i fëmijëve të komunitetit rom paraqet mjaft vështirësi. Ajo që bie në sy është se masat e marra nuk shoqërohen me punë paraprake të mjaftueshme ndërgjegjësuere apo sensibilizuese me prindërit romë si nga ana e njësive vendore, por edhe nga institucionet arsimore, për të mirat që sjell arsimimi cilësor, sipas nevojave dhe kapaciteteve të gjithësecilit.

“Kemi marrë masa për rifunksionimin e klasave të Shansit të Dytë, ku krahas takimeve me përfaqësues të DAR, përfaqësuesit e OJF-ve etj, familjeve të interesuara iu ofrua mikrokredi për gjenerim të ardhurash nga fondacioni “Terre des Hommes”, si dhe u vlerësuan nevojat e fëmijëve për veshje të cilat u mundësuan nga fondacioni “A2B”. Këto fondacione ndihmuan edhe me një lloj suporti tjetër, duke i dhënë një numuri të caktuar familjesh rome, që kishin fëmijë në moshë shkollore, rroba të përdorura për t’i shitur në treg, me kusht që t’i dërgonin fëmijët në shkollë, por kjo funksionoi shumë pak” Drejtor i kujdesit social, Bashkia Elbasan

“Në shkollat shtetërore nuk ka ndihma. Vetëm fëmijët që ndjekin klasat speciale të Fondacionit “Ndihmë për Fëmijët”, marrin ndihma. Para një viti kanë marrë pako me ushqime, mjete

shkollë dhe familjet e tyre janë ndihmuar për të ngritur ndonjë biznes të vogël. Gjithashtu fëmijët që frekuentojnë klasën e Shansit të Dytë, janë ndihmuar nga shoqatat: “Ndihmë për Ballkanin”, “Terre des Hommes” dhe “Romani Sezi”, herë pas here në varësi të nevojave me mjete didaktike, veshmbathje etj. Për sa i përket pjesës tjetër të fëmijëve që mësojnë në shkollat shtetërore, ato janë referuar tek Njësia për Mrojtjen e Fëmijëve në Bashki, e cila i ka referuar si raste në nevojë po tek shoqatat, të cilat janë përpjekur t’i ndihmojnë” Lider informal rom

Nga intervistat e bëra vihet re se duke qenë i vështirë financimi i politikave sociale nëpërmjet buxhetit të shtetit është marrë në konsideratë rruga e bashkëfinancimit si p.sh projekte të përbashkëta me OJF në funksion të arsimimit të fëmijëve romë. Megjithatë kjo nuk është e mjaftueshme, pasi dështimet në arsimimin e këtyre fëmijëve flasin vetë. Po t’i thuash prindit rom po të jap rroba për të shitur, me kusht që të dërgosh fëmijën në shkollë, pa e ndërgjegjësuar sa duhet për dobitë e mëdha që sjell arsimimi, për pritshmëritë që ato duhet të kenë për fëmijët e tyre nëse arsimohen si duhet, pothuajse të gjitha përpjekjet të shkojnë kot. Nga ana tjetër ajo që vihet re, është se në kriteret specifike që njesitë vendore aplikojnë për përfitimin e ndihmës ekonomike, nuk përbëjnë kriter më vete familjet, fëmijët e të cilave vazhdojnë arsimin e detyrueshëm shkollor.

“Ne në bazë të kriterëve të caktuara më parë ne përcaktojmë edhe ndihmën ekonomike për çdo familje në nevojë, po për familjet e varfëra që kanë fëmijët e tyre në shkollë, shkollimi i tyre, nuk ka përbërë ndonjëherë kriter më vete” Punojëse, Njësia për Mrojtjen e Fëmijëve, Bashkia Berat

Roli i shkollës në ndihmë të politikave arsimore dhe sociale

Shkolla natyrshëm është një nga aktorët kryesorë në harmonizimin e politikave sociale me ato arsimore. Në mjaft shkollë të qyteteve, janë vendosur personat e kontaktit (në shumë raste psikologu ose mësuesi i rekomanduar nga drejtoria), që duhet të referojnë rastet e fëmijëve me probleme social – ekonomike të mprehta, pranë Zyra apo Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashkitë përkatëse. Këto të fundit nga ana e tyre hartojnë planet e veprimit për menaxhimin e rasteve, në mënyrë që të ndihmohen familjet që fëmijët e tyre të mos braktisin shkollën. Shkolla nga ana e saj, gjithmonë sipas ligjit ka për detyrë të njoftojë prindërit për mungesat pa arsye të fëmijëve ose mungesat e dyshimta. Këtu vihet re se lidhja e shkollës me familjen nuk është e kënaqshme dhe për më tepër rastet e braktisjes së shkollës, gjithmonë justifikohen si largime të

familjes së fëmijës në një vend tjetër, duke e bërë fenomenin e braktisjes të pamatshëm në mënyrë reale. Nuk mjafton vetëm kjo, ka edhe fëmijë romë që ndonëse shkojnë në shkollë me vështirësi shkruajnë apo lexojnë. Mundësitë që u ofron strategjia e arsimit të romëve, siç janë “Shansi i Dytë” apo klasat ndihmëse, lënë për të dëshiruar. Ndërkohë që klasat ndihmëse nuk kanë funksionuar njësoj në të gjitha zonat.

“Kanë dëshirë të marrin pjesë në aktivitete por kanë vështirësi, ndër të cilat mund të përmendim paragjykimet fisnore. Me pak fjalë nëse fëmijët e një fisi rom prononcohen që do të vijnë në aktivitet me fëmijët e një fisi tjetër (që janë në konflikt apo kanë pasur mosmarrëveshje midis tyre), nuk marrin pjesë. Ky lloj paragjykimi fisnor ndikon edhe në frekuentimin e shkollës. Kam pasur shumë vështirësi për t’i rregjistruar dhe ulur në nëpër banka fëmijët e klasës së shansit të dytë”. Mësuese, “Shansi i Dytë”, Berat

“Në klasën e Shansit të Dytë janë regjistruar për këtë vit 21 fëmijë, nga të cilët 10 vijnë rregullisht” Mësuese, Korçë

“Nëse do të flisja singlerisht, fëmijët romë nuk kanë interes për t’u arsimuar. Janë shumë më të interesuar për përfitimet e momentit, sapo hasin vështirësinë më të vogël e braktisin shkollën”. Mësuese, Shansi i Dytë, Fier

Për sa i përket prindërve romë meqenëse një pjesë e mirë e tyre nuk dinë shkrim e këndim, ata duan që fëmijët e tyre të mësojnë të paktën të shkruajnë dhe të lexojnë.

“ Fëmijët duhet të mësojnë patjetër të shkruajnë dhe të lexojnë, pasi duhet për të bërë shumë gjëra në jetë. Nëse do t’u duhet të marrin patentën për makinë për shembull nuk e marrin dot pa ditur shkrim e lexim”. Prind, Fshati Rom, Fier

Nga ana tjetër drejtorët e shkollave dhe përfaqësuesit e drejtorive arsimore shprehen pozitivisht kur flitet për arsimin bazë të fëmijëve romë. Të pyetur në lidhje frekuentimin e tij nga ana e romëve, ata thonë se arsimi arsimimi bazë frekuentohet nga fëmijët romë, ndonëse askush nuk shprehet për frekuentim 100% dhe nuk jepen të dhëna të sakta në numër. Të gjithë pranojnë se ka edhe fëmijë romë, të cilët nuk frekuentojnë për shkaqe kryesisht ekonomike. Ajo që vihet re është se informacioni i ofruar nga specialitë të DAR-eve, në të gjitha zonat e studimit është kontradiktor me atë të dhënë nga shoqatat, institucionet e tjera si bashkitë apo vetë prindërit.

Specialistët e drejtorive arsimore, por edhe drejtorët e shkollave, pothuajse në të gjitha zonat e studimit tonë, ngrejnë problemin e regjistrimit të fëmijëve romë në gjendjet civile, pasi fëmijët romë që nuk janë të regjistruar në gjendjen civile nga prindërit e tyre, e vështirësojnë punën e drejtorive arsimore për evidentimin e tyre. Kjo gjë krijon probleme kur afrohet koha e shkollës, sepse këta fëmijë nuk ekzistojnë, as për pushtetin lokal dhe as për drejtoritë arsimore. Prandaj vetë përfaqësuesit e arsimit kërkojnë që pushteti lokal të marrë masa për t'i regjistruar këta fëmijë, pasi kjo do të ishte një ndihmesë e madhedhe në punën e tyre në evidentimin e fëmijëve në moshë shkollore.

“ Në qytetin tonë vazhdon të jetë problem regjistrimi i fëmijëve romë, por nga ana tjetër ajo që na e vështirëson punën është edhe mungesa e të dhënave të sakta nga Bashkia, për numrin e fëmijëve romë në moshë shkollore. Duhet një bashkëpunim më i ngushtë ndërmjet dy insitucioneve tona”” Specialist, DAR, Elbasan

Drejtoritë Arsimore Rajonale përpos bashkëpunimit me institucionet e pushtetit vendor, e shohin shumë të rëndësishëm edhe bashkëpunimin me OJF të ndryshme, që merren me çështjet rome, pasi këta të fundit mund të shërbejnë si ura lidhëse midis tyre dhe familjeve rome. Të gjitha zonat tona të studimit e kanë parë këtë bashkëpunim si prioritet me qëllim arsimimin e fëmijëve romë.

“ Klasa “Shansi i dytë” është projekt i Ministrisë së Arsimit, por u quajt i dështuar pasi nuk dha rezultatet e duhura. Para tre vjetësh, në një nga takimet e rradhës që realizon Njësia për mbrojtjen e Fëmijëve në Bashkinë Elbasan, nga shoqarta Romano Sezi (shoqatë rome), u ofruan 40 fëmijë të moshës 9-18 vjeç, që nuk kishin qenë asnjëherë në shkollë apo e kishin braktisur atë. Nisur nga kjo u mendua të shfrytëzohej ky projekt për integrimin e këtyre fëmijëve duke bërë një përpjekje të përbashkët për rifunksionimin e tij. Kështu u krijua një grup pune i përbërë nga përfaqësues të DAR, shoqatave të ndryshme si “ Ndihmë për Ballkanin”, “ Terre des Homes” dhe Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashki. Ajo që u arrit nga ky proces ishte:

- *Vendosja e klasës në shkollën më të afërt për komunitetin rom*
- *Arredimi i klasës, u realizua nga kontributi i shoqatës “Ndihmë për Ballkanin”*

- *Vendosja e nje personi ndihmës nga komuniteti rom, që do të shoqëronte fëmijët dhe do të ndihmonte mësuesen në klasë. Pagesa u realizua nga shoqata “ Ndihmë për Ballkanin”*
- *Paisja e fëmijëve me libra dhe mjete mësimore nga shoqata “Terre des Hommes”*
- *Mbështetja e disa familjeve të përfshirë në këtë klasë me mikrokredi për gjenerim të ardhurash, realizuar nga shoqata “ Terre des Hommes”. Mësuese, Klasa “Shansi i Dytë”, Elbasan*

“ Këtu në Korçë ka shumë shoqata që përfaqësojnë romët. Kemi bashkëpunuar gjithmonë me to në të mirë të arsimimit të fëmijëve romë” Specialist DAR, Korçë

Në lidhje me sfidat e drejtorive arsimore dhe shkollave për arsimin e romëve, sipas dëshirave dhe nevojave që ata kanë, të intervistuarit nuk kanë të qartë se çfarë objektivi duhet të ketë institucioni i tyre. Për bashkitë, drejtoritë arsimore apo shkollat mosbraktisja, që natyrisht është një nga objektivat themelorë të shkollës, e ezaoron krejtësisht problemin e shkollimit të fëmijëve romë. Kur pyeten për:

- të dhëna standarte mbi arsimimin e komunitetit rom
- objektiva të qarta lidhur me arsimimin e tij
- monitorimin e nivelit të nxënies të fëmijëve romë, as drejtoritë arsimore dhe as shkollat nuk i përgjigjen në mënyrë të drejtpërdrejtë pyetjeve. Ata japin përgjigje kaotike dhe përpiqen që t’i shmangen atyre.

*“Drejtoria jonë arsimore, në lidhje me shkollimin e fëmijëve të komunitetit Rom ka si qëllim të sajin eliminimin e braktisjes. Për këtë qëllim në bashkëpunim me bashkinë dhe OJF e ndryshme janë marrë masa për ndjekjen e regjistrimit të fëmijëve romë në të gjithë nivelet e arsimit, duke synuar përfundimin prej tyre të arsimit të detyruar”*Specialist, DAR, Fier

Gjatë gjithë procesit të intervistave nuk kemi marrë informacion të saktë sesi është zbatuar strategjia për arsimimin e romëve dhe kush janë sfidat kryesore në lidhje me të. Nuk ka një plan veprimi të mirëkoordinuar nga Ministria e Arsimit, që të zbatohet për realizimin e kësaj strategjie, e cila në vitin 2013 mbaroi, për t’ia lënë vendin një tjetre, e cila nuk është gjë tjetër veçse vazhdimësia e strategjisë së parë.

KAPITULLI V

DISKUTIMI I REZULTATEVE

Gjatë gjithë kapitullit të pestë jemi përpjekur të sjellim një pasqyrë të gjetjeve kryesore të studimit, të cilat janë të lidhura ngushtë me qëllimin dhe objektivat e tij. Duke pasur si qëllim eksplorimin e situatës arsimore reale të fëmijëve të komunitetit rom, për të parë se çfarë u ofron shkolla shqiptare atyre dhe a synon ajo drejt edukimit gjithpërfshirës, gjithmonë në funksion të formimit të individit, nevojave, normave dhe vlerave të tij, cilësive të personalitetit dhe mbi të gjitha të aftësimit, me shprehje praktike themelore bazë për një jetë dinjitoze në shoqëri, studimi u mendua të realizohej në bazë të disa objektivave të caktuar. Rezultatet e studimit treguan se arsimi gjithpërfshirës vitet e fundit është shndërruar në një fenomen delikat, që ndikon në cilësinë e jetës së individit. Nga ana tjetër shteti Shqiptar ka hartuar një kornizë të plotë ligjore për arsimin gjithpërfshirës dhe arsimimin e pakicave etnike në Shqipëri.

5.1 Objektivi 1: Analizë e kuadrit ligjor shqiptar për arsimimin e pakicave etnike në vendin tonë.

Pas viteve '90, në shumë vende europiane të dala nga regjimet totalitare sikurse edhe Shqipëria, u përfshinë në valën e ndryshimeve të cilat morën formën e reformave progressive në edukim dhe u orientuan drejt prirjeve të kohës si: arsimi për të gjithë, të nxënësit në shoqërinë e dijes, respektimi i të drejtave njerëzore, barazi dhe cilësi në arsim, gjithpërfshirja, diskriminimi etj. Ligji për arsimin parauniversitar nr 69/2012, i vendit tonë në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 e kushtetutës, thotë shprehimisht:

1. Personave që u përkasin pakicave kombëtare, u krijohen mundësi të mësojnë dhe të mësohen në gjuhën amtare, të mësojnë historinë dhe kulturën e tyre, sipas planeve dhe programeve mësimore.
2. Për të mundësuar pjesëmarrje aktive dhe të barabartë në jetën ekonomike, shoqërore, politike e kulturore të Republikës së Shqipërisë, nxënësve të pakicave kombëtare u krijohen kushte për mësimin e gjuhës shqipe dhe njohjen e historisë e të kulturës shqiptare.

3. Planet e programet mësimore, si dhe raportet e përdorimit të gjuhës amtare dhe asaj zyrtare në procesin mësimor përcaktohen me akte të veçanta të ministrit.

Duket qartazi në këtë nen, sanksionimi i parimit të barazisë, sikundër është një trajtim disi më specifik për këtë target grup. Ky trajtim i diferencuar vjen si nevojë për mësimin e të dy gjuhëve. Në mënyrë të koncentruar në ligj pasqyrohen qartazi jo vetëm parimet kushtetuese, por edhe ato ndërkombëtarisht të pranuar. Duke u nisur nga problemet e mëdha që paraqesin pakicat etnike, kryesisht rome dhe egjiptiane në Shqipëri në lidhje me arsimimin bazë të tyre, mund të themi se problemi nuk qëndron tek kuadri ligjor shqiptar. Kuadri ligjor në Shqipëri, për arsimimin e pakicave etnike, në aspektin teknik është i plotë dhe inkorporon direktivat e BE dhe parime të Konventës antidiskriminim. Shqipëria si shtet i së drejtës sanksionon të drejtën për arsim që në Kushtetutë, për të vazhduar me pas me ligjet konkrete. Problematika qëndron tek faza post miratim e ligjit. Kjo fazë lidhet me politikat ekzekutive të shtetit, që duhet të përfshijnë të gjithë institucionet përgjegjëse.

Ndonëse sanksionohet me ligj, siç e kemi përmendur edhe më lart, fëmijëve të komunitetit Rom, nuk u mundësohet në shkollat publike mësimi i gjuhës rome. Këtu është për t'u përhëndetur rasti i parë i futjes së mësimin të gjuhës rome në një shkollë shtetërore, në Elbasan. Megjithatë është shumë pak, përsëri është një përpjekje, që duhet të konsiderohet edhe nga shumë shkolla të tjera në Shqipëri.

Funksionimi si duhet i ligjit për arsimin parauniversitar përbën një problem jo të vogël. Nga përpunimi i të dhënave rezulton se një pjesë e konsiderueshme e prindërve romë nuk janë informuar mbi kuadrin e plotë ligjor të arsimit bazë të detyrueshëm, apo të arsimit gjithëpërfshirës. Ata duken indiferentë ndaj ligjit dhe nuk e kanë shkuar ndër mend, t'a lexojnë apo të informohen për të. Kështu nga 15 nëna rome të pyetura për këtë problem, vetëm 2 kishin dijeni përciptazi për ligjin. Pak a shumë e njejta gjë po pak më ndryshe mund të thuhet për baballarët romë. Kështu nga 19 baballarë vetëm 11 prej tyre nuk kishin fare dijeni për ligjin mbi arsimimin e pakicave etnike.

Nga ana tjetër mësuesit në përgjithësi kanë njohuri të pjesshme mbi ligjin për arsimin e pakicave etnike dhe arsimin gjithëpërfshirës. Porë në këtë këndvështrim, ata i njohin pak detyrimet që kanë

gjatë mësimdhënies në klasa me nxënës të komunitetit rom. Ajo që bie në sy është se mungesa e të kuptuarit çdo të thotë “arsimgjithëpërfshirës”, përbën një barrierë që ndikon në punën e përditshme të mësuesit. Krahasuar me vendet e Evropës Perëndimore, Shqipëria është disa hapa prapa, pasi kushtet për arsimin gjithëpërfshirës në ato vende kanë filluar disa dekada më herët dhe për pasojë, cilësia e mësimdhënies është më e lartë, sikurse edhe mjedisi që ofron shkolla për këta fëmijë është më miqësor.

Ndërsa përsa i përket institucioneve të tjera, siç janë njësitë bashkiake, drejtoritë arsimore rajonale etj, përpos disa përpjekjeve të bëra, në përgjithësi ata e shohin problemin e arsimimit të romëve vetëm si çështje mosbraktisje. Bashkëpunimi dhe koordinimi i punëve apo detyrave midis tyre nuk është asnjëherë në nivelin e duhur. Nëse shifrat e braktisjes shkollore për fëmijët e komunitetit rom minimizohen, atëherë gjithçka është në rregull, pasi lufta ndaj braktisjes shkollore, konsiderohet si masa më konkrete për arsimimin e pakicave etnike. Kjo i bën ato të jenë neglizhentë apo indiferentë ndaj punës sensibilizuese dhe ndërgjegjësuere me mësuesit, drejtorët e shkollave, punonjësit socialë etj, nëpërmjet organizimit të seminareve trajnuese dhe jo vetëm, për trajtimin e fëmijëve të komunitetit Rom. Shpeshherë të gjithë këta aktorë, harrojnë faktin se për pakicat etnike (në rastin tonë komuniteti rom), bazuar në kontekstin socio-kulturor nga ato vijnë, duhet një trajtim i diferencuar, gjithmonë në respekt të parimit të barazisë në fushën e arsimit.

5.2 Objektivi 2: Evidentimi i pengesave kulturore institucionale dhe infrastrukturore që vështirësojnë arsimimin sipas nevojave dhe kapaciteteve të fëmijëve romë

Fëmijët e komunitetit Rom, përballen me një sërë vështirësish qofshin këto ekonomike apo sociale. Familjet rome zakonisht kanë shumë fëmijë. Duke qenë se kanë një jetesë nën normalen, mjedis dhe strehim jo të përshtatshëm, rritja dhe edukimi i fëmijëve lë shumë për të dëshiruar. Një pjesë e madhe e tyre vuajnë nga probleme të mprehta sociale si dhuna, mosrespektimi i të drejtave, divorcet e prindërve etj. Karakteristikat e jetesës së familjeve rome, kanë ndikim mjaft të madh tek fëmijët, të cilët duke mos marrë arsimin e duhur nuk mund të integrohen në shoqëri, duke sjellë si rezultat qarkullimin e varferisë dhe të problemeve sociale në një cikël të mbyllur që trashëgohet brez pas brezi.

Përgjatë këtij studimi evidentohet situata tejet e vështirë socio-ekonomike e fëmijëve të komunitetit rom, e cila ndikon direkt në cilësinë e jetës së tyre. Gjendja e vështirë ekonomike i detyron prindërit romë, t'i largojnë fëmijët nga shkolla edhe kur ata janë të interesuar për arsimin e tyre. Gjatë intervistave vetëm vetëm 10 prindër nga 35 d.m.th 28% e prindërve të intervistuar arrinin t'u siguronin fëmijëve të tyre kushtet, materialet e duhura shkollore, ushqimin dhe veshmbathjen e përshtatshme. Po të njëjtën gjë mund të konstatojmë edhe në studime të tjera, që kanë analizuar situatën ekonomike të komunitetit Rom. Kështu sipas një studimi të PNUD, "Prekshmeria Shoqërore e Romëve në Shqipëri, 2006:

"... një familje rome shpenzon 20 euro në vit për arsimimin e fëmijëve të tyre, ndërsa familjet jorome shpenzojnë në vit 308 euro për të njëjtin qëllim. Për 34% të romëve të anketuar përballimi i shpenzimeve për blerjen e librave, pajisjeve shkollore, pagesa e detyrimeve dhe të tjera shpenzime që lidhen me arsimimin, që shpesh i tejkalojnë të ardhurat e tyre, janë arsyet kryesore përse ndalet arsimimi i tyre..(fq. 22-23).

Pjesë përbërëse e situatës së vështirë ekonomike janë emigrimi, migrimi, papunësia apo punësimi i fëmijëve. Të gjithë këto faktorë, kanë ndikuar mjaft negativisht në arsimimin e fëmijëve të komunitetit Rom. Migrimi dhe emigrimi sjellin një çorientim të vërtetë të fëmijëve romë, të cilëve në të tilla raste u mungon pothuajse fare kujdesi prindëror. Këtë gjë mund t'a gjejmë edhe në studime të tjera. Kështu sipas Tamo& Karaj(2007):

"... prindërit i lënë fëmijët e tyre me gjyshërit apo dhe me nënat dhe largohen në vendet fqinje për të siguruar të ardhura ekonomike më të mira për fëmijët e tyre". (Fq.43)

Këto faktorë sjellin edhe një problem tjetër jo të vogël, siç është regjistrimi i fëmijëve romë të kthyer nga emigrimi, të cilët nuk figurojnë në regjistrat e gjendjeve civile. Kur prindërit romë kthehen nga emigrimi përballen me një kosto të pajisjes me dokumente, që për ta është mjaft e konsiderueshme. Këto dokumente janë mjaft të nevojshëm për të regjistruar fëmijët në shkollë. Mospajisja me to, i detyron një pjesë të prindërve romë që të mos e bëjnë asnjëherë regjistrimin e fëmijëve të tyre në shkollë, gjë që sjell mohimin e mundësisë për të frekuentuar shkollën. Megjithatë është për t'u përmendur fakti se Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka lëshuar në vite urdhëresa, të cilat lejonë rregjistrimin e fëmijëve romë pa dokumentet e nevojshme. Këto urdhëresa shpesh nuk zbatohen nga një pjesë e konsiderueshme e autoriteteve shkollore duke i

lënë fëmijët romë pa zgjedhje, por të detyruar të rregjistrohen vetëm në ato shkolla të cilat janë të etiketuara si “shkolla geto rome”. Nga ana tjetër papunësia në nivelë shumë të larta për pothuajse të gjithë komunitetin rom, i detyron prindërit romë të heqin fëmijët e tyre nga shkolla dhe t’i përdorin si krah pune për të ndihmuar familjen. Kështu nga 15 nëna të intervistuar vetëm 10 prej tyre janë të papuna, ndërsa, ndërsa nga 20 baballarë 11 prej tyre janë të papunë. Ajo që ra në sy ishte niveli mjaft i ulët arsimor i nënave rome. Përpos problemeve ekonomike në arsimimin e fëmijëve romë vërejmë edhe pengesa që lidhen ngushtë me aspektin kulturor që i karakterizon. Këtu mund të përmendim martesat në moshë të hershme apo mentalitetin e prindërve romë lidhur me shkollën. Në përgjithësi prindërit romë romë e shohin shkollën si një gjë të rëndësishme. Ndonëse nga intervistat e marra pothuajse 100% e familjeve rome dëshironin që fëmijët e tyre të mbaronin të paktën arsimin fillor, vetëm pak prej tyre e konsiderojnë arsimin e fëmijëve të domosdoshëm. Të njëjtat fakte mund t’i shohim nëse i referohemi edhe Fondacionit të Sekretariatit të Përfshirjes së Romëve, 2013. Edhe kur fëmijët romë e nisin shkollën me kalimin e viteve ata ndikohen nga prindërit e tyre dhe e braktisin atë. Kështu vajzat po edhe meshkujt, sipas traditës apo kulturës rome i martojnë shumë të vegjël. Nëse do t’i përmbledhnim në disa pika kryesore pengesat kryesore kulturore institucionale dhe infrastrukturore, që pengojnë arsimimin sipas nevojave dhe kapaciteteve të fëmijëve romë do të bënim këtë renditje: pengesa si rrjedhojë e kushteve të vështira ekonomike dhe pengesa si rrjedhojë e kulturës dhe traditës rome dhe pengesa si rrjedhojë e moskordimit si duhet të detyrave të institucioneve përgjegjëse, për arsimimin e romëve. Të trija këto pengesa të gërshetuara prodhojnë: prindër analfabetë, vlerësim të ulët për veten dhe aftësitë që kanë, mungesë modelesh suksesi, përjashtim social, etj

5.3 Objektivi 3: Evidentimi i nevojave të fëmijëve të komunitetit rom për shërbime arsimore.

Arsimimi i fëmijëve romë sipas kapaciteteve dhe nevojave që ata kanë, mbetet një nga sfidat më të mëdha të sistemit tonë arsimor. Mungesa e aksesit në arsim për fëmijët e komunitetit rom, niveli i ulët i arsimimit dhe kualifikimit profesional të këtij komuniteti, niveli i ulët i regjistrimeve në shkollë, niveli i lartë i braktisjes shkollore etj, janë prezente në shumë raporte studimore, punime shkencore të autorëve të ndryshëm etj, ku ato janë trajtuar gjërë e gjatë. Ajo çka nuk trajtohet është niveli i të nxënit i fëmijëve romë, apo objektivat për sa i përket arsimimit të tyre. Arsimimi i romëve është trajtuar kryesisht si mosbraktisje e shkollës apo mësim shkrimi e këndimi. Kështu

e mendojnë jo vetëm prindërit romë por edhe mësues, nxënës e më gjerë. Vlen të nënvizohet se qoftë mosbraktisja, qoftë mësimi i shkrimit apo leximit kanë të bëjnë vetëm me sistemin formal të edukimit, i cili i jep përparësi përfitimit të dijeve duke lënë pas dore llojet e tjera të të mësuarit. Pjesëmarrja në nivele sa më të kënaqshme në shkollë nuk është gjithmonë garanci për nxënës të suksesshëm. Fëmijët e këtij komuniteti ashtu si të gjithë fëmijët e tjerë kanë dëshira, nevoja dhe kapacitete. Deri tani që të trija janë parë si tre gjëra të paharmonizuara. Ndërhyrjet për harmonizimin e tyre janë fragmentare, gjë që evidentohet tek mungesa e aftësive jetësore bazë, që i karakterizon këto fëmijë. Shkolla ka si detyrë të sajën kryesore mundësimin e integritetit të individit në shoqëri me potencialin që ai mbart, që mund të jetë i ndryshëm por edhe mjaft i vlefshëm për komunitetin lokal apo global ku ai bën pjesë. Ata që kanë lidhje të drejtpërdrejta me nxënësit janë mësuesit, të cilët konsiderohen si përgjegjës kryesorë të arritjeve ose jo të nxënësve të tyre. Këtë perceptim e vërejmë nga intervistat e bëra me prindër, liderë informale romë, nxënës romë etj. Sipas tyre fëmijët e komunitetit rom kanë nevojë për mësues më të kualifikuar. Nga intervistat e marra del se mësuesit janë neglizhentë ndaj nxënësve romë dhe komunikimi i tyre me ta lë për të dëshiruar. Komunikimi karakterizohet nga dhuna verbale, e cila është një nga format më të përhapura nga mësuesi tek nxënësi, por edhe dhuna fizike kundrejt nxënësve romë konsiderohet jo rrallëherë nga mësuesit si një formë për të edukuar fëmijët dhe për mbarëvajtjen e klasës. Ata besojnë shpesh është i nevojshëm dhe efikas në trajtimin e nxënësve romë. Në përgjithësi mësuesit nuk arrijnë të vlerësojnë si duhet interesa apo dëshira të ndryshme, që mund të shfaqin nxënësit romë gjatë mëimit, pasi edhe të këndosh bukur, të kërcesh bukur etj, nuk janë gjëra që duhet të anashkalohen, të mosvlerësohen. Mësuesit e intervistuar në përgjithësi edhe në biseda të lira që zhvilluam me to, vlerësonin maksimalisht nxënësit që ishin shumë mirë në lëndët matematikë dhe gjuhë dhe nuk i konsideronin pothuajse fare, nxënësit e tjerë që mund të shkëlqenin në lëndë si edukimi muzikor, edukimi fizik apo edukimi figurativ, lëndë tek të cilat nxënësit rom shfaqin mjaft interes. Ata me zë të ulët e pranojnë punën jo të mirë të tyre për nxënësit e pasuksesshëm, që janë kontigjent abandonimi e me zë të lartë ua kalojnë këtë përgjegjësi të tjerëve. Bazuar në intervistat e marra nga 14 mësues 9 prej tyre akuzojnë fëmijët për rezultate të dobëta duke i etiketuar si të pazotë dhe 10, prej tyre e shohin përgjegjësinë diku tjetër, kryesisht tek prindërit duke i etiketuar neglizhentë. Mësuesit në të shumtën e rasteve nuk tregohen mbështetës apo inkurajues për fëmijët romë, kryesisht në të nxënët sipas nevojave dhe dëshirave që ata kanë. Me pak fjalë nxënësit romë kanë nevojë për

mësues më të kualifikuar. Vetë mësuesit pohojnë se Ministria e Arsimit dhe Shkencës por edhe Drejtoritë Arsimore Rajonale, nuk kanë marrë masa për informimin e tyre rreth kulturës dhe traditave romë si dhe trajnimin e tyre, në lidhje me mënyrën e trajtimit të nxënësve të komunitetit rom në veçanti.

Intervistat e zhvilluara me prindër romë por edhe me mësues nënvizojnë edhe nevoja të tjera të nxënësve të komunitetit rom si p.sh nevojën mjete shkollore dhe për kushte më të mira në shkollë. Sipas të dhënave cilësore, shumë familje romë nuk mund të përballojnë koston e blerjes mjeteve shkollore por edhe të rrobave të përshtatshme për çdo stinë, për fëmijët e tyre, ndryshe nga shumica e familjeve joromë, të cilat i veshin fëmijët e tyre me rrobat e duhura pavarësisht kushteve në shkollë, si mungesa e ngrohjes në dimër etj.

Nxënësit romë nga ana e tyre shprehen se shkolla nuk i tërheq dhe aq shumë. Nga 16 nxënës 11 prej tyre listuan të njëjtat arsye:

- nuk kanë shokë në klasë
- mësuesja sillet ashpër dhe i vë gjithmonë në bangat e fundit
- mësuesja nuk merret me to
- nuk kuptojnë mirë gjuhën
- mësimet janë shumë të vështira
- nuk i ndihmon njeri për detyrat
- nuk i angazhojnë në aktivitete shkollore
- ora e mësimi është shumë e mërzitshme

Përgjatë analizës së të dhënave cilësore të studimit del në pah edhe një nevojë tjetër e fëmijëve romë për një tjetër shërbim arsimor. Bëhet fjalë për mungesën e teksteve shkollore, në të cilat ilustruhet historia dhe kultura e komunitetit rom. Fëmijët romë i kuptojnë shumë mirë traditat e minoritetit të tyre, por kur shkojnë në shkollë duhet të mësojnë gjithçka nga librat e shkruar dhe të ilustruar, ku flitet rreth kulturës dhe traditave maxhoritare dhe në asnjë rast të vetëm nuk gjejnë qoftë edhe një element të kulturës apo traditës së tyre. Respektimi i traditës dhe kulturës është një faktor i rëndësishëm, që fëmijët romë e mësojnë vetëm në komunitetet ku ata jetojnë dhe jo në shkollë. Kurikula duke mos përfshirë diferencat kulturore që ata përfaqësojnë, kthehet në pengesë për fëmijët e komunitetit rom për të pasur akses normal në ciklin e arsimit të

detyruar. Gjatë intervistave u vu re edhe një nevojë tjetër që del për të siguruar një arsim cilësor të nxënësve romë. Nevoja që shkolla disa përgjegjësi ligjore përkundrejt tyre, t'i konsiderojë si nevoja të domosdoshme. Këtu është rasti për të përmendur mungesën e marrëdhënieve të fëmijëve apo prindërve romë me psikologët në shkolla. Në intervistat e bëra pothuajse të gjithë prindërit por edhe nxënësit romë, pohuan se nuk kontaktonin pothuajse fare me psikologët shkollorë, madje një pjesë e tyre nuk kish dëgjuar asnjëherë për ta. Ndërsa përsa i përket nevojës së përfshirjes së fëmijëve romë në aktivitete shkollore dhe jashtëshkollore, përfaqësuesit e drejtorive arsimore si dhe mësuesit apo drejtorët e shkollave, shprehen se ata kanë shumë dëshirë të përfshihen në këto aktivitete, madje janë aktivë, por ata pranojnë mungesën e këtyre aktiviteteve. Aktivitetet jashtëshkollore janë shumë të limituara. Ata konsistojnë kryesisht në Ditën e Romëve, 8 prill, në festën e 7-8 Marsit dhe në atë të Vitit të Ri. Shkollat nuk ofrojnë kurse verore dhe nuk rezultojnë të ketë më as shkolla verore. Edhe pse drejtoritë arsimore e kanë prioritet përfshirjen e fëmijëve romë në këto aktivitete, ato janë shumë të të varfra si në numër, ashtu edhe në program.

5.4 Objektivi 4: Roli dhe rëndësia e politikave arsimore dhe sociale, në ndihmë të arsimimit bazë cilësor të fëmijëve të komunitetit rom

Sistemi arsimor në Shqipëri shërben si sektor shërbimi, i cili synon drejt arsimit gjithëpërfshirës. Arsimi gjithëpërfshirës në kuptim të gjërë, nënkupton procesin e rritjes së pjesëmarrjes dhe uljes së përjashtimit, kupjesëmarrja nënkupton njohje pranimit, respekt dhe përfshirje në procesin e të nxënësve dhe në veprimtaritë sociale në mënyrë të tillë që t'i sigurojë individit zhvillimin e ndjesisë, që është pjesë e kësaj shoqërie. Megjithatë kjo jo gjithmonë është e mundur, pasi shpeshherë varfëria vazhdon të mbetet faktor negativ për ndjekjen e shkollës së detyruar, e cila konsiderohet si aktori kryesor në përmbushjen e asaj çka thamë më lart. Në teori flitet vazhdimisht për vizionin e ri arsimor në Shqipëri, i cili ndryshe nga ai tradicional, që e detyronte nxënësin t'i përshtatej atij mekanikisht, ka në qendër nxënësin me nevojat dhe interesat e tij. Një aktor i vetëm në vënien në jetë të këtij vizioni nuk është i mjaftueshëm. Misioni për realizimin e arsimit gjithëpërfshirës kërkon bashkëpunim të një sërë aktorësh. Kështu në rang lokal koordinimi midis aktorëve lokalë si: pushteti lokal, DAR (Drejtori Arsimor Rajonale), shkollë, komunitet, shoqëri civile, është më se i nevojshëm dhe i domosdoshëm. Për këto arsye, objektivi i arsimit gjithëpërfshirës do të mund të arrihet vetëm në saj të harmonizimit të politikave arsimore,

programeve specifike arsimore me politikat sociale. Nëse do t'i referoheshim realitetit, do të vërejm se probleme të ndryshme emergjente, mund t'i bëjnë autoritetet lokale që sapo i përmendëm, të pavëmendshme ndaj arsimimit sidomos ndaj arsimimit të grupeve vulnerabël, siç janë në rastin tonë, fëmijët e komunitetit Rom. Një nga problemet primare në lidhje me politikat që institucionet arsimore si drejtoritë arsimore rajonale por edhe institucionet e tjera si bashkitë apo njësitë vendore, duhet të ndërmarrin duke kooperuar me njëra tjetrën, është evidentimi dhe sensibilizimi i fëmijëve të komunitetit Rom, për të vazhduar shkollën. Ajo që vihet re është se nuk ka një strategji të saktë në lidhje me këtë fenomen. Rreth të ndryshme veprojnë në mënyra të ndryshme, por kryesisht mbështeten në ndihmën e organizatave të huaja, si: UNICEF, PNUD, Save the Children, NFP, si dhe nga vetë shoqatat e komunitetit rom. Drejtoritë arsimore nuk kanë një plan të cilin e ndjekin çdo vit. Kjo edhe për mungesë kapacitetesh njerëzore në strukturat e tyre. Drejtoritë arsimore pranojnë se ato vetë luajnë rolin e ndihmës në këtë proces dhe jo të protagonistit, sepse politikat që ndjekin, nuk e qartësojnë këtë pikë shumë të rëndësishme të strategjisë për arsimimin e romëve.

Nga intervistat e bëra përfaqësuesit e DAR në rrethet, pothuajse në të gjitha zonat në fokus të studimit tonë, ngrejnë problemin e regjistrimit të fëmijëve romë në gjendjen civile. Shumë fëmijë romë nuk janë të regjistruar në gjendjen civile nga prindërit e tyre dhe kjo jo vetëm vështirëson punën e DAR-le, për evidentimin e tyre, por bëhet një pengesë shumë e madhe kur afrohet koha e shkollës, pasi këta fëmijë nuk ekzistojnë as për pushtetin lokal dhe as për drejtoritë arsimore. Prandaj vetë përfaqësuesit e arsimit kërkojnë mbështetje dhe ndihmë nga pushteti lokal, me qëllim që ky i fundit të marrë masa dhe t'i regjistrojë pa asnjë lloj tarife.

Nga intervistat e bëra u vu re se duke qenë i vështirë financimi i politikave sociale nëpërmjet buxhetit të shtetit është marrë në konsideratë rruga e bashkëfinancimit si p.sh projekte të përbashkëta me OJF në funksion të arsimimit të fëmijëve romë. Megjithatë kjo nuk është e mjaftueshme, pasi dështimet në arsimimin e këtyre fëmijëve flasin vetë. Po t'i thuash prindit rom po të jap rroba për të shitur, me kusht që të dërgosh fëmijën në shkollë, pa e ndërgjegjësuar sa duhet për dobitë e mëdha që sjell arsimimi, për pritshmëritë që ato duhet të kenë për fëmijët e tyre nëse arsimohen si duhet, pothuajse të gjitha përpjekjet të shkojnë kot. Nga ana tjetër ajo që vihet re është në kriteret specifike, që njësitë vendore aplikojnë për përfitimin e ndihmës

ekonomike, nuk përbëjnë kriter më vete familjet, fëmijët e të cilave vazhdojnë arsimin e detyrueshëm shkollor.

Ajo që është shumë e rëndësishme është fakti se sfidat e drejtorive arsimore por jo vetëm, edhe të institucioneve të tjera lokale apo qendrore, përgjegjëse për realizimin e strategjisë për arsimin e romëve, nuk janë shumë të qarta për to. Nga intervistat e bëra me specialistë apo dhe drejtues të këtyre institucioneve, vihen re dy gjëra të cilat i kemi përmendur edhe herë të tjera:

- Mungesë objektivash të qarta lidhur me arsimimin cilësor të fëmijëve të komunitetit Rom
- Pamundësi për të monitoruar nivelin e tyre të të nxënës

Pikërisht kjo situatë sjell edhe mungesë të përpjekjeve serioze për të marrë masa më rezultative për arsimimin cilësor të romëve siç mund të ishte edhe futja në shkolla e gjuhës romani për fëmijët e komunitetit Rom. Në pothuajse të gjitha studimet e bëra në këtë drejtim theksohet vështirësia gjuhësore që hasin fëmijët romë në shkolla, gjë që bën që shumë prej tyre që kanë vështirësi, sepse mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe, të braktisin shkollën. Mësuesit ndihmës apo moderatorët do të ishin një ndihmesë e madhe në këtë drejtim, pasi ato do të ishin jo vetëm mbështetje për nxënësit romë por do t'i ndihmonin shumë ata edhe në kuptimin e gjuhës. Po le ta nsim problemin qysh në zanafillë. Ky problem duhet parë qysh tek hartimi dhe zhvillimi i politikave nga qeveria Shqiptare, e cilaka treguar interes në implementimin e tyre, për kalimin e pengesave që hasin romët gjatë arsimimit të tyre por hapat që janë marrë janë minimalë. Nëse i referohemi objektivave të realizuara lidhur me edukimin e fëmijëve romë, pjesa më e madhe studimeve të bëra, ka të bëjë me identifikimin e nevojave sipas fushave prioritare. Ky identifikim është i natyrës cilësore, pothuajse në të gjitha rastet mungojnë të dhënat sasiore. Nëse do të jemi më konkretë mund të japim edhe shembuj: psh është i identifikuar problemi i braktisjes së shkollës nga fëmijët romë si dhe pasojat që sjell ky fenomen, por mungojnë shifrat konkrete për fëmijët romë në përgjithësi apo të ndarë sipas kategorive, vajza-djem apo sa fëmijëve romë braktisin shkollën në një vit e kështu me rradhë. Është e rëndësishme të theksohet se identifikimi i nevojave me natyrë cilësore për minoritetin rom është një proces tashmë i përsëritur ndër vite, si nga struktura zyrtare ashtu dhe nga organizata vendase dhe të huaja. Nisur nga ky fakt përsëritja e mëtejshme e tyre është tregues i rëndësishëm i nivelit të ulët të zbatimit të strategjisë për zhvillimin e komunitetit Rom. Liderët informalë romë janë pesimistë rreth punës që Ministria por edhe pushteti vendor, ka bërë jo vetëm përsa i përket takimeve që janë organizuar por edhe

marrjes së masave konkrete për të kaluar barrierat që romët hasin në edukim. Ata konfirmojnë se aktorët e larpërmendur nuk e kanë marrë plotësisht përsipër rolin e tyre në këtë veprimtari. Me shumë janë angazhuar organizatat, ku bëjnë pjesë ato rome, të cilat kanë ndërtuar programe në ndihmë të minoritetit Rom. Mësuesit në përgjithësi konfirmojnë se dhe pse në shkollat ku ata punojnë ka numër të madh të nxënësve rom, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Drejtoritë Arsimore Rajonale nuk kanë marrë masa për informimin e mësuesve të shkollave rreth strategjisë. Informacioni i vetëm që mësuesit kanë rreth strategjisë është marrë nga interneti ose nga broshurat që na i kanë ofruar organizatat rome dhe jo-rome. Përsa i përket hapave të ndërmara nga Ministria e Arsimit (sidomos në lidhje me trajnimin e tyre rreth kultursë dhe traditave rome) asnjë e tillë nuk është ndërmarrë në shkollat 9-vjeçare të përfshira në studim. Disa nga organizatat që punojnë në fushën e strategjisë dhe arsimimit të romëve janë: UNICEF, Save the Children, Korporacioni Zvicerian etj. Ka dhe organizata të tjera por që punojnë në nivel lokal. Shoqatat kombëtare rome bashkëpunojnë me shoqata të tjera lokale rome në të gjithë Shqipërinë. Ministria e Arsimit dhe Shkencës në bashkëpunim me to, është munduar të reduktojë deri diku pengesat që nxënësit romë hasin në edukim, duke ofruar libra dhe materiale shkollore falas, kurse analfabetizmi, shkolla verore, kopshte etj. Duke qenë se strategjia nuk funksionon më, duhet theksuar se problemet më të mëdha në lidhje me hapat që duheshin ndërmarrë për kalimin e pengesave që romët hasin në edukim lidhet drejtpërdrejt me buxhetimin e tyre. Përderisa qeveria Shqiptare nuk kishte planifikuar një buxhet specifik për strategjinë, vështirësitë në implementimin e saj që në fillim ishin shumë të mëdha (nuk mund të përmbushen hapat e planifikuar vetëm me ndihmën e organizatave ndërkombëtare). Tashmë Plani i ri i Veprimit: “Përfshirja sociale e minoriteteve rome dhe egjiptiane 20015-2020”, është draftuar nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe në vazhdim do t’i prezantohet aktorëve kryesorë. Ky do të jetë një plan e integruar ku një vend të rëndësishëm zë edukimi i fëmijëve romë dhe buxheti mendohej të jetë pjesë përbërëse e çdo hapi i cili do të ndërmerret.

5.5 Objektivi 5: Si paraqitet harmonizimi i politikave arsimore dhe sociale në Shqipëri

Nga gjithë sa u tha edhe më sipër harmonizimi i politikave sociale me ato arsimore, si kusht i domosdoshëm për arsimimin cilësor të fëmijëve në nevojë, në rastin tonë të fëmijëve të komunitetit rom, kërkon koordinimin e punës të një sërë aktorësh si:

- Pushteti lokal
- Drejtori Arsimore Rajonale
- Shkollë
- Shoqëri civile
- Komunitet

Ajo që kemi konstatuar përgjatë gjithë studimit tonë (e kemi përmendur edhe herë të tjera), është fakti se në hartimin e politikave sociale politikbërësit janë përqëndruar vetëm në problemin e varfërisë dhe nuk kanë patur aspak vizion më të gjërë, për të lidhur politikat afatshkurtëra me fokusime në probleme më të gjëra dhe me realizimin e zgjidhjeve afatgjata.

Ky harmonizim është i lidhur ngushtë me mënyrën se si funksionon sektori i shërbimeve sociale në njësitë vendore, të cilat kanë hapesirat e nevojshme ligjore për të mbështetur familjet e varfra me burime nga buxhetet e taksave lokale, duke caktuar kriteret specifike.

Shkolla gjithashtu si një nga aktorët kryesorë në harmonizimin e politikave sociale me ato arsimore, ka në dorë detyrën që nëpërmjet personave të kontaktit (në shumë raste psikologu ose mësuesi i rekomanduar nga drejtorja), të referojnë rastet e fëmijëve me probleme social – ekonomike të mprehta pranë Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve në Bashki. Këto të fundit hartojnë një plan veprimi për menaxhimin e rasteve në mënyrë që të ndihmohet familja dhe fëmija të mos braktisë shkollën. Po sipas ligjit shkolla ka për detyrë që të njoftojë prindërit mbi mungesat paarsye të fëmijëve ose mungesat e dyshimta. Në këtë aspekt vihet re se lidhja e shkollës me familjen nuk është e kënaqeshme dhe për më tepër rastet e braktisjes së shkollës gjithmonë justifikohen si largime të familjes së fëmijës në një vend tjetër, duke e bërë fenomenin e braktisjes të pa matshëm në mënyrë reale. Ndërsa për sa i përket aktorëve të tjerë si shoqëria civile apo komuniteti edhe ato janë konsideruar si aktorë mjaft të rëndësishëm, në sfidën për arsimimin sipas nevojave dhe kapaciteteve të fëmijëve romë. Kështu në të gjitha zonat e marra

në studim, veprojnë OJF-të, që kanë në fokus fëmijët. Shërbimet që ofrojnë ato variojnë nga ofrimet e kujdestarisë pranë qendrave rezidenciale, shërbim ditor pranë qendrave ditore, suport në mjete didaktike apo tekste shkollore për fëmijët e familjeve në nevojë, ndihma ushqimore, ushqim falas në shkollë deri në mikrokredi për gjenerim të ardhurash. Ndërsa përsa i përket komunitetit mund të themi se një komunitet i ndërgjegjësuar për rëndësinë e arsimit të fëmijëve të tij, natyrisht që do të kthehet në një faktor pozitiv në këtë drejtim. Në këtë kontekst sensibilizimi i komuniteteve të marzhinalizuara, sikurse është komuniteti rom, është detyrë dhe përgjegjësi e aktorëve që përmendëm pak më lart: pushteti lokal, shkollë, shoqëri civile. Koordinimi mes të cilëve do të ishte dhe një harmonizim perfekt i politikave arsimore me ato sociale. Nga intervistat e bëra me të gjithë aktorët e lartpërmendur, mund të themi se akoma nuk mund të flitet deri tani për harmonizimin të mirfilltë të politikave sociale me politikat arsimore, pasi ajo çka vihet re nga të gjithë aktorët është mungesa e objektivave të qarta përsa i përket çështjes së arsimit cilësor të fëmijëve të komunitetit Rom dhe mënyrës se si duhet punuar me ta. Së pari mosfunksionimi i ligjit të arsimit parauniversitar përbën një problem mjaft të rëndësishëm, të cilin drejtuesit e arsimit e shikojnë si të pamundur sidomos funksionimin e pjesës së përgjegjësisë prindërore, ndërsa vetë prindërit as që e njohin fare. Vihet re gjithashtu edhe dështimi i politikave të ndërrmara nga shteti dhe organizatat e ndryshme ndërkombëtare për zhdukjen e analfabetizmit. Kështu “Shansi i Dytë”, një mundësi e cila duhet t’u ofrohet romëve në mbarë vendin për t’u bërë të mundur romëve, që nuk dijnë të shkruajnë dhe të lexojnë t’u jepet një mundësi për të eliminuar këtë mangësi në jetën e tyre, pothuajse nuk funksionon më. Pushtetet vendore nga ana tjetër nuk ndjekin asnjë politikë mbështetëse financiare për prindërit romë që kanë fëmijët në shkollë, si dhe nuk promovon pothuajse fare modele të suksesshme të romëve në zonat ku ata jetojnë. Komuniteti rom ka dëshira, nevoja dhe kapacitete por deri tani ato janë parë si tre gjëra të paharmonizuara. Ndërhyrjet për harmonizimin e tyre janë fragmentare, secili nga aktorët e sipërpërmendur bën pjesën e tij dhe mjaftohet me kaq. Këtë e dëshmojnë edhe të dhënat kontraktore që secili institucion ofron p.sh në lidhje me numurin e fëmijëve romë që ndjekin shkollën. Duke u mbështetur në të dhënat e nxjerra, do të përpiqemi të paraqesim një përmbledhje (sipas mendimit tonë), të anëve të forta dhe të dobëta të këtij harmonizimi, të cilën do ta pasqyrojmë në kapitullin në vijim.

KAPITULLI VI

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Kapitulli i VI prezanton një përmbledhje të studimit dhe parashtron përfundime të detajuara mbi të gjitha çështjet e marra në studim dhe rekomandimet përkatëse për të ardhmen lidhur me arsimimin cilësor të fëmijëve të komunitetit rom. Për të nxjerrë përfundimet, studimi ka kaluar një proces të gjatë analize dhe vlerësimi të fakteve.

Kështu për të parë se a synon shkolla jonë drejt edukimit gjithpërfshirës, i cili duhet të jetë gjithmonë në funksion të formimit të individit, dhe aftësimi të tij me shprehje praktike themelore bazë, për jetën, u munduam të analizojmë si fillim kuadrin ligjor shqiptar për arsimimin e pakicave etnike në Shqipëri. Analiza pati si qëllim shqyrtimin e kuadrit ligjor shqiptar për arsimimin e pakicave etnike dhe gjykimin mbi masat konkrete që duhet të ndërmerren në praktikë, për të sensibilizuar dhe për të tërhequr vëmendjen e të gjithë aktorëve dhe specialistëve të arsimit dhe jo vetëm, që ta njohin dhe ta kuptojnë si duhet rëndësinë e ligjit për arsimin parauniversitar të minoriteteve, si dhe nënvizimin e domosdoshmërisë, që të gjenerohen politika mbështetëse dhe të merren masa konkrete, për ta bërë ligjin sa më shumë të njohur dhe zbatueshëm në shkallë vendi. Analiza e detajuar e kuadrit ligjor na solli në përfundimin se:

Kuadri ligjor në Shqipëri, për arsimimin e pakicave etnike, në aspektin teknik është i plotë dhe inkorporon direktivat e BE dhe parime të Konventës antidiskriminim. Shqipëria si shtet i së drejtës sanksionon të drejtën për arsim që në Kushtetutë, për të vazhduar me pas me ligjet konkrete. Problematikat qëndrojnë tek faza post miratim e ligjit, faze e cila lidhet direkt me politikat ekzekutive të shtetit, të cilat duhet të përfshijnë të gjithë institucionet përgjegjëse.

Mbështetur në këto problematika kemi arritur në rekomandimet e mëposhtme:

- Duhet të hartohen strategji afatmesme dhe afatgjata ku jo vetëm të implementohen parimet kryesore ndërkombëtare, por edhe të përshtaten me kushtet dhe nevojat specifike dhe konkrete të vendit tonë.
- Ministrite e linjës, në kuadër të fondeve IPA, duhet të ndërmarrin projekte dhe të kërkojnë ndihmën e mbështetjen e të huajve.

- Politikat ekzekutive për zbatimin e legjislacionit duhet të bëhen më konkrete, të intensifikohen dhe të diferencohen, të përfshihen grupet e interesit dhe institucionet përgjegjëse
- Institucionet përgjegjëse duhet ta kanalizojnë veprimtarinë e të ndërmarrin masa konkrete për arsimimin e pakicave etnike
- Për pakicat etnike, bazuar në kontekstin socio-kulturor nga ata vijnë, duhet një trajtim i diferencuar për aplikimin e parimit të barazisë në fushën e arsimit.
- Duhet vënë në dispozicion nga ana e shtetit burime njerëzore, financiare dhe institucionale për realizimin e strategjisë për pakicat etnike në fushën e arsimit
- Duhet të stabilizohen mekanizma të monitorimit dhe vlerësimit, të zbatimit të strategjisë kombëtare për pakicat romë në vendin tonë.

Për sa i përket pengesave kulturore, institucionale dhe infrastrukturore që pengojnë arsimimin sipas nevojave të fëmijëve romë këtu mund të rradhisim të parën:

Situatën e vështirë socio-ekonomike të këtij komuniteti. Kjo situatë nënkupton nivel të ulët ekonomik i cili është një nga faktorët kryesorë për mosfrekuentimin e arsimit nga ana e fëmijëve romë, ose të braktisjes së shkollës. Kushtet e jetësës së familjeve romë i detyrojnë prindërit t'i largojnë fëmijët nga shkolla, pasi nuk arrijnë t'u plotësojnë kushtet minimale të jetesës fëmijëve të tyre si ushqim, veshmbathje etj. Ky nivel i ulët ekonomik është i lidhur ngushtë me:

- Prindër analfabetë
- Vlerësim të ulët për veten dhe aftësitë që çdo individ mund të ketë
- Fokusim vetëm tek punët artizanale apo tregëtia
- Mungesa e modeleve të suksesit, etj

Të gjitha këto bëhen burim i një morie problemesh, të cilat na ndihmuan për të nxjerrë përfundimet e mëposhtme:

- Prindërit romë janë pak të interesuar për arsimimin e fëmijëve të tyre. Ata nuk i kushtojnë rëndësinë e duhur arsimit të fëmijëve të tyre, duke mos ndier asnjë përgjegjësi për sa i përket ushtrimit të përgjegjësisë prindërore
- Po t'i referohemi studimeve të ndryshme, nënat e arsimuara konsiderohen si matës i përafërt (proxi), për statusin ekonomikocial të familjes. Sikurse edhe Glasgow et

al.(1997) e kanë shpjeguar, “ fëmijët me nëna të pashkolluara kanë më tepër tendencë të jenë të varfër.” (fq 508). Kështu të dhënat cilsore nxorrën si përfundim se sa më të pashkolluara ishin nënat, aq më pak aftësi për jetënkishin fëmijët e tyre.

- Mosregjistrimi i fëmijëve romë në gjendjen civile, që në momentin e lindjes së tyre përbën një problem të madh për identifikimin e tyre nga ana e institucioneve arsimore.
- Fëmijët romë karakterizohen nga përqendrim i ulët gjatë mësimi, kjo si pasojë e kequshqyerjes. Bën në sy fakti se edhe kur familjet romë e kanë mundësinë ekonomike, nuk kanë njohuritë e duhura për të ushqyer shëndetshëm fëmijët e tyre. Nënat romë kanë mungesë aftësish dhe njohurish për sa i përket gatimit për fëmijët e tyre.
- Fëmijët romë e braktisin arsimin e detyruar në mjaft raste edhe nga mungesa e rrobave të përshtatshme sipas stinëve.
- Shkak i braktisjes së shkollës bëhen edhe punë të ndryshme, që bëjnë fëmijët romë për të ndihmuar prindërit në aktivitete të ndryshme kryesisht tregëtare që ata ushtrojnë.
- Profesionet e trashëguara dhe jo të mësuara në shkolla si punët artizanale apo tregtia e rrobave të përdorura, bën që prindërit të përfshijnë në to fëmijët e tyre që në moshë të vogël, duke anashkaluar totalisht nevojën për shkollë.
- Braktisja e shkollës nga fëmijët romë ka dhe një tjetër shkak. Bëhet fjalë për përfshirjen në punë të rrezikshme të fëmijëve romë, si p.sh lypja në rrugë ku në disa raste i organizuar nga vetë prindërit romë, ose nga fëmijët më të mëdhenj të këtij komuniteti.
- Një shkak tjetër burim i braktisjes shkollore që lidhet ngushtë me situatën e vështirë ekonomike të familjeve romë është edhe migrimi dhe emigrimi. Kështu migrimi i familjeve romë brenda vendit në periudha të ndryshme të vitit bën që fëmijët të shkëputen nga shkolla. Vështirësitë ekonomike i detyrojnë prindërit romë të lëvizin brenda vendit, kryesisht në zonat urbane për të siguruar jetesën, duke marrë me vete dhe fëmijët të cilët nuk regjistrohen në shkollat e vendeve ku ata shkojnë. Kjo bën të pamundur dhe ndjekjen e tyre nga institucionet arsimore ku ata figurojnë të regjistruar. Emigrimi gjithashtu ka bërë që fëmijët romë jo vetëm të mos ndjekin arsimin në vendet ku kanë emigruar, por edhe kur të kthehen në atdhe, të mos regjistrohen më nëpër shkolla, pasi procedurat e regjistrimit rezultojnë të kushtueshme dhe të ndërlikuara për prindërit e tyre. Përballë pengesave të tilla, prindërit preferojnë të mos i dërgojnë fare apo t'i rikthejnë në shkolla fëmijët e tyre.

- Komuniteti Rom në përgjithësi është paragjykses dhe nuk është mbështetje për fëmijët dhe prindërit e fëmijëve që frekuentojnë shkollën. Kjo kryesisht pas klasës së pestë të arsimit 9-vjeçar. Pjesë e paragjyksimeve dhe mendësive të këtij komuniteti janë edhe martesat në moshë të hershme një nga shkaqet kryesore të braktisjes së shkollës në moshë të hershme. Ky fenomen është më i theksuar te vajzat të cilat në moshën 11-12-vjeçare martohen madje edhe kundër dëshirës së tyre nga familjet, të cilat i detyrojnë të shkëputin marrëdhëniet e tyre me shkollën. Ky fenomen vihet re dhe te djemtë romë por tek vajzat është dhe më i theksuar.
- Diskriminimi në shkolla nga ana e mësuesve por jo vetëm, është një tjetër shkak i braktisjes shkollore, pasi fëmijët romë e kanë mjaft të vështirë të socializohen me pjesën tjetër të klasës pasi nuk mbështeten nga mësuesit. Këta të fundit mund të mos diskriminojnë me fjalë por me veprime, duke i veçuar nga pjesa tjetër e klasës në vendosjen e tyre në bankat e fundit, apo duke mos i përfshirë në procesin e mësimin, duke mos i inkurajuar në aftësitë që kanë etj.
- Mbështetja ekonomike për prindërit romë të cilët kanë fëmijët në shkollë, është inegzistente pasi pushtetet vendore nuk ndjekin politika financiare mbështetëse për prindërit romë, të cilët kanë fëmijë në shkollë.
- Në përgjithsi prindërit romë, nuk përpiqen t'u mësojnë fëmijëve të tyre disa aftësi bazë, mjaft të domosdoshme për jetën e tyre të përditshme, si p.sh si të vishen, si të ushqehen, si të mbajnë higjienën vetjake, si të komunikojnë me të tjerët etj. Duke qenë vetë të pashkolluar ata nuk janë në gjendje t'u mësojnë apo t'u ofrojnë modele fëmijëve të tyre.
- Po t'i referohemi studimeve të ndryshme, nënat e arsimuara konsiderohen si matës i përafërt (proxi), për statusin ekonomikocial të familjes. Sikurse edhe Glasgow et al.(1997) e kanë shpjeguar, “ fëmijët me nëna të pashkolluara kanë më tepër tendencë të jenë të varfër.”(fq 508). Kështu të dhënat cilsore nxorren si përfundim se sa më të pashkolluara ishin nënat, aq më pak aftësi kishin fëmijët e tyre.
- Romëve u mungojnë modelevë suksesi. Duke mos pasur model suksesi për t'u marrë si shembull, prindërit romë nuk kanë shpresa se shkolla mund të ndryshojë jetën e fëmijëve të tyre.

Për sa i përket nevojave të komunitetit rom për shërbime arsimore, të dhënat cilësore na ndihmuan për të nxjerrë përfundimet e mëposhtme:

- Ndërgjegjësimi dhe sensibilizimi i komunitetit Rom, i prindërve romë që kanë fëmijë në moshë shkollore, nga ana e institucioneve arsimore nuk është i mjaftueshëm.
- Problemi i arsimimit cilësor të romëve, reduktohet në mosbraktisje shkollore. Institucionet arsimore kanë si objektiv primar reduktimin e braktisjes së shkollës nga fëmijët romë. Nëse realizohet kjo atëherë për ta çështja e arsimimit të romëve është e ezaurua
- Drejtoritë Arsimore Rajonale, drejtoritë e shkollave por edhe vetë mësuesit nuk kanë objektiva të qarta lidhur me arsimimin cilësor apo monitorimin e të nxëniet të fëmijëve romë.
- Nxënësit romë kanë nevojë për mësues më të kualifikuar. Mësuesit në të shumtën e rasteve nuk tregohen mbështetës apo inkurajues për fëmijët romë, kryesisht në të nxënësit sipas nevojave dhe dëshirave që ata kanë.
- Kurrikula i bën fëmijët romë të ndjehen të pasuksesshëm. Mungojnë tekstet shkollore, në të cilat ilustrohet historia dhe kultura e komunitetit rom. Fëmijët romë i kuptojnë shumë mirë traditat e minoritetit të tyre, por kur shkojnë në shkollë duhet të mësojnë gjithçka nga librat e shkruar dhe të ilustruar, ku flitet rreth kulturës dhe traditave maxhoritare dhe në asnjë rast të vetëm nuk gjejnë qoftë edhe nje element të kulturës apo traditës së tyre. Respektimi i traditës dhe kulturës është një faktor i rëndësishëm, që fëmijët romë e mësojnë vetëm në komunitetet ku ata jetojnë dhe jo në shkollë. Kurrikula duke mos përfshirë diferencat kulturore që ata përfaqësojnë, kthehet në pengesë për fëmijët e komunitetit rom për të pasur akses normal në ciklin e arsimit të detyruar.
- Nuk ka politika të qarta dhe të mjaftueshme të ndërrmara nga shkollat për të përfshirë prindërit romë në vendimmarrjet e tyre. Prindërit romë përfshihen shumë pak në strukturat prindërore që ngrejnë shkollat, të cilat nga ana e tyre, ruajnë kontakte shumë të pakta me ta.
- Fëmijët romë në shumicën e rasteve e fillojnë shkollën me disnivel njohurish, por shpesh kanë edhe diferenca midis moshës dhe nivelit shkollor (13-14 i pashkolluar ose në klasë të parë, dytë, tretë etj). E gjitha kjo sjell vështirësi në integrimin e tyre në klasa normale.
- Fëmijët romë vuajnë nga mungesa e eksperiencave shkollore dhe eksperiencave të tjera të jetës. Ato i frekuentojnë shumë pak kopshtet, gjë që i privon nga mundësia për të nësuar

gjuhën shqipe dhe për të fituar ekperiencia jetësore, që nuk mund t’i marrin nga familjet e tyre apo nga mjedisi ku jetojnë.

- Fëmijëve romë u mungon ndihma nga prindërit. Niveli shumë i ulët arsimor i tyre është një pengesë të madhe, pasi ata as nuk i kuptojnë fëmijët e tyre dhe nuk i ndihmojnë dot në detyrat e shtëpisë.
- Mësuesit i etiketojnë fëmijët romë si problematikë, të painteresuar për mësimet dhe me mungesa aftësish dhe njohurish
- Fëmijët romë vuajnë nga diskriminimi nga ana e mësuesve, fenomen ky i cili i largon fëmijët romë nga shkolla, pasi nuk arrijnë të socializohen me pjesën tjetër të klasës dhe nuk gjejnë mbështetje nga mësuesit, të cilët edhe pse nuk i diskriminojnë me fjalë, arrijnë ta bëjnë këtë me veprime, duke i veçuar nga pjesa tjetër e klasës në vendosjen e tyre në bankat e fundit, apo duke mos i përfshirë në procesin e mësimin.
- Punësimi i një numri të pakët mësuesish romë e vështirëson komunikimin e mësuesve me nxënësit që vijnë nga ky komunitet. Mungesa e politikave të punësimit të romëve nga ana e drejtorive arsimore, bën që romët të mos nxiten për t’u arsimuar në ciklet më të larta të studimit.
- Fëmijëve romë nuk u mundësohet në shkollë mësimi i gjuhës së tyre romani, edhe pse kjo është një e drejtë e sanksionuar me ligj. Megjithatë kanë filluar përpjekjet e para në këtë drejtim. Mund të përmendim këtu si shembull mjaft pozitiv, mundësimin e mësimin të gjuhës rome, për herë të parë për vitin shkollor 2015-2016, në shkollën 9-vjeçare “Hamit Mullisi”, në Elbasan. Ky është edhe rasti i parë në të gjithë Shqipërinë. Mësimi i gjuhës romani, zhvillohet nga një studente rome, e cila e zhvillon atë mbi baza vullnetare. DAR Elbasan ka si qëllim të saj punësimin e saj menjëherë pas diplomimit.
- Funksionimi si duhet i ligjit të arsimit parauniversitar është një problem jo i vogël. Shumica e prindërve nuk e njeh fare ligjin dhe pjesën e përgjegjësisë prindërore që sanksionohet në të. Edhe kur bëhen me dije për përgjegjësinë e tyre ligjore si kujdestarë të fëmijëve të tyre, të cilët mbajnë përgjegjësi ligjore për mosfrekuentimin e shkollës nga fëmijët e tyre, ata tregohen mjaft indiferentë.
- Frekuentimi fiktiv i shkollës është një tjetër problem që bëhet pengesë në marrjen e të dhënave të sakta nga institucionet qendrore. Shumë fëmijë romë figurojnë vetëm si emra në regjistrë. Vetë drejtuesit e shkollave por edhe mësuesit, për të mos ulur numrin e

nxënësve në klasa por edhe me shpresën që ata mund të rikthehen në një periudhë tjetër të vitit, nuk njoftojnë drejtoritë arsimore por vazhdojnë të kalojnë fëmijët nga një klasë në tjetrën.

- Mungesa e psikologut apo punonjësit social është një tjetër problem. Në shumicën e shkollave, sidomos në ato periferike dhe rurale, ky shërbim nuk ofrohet fare. Ndërsa në shkollat e zonave urbane shërbimi psikosocial është fiktiv, pasi numri i lartë i fëmijëve që mbulojnë psikologët e këtyre shkollave, bën të pamundur komunikimin e tij me ta. Në këto kushte ky shërbim mbetet thjesht formal. Fëmijëve të komunitetit Rom nuk u ofrohet asnjë lloj shërbimi i tillë, aq më pak prindërve të tyre, si pjesë e procesit të arsimimit të fëmijëve të tyre.
- Mungesa e aktiviteteve jashtëshkollore apo numri i ulët i tyre është problem për pothuajse të gjitha shkollat. Edhe kur zhvillohen ato pak veprimtari, fëmijët romë rrallëherë janë protagonistë.

Vizioni i ri arsimor në Shqipëri, ndryshe nga ai tradicional, që e detyronte nxënësin t'i përshtatej atij mekanikisht, ka në qendër nxënësin me nevojat dhe interesat e tij. Këtij qëllimi i shërben edhe arsimi gjithëpërfshirës. Misioni për realizimin e arsimit gjithëpërfshirës kërkon bashkëpunim të një sërë aktorësh. Kështu në rang lokal koordinimi midis aktorëve lokalë si: pushteti lokal, DAR (Drejtori Arsimor Rajonale), shkollë, komunitet, shoqëri civile, është më se i nevojshëm dhe i domosdoshëm. Për këto arsye, objektivi i arsimit gjithëpërfshirës do të mund të arrihet vetëm në saj të harmonizimit të politikave arsimore, programeve specifike arsimore me politikat sociale. Më poshtë do paraqesim sipas mendimit tonë një përmbledheje të anëve të forta dhe anëve të dobëta të këtij harmonizimi:

Anët e forta dhe anët e dobëta të harmonizimit të politikave arsimore dhe sociale në Shqipëri

Tabela 7

Anët e forta	Anët e dobëta
Vendimarrja që ka qenë kryesisht në nivelin e pushtetit qendror, po zëvendësohet nga një prirje tjetër e fuqishme me kah te orientuar nga dekoncentrimi dhe decentralizimi i politikave sociale, në nivele më të ulëta pushteti.	Mosfunksionimi si duhet i hallkave: pushtet qendror siç janë ministritë e linjës dhe pushtetit lokal siç janë bashkitë, drejtoritë rajonale arsimore, shoqëritë civile, komunitetet etj.
Pushtetet vendore për të realizuar mbrojtjen e	Programimi i ndihmës ekonomike nuk është

të drejtave të fëmijëve, kanë marrë përsipër krijimin e institucioneve të tilla si Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve në rangje lokale.	bazuar në testimin e mjeteve për jetesë.
Hartimi i projekt buxheteve nga sektorët e programimit social të quajtura “fonde sociale” për t’u ardhur në ndihmë familjeve në nevojë në drejtim të arsimit të detyruar të fëmijëve të tyre.	Në kriteret specifike që njesitë vendore aplikojnë për përfitimin e ndihmës ekonomike, nuk përbëjnë kriter më vete familjet, fëmijët e të cilave, vazhdojnë arsimin e detyrueshëm shkollor.
Vendosja e psikologut shkollor dhe e personave të kontaktit në shkolla mundëson nxjerrjen në pah të problematikave dhe parandalimin e braktisjes së shkollës.	Pushteti lokal bazuar në ligjin për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, duhet të bëjë alokimin e fondeve për fëmijët. Por si do të bëhet kjo kur mungojnë të dhënat dhe problematikat?
Krijimi i një mundësie të dytë, e quajtur ndryshe “shansi i dytë”, i ka dhënë mundësinë për të mësuar mjaft fëmijëve, që nuk kanë qenë asnjeherë të regjistruar në shkollë ose e kanë braktisur atë.	Mungojnë të dhënat ekspertizë, për të ndërtuar një buxhet efikas kryesisht në drejtim të arsimit.
Politikat sociale po orientohen drejt suportit të pjesës më vulnerabël të popullsisë, duke u bazuar tek nevojat më themelore të grupeve në nevojë, duke reduktuar në masë të ndjeshme numrin e familjeve parazitare apo që nuk e meritojnë dhe duke bërë të mundur rritjen e suportit për familjet që janë realisht në nevojë.	Në shumëllojshmërinë e zërave përbërës të një buxheti, mungon zëri që do të bënte të mundur mbulimin në menyrë të konsiderueshme të njëpjesë nevojash për arsimim të kësaj kategorie fëmijësh.
Ka ndryshime në drejtim të burimeve të financimit të politikave sociale. Në pamundësi të financimit të politikave sociale përmes buxhetit të shtetit, është marrë në konsideratë rruga bashkefinansimit siç janë projektet e përbashkëta me OJF, në funksion të edukimit të fëmijëve të shtresave në nevojë.	Ndihma ekonomike u jepet familjeve pa asnjë lloj kushti, si p.sh ofrimi i ndihmës kundrejt arsimit të fëmijëve.
Njësitë e qeverisjes vendore kanë hapesirat e nevojshme ligjore edhe për të mbështetur familjet e varfra me burime nga buxhetet e taksave lokale, duke caktuar kriteret specifike.	Nuk përdoret një pjesë e asistencës sociale si nxitës me mjaft efikasitet, për të realizuar përmirësimin cilësor të shkollimit të shtresave të marginalizuara.

	Shkolla nuk përmbush përgjegjësitë ligjore përkundrejt këtij kontigjenti fëmijësh, këtu vërejmë: a) moskoordinim të mirë të punës shkollë- DRA b) mosraportim nga drejtoritë e shkollave të situatës reale të braktisjes c) mosnjohje të përgjegjësiave në dy nivele DRA- drejtori shkollash d) roli i psikologut kundrejt kësaj kategorie fëmijësh lë për të dëshiruar e) në shkolla ka diskriminim për arsye, etnie kulturore apo gjendjes social-ekonomike ë) shkolla nuk ofron aktivitete kulturore për menaxhimin e kohës së lirë të nxënësve, dhe për krijimin e një mjedisi nxitës i marrëdhënieve pozitive mësues-nxënës, nxënës-nxënës. f) kjo kategori nxënësish, përveç etiketimit negative, nuk merr suportin e duhur nga mësuesit. g) mungon një paketë nënligjore me të cilën politika të caktuara sociale do të harmonizoheshin dhe do të ndikonin në mbështetjen dhe realizimin në praktikë, të një arsimimi më cilësor të shtresave në nevojë
--	---

Nisur nga sa thamë më lart kemi arritur në përfundimet e mëposhtme:

- Realizimi i parimit “arsim për të gjithë” në mjaft raste ndesh një sërë pengesash, të cilat janë shpesh të vështira për tu kapërcyer, ndër të cilat mendojmë se pengesa kryesore është varfëria. Familjet me të ardhura të ulta, megjithëse e dëshirojnë shkollimin, hezitojnë ti dërgojnë fëmijët e tyre në shkollë për shkak të kostos direkte të shkollimit.
- Në vendin tonë nuk janë vënë në jetë politika të ndryshme të lehtësimit financiar të familjeve të varfra, me kushtin që fëmijët e tyre të ndjekin shkollën
- Organizatat dhe donatorët e huaj kanë sjellë përvojën e tyre në harmonizimin e politikave sociale me ato arsimore, duke sjellë dëshmi të përmirësimeve në ndjekjen e shkollës nga fëmijët e familjeve të varfra.
- Deri më sot nuk është ideuar ndonjë formë e ndihmës ekonomike ndaj familjeve në nevojë posaçërisht për të vënë në jetë parimin e “arsimit për të gjithë”

- Megjithë përmirësimet të treguesve të ndjekjes së shkollës, ka një pabarazi të ndjeshme në përfitimet arsimore ndërmjet familjeve me të ardhura të ndryshme.

Nëse do t'i referoheshim secilës prej hipotezave të parashtruara qysh në fillim të punimit mund të themi se:

- Hipoteza e parë: Shkolla shqiptare nuk arrin plotësisht synimin arsimim për të gjithë, i cili i jep mundësinë çdo nxënësi të përparojë në varësi të aftësive që disponon, vërtetohet plotësisht
- Hipoteza e dytë: Shkolla nuk merr parasysh nevojat, kapacitetet dhe aftësitë e fëmijëve të komunitetit rom, gjithashtu vërtetohet
- Hipoteza e tretë: Në vendin tonë nuk mund të flitet deri tani për harmonizim të mirëfilltë të politikave sociale me politikat arsimore, vërtetohet

Rekomandime:

Ky studim ka si qëllim edukimin cilësor të fëmijëve të komunitetit rom. Përgjatë gjithë studimit janë evidentuar një sërë vështirësish, që pengojnë këta fëmijë për të pasur akses normal në arsimin e detyruar. Institucionet dhe strukturat përgjegjëse duhet t'i marrin seriozisht në konsideratë këto pengesa, me qëllim që të krijojnë mundësi reale në dobi të përmirësimit të situatës. Duke qenë se edukimi publik maxhoritar nuk është aspak sinkron me edukimin tradicional rom, jemi përpjekur të rekomandojmë politika të natyrës institucionale:

- Qeveria Shqiptare duhet të sigurojë mbështetje buxhetore për minoritetin rom në Shqipëri, që në fazën e planifikimit të buxhetit.
- Gjatë hartimit të politikave për arsimimin e romëve, duhet të specifikohen masa konkrete për realizimin e shanseve të barabarta në edukim. Këto politika duhet të përfshijnë strukturat apo grupet që ndikohen nga procesi i edukimit, siç janë prindërit dhe fëmijët romë, administratat e shkollave dhe mësuesit, autoritetet vendore, shoqëritë civile, komunitetin jo rom, që jeton në të njëjtat zona etj.
- Në nivel qendror duhet të ketë buxhete të ndara, të detajuara për fëmijët. Këto buxhete duhet të hartohen në bazë të nevojave dhe të jenë të specifikuara në programet për fëmijë, madje të ketë dhe një institucion përgjegjës për këtë.

- Krijimin e një pakete nënligjore me të cilën politika të caktuara sociale, do të harmonizoheshin dhe do të ndikonin në mbështetjen dhe realizimin në praktike të arsimimit cilësor të fëmijëve të komunitetit Rom.
- Zbatim të politikave “të alternuara”(pozitive,shtrënguese), në harmonizimin social arsimor, që do të thotë shtim të ndihmës ekonomike, ose pakësim të saj për familjet që janë në skemën e ndihmës ekonomike dhe që kanë fëmijët e tyre në moshën e ndjekjes së arsimit nëntë-vjeçar.
- Bashkëpunimi ndërmjet aktorëve me fokus fëmijët romë, si institucione qendrore, lokale, të shoqërisë civile, të donatoreve, etj, do të ishte shumë i rëndësishëm në hartimin e buxheteve.
- Kthimi në kriter specifik për përfitimin e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë, të pasurit e fëmijëve në moshën e arsimit të detyrueshëm.
- Klasifikimi me saktësi i të gjitha shkaqeve kryesore që i detyrojnë fëmijët romë të braktisin shkollën.
- Organizimi i sesioneve parandaluese në shkolla pasi këto sesione
 - i krijojnë mundësi fëmijës të njohë rreziqet që paraqet rruga dhe kushtet e tyre të punësimit (nëse janë fëmijë që punojnë).
 - ndikojnë në ngritjen e partneriteteve të vogla midis ekipeve sociale dhe atyre të shkollës. Çdo shkollë ka projektin e vet pedagogjik ku gjate vitit shkollor parashikohen aktivitete jashtëshkollore (ekskursione, ndeshje). Fatkeqësisht keto veprimtari shpesh nuk realizohen për mungesë financimi. Partneriteti me OJF-të mund t'i bënte ato të mundshme e të larmishme.
- Bazuar ne sloganin “arsimi falas për të gjithë fëmijët”, duhet realizuar afrimi me shkollën i fëmijëve që vijnë nga familje në vështirësi ekonomike, përmes përcaktimit të një skeme të ndihmës financiare.
- Gjendja e tanishme e defavorizimit arsimor të fëmijëve të komunitetit rom, shtron nevojën e marrjes së vendimeve qeveritare adekuate, pra të përzgjidhen dhe te zbatohen ato politika që kanë sjellë sukses në vende te tjera.
- Procesi i decentralizimit të shërbimeve sociale nga pushteti qendror në pushtetin lokal, kërkon krijimin e një sistemi grumbullimi të dhënash për ndarjen e fondeve sipas nevojave.

- Pjesëmarrja në vendimmarrje e romëve është mjaft e rëndësishme. Ndonëse përfaqësues nga minoriteti rom janë përfshirë në draftin e politikave që adresojnë problemet e tyre, ata nuk konsiderohen si aktorë kyç në vendimmarrjen mbi këto politika.
- Shkolla duhet të bëjë një punë të madhe, për të krijuar një ambient tërheqës e të dashur për fëmijët. Mësuesi duhet të jetë i pari që duhet ta kuptojë rolin e tij vendimtar në jetën e një fëmije. Ai duhet t'i zgjasë dorën një fëmije që nuk është fajtor se vjen nga një familje e varfër apo me nivel të ulët kulturor dh që prindërit e tij nuk interesohen për të, apo që ka vështirësi në të nxënë.
- Organizimin e trajnimeve të vazhdueshme të mësuesve, të cilat nuk duhet të trajtojnë vetëm fenomenin e braktisjes shkollore, por edhe mënyrës së tyre të komportimit me fëmijët e komuniteteve, me qëllim krijimin e marrëdhënieve të shëndosha me nxënësit.
- Kurrikula shkollore duhet të ndryshojë në mënyrë që t'u mundësojë të gjithë nxënësve njohuritë bazike për historinë, kulturën apo traditat e komunitetit rom. Për këtë qëllim, ka rëndësi zbatimi i programeve që mbështesin multikulturalizmin në shkolla. Gjithashtu është e rekomandueshme, përfshirja në kurrikulën shkollore e lëndëve specifike që trajtojnë anti-paragjykimin dhe mos përjashtimin.
- Politikat arsimore duhet të përdorin instrumente për të ruajtur ekuilibrat etnike, kryesisht në shkolla që ndodhen pranë vendbanimeve të pakicave etnike rome. Për të arritur këtë është e rekomandueshme që në këto shkolla, të ruhet raporti fëmijë rom dhe jorom sipas raportit të popullatës rome dhe jorome në shkollë. Shkollat me numër të madh fëmijësh romë nuk duhet të lejojnë fëmijë të tjerë romë të regjistrohen në to, sikurse shkollat me numër të madh fëmijësh joromë duhet të regjistrojnë gjithnjë e më shumë fëmijë romë me qëllimin vendosjen e ekuilibrave midis fëmijëve romë dhe joromë. Kjo politikë mund të realizohet vetëm me transparencë dhe gjithëpërfshirjen e prindërve romë dhe joromë.
- Duhet të përcaktohen objektiva të qarta lidhur me edukimin e fëmijëve të komunitetit rom si dhe të bëhen përpjekje për të monitoruar shkallën e tyre të të nxënit.
- Objektivat lidhur me edukimin e romëve krahas objektivave të tjera të shpallura në Planin e Veprimit 2015-2020, duhet të trajtohen njëkohësisht dhe në mënyrë të integruar. Eksperienca e vendeve të tjera në rajon tregon se vetëm në këtë mënyrë garantohet efektiviteti i strategjisë. Plani i Veprimit të gjithashtu duhet të pasqyrojë elementë të rinj që reflektojnë marrjen parasysh të problemeve të hasura në “ Strategjinë Kombëtare për

Përmirësimin e Kushteve të Jetesës së Minoritetit Rom”. Përpos kësaj është shumë e rëndësishme që të përcaktohen treguesit e progresit për ndjekjen e objektivave nga të gjithë aktorët në nivel qendror dhe në nivel lokal

Drejtoritë Arsimore Rajonale ndodhen përballë sfidave të mëdha, në procesin e gjatë dhe të vështirë të arsimit cilësor të fëmijëve romë. Për këtë arsye mendojmë se rekomandimet e mëposhtme duhet të merren në konsideratë prej tyre:

- DAR – të duhet të jetë më shumë në rolin e suportuesit se sa të kontrolluesit, veçanërisht për procesin e arsimit të fëmijëve romë.
- Ata duhet të kenë prioritet të punës edukimin parashkollor të fëmijëve romë, pasi kjo do të ndihmonte procesin. Faktet flasin që kur fëmijët romë kanë frekuentuar kopshtin kanë pasur rezultate të mira në shkollë.
- Të zbatohet ligji për arsimin e detyrueshëm, pra masa shtrënguese për prindërit që nuk i dërgojnë fëmijët në shkollë.
- Të vazhdoje puna sensibilizuese dhe ndërgjegjësuere me prindërit dhe mësuesit, pasi ka diskriminim të fëmijëve romë në shkollat shtetërore nga këta të fundit.
- Të motivohen mësuesit që punojnë me fëmijët romë.
- Të ketë më shumë bursa e programe mbështetëse për t’u përqasur me natyrën, kulturën temperamentin që kanë fëmijët romë, pasi shkollat tona nuk ofrojnë asnjë argëtim për këta fëmijë dhe kjo gjë shpesh kthehet në një nga shkaqet e braktisjes së shkollës, duke pasur parasysh temperamentin e tyre.

Nga ana tjetër edhe vetë komuniteti rom ka sfidat e tij, ku më kryesorja është ndjesia e të qenit inferior. Këtë ndjenjë inferioriteti e kemi parë jo vetëm tek fëmijët por edhe tek prindërit e tyre. Shpesh vetë prindërit na thonin: “ne nuk bëhemi mos u lodhni kot” Në këtë prizëm duke pasur një vetëvlerësim të ulët për veten ata përqasin më shumë punën, më mirë të kenë sot për sot, sesa të nxënë të do t’iu vlejë për të ardhmen. Për këtë arsye mendojmë se rekomandimet e mëposhtme për këtë komunitet janë të vlefshme:

- Të kuptojnë rëndësinë e arsimit, pasi ndodh që edhe nxënës që janë të mirë dhe përparojnë kënaqshëm, në një moment të caktuar tërhiqen nga shkolla pa asnjë shkak. Këtë mund ta quajmë si “fenomenin e rrymës”, tërhiqen nga rryma, pra edhe ata bëjnë si

bashkëmoshatarët e tyre pa ndonjë arsye të fortë. Në përgjithësi kanë zbehje të shpejtë të dëshirës për të vazhduar, lodhen shpejt dhe tërhiqen.

- Komuniteti Rom duhet të minimizojë sa më shumë diskriminimin brenda llojit.
- Komuniteti Rom duhet të kuptojë rëndësinë e arsimimit cilësor si e vetmja rrugë për të dalë nga situatë ku ndodhen. Vetëm arsimimi cilësor do të mund t'i pajisë fëmijët romë me shprehitë e munguara, mjaft të domosdoshme për jetën dhe integrimin në shoqëri.

Bibliografia

Acedo, C. (2008). Inclusive education: pushing the boundaries. Prospects, 38

Abdikeeva, A., MRG Partners: (Sept. 2005) “Roma Poverty and the Roma National Strategies: The Case of Albania, Greece and Serbia”

Albana Markja, Evis Mastori, Irida Sina “Udhëzues për shkollat qendër komunitare, një shkollë miqësore për të gjithë”, Tiranë 2014.

Bërxolli., A Atlasi Gjeografik i popullsisë së Shqipërisë, Struktura etnike dhe fetare, Tiranë 2003

Browlie., I (2009). Basic Documents in International Law. Oxford University Press

Benson., P.L.2003 Development assets and Asset-Building Community: Conceptual and Empirical Foundations. New-York: Kluwer/Academic Publishers

Bitu. Nand Morteau.C (2010), Are the Rights of the Child Negotiable? The Case of Early Marriages within Roma Communities in Romania, Bucharest, ISBN 978-973-139-143-4

Bashkia Korçë., “Plani ndërvendor për zhvillimin e komuniteteve rome dhe egjiptiane” 2014-2020

Bashkia Berat., “Plani ndërvendor për zhvillimin e komuniteteve rome dhe egjiptiane” 2014-2020

Byroja e zhvillimit të arsimit, Shkup, 2009.DORACAK për arsim për shkathtësi jetësore: prej klasës IV-VI të shkollës fillore/doracakun e përgatitën: Filipina Negrievs etj, nën udhëheqje të Violeta Petroska – Beshka.

Claveria, J.V. & Alonso, J.G. (2003) Why Roma do not Like Mainstream schools: Voice of People Without Territory, in Harvard Educational Review, Vol. 73, Nr.4

Cohen, L., Manion, L., & Morrison, K. (2007) Research Methods in Education, 6th ed. London: Routledge Falmer

Catherine Marshall, Gretchen B. Rossman, Designing Qualitative Research, Copyrighted Material, 1999

Çështje të arsimit të fëmijëve të komunitetit rom”. Studim krahasues. Fshati Drizë dhe Baltëz, Fier. 2013

David Crowe, John Kolsti, Albanian Gypsies: The Silent Survivors, in Crowe and Kolsti eds., The Gypsies in Eastern Europe, (Armonk, New York: Sharpe, 1991

Dokumenti i OKB E/CN4/Sub2/399 10, miratuar më 31 gusht 1977

Drafti i 26 gushtit 1977, dokument E/CN4/Sub2/L.670

Gëdeshi, I, Miluka, “ Studim për vlerësimin e nevojave të komuniteteve rome dhe egjiptiane në Shqipëri”, Tiranë 2012

Delors, J., ‘Zhvillimi i arsimit të shekullit të XXI’, Zagreb, 1999

Doebbler, C. (2007). Introduction to International Human Rights Law. CD Publishing, Washington, DC, USA. Fq. 103-106

Dekada e Përfshirjes së Romëve. Plani Kombëtar i Veprimit 2010-2015. Tiranë 2011

De Soto H., S. Beddies, dhe I. Gedeshi “Romët dhe Egjiptianët në Shqipëri: Nga përjashtimi social në përfshirjen sociale”, Banka Botërore, Washington D.C. 2005

ERRC., “ Një rast i panjohur, romët në Shqipëri”. 1997.

Edward., F. Fern, The Use of Focus Groups for Idea Generation: The Effects of Group Size, Acquaintanceship, and Moderator on Response Quantity and Quality”, Journal of Marketing Research, February, 1982, fq. 3.

European Commission Directorate-General for Employment, Social Affairs and Equal Opportunities September 2008, SOCIAL INCLUSION AND SOCIAL PROTECTION IN ALBANIA PËRMBLEDHJE

FPGSH (Forumi i Pavarur i Gruas Shqiptare).Raport: “Mbi situatën e romëve që jetojnë e punojnë në vendshkarkimin e mbeturinave në Sharrë”.

Flecha, R. (1999) Modern and Post modern Racism in Europe: Dialogic Approach and anti-racist pedagogies, Harvard Educational review, Nr. 69.

Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, Tiranë 2012

Fatmira Zenelaj Diana Bajrami Biologji, Libër mësuesi 7-8-9, Albas, Tiranë 2008

Feyerabend, P. (1993). Against the method, New York: Verso

Florian Kulla, Lidra Remaçka, Marina Ndrio, “Jam mes jush, i ngjashëm, i ndryshëm, i barabartë”, Tiranë, 2014, fq 20

Frank I. Luntz, The Makings a Good Focus Group, Voice of Victory Pjesa II, 16 maj dhe 30 maj, 1994, The Polling Report, SHBA.

Gardner, H. (2003): “Mendja e pashkolluar. Çfarë duhet duhet të kuptojne nxënësit”, Instituti i Studimeve Pedagogjike, Tiranë 2003.

Gombert Tobias et al. Bazat e Demokracisë Sociale Botuar nga Fondacioni Friedrich Ebert Akademia për Demokraci Sociale Bonn, dhjetor 2009. Tiranë, janar 2013.

Hariss, O’Boyle & Warbrick. (2009). Law of the European Convention on Human Rights. Oxford University Press. Second Edition.

Hamilton., S.F, Hamilton., M.A. et Pittman, K (2004) Principles for youth development. Tek S.F.

Hamilton et M.A. Hamilton (Eds). *The youth development handbook: coming of age in American Communities* Thousand Oaks, CA: Sage.

Hitendra Pillay, Alda Duraj, “Duke mbështetur edukimin përfshirës për fëmijët në nevojë me artikulumin e nismave për EEE-P dhe EFA”. Draft Raport - qershor 2007.

Habermas.,J. (1981). The theory of communicative action, vol. 1: Reasons and the rationalization of society. Boston: Beacon Press.

Iniesta., A. (1981) Los Gitanos: Problemas socioeducativos. Madrid: Narcea.

Kulla F, Remaçka L, Ndrio M, “Jam mes jush, i ngjashëm, i ndryshëm, i barabartë”, Tiranë, 2014

Korniza kurikulare e arsimit parauniversitar të Republikës së Shqipërisë, Tiranë 2014.

Këshilli i Ministrave Nr.633, Fletorja Zyrtare, 18 Shtator 2003.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Tiranë 2009

Kende, A. “ The Hungary of otherness: The Roma (Gypsies) of Hungary, Journal of European Area Studies”, 8. 2000

Luis Cohen, Lawrence Manion, Keith Morrison, Research Methods in Education, Routledge, 2007.

Liégeois (2007)., ”Romët në Evropë”

Lodico, M. G. Spaulding D.T. and Voegtle, H. V. Methods in Educational Research: from theory to practice. San Francisco, CA: Jossey-Bass, 2006.

Leci ., E, “Marrëdhëniet dhe integrimi i romëve në jetën shqiptare”, botim i Qendrës Shqiptare për të Drejtat e Njeriut. Tiranë, 2001.

Maria Koinova, Minorities in Southeast Europe: Roma of Albania, Center for Documentation and Information on Minorities in Europe - Southeast Europe (CEDIME), 2000.

Musliu., A “Sistemi i të drejtave të njeriut”. Tetovë 2012

Mac Donald, G.B., et Valdivieso., R Measuring deficits and assets: how we track youth development now and how you should track it. Tek youth Development: issues, challenges and directions. Philadelphia, PA: Public/Private Ventures, 2000.

Michailakis, D. & Reich, W. Dilemmas of inclusive education. ALTER, European Journal of Disability Research, 2009.

Ministria Arsimit dhe Shkencës, “Program i Qytetarisë” klasat 1 dhe 6, Tiranë 2014.

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit. Udhëzim nr, 16, dt 03.08.2016, “ Për vitin shkollor 2015-2017, në sistemin arsimor parauniversitar”.

Mac Laughlin.,J. (1999) European Gypsies and the historical geography of loathing, Washington Review

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve. “MARTESAT E HERSHME NË SHQIPËRI”. Një vështrim Specifik i Komunitetit Rom. Mbeshtetur nga Fondi Kanadez për Iniciativat Lokale ISBN: 978-9928-114-53-2 Printuar nga: Shtypshkronja “Natyra”, 2015.

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve Raport studimor “Situata e fëmijëve rom” për vitin 2012 - Qarku Fier, Eksperte Rajonale Eridjona Kica, Prill 2014.

Pakicat dhe mbrojtja e të drejtave të tyre në Shqipëri. Libër i realizuar me mbështetjen e Këshillit të Europës, i cili përmban konventa, legjislacion, raporte dhe materiale shpjeguese mbi pakicat kombëtare, 2003

Prekshmeria shoqërore e romëve në Shqipëri”, UNDP 2006

Plani Kombëtar i Veprimit për integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e

Shqipërisë, 2016-2020, Tiranë 2015

Projekt i Këshillit të Europës, për Edukimin e Fëmijëve Romë në Evropë, (Romët/Histori)

Lëvizja “Romani”, [1971]

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC)., Arsimi bazik cilësor në funksion të zhvillimit njerëzor, raport humultues, Prishtinë, 2006

Ringold D., Orenstein A. M., Wilkens E., Roma in an Expanding Europe: Breaking the Poverty Cycle, A World Bank Study, Washington D.C, 2003

Resolution 1992/65, “Protection of Roma (gypsies)”, 4 mars 1992

Rezoluta 249 (1993) mbi Ciganët në Europë: Roli dhe Përgjegjësia e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale. Konferenca e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Europës, 18. 03.,1993

Raport mbi të Drejtat e Romëve dhe të Komuniteteve Shtegtare në Europë, 2012

“Reforma e sistemit arsimor”, Raporti paraprak, 2014

Ritchie J, Lewis J. (2003) Qualitative research practice.

Richard A. Krueger, Focus Groups: A Practical Guide for Applied Research, Sage, 1994

Sandro Costarelli, Children of Minorities: Gypsies, Innocenti, Insights, UNICEF, International Children Development Center, Firenze, 1993

Smith, Rh., Textbook on International Human Rights Law. Oxford University Press, 4th Edition, 2010

Scot W. Vanderstoep, Deirdre D. Johnston, Research Methods for Real Life: Blending Qualitative and Quantitative Approaches, Jossey Bass, San Francisco, 2009

Shefki Lika., Panoramë sociale për Qarkun e Elbasanit. 2008

Terre des hommes “ Komunitet mbështetës, familje bashkëpunuese, fëmijë të mbrojtur”. Tiranë 2012

United Nations Development Programme in Albania, At Risk: The Social Vulnerability of Roma in Albania “Në rrezik: Prekshmëria Shoqërore e Romëve në Shqipëri”, Tiranë: UNDP Albania, 2006

Unicef (2011) Press Release: Albanian youth call for more investments in adolescents as way to break down cycles of poverty and inequity.

Glasgow L.K., Dornbusch, S.M., Troyer, L., Sreiner, L., & Ritter P.L. “ Parenting Styles”, adolescents’ attributions and educational outcomes in nine heterogeneous high schools” *Child development.*, 1997

Burime interneti

www.coe.int/rom. Këshilli i Evropës, Mbrojta e të Drejtave të Romëve.

<http://psychclassics.yorku.ca/Maslow/motivation.html>). Maslow, A.H.(1943) A theory of Human Motivation. *Psychological Review*, 50, f. 370.

<http://www.unicef.org/albania/media.html> Unicef (2011) Press Release: Albanian youth call for more investments in adolescents as way to break down cycles of poverty and inequity [http](http://www.unicef.org/albania/media.html)

<http://diskriminimi.org/default#!singlearticle-view/20151205-001>

<http://www.arsimi.gov.al/al/arsimi/shkolla>

<http://shtetiweb.org/politikat-sociale-2/>

Shtojca

1. Intervista gjysmë të strukturuar me mësues dhe drejtorë të shkollave 9-vjeçare

Shkolla _____

Qyteti _____

Fshati _____

Kodi i intervistës: _____

Emri dhe mbiemri i të intervistuarit: _____

Data: ____/____/____/

Pyetjet

1) A keni marrë pjesë në ndonjë trajnim mbi kulturën, traditën dhe historinë rome?

- Kush i ka organizuar ato
- Ç'përmbajtje kishin këto trajnime

2) A e dini sa është numri i përgjithshëm i nxënësve në shkollën tuaj dhe sa prej tyre janë romë?

3) Cila është përbërja racore dhe etnike e klasave ku ju jepni mësim?

- A shoqërohen nxënësit me njeri-tjetrin pavarësisht nga përbërja racore e tyre?

4) Cila është ecuria e nxënësve romë krahasuar me atë të nxënësve të tjerë në klasat ku ju keni dhënë mësim apo jepni mësim?

5) Cili është mendimi juaj për kushtet e mësimdhënies në klasat ku ju keni dhënë mësim dhe në përgjithësi në shkollën tuaj?

- A ndikojnë këto kushte në ecurinë e mësimdhënies?

6) A ka mësues romë në përbërjen e stafit mësimor të shkollës tuaj?

7) A organizohen shkolla verore në shkollën tuaj?

- Nëse po a marrin pjesë nxënës romë në to? dhe jo rom?
- Nëse po, si ka qene ecuria e tyre?

8) A janë përfshirë në tekstet shkollore tema që trajtojnë kulturën, traditën dhe zakonet rome.

- Nëse po, a ndikon ky faktor në ecurinë në mësim të nxënësve romë.
- Nëse jo, a ndikon ky faktor në ecurinë në mësim të nxënësve romë.

9) Keni vënë re ndryshime në veshje dhe pajisje mësimore midis fëmijëve romë dhe jo romë?

- A i ka dhënë zgjidhje shkolla këtyre problemeve?
- A ndikon ky faktor në ecurinë e tyre në mësim?

10) A keni vështirësi me nxënësit romë si rezultat i mungesave dhe vështirësive që kanë me gjuhën shqipe?

- A egzistojnë kurse ndihmëse për mësimin e gjuhës shqipe për këta nxënës?

11) Braktisja e shkollës dominohet më shumë nga djemtë apo vajzat rome?

12) Cilat janë vështirësitë që fëmijët romë hasin në edukim për shkak të diferencave kulturore që ata paraqesin?

13) A kanë diferenca në shprehi dhe aftësi midis nxënësve romë dhe atyre të shumicës?

- Nëse po cilat janë shkaqet sipas jush

14) A përdoren forma ndëshkuese nga mësuesit e shkollës tuaj kundrejt nxënësve që kanë probleme në mësim në përgjithësi dhe atyre rom në veçanti?

- Pyetje rreth marrëdhënies mësues- nxënës, prindër romë

15) Cilët janë faktorët më të rëndësishëm, që ndikojnë në vështirësitë që hasin nxënësit romë në edukim?

16) Si paraqitet komunikimi me prindërit romë në shkollën tuaj?

- Ç'forma komunikimi përdorni me prindërit e nxënësve romë që hasin vështirësi të mëdha në mësim?
- Si bashkëpunoni me ta për të kapërcyer këto vështirësi?

17) Niveli arsimor i prindërve romë, sipas jush, përbën problem shqetësues për mbarëvajtjen në mësimet e fëmijëve të tyre?

- Si veproni për të ndihmuar nxënësit romë në raste të tilla?

18) Cilat janë nevojat, dëshirat dhe kapacitetet e nxënësve romë?

- Arsimimi i tyre i përgjigjet këtyre nevojave, dëshirave dhe kapaciteteve?

19) A ka punonjës social në shkollën tuaj dhe cila është marrëdhënia e tij me nxënësit e komunitetit rom?

2. Intervista gjysmë të strukturuar me mësues të “shansit të dytë”

Shkolla _____

Qyteti _____

Fshati _____

Kodi i intervistës: _____

Emri dhe mbiemri i të intervistuarit: _____

Data: ____/____/____/

Pyetjet

- 1) A mund të na sqaroni mbi funksionimin e klasës së “shansit të dytë”
- 2) Aktualisht sa fëmijë nga komuniteti Rom frekuentojnë klasat e shansit të dytë?
- 3) Cilat janë rrugët që ju ndiqni për përfshirjen e tyre në shkollë?
- 4) Sipas mendimit tuaj, a janë të interesuar romët për tu arsimuar?
- 5) Si është gjendja e tyre social-ekonomike?
- 6) A organizoni ju aktivitete dhe a përfshihen fëmijët e komunitetit rom në to?
- 7) Sipas jush cilat janë sfidat e komunitetit Rom?

3. Intervista gjysmë të strukturuar me prindër romë

Qyteti _____

Fshati _____

Kodi i intervistës: _____

Emri dhe mbiemri i të intervistuarit: _____

Data: ____/____/____/

Pyetjet

1. A keni shkollë në zonën tuaj?
 2. A shkojnë në shkollë fëmijët tuaj?
 3. Si janë kushtet e shkollave sipas mendimit tuaj? Ç'mendim keni për stafin? Mësuesit?
 4. A i merrni librat falas fëmijët tuaj apo paguani për to?
 5. A shkon shpesh në shkollë në takime me mësuesit? Si ju presin ato?
 6. A janë fëmijët tuaj pjesëmarrës në aktivitete të ndryshme që zhvillohen në shkollë? Cilat?
 7. A zhvillon biseda me përfaqësues të DAR?
- Cilat janë bisedat apo tematika e tyre?
- A keni diskutuar ndonjëherë rreth rëndësisë që ka ndjekja e shkollës?
8. A organizohen shkolla verore nga institucionet arsimore për fëmijët tuaj? Çfarë mësojnë në to?

4. Intervista gjysmë të strukturuar me lider informalë romë

Z _____

Qyteti _____

Fshati _____

Kodi i intervistës: _____

Emri dhe mbiemri i të intervistuarit: _____

Data: ____/____/____/

Pyetjet

1) Cilat janë format e informimit dhe komunikimit që përdorni me drejtorët dhe mësuesit për vështirësitë që hasin nxënësit romë në shkollë?

2) Si e organizoni bashkëpunimin me liderë të tjerë romë apo organizata jo-fitimprurëse rome dhe jorome për të kapërcyer vështirësitë që hasin nxënësit romë në edukim?

3) A organizohen takime nga Ministria apo Drejtoritë Arsimore Rajonale me liderë, organizata jofitimprurëse rome apo drejtues shkollash për njohjen dhe zbatimin e strategjisë kombëtare për romët?

4) A keni marrë masa ju si komunitet për zbatimin e kësaj strategjie?

- Çfarë masash konkretisht?

Pyetje për vështirësitë që hasin fëmijët rom në edukim, varfërinë, politikat sociale, politikat arsimore

1) A keni të dhëna për numrin e familjeve rome që jetojnë në varfëri ekstreme?

- Si janë kushtet e tyre të jetesës?

2) A keni të dhëna mbi numrin e fëmijëve rom që kanë braktisur shkollën për shkak të varfërisë?

- Sa prej këtyre fëmijëve janë detyruar nga familjet e tyre të punojnë dhe kryesisht çfarë punësh bëjnë ata?

3) A ka prindër romë që kanë emigruar?

- Nëse po, në përgjithësi këta prindër i marrin fëmijët me vete, apo i lënë me të afërmit e tyre?

4) A hasin vështirësi fëmijët e komunitetit tuaj për t'u regjistruar në shkollë? Çfarë vështirësish?

5) A dini raste ku fëmijët romë janë keqtrajtuar nga nxënësit e tjerë dhe mësuesit?

- A ka braktisje të shkollës për këtë arsye?
- A e keni ngritur zërin ju si komunitet për të ndaluar këto dukuri?

6) Si shfaqet racizmi dhe diskriminimi kundrejt nxënësve romë dhe në tërësi kundrejt komunitetit tuaj? Pyetje mbi kulturën, gjuhën dhe traditat romë.

7) Mungesa e njohurisë së gjuhës shqipe nga fëmijët romë, a përbën pengesë në ecurinë e tyre në shkollë?

- Çfarë është bërë për ta kaluar këtë vështirësi?

8) Çfarë barrierash të tjera ekzistojnë në nivelin e ulët arsimor të nxënësve romë si rrjedhojë e ndryshimeve kulturore që paraqesin këta nxënës?

- Ndryshime në mënyrën se si janë rritur?
- Ndryshime në mënyrën se si i perceptojnë dhe se si i kanë mësuar gjërat në jetë?

Pyetje mbi marrëdhëniet prindër-nxënës rom

1) Në komunitetin tuaj, a është problem shqetësues analfabetizmi i prindërve romë?

2) Si ndikon niveli i ulët arsimor i prindërve në edukimin e fëmijëve të tyre?

3) A janë organizuar në komunitetin tuaj takime prindër për të diskutuar rreth problemeve që fëmijët e tyre hasin në shkollë?

- Ç'forma janë përdorur për ndërgjegjësimin e këtyre prindërve, për ndihmesën që mund të japin për edukimin e fëmijëve të tyre?

4) A janë organizuar kurse analfabetizmi për fëmijët që kanë braktisur shkollën si dhe për prindër romë në komunitetin tuaj?

5. Intervista gjysmë të strukturuar me specialistë në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit dhe në Drejtoritë Arsimore Rajonale, rreth problemit të arsimimit të fëmijëve romë

Kodi i intervistës _____

Emri dhe mbiemri i të intervistuarit: _____

Data: ____/____/____/

Pyetje:

- 1) Si paraqitet niveli i frekuentimit të nxënësve romë të shkollave 9-vjeçare krahasuar nga ai i nxënësve të tjerë në këto shkolla?
- 2) A ka ndryshim midis performancës së fëmijëve romë dhe atyre joromë në shkollë?
- 3) A mund të na thoni diçka më konkrete në lidhje me ndikimin që ka niveli i varfërisë në ecurinë arsimore të nxënësve romë?
- 4) Përpos varfërisë cilat janë vështirësitë e tjera që hasin nxënësit romë në edukim të cilat ndikojnë në nivelin e ulët arsimor krahasuar me nxënësit e tjerë?
- 5) Cili është opinion juaj keni për cilësinë e mësimdhënies në shkollat 9-vjeçare pranë komuniteteve romë?
- 6) A ka shkolla në vendin tonë, ku numri i nxënësve romë është më i madh se ai i nxënësve në përgjithësi?
- 7) A ka ndodhur që nxënësit shqiptarë të largohen nga shkollat ku shumicën e përbëjnë nxënësit romë? Nëse po cilat janë shkaqet sipas mendimit tuaj?
- 8) Çfarë pengesash hasin nxënësit romë për regjistrimin në shkollë?
 - A e kanë ata dokumentacioni e duhur për tu regjistruar në shkolla?
 - A përbëjnë autoritetet shkollore pengesë në këtë drejtim dhe a janë marrë masa për kapërcimin e tyre?

- 9) A kanë njohuri mësuesit mbi traditën, historinë dhe kulturën rome
- 10) A kanë nxënësit romë vështirësi në kuptimin e gjuhës shqipe kur regjistrohen në shkollë?
- A përbën kjo një pengesë në ecurinë e tyre në mësim?
 - Çfarë ndihme i është dhënë për të përmirësuar njohuritë e tyre mbi gjuhën shqipe?
- 11) Sipas mendimit tuaj, çfarë vështirësish të tjera ndikojnë në edukimin e fëmijëve romë? Pyetje mbi politikat që ka ndërmarr Ministria e Arsimit për kapërcimin e këtyre vështirësive
- 12) A janë ndërtuar shkolla të reja apo rikonstruktuar shkollat ekzistuese të cilave u mungonin kushtet normale të mësimin në zonat e banuara nga komuniteti rom?
- 13) Cili është numri i shkollave 9-vjeçare pranë zonave të komunitetit rom, të cilat janë pajisur me bazën didaktike të nevojshme?
- 14) A janë vendosur sanksione nga Ministria e Arsimit dhe Sportit apo DAR-të ndaj prindërve romë, që refuzojnë të dërgojnë fëmijët e tyre në shkollë?
- 15) A përdoren stimuj nga Drejtoritë Arsimore Rajonale për mësuesit që punojnë me fëmijët romë?
- 16) Çfarë ndihme u kanë ofruar Drejtoritë Arsimore Rajonale fëmijëve romë të cilët kanë hasur vështirësi në blerjen e teksteve dhe mjeteve të tjera shkollore?
- 17) A janë organizuar kurse për gjuhën shqipe për fëmijët rom të cilët kanë pasur probleme në këtë drejtim? Në qoftë se po, çfarë avantazhesh kanë sjellë këto kurse?
- 18) A janë organizuar pranë këtyre shkollave kurse për eliminimin e analfabetizmit për fëmijët dhe të rinjtë romë që kanë braktisur shkollat? Në qoftë se po, si funksionojnë këto kurse?
- 19) A organizohen shkolla verore për nxënësit romë dhe joromë? Nëse po cili është rezultati i tyre?
- 20) A janë vendosur pranë shkollave psikologë dhe punonjës socialë?
- Në qoftë se po, çfarë ndihme u kanë ofruar ata fëmijëve romë që kanë probleme në edukim?

- 21) Çfarë ndihme u është ofruar familjeve të nxënësve romë me vështirësi financiare?
- 22) Cilat janë institucionet shtetërore dhe joshtetërore me të cilat ka bashkëpunuar Ministria e Arsimit dhe Sportit për edukimin cilësor të fëmijëve romë?
- 23) Çfarë pune është bërë me secilin prej këtyre institucioneve?

6. Intervista gjysmë të strukturuar me nxënës romë

Kodi i intervistës _____

Emri dhe mbiemri i të intervistuarit: _____

Data: ____/____/____/

Pyetje:

1) Përse disa nga shoket tuaj e braktisin shkollën?

2) A ju pëlqen shkolla?

- Nëse po përse?
- Nëse jo përse?

3) Cilat janë lëndët që ju pëlqeni më shumë dhe pse?

4) A ju ndihmojnë prindërit në përgatitjen e mësimëve?

5) A jeni njohur nga mësuesit me disa nga të drejtat e fëmijëve?

6) Nëse një i huaj do t'ju propozonte t'ju jepte para e plot gjëra të mira, do të shkonit pas tij qoftë edhe jashtë vendit tuaj?

- Nëse jo përse?
- Nëse po përse?